



SIGMA

Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
Iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, e financuar kryesisht nga BE

RISHIKIMI I PROKURIMEVE PUBLIKE DHE I SISTEMEVE TË MJETEVE EFEKTIVE LIGJORE NË BASHKIMIN EUROPIAN

DOKUMENTI I SIGMA-S NR. 41

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit - është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Europian (BE), financuar kryesisht nga BE.

Duke punuar në partneritet me vendet përfituese, Sigma mbështet qeverisjen e mirë përmes:

- vlerësimit të përparimit të reformave dhe identifikimit të përparësive bazuar në të dhëna bazë që pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe legjislacionin ekzistues të BE-së (the *acquis communautaire*);
- dhënies së ndihmës për vendimmarrësit dhe administratat në ndërtimin e institucioneve dhe të procedurave për realizimin e standardeve dhe praktikën e mirë europiane;
- lehtësimit të ndihmës nga BE dhe donatorë të tjerë brenda dhe jashtë Europës duke ndihmuar për hartimin e projekteve, garantimin e parakushteve dhe mbështetjen për zbatimin.

Në vitin 2007 Sigma po punon me vendet partnere që vijojnë:

- **Shtetet e reja anëtare të BE-së** - Bullgaria dhe Rumania
- **Vendet kandidatë të BE-së** Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia
- **Vendet e Ballkanit Perëndimor**- Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (shteti, federata e B&H dhe Republika Srpska), Mali i ZI, Serbia dhe Kosova (që qeveriset që në qershor 1999 nga UNMIK (Misioni i Përkohshëm Administrativ i OKB/UN Interim Administration Mission in Kosovo).
- **Ukraina** (aktivitetet e financuara nga Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar).

Programi SIGMA mbështet përpjekjet për reforma të vendeve partnere në fushat si më poshtë:

- Kuadri ligjor dhe administrativ, shërbimi civil dhe drejtësia, sistemi i integritetit publik
- Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP), auditimi i jashtëm, lufta kundër mashtrimit, menaxhimi i fondeve të BE-së
- Menaxhimi i shpenzimeve publike, sistemet e buxhetit dhe të thesarit
- Prokurimi publik
- Hartimi i politikave dhe koordinimi
- Normimi më i mirë.

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

Të drejtat e autorit: OECD, 2007

Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Public Procurement Review and Remedies Systems in the European Union*.

OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse të këtij materiali ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike rights@oecd.org.

PARATHËNIE

Një tenderues i pasuksesshëm që beson se procesi i prokurimit publik është kryer në shkelje të ligjeve përkatëse duhet të ketë akses në sistemin e rishikimit dhe të përfitimeve nga mjetet efektive ligjore. Procedurat e rishikimit të prokurimeve publike kanë si synim të ofrojnë mjete efektive për tenderuesit e dëmtuar. Synimi i këtij dokumenti është të japë një kuptim dhe të ofrojë një njohuri më të mirë të mënyrës sesi **shtetet anëtare të BE-së¹ e organizojnë sistemin e tyre të rishikimit të ankesave dhe të mjeteve efektive ligjore**. Ai përfshin një diskutim për arsyetimin për përzgjedhjen e modeleve të ndryshme. Shpresohet që ky dokument të stimulojë shtetet aktuale kandidatë dhe shtetet kandidatë në të ardhmen, shtete të tjera partnere të Sigmas, dhe shtetet anëtare të BE-së të marrin masa, aty ku është e nevojshme, që të përmirësojnë cilësinë e sistemeve të tyre të rishikimit dhe të dëmshpërblimit. Do t'i kushtohet një vëmendje e posaçme disponueshmërisë së mjeteve ligjore si pjesë e zbatimit të Direktivës së Komunitetit Europian 89/665 dhe Direktivës 92/13, si nga aspektet ligjore dhe nga ato institucionale. Për më tepër, dokumenti hedh dritë mbi kulturën e rishikimit dhe të dëmshpërblimeve dhe mbi përgatitjen e këtyre sistemeve në praktikë.

Në vitin 2000 Sigma botoi një dokument për *Procedurat e Rishikimit të Prokurimit Publik* (Dokumenti i Sigma-s nr 30), i cili u prit mirë dhe u vlerësua shumë nga shtetet kandidatë në punën e tyre për të krijuar organizime dhe procedura ankesash, rishikimesh, dhe dëmshpërblimesh në përputhje me rregullat përkatëse të Komunitetit. Duket se dokumenti është përdorur dhe si dokumentacion reference dhe si udhëzim për një cikël më të gjerë qeverish, duke përfshirë dhe shtetet e reja anëtare, në punën e tyre për krijimin e mekanizmave efektivë të ankimit. Gjithsesi, bazuar në dialogun e vijueshëm me shtetet partnere të Sigma-s, duket se fusha e rishikimit dhe dëmshpërblimeve mbetet ende shqetësimi kryesor për pjesën më të madhe të vendeve. Vendet kanë treguar interes në të mësuarit më shumë rreth mënyrës sesi shtetet e tjera i kanë organizuar sistemet e tyre të rishikimit dhe si kanë përdorur sisteme të caktuara rishikimi. Si rezultat, gjatë viteve të fundit, një ndër qëllimet parësore të bashkëpunimit të Sigma-s me shtetet partnere është ofrimi i ndihmës eksperte, kryerja e rishikimeve të vendeve dhe organizimi i konferencave dhe seminareve për këtë çështje.

Situata ka ndryshuar shumë që prej botimit në vitin 2000 të Dokumentit të Sigma-s nr 30, *Procedurat e Rishikimit të Prokurimit Publik*. Ndryshimet më të rëndësishme janë si më poshtë:

- Sfera e vendeve me interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sistemet e mjeteve efektive ligjore për prokurimet publike në BE është rritur dhe sot numëron rreth 40 shtete (shtetet anëtare të BE-së, shtetet e EEA-s (EFTA), shtetet kandidatë për në BE dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor).
- Disa vendime të reja të Gjykatës Europiane të Drejtësisë për çështjet e prokurimeve publike, në veçanti çështja *Alcatel*², kanë pasur shumë ndikim mbi procesin e rishikimit dhe trajtimit të ankesave në Shtetet Anëtare.
- Shtetet jo vetëm përpiqen të krijojnë procedura rishikimi që janë në përputhje me të drejtën e Komunitetit (të cilat më parë kanë qenë përparësia kryesore), por janë veçanërisht të interesuar, në kuadrin e përvojave të tyre, që ta bëjnë rishikimin më shpejt dhe më efektiv në praktikë nëpërmjet zhvillimit të strukturave më të përshtatshme dhe procedurave administrative. Shtetet Anëtare janë të lira të zgjedhin organizimin dhe procedurat për rishikim për aq kohë sa zbatohen të drejtat dhe masat korrigjuese në përputhje me Direktivat e BE-së. Kjo ka çuar në krijimin e një game të pasur mekanizmash rishikimi ndërmjet shteteve anëtarë, duke filluar që nga përdorimi i sistemit të gjykatës në të gjitha etapat e procesit të dhënies së kontratës deri në bazimin tek

¹ Duke pasur parasysh zgjerimin e afërt të Bashkimit Europian më 1 janar 2007, për qëllimet e këtij studimi Bullgaria dhe Rumania janë trajtuar si shtete anëtare të BE-së.

² Sipas këtyre vendimeve (C-81/98 dhe C-212/02), kërkohet një periudhë e arsyeshme pezull ndërmjet dhënies së kontratës dhe përfundimit të saj për të lejuar një proces efektiv rishikimi të dhënies së kontratës.

arbitrazhi dhe modelet e tribunalëve me ose pa kapacitet gjyqësor. Ka shpjegime dhe justifikime të ndryshme për përzgjedhjen e një modeli të caktuar, por zhvillimi dhe eksperiencat e nxjerra për përdorimin e tij përbëjnë një burim të vyer informacioni për shtetet partnere të Sigma-s në përpjekjet e tyre për të përmirësuar sistemet e tyre të rishikimit.

- Me zhvillimet e fundit në prokurimin publik të BE-së, ka gjithnjë e më tepër nevojë për trajnim dhe informacion për një grup të gjerë aktorësh në fushën e rishikimit të prokurimit, të tillë si gjyqtarë, arbitra, juristë, politikëbërës e të tjerë persona të angazhuar me rishikimin e ankesave për prokurimet publike.

Si rrjedhojë, përditësimi i Dokumentit të Sigmas nr. 30, por me një gamë më të gjerë objektivash, duhet të plotësojë një funksion më të dobishëm duke iu dhënë informacion shteteve në punën e tyre drejt reformës dhe duke përmirësuar rishikimin e sistemeve të tyre të prokurimeve publike dhe të dëmshpërblimeve. Ky studim jep një analizë krahasuese të sistemeve të rishikimit dhe të dëmshpërblimeve të Shteteve Anëtare, por nuk mundohet të vlerësojë avantazhet/disavantazhet e tyre përkatëse ose të rekomandojë rregullime të posaçme institucionale.

PASQYRA E LËNDËS

PROGRAMI SIGMA.....	2
PARATHËNIE	3
PASQYRA E LËNDËS.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
METODOLOGJIA	10
1. Hyrje.....	12
1.1 Direktivat e Dëmshpërblimeve	12
1.2 Traktati i KE-së dhe Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë	13
1.3 Praktika të tjera kombëtare.....	14
2. Kuadret institucionale: si i kanë organizuar shtetet anëtare sistemet e tyre të rishikimit dhe të dëmshpërblimit	14
2.1 Ankimi tek Autoritetet Kontraktuese	14
2.2 Klasifikimi i Sistemeve të Rishikimit në Sisteme të Dyfishta dhe të Njëfishta	15
2.3 Gjykatat e Përgjithshme dhe Organet e Specializuara të Rishikimit	16
2.4 Apelet	18
2.5 Organet e Rishikimit të shkallës së fundit	18
2.6 Dëshmitë dhe pajtimi	19
2.7 Avokati i Popullit dhe Organet Këshillimore	19
2.8 Forumet kryesore të rishikimit	20
3. Dëmshpërblimet e disponueshme	20
3.1 Pezullimi i vendimeve të prokurimit publik.....	20
3.2 Masat e përkohshme.....	21
3.3 Anulimi i një kontrate të përfunduar.....	22
3.4 Dëmet	23
3.5 Gjobat materiale dhe pagimi i gjobave periodike	23
4. Kuadri ligjor që drejton sistemet e rishikimit të Shteteve Anëtare.....	23
4.1 Objektivi i sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit.....	24
4.2 E drejta procedurale	25
5. Mjedisë dhe kultura e rishikimit të prokurimeve publike	30
5.1. Trajnimi	31
5.2 Qëndrimet dhe besueshmëria në lidhje me proceset e rishikimit.....	32
5.3 Funksionimi i sistemeve të rishikimit dhe mjeteve efektive dëmshpërblyese në praktikë	32
5.4 Shoqëria civile.....	35
6. Përfundime	35
SHTOJCË: RAPORTET E VENDEVE INDIVIDUALE PËR SISTEMET E RISHIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË ANKESAVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE NË SHTETET ANËTARE	37
1. Austria.....	37
2. Belgjika	40
3. Bullgaria.....	43
4. Qiproja	46
5. Republika Çeke	47
6. Danimarka	50
7. Estonia	53
8. Finlanda.....	56
9. Franca	59

10.	Gjermania.....	63
11.	Hungaria.....	67
12.	Irlanda.....	71
13.	Letonia.....	73
14.	Lituania.....	76
15.	Luksemburgu.....	78
16.	Malta.....	80
17.	Holanda.....	83
18.	Polonia.....	86
19.	Portugalia.....	90
20.	Rumania.....	91
21.	Republika e Sllovakisë.....	93
22.	Sllovenia.....	96
23.	Suedia.....	99
24.	Mbretëria e Bashkuar.....	101

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemet e rishikimit të prokurimeve publike dhe të dëmshpërblimeve të shteteve anëtare të BE-së duhet të krijohen dhe të zhvillohen mbi bazën e kërkesave specifike të Direktivave të EK-së për Rishikimin dhe Dhënien e Kontratave të Prokurimeve Publik nr 89/665/KEE dhe 92/13/KEE, Traktatit të KE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Në veçanti, këto sisteme duhet t'i ofrojnë tenderuesve të dëmtuar rishikime dhe kompensime **të shpejta, efektive, transparente dhe jo-diskriminuuese**. Ka dhe disa kërkesa të tjera shtesë, por ato nuk mbulojnë çdo detaj të sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit dhe lënë vend të konsiderueshëm përzgjedhjeje nga opsionet e shteteve anëtare.

Në 24 shtetet anëtare³ të përfshira në këtë studim ka **elemente të përbashkëta** thelbësore, por ka dhe **dallime ndërmjet** sistemeve të rishikimit dhe dëmshpërblimit ndërmjet tyre. Këto pika të përbashkëta dhe dallime lidhen me kuadrot institucionale, mjetet efektive në dispozicion të vendeve, kuadrot ligjore që rregullojnë objektin dhe procedurën dhe kulturën e rishikimit.

Për sa i përket **kuadrove institucionale**, d.m.th. mënyrës sesi shtetet anëtare i kanë organizuar sistemet e tyre të rishikimit, e përgjithshmja është që pjesa më e madhe e shteteve anëtare parashikojnë **ankime të drejtpërdrejta për subjektin kontraktues** që ka kryer shkeljen e pretenduar të ligjit të prokurimit publik si fazë e parë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë rishikimi. Gjithsesi, kjo mundësi nuk konsiderohet si etapa e parë e procesit të rishikimit që kërkohet nga Direktivat përkatëse të KE-së. Si rezultat, mund të gjenden dallime për sa i përket faktit nëse kjo ankesë shihet si etapa e parë detyruese dhe nëse tenderuesit e përdorin këtë mundësi praktikisht, dhe në lidhje me detajet procedurale, të tilla si afatet kohore. Të gjithë shtetet anëtarë kryejnë një **rishikim gjyqësor ose quasi (pothuajse)-gjyqësor në shkallën e parë** për vendimet e prokurimeve.

Disa shtete klasifikohen në përputhje me parimet e një sistemi **të dyfishtë**, ndërsa të tjerë shtete përdorin parimet e një sistemi **të njëfishtë** të rishikimit të prokurimeve publike. Vendet me sisteme të njëfishta janë vendet që kanë një rrugë të caktuar organesh rishikimi (nga shkalla e parë deri në shkallën e tretë të rishikimit) ndërsa vendet me sisteme të dyfishta karakterizohen nga dy rrugë rishikimi. Shpesh, faktori që ndan dy rrugët në sistemin e dyfishtë është mënyra e përfundimit të kontratës. Gjithsesi, ato rrugët mund të ndahen dhe nga natyra publike ose private e subjektit kontraktues “palë e paditur”. Shtetet anëtare përdorin si gjykatat e zakonshme dhe gjykatat administrative si dhe **organet e specializuara të prokurimit publik për rishikim** si institucionet e rishikimit. Me pak përjashtime, rishikimi i shkallës së parë nëpërmjet një organi rishikimi të specializuar mund të apelohej në një gjykatë të zakonshme ose gjykatë administrative. Vetëm pak vende kanë senate ose dhoma/departamente të posaçme prokurimi publik në këto gjykata të zakonshme ose administrative. Në disa shtete anëtare, shkalla e dytë e gjyqimit është shkalla e fundit, ndërsa disa shtete anëtare lejojnë dhe shkallën e tretë të rishikimit gjyqësor.

Të gjitha organet e rishikimit të shkallës së fundit duket se i plotësojnë kërkesat e një gjykate, siç parashikohen në vendimet *Dorsch* dhe *Salzmann* të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.⁴ Shumë shtete anëtare kanë krijuar **organe për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve**, të tilla si panelet e arbitrazhit dhe, madje, një rol i tillë mund të luhet dhe nga Avokati i Popullit.

Së fundmi, disa shtete anëtare kanë organe këshillimore jo gjyqësore, të përbërë nga përfaqësuesit e të dyja palëve që rishikojnë çështjet e prokurimit, të cilat zakonisht nuk nxjerrin një vendim detyrues.

³ Për qëllimet e këtij raporti, Bullgaria dhe Rumania janë përfshirë në kategorinë e Shteteve Anëtare të BE-së, megjithëse pranimi i tyre i plotë u realizua më 1 janar 2007.

⁴ Sipas këtij vendimi, për t'u cilësuar si gjykatë, ky organ duhet të themelohet mbi bazën e një ligji ose nga një ligj; ai duhet të jetë organ i përhershëm dhe vendimet e tij duhet të merren mbi bazën e rregullave gjyqësore dhe duhet të jenë të detyrueshme dhe procedura e tij duhet të jetë një procedurë ndërmjet palësh (*inter partes*). Një gjykatë është e pavarur nga ekzekutivi dhe nga administrata si dhe nga çdo pjesë tjetër e qeverisë, dhe vendimet e saj kanë natyrë juridikionale.

Shtetet anëtare kanë pika të përbashkëta dhe dallime në lidhje me **dëmshpërblimet e disponueshme**. Këto dëmshpërblime përfshijnë pezullimin e vendimeve të paligjshme të prokurimeve, masat e përkohshme, dëmshpërblimin e dëmeve dhe, në disa vende, për ndërmarrjet përfshihen dhe gjoba periodike. Së pari, shtetet anëtare i lejojnë organet e rishikimit të **pezullojnë vendimet e paligjshme të prokurimeve publike** përpara përfundimit të kontratës. Përfundimi i kontratës është një pikë thelbësore në një procedurë prokurimesh, pas së cilës shumë shtetet anëtare lejojnë vetëm dëmshpërblimin për dëmin. Për të lejuar lënien mënjantë të vendimit për dhënien e kontratës dhe në përputhje me vendimet e *Alcatel-it*⁵ të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, shumë juridiksione kanë prezantuar **një periudhë pezull** prej 7-30 ditësh nga dhënia e vendimit deri në përfundimin e kontratës. Gjithsesi, efektiviteti i periudhës pezull dallon nga një juridiksion tek tjetri pasi nuk ka dallime nëse fillimi i proceseve pezullon procedurën e dhënies së kontratës, dhe nëse përfundimi i një kontrate gjatë periudhës pezull e bën kontratën të pavlefshme, si dhe nuk ka përcaktime të lidhura me afatin kohor brenda të cilit gjyqtarët duhet të marrin një vendim për një procedurë rishikimi. Në përgjithësi, një kontratë e përfunduar mund të anulohet vetëm kur plotësohen kërkesat e përcaktuara në mënyrë strikte.

Së dyti, ka **masa të përkohshme** të aplikueshme, por ato zbatohet në bazë të legjislacioneve të brendshme, pra janë objekt i dallimeve kombëtare. Në një numër të vogël shtetesh anëtare, depozitimi i një ankese ka efekt automatik vezullues, duke çuar në ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Në pjesën më të madhe të vendeve tenderat duhet t'i kërkojnë specifikisht organit rishikues të zbatojë masa të përkohshme, për shembull për ndërprerjen e procedurës. Më pas organi i rishikimit mund të zbatojë masa të përkohshme në pritje të një vendimi përfundimtar, duke marrë parasysh pasojat e mundshme të masave të përkohshme për të gjitha interesat që mund të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik, dhe mund të vendosë kundër marrjes së masave të tilla kurdo që pasojat e tyre negative mund të jenë më të mëdha se përfitimet prej tyre. Për më tepër, ekziston një bazë e ngjashme për sa i përket disponueshmërisë dhe kërkesave për kompensim për dëme, të cilat zakonisht trajtohen pas përfundimit të kontratës. **Gjobat periodike** mund të jenë pjesë të vendimeve ose mund të përbëjnë dëmshpërblimin për ndërmarrjet në disa shtete anëtare.

Ka ngjashmëri dhe dallime dhe në lidhje me **kuadrin ligjor** të sistemeve të rishikimit të shteteve anëtare. Së pari, kuadri ligjor lidhet me **objektin/qëllimin** e sistemin. Në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, sistemi zbatohet njësoj **si për kontratat sipër dhe nën prag** të Direktivës për Prokurimin Publik të KE-së nr. 2004/17 dhe 2004/18. Pak vende nga shtetet anëtare përdorin sistemin e rishikimit dhe dëmshpërblimeve vetëm për kontrata mbi prag, ndërsa në vende të tjera ka masa të ndryshme lehtësuese, organe rishikimi dhe kërkesa procedurale për kontrata nën këtë prag. Po ashtu, në shumë shtete anëtare, sistemi i rishikimit dhe i mjeteve lehtësuese zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha organet dhe subjektet kontraktuese, ndërsa në të tjera ka baza ligjore të ndryshme dhe organe të ndryshme rishikimi në varësi të faktit nëse kontrata është dhënë nga një subjekt publik ose nga një ndërmarrje, ose në bazë të faktit nëse subjekti kontraktues është subjekt publik ose privat. Së dyti, kuadri ligjor lidhet me **ligjin procedural** për rishikim, që mbulon çështje të tilla si: kush mund ta fillojë një proces, brenda cilave afatesh kohore, me çfarë kostoje, si mund të përfshihen ekspertët, a duhet të merret parasysh konfidencialiteti dhe si mësojnë aplikantët rreth rezultateve të proceseve.

Së fundmi, ka ngjashmëri dhe shumë dallime dhe për sa i përket **kulturës së rishikimit** të shteteve anëtare. Ky nocion përfshin trajnimet, sjelljet, besueshmërinë, dhe përdorimin e sistemit në praktikë. Mundësitë e **trajnimet** për gjyqtarët dhe anëtarët e panelit të rishikimit, juristët, tenderuesit dhe oficerët kontraktues për ligjin e prokurimeve publike; sfondin teknologjik dhe ekonomik të prokurimeve dhe mënyrën sesi funksionojnë procedurat në praktikë, të cilat ndryshojnë shumë nga njëri shtet në tjetrin. Shumë shtete anëtare kanë një spektër të gjerë mundësish trajnimi – të cilat variojnë nga mësimdhënia dhe kërkimi që lidhet me prokurimin publik në universitete dhe institucione të tjera të arsimit të lartë. Konferenca, botime ligjore e të tjera, apo seminare të organizuara privatisht janë disa nga mundësitë e përdorura për sistemin e rishikimit dhe të dëmshpërblimeve në disa vende, ndërsa mundësitë në vende të tjera janë shumë të kufizuara. Tenderuesit e përdorin aktivisht sistemet e tyre të rishikimit për të ndrequr gabimet dhe për të

⁵ Çështjet C-81/98 dhe C-212/02.

nxitur interesat e tyre. Gjithsesi, në shumë juridiksione, tenderuesit ndihen të dekurajuar nga kostoja e lartë, ose nga mundësia për të kapur një kontratë tjetër, ndërsa në disa shtete tenderuesit shihen nga organet kontraktuese si abuzues të sistemit në mënyrë që të pengohen procedurat e prokurimit, ose të detyrohen konkurruesit të dalin nga kontrata. Sjellja e pjesës më të madhe të gjyqtarëve përshkruhet si e drejtë dhe e balancuar. Sistemet kombëtare dallojnë shumë për sa i përket suksesit të ankesave dhe akuzave në shkallën e parë. Në shkallën e dytë dhe të tretë tenderuesit janë kryesisht më pak të suksesshëm. Në disa shtete përfshihen organizata joqeveritare në sistemin e rishikimit, përgjithësisht duke ju dhënë këshilla tenderuesve dhe ndonjëherë duke punuar për proceset. Në pak shtete anëtare këto OJQ mund të fillojnë dhe proceset.

METODOLOGJIA

Në secilin nga shtetet anëtare të BE-së, studimi përqendrohet në katër fusha kryesore: kuadrin legjislativ, kulturën e rishikimit dhe dëmshpërblimit dhe funksionimin e sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit në praktikë. Janë bërë përpjekje që këto çështje të hetohen dhe të diskutohen veçmas, por trajtimi i veçantë i këtyre çështjeve nuk ka qenë gjithnjë i mundur, pasi kuadrot ligjore dhe institucionale, për shembull, kanë ndikim të pashmangshëm mbi kulturën e rishikimit dhe të dëmshpërblimeve dhe në funksionimin e sistemit.

Studimi u krye nga Skuadra e Projektit të Sigma-s dhe u rishikua nga një Skuadër Mbikëqyrëse. Të dhënat e nevojshme u mblodhën nëpërmjet një pyetësoi të detajuar, të cilët u shpërndanë në pikat e kontaktit për 25 shtetet anëtare dhe në Bullgari dhe në Rumani. Studimi reflekton situatën në shtetet anëtare siç ka qenë në gjysmën e parë të 2006-ës. Të gjitha pikat e kontaktit brenda administratave publike të shteteve anëtare patën mundësi të komentonin dhe të miratonin projekt-raportet e vendeve pasi këto projekt raporte u përfunduan nga Skuadra e Projektit Sigma.

Përgjegjësia kryesore e **Ekipit të Projektit Sigma** ishte përmeshja e aktiviteteve të shoqëruara me planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e studimit deri në përfundimin e suksesshëm të raportit dhe botimit të Dokumentit të Sigma-s. Anëtarët e Skuadrës së Projektit ishin Martin Trybus, Peder Blomberg, dhe Piotr-Nils Gorecki.

Skuadra e Rishikimit u krijua me qëllimin e dhënies së komenteve për metodologjinë dhe për draftin dhe raportet përfundimtare të studimit. Skuadra u përbë nga Jowl Arnould (Francë), David d'Hooghe (Belgjikë), Jens Fejø (Danimarkë), and Tomaž Vesel (Slloveni).

U krijua një **Rrjet Pikash Kontakti** brenda administratave publike të shteteve anëtare, detyra e të cilit ishte dhënia e dokumentacionit dhe informacionit për mënyrën sesi është organizuar dhe konceptuar sistemi i rishikimit, duke përfshirë dhe statistikën e ankesave, kur ato ishin të disponueshme. Pikat e kontaktit u përzgjedhën ose u rekomanduan nga **Rrjeti European i Prokurimit Publik (RrPP)**, i cili është një rrjet bashkëpunimi i zyrtarëve ekspertë të prokurimit publik në të gjitha shtetet anëtare, të gjitha shtetet në proces anëtarësimi, anëtarët e EEA-s, Zvicër, shtetet kandidate të BE-së dhe në shtete të tjera Europiane.

Skuadra e Projektit Sigma përgatiti një pyetësor të detajuar, i cili iu dërgua rrjetit të pikave të kontaktit për plotësim, duke përfshirë dhe statistikën për dëmshpërblimet, nëse janë të aplikueshme. Për atë që ishte e mundur Skuadra e Projektit Sigma dhe Skuadra e rishikimit analizuan tekste ligjore të cilat përmendeshin drejtpërsëdrejti në pyetësor, ose në versionin origjinal ose në versionet e përkthyer. Në periudhën e kohës nga marsi deri në gusht 2006 Skuadrës së Projektit Sigma iu kthyen 24 pyetësorë, përkatësisht nga Austria, Belgjika, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Suedia, dhe Mbretëria e Bashkuar.

Duhet të qartësohen disa pika në lidhje me **kufijtë e kësaj qasje metodologjike**. Së pari, për shkak se tre shtete anëtare nuk i kthyen pyetësorët e tyre, studimi nuk përbën një rishikim të plotë të sistemeve të rishikimit dhe dëmshpërblimit në të gjithë shtete anëtare. Gjithsesi, 24 nga 27 pyetësorë përfaqësojnë një përgjigje pozitive, e cila duhet të ofrojë bazë të mjaftueshme për një trajtim të kuptimtë.

Disa sisteme kombëtare rishikimi dhe dëmshpërblimi ofrojnë një mbulim më të gjerë sesa kërkohet nga Direktivat e KE-së, duke përfshirë kontrata dhe jashtë objektit të Direktivave të BE-së. Studimi ofron informacion të dobishëm për qëllimin e një mbulimi të tillë të zgjeruar, por për shkak të kufizimeve në këtë metodologji, ka qenë e mundur që çështja e mbulimit të zgjeruar të diskutohet në mënyrë sistematike në këtë studim.

Studimi nuk bën ndonjë dallim mbi bazën e natyrës së kontratave (publike ose koncesionare), të cilat mund të kenë ndikim mbi përfundimet e nxjerra në seksionin krahasues të tij. Kjo lidhet në veçanti me shtetet

anëtare ku përgjegjësitë për dëmshpërblime në zonën e koncesioneve trajtohen në mënyrë të ndryshme nga ato të kontratave publike.

Pra, studimi nuk ka informacion sistematik për mënyrën sesi shtetet anëtare i organizojnë dëmshpërblimet në lidhje me natyrën e kontratave.

1. Hyrje

Objektivi kryesor për krijimin e një sistemi rishikimi ankesash dhe dëmshpërblimesh për prokurimet publike është detyrimi i zbatimit të legjislacionit thelbësor të prokurimeve publike. The ky sistem i jep legjislacionit “dhëmbë”: mundësia e rishikimit dhe dëmshpërblimit shërben si dekurajuese për shkeljen e ligjit dhe, si rezultat, inkurajon përputhshmërinë me ligjin. Po ashtu, mund të korrigjohen dhe shkeljet e ligjit dhe gabimet e pavetëdijshme. Si rezultat, një sistem funksional rishikimi dhe dëmshpërblimi për prokurimet publike mund të kontribuojë për arritjen e objektivave të rregullave themelore, të tilla si trajtimi jo diskriminues dhe i barabartë, transparencja dhe vlera për para. Sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimeve të prokurimit publik të shteteve anëtare të BE-së duhet të përputhen me kërkesat e të drejtës së Komunitetit Europian: Traktatin e KE-së, Direktivën e KE-së për Dëmshpërblimet e Sektorit Publik 89/665/KEE dhe Direktivën e Dëmshpërblimeve të Ndërmarrjeve nr 92/13/KEE. Të dyja direktivat janë aktualisht në proces rishikimi.⁶ Për më tepër, këto sisteme rishikimi dhe dëmshpërblimi normalisht kërkojnë të përputhen me aspektet jashtë zbatimit të Direktivave të Dëmshpërblimeve, të tilla si jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian në lidhje me respektimin e të drejtave për mjete dëmshpërblyese efektive dhe proces të rregullt dëgjimor si dhe proces të rregullt ligjor që rrjedhin nga neni 6 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe aspekteve të lidhura me praktikën e mirë kombëtare.

1.1 Direktivat e Dëmshpërblimeve

Direktiva e Dëmshpërblimeve e Sektorit Publik e KE-së nr. 89/665/KEE dhe Direktiva e Dëmshpërblimit e Ndërmarrjeve nr. 92/13/EEC parashikojnë kërkesat minimale në lidhje me sistemet e rishikimit dhe të dëmshpërblimit e shteteve të anëtarëve. Këto kërkesa minimale lidhen me kontratat e dhëna brenda fushës së zbatimit të Direktivës së EK-së për Prokurimet në Sektorin Publik 2004/18/EC dhe Direktivën e KE-së për Prokurimin e Ndërmarrjeve 2004/17/KE. Kërkesat përfshijnë parimet, pozicionimin, dëmshpërblimet, organet e rishikimit dhe kufizimet. Por, një sistem kombëtar rishikimi dhe dëmshpërblimi mund të përfshijë dhe kontakte jashtë qëllimit të Direktivës për Prokurimin Publik, të tilla si kontratat nën pragun e aplikimit ose koncesionimet e shërbimit.

Si rregull i përgjithshëm, Shtetet Anëtare të BE-së duhet të sigurohen se vendimet e mara nga organet kontraktuale të mund të rishikohen me efektivitet dhe sa më shpejt të jetë e mundur për aq kohë sa vendime të tilla kanë prekur të drejtën e Komunitetit në fushën e prokurimit publik ose rregullave kombëtare në zbatim të kësaj të drejte. Nocioni i “**efektivitetit**” të një sistemi rishikimi dhe dëmshpërblimi është qartësuar dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (shih për shembull çështjen C-92/00, paragrafi 67 dhe çështjen C-390/98 *Bankat k. Autoritetit të Qymyrit dhe Sekretarit të Shtetit për Tregtinë dhe Industrinë* [2001] ECR I-6117, paragrafi 121; çështja C-453/99 *Courage dhe Crehan* [2001] ECR I-6297, paragrafi 29). Më specifikisht, duket se sistemi duhet të përfshijë organe operative rishikimi, rregullat e përfaqësimit në organet e rishikimit, kostot, rregullat për efektin e depozitimit të një proteste, objektivin, mundësinë për lënien mënjane të vendime individuale të prokurimit, duke përfshirë vendimin për dhënien e kontratës, dëmtimet dhe masat e përkohshme. Për më tepër, aspektet e efektivitetit përfshijnë çështje të aksesit dhe të kënaqjes së tenderuesve me sistemin (shpesh tësinë e proceseve, apelet kundër vendimit të shkallës së parë, etj.), dhe mundësisht transparencën e përgjithshme dhe madje dhe thjeshtësinë e sistemit.

Për më tepër, nocioni i ndërlidhur i “**shpejtësisë**” kërkon që proceset të kryhen dhe të vendosen shpejt. Përveç të qenit efektiv dhe të shpejtë, masat efektive dëmshpërblyese nuk duhet të jenë diskriminuese si rezultat i dallimit të bërë nga Direktivat ndërmjet rregullave kombëtare që zbatohen të drejtën e Komunitetit dhe rregullave të tjera kombëtare. Procedurat e rishikimit të parashikuara në të dyja Direktivat për mjetet

⁶ Propozimi i Komisionit për një Direktivë që ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/EEC dhe 92/13/EEC në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të rishikimit që lidhen me dhënien e kontratave publike [COM(2006) 195 finale/2] e datës 4 maj 2006: shih http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/remedies/remedies_en.htm.

efektive dëmshpërblyese përfshijnë kompetencat e mëposhtme: marrjen e masave të përkohshme nëpërmjet procedurave të ndërmjetme, ose për të pezulluar ose për të siguruar pezullimin e vendimeve të marra në mënyrë të paligjshme, dhe për mbulimin e dëmeve për personat e cenuar nga shkelja. Shtetet Anëtare mund të vendosin të përdorin organet e rishikimit që nuk janë gjyqësore në natyrë, por duhet të sigurojnë se vendimet e këtyre organeve të jenë objekt i rishikimit gjyqësor. Rishikimi gjyqësor duhet të bëhet nga një gjykatë or nga një organ rishikimi që domosdoshmërisht duhet të jetë i pavarur nga organi i rishikimit fillestar dhe nga autoriteti kontraktues, dhe ky organ duhet të pranojë ato standarde që janë thuajse identike me standardet e një gjykate.

Direktivat e mjeteve efektive dëmshpërblyese nuk i rregullojnë plotësisht sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimit të shteteve anëtare. Për shembull, nuk ka kërkesa që specifikojnë nëse rishikimi duhet të bëhet nga gjykata të zakonshme, të posaçme apo administrative apo specifikime që lidhen me llojin e ligjit ku duhet të trajtohet sistemi i rishikimit dhe i dëmshpërblimit. Për më tepër, Direktiva e mjeteve efektive dëmshpërblyese përmban dhe "opsione", duke i lënë kështu mundësi shteteve anëtare hapësirë për manovrim kur zbatohen dëmshpërblimet. Për shembull, sipas Direktivës për Dëmshpërblimet për Ndërmarrjet, shtetet anëtare mund të përzgjedhin t'u japin organeve të rishikimit kompetencën për pezullimin e vendimeve të prokurimeve publike dhe dhënies së kompetencave për vendosjen e gjobave. Pra, ka mundësi për manovrim të shumta për sa i përket sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit në të 24 shtete e përfshira në këtë studim.

Gjithsesi, për të qenë më i saktë në lidhje me interpretimin e Direktivave, mbi bazën e nenit 2 (1) të Direktivës 92/13/EEC, shtetet anëtare kanë të drejtë 1) të marrin masa të përkohshme dhe 2) të pezullojnë vendimet, ose 3) të marrin masa të tjera të ndryshme nga ato që jepen në pikën 1) dhe 2), në veçanti në lidhje me pagesën e një shume të caktuar. Kjo pagesë është vetëm një masë e mundur për t'u marrë.

1.2 Traktati i KE-së dhe Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë

Parimi bazë që rrjedh drejtpërsëdrejti nga Traktati i KE-së dhe me të cilin duhet të përkojnë sistemet e rishikimeve dhe të dëmshpërblimeve në shtetet anëtare të BE-së është ai i **mos diskriminimit** për shkak të kombësisë (Neni 12 i Traktatit të KE-së). Direktivat e KE-së për Prokurimet Publike parashikojnë aspekte të veçanta të këtij parimi, ndërsa parimi më i gjerë e më i përgjithshëm zbatohet për të gjitha çështjet që nuk specifikohen në këto instrumente ligjore. Parime të tjera të Traktatit të KE-së janë transparenca dhe proporcionaliteti/përpjesëtueshmëria. Shumë shpesh zbatimi praktik i këtyre parimeve është qartësuar në vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Ndërkohë që nuk ka një doktrinë të shprehur të **precedentit ligjor** në të drejtën e Komunitetit të tillë që i kërkon Gjykatës Europiane të Drejtësisë të ndjekë jurisprudencën e saj të mëparshme, jurisprudenca e Gjykatës ka një rëndësi shumë të madhe. Gjykata ndjek vendimet e saj të mëparshme thuajse në të gjitha çështjet dhe shumë shpesh citon pjesë nga vendimet e saj të mëparshme. Më tej, autoriteti i Gjykatës si interpretuesi përfundimtar i të drejtës së Komunitetit e lejon atë të qartësojë të drejtën, dhe, nëse është nevojshme, dhe të plotësojë boshllëqet e pashmangshme të lëna nga ligjvënësi. Disa nga vendimet e shumta të gjykatës për të drejtën e prokurimit publik qartësojnë legjislacionin e KE-së në kuadrin e objektivave të saj të deklaruar. Si rezultat, vendimet kryesore të Gjykatës në lidhje me rishikimin dhe dëmshpërblimin duhet t'i shtohen kuadrin ligjor të cilin duhet të respektojnë sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimit të shteteve anëtare. Për më tepër, duhet të theksohet se disa vendime të Gjykatës trajtojnë aspekte të përgjithshme të dëmshpërblimeve të cilat nuk mbulohen specifikisht nga Direktivat 89/665/KEE dhe 92/13/KEE.

Të drejtat procedurale të parashikuara në Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë ndikim të madh mbi sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimeve të prokurimit publik.

1.3 *Praktika të tjera kombëtare*

Siç u tha dhe më lart, Direktivat e BE-së për Dëmshpërblimin 89/665/KEE dhe Direktiva 92/13/KEE nuk rregullojnë në mënyrë të plotë sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimit në shtetet anëtare. As jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë nuk i trajton të gjitha pyetjet që dalin në këtë kuadër. Disa praktika në lidhje me rishikimet dhe dëmshpërblimet që janë zhvilluar në shumë vende nuk trajtohen specifikisht në Direktivat e mjeteve efektive dëmshpërblyese. Gjithsesi, vija ndarëse ndërmjet këtyre “praktikave kombëtare” dhe parimeve të përgjithshme të rishikimit efektiv dhe të shpejtë të kërkuar nga Direktivat e mjeteve efektive dëmshpërblyese nuk është gjithmonë shumë e qartë, por praktika të caktuara, të tilla si arsyetimi i vendimeve për ankesat, dëgjimi i të dyja palëve të përfshira, ose konfirmimi i marrjes së ankesave mund të klasifikohet si praktika të mira të kërkuara specifikisht dhe shprehimisht nga e drejta e Komunitetit.

2. **Kuadrot institucionale: si i kanë organizuar shtetet anëtare sistemet e tyre të rishikimit dhe të dëmshpërblimit**

Studimi nuk bën ndonjë dallim mbi bazën e natyrës së kontratave (kontrata publike ose koncesionare), të cilat mund të kenë ndikim mbi përfundimet e nxjerra në këtë seksion. Kjo lidhet kryesisht me shtetet anëtare, ku përgjegjësitë për dëmshpërblime në zonën e koncesioneve trajtohen në mënyrë të ndryshme nga kontratat publike.

Ky seksion mbulon institucione të ndryshme (gjykatat, rishikimet thuajse ligjore (*quasi-gjyqësore*), dhe organe të tjera rishikimi) që merren me rishikimin dhe dëmshpërblimin e prokurimeve publike në shtete anëtare të BE-së. Ndërmjet organeve të rishikimit të prokurimit publik të shteteve të ndryshme vihen re ngjashmëri të mëdha, por ekzistojnë dhe shumë dallime ndërmjet tyre. Për informacione të detajuara për kuadrin institucional të shteteve anëtare individuale ju lutem referojuni raporteve të shteteve përkatëse, të dhëna në Shtojcë.

2.1 *Ankimi tek Autoritetet Kontraktuese*

Së pari ekziston nevoja e qartësimit të dallimit ndërmjet një ankese fillestare administrative, nëpërmjet së cilës një tenderues, duke depozituar drejtpërsëdrejti një ankesë tek autoriteti kontraktues kërkon zgjidhjen e një mosmarrëveshje dhe njoftimit paraprak për kërkim rishikimi, sipas Nenit 1(3) të Direktivave të mjeteve efektive dëmshpërblyese. Detyrimi për njoftimin paraprak, i cili në Direktivë parashikohet si opsional (jo detyrues), është thjeshtë një informacion që i jepet autoritetit kontraktues për kërkesë për rishikim që do t'i dërgohet organit përgjegjës për rishikim në shkallën e parë.

Studimi ka konstatuar se një element i përbashkët i sistemeve të rishikimit dhe dëmshpërblimit të prokurimit publik të shteteve anëtare është mundësia për **t'u ankuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tek organi ose subjekti përkatës kontraktues** që jep kontratën ose tek institucionet më të larta ku varen ata në rast pretendimi shkelje të ligjit të prokurimit publik. Gjithsesi, ekzistojnë dallime të mëdha në lidhje me përdorimin e këtij opsioni në praktikë, të lidhura me faktin nëse ankimi është parakusht për rishikimin gjyqësor apo jo dhe a është ky hap në përputhje me rregullimin e tij të detajuar. Ankimi paraprak tek subjekti kontraktues në vetvete përbën **fazën e parë detyruese për rishikim** në disa shtete, si në Qipro dhe Gjermani. Në Portugali kjo ankesë fillestare nuk është kërkesë, por është gjithsesi mënyra më e zakonshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në çështjet e prokurimeve publike, dhe pjesa më e madhe e ankesave nuk shkojnë më tej. Në Letoni ankimi paraprak është parakusht për rishikimin gjyqësor vetëm në rastet e dokumenteve të rregullta të kontratës. Një ankim për autoritetin kontraktues mund të ofrojë **avantazhe** të qarta, veçanërisht në rastet ku bëhet fjalë për një gabim njerëzor dhe të dukshëm dhe jo për një shkelje të qëllimshme të ligjit të prokurimeve publike, ose në rastet që përfshijnë interpretime “delikate” të ligjit. Kjo është arsyeja pse disa shtete anëtare, të tilla si Finlanda dhe Hungaria u kërkojnë tenderuesve që kërkojnë rishikim quasi-gjyqësor ose rishikim gjyqësor që t'i dërgojnë një kopje të ankesës ose padisë së tyre autoritetit kontraktues në fjalë. Në këtë mënyrë, subjekti kontraktues ka mundësi të korrigjojë një gabim të

paqëllimshëm (nëse një gjë e tillë mund të bëhet pa cenuar askënd). Tenderuesi mund të **shmangë konfrontimet** me autoritetin përkatës kontraktues gjatë përdorimit të rishikimit quasi-gjyqësor ose gjyqësor. Plus, kjo mund të jetë dhe **mënyra më e shpejtë për të korrigjuar** shkeljen. Së fundmi, kjo rrugë çon në shmangien e **kostove** të lidhura me proceset e rishikimit. Nga ana tjetër, proceset e gjata kohore mund të zgjasin procedurën e përgjithshme të rishikimit nëse kjo është vetëm hyrja në rishikimin quasi-gjyqësor ose gjyqësor. Në një situatë të tillë mund të humbet kohë e vlefshme në pritje të subjektit kontraktues që vendosë për ankesën. Në kuadrin e një ankese të drejtpërdrejtë tek subjekti kontraktues si parakusht për rishikimin quasi-gjyqësor ose gjyqësor, duhet të merren parasysh kërkesat e mjeteve dëmshpërblyese “të shpejta”, siç parashikohen në direktivat e KE-së, në veçanti kur bëhet fjalë për kohën kur organet duhet të vendosin për ankesa të tilla. Në shumë shtete anëtare organet kontraktuese duhet të vendosin për ankesat brenda pak ditësh. Por, në rastin kur është depozituar paralelisht njoftimi paraprak, nuk ekziston detyrimi i pritjes për vendimin e autoritetit kontraktues.

Në Irlandë nevoja për ankesa dhe rishikim gjyqësor reduktohet në praktikën e **informimeve** ku subjektet kontraktuese shpjegojnë dhe diskutojnë pikat e forta dhe të dobëta të tenderuesve individualë me tenderët e përfshirë. Këto informime nuk kërkojnë, por inkurajohen si mënyrë e nxitjes së **dialogut konstruktiv dhe transparent** ndërmjet subjekteve kontraktuese dhe tenderuesve.

2.2 *Klasifikimi i Sistemeve të Rishikimit në Sisteme të Dyfishta dhe të Njëfishta*

Kuadrot institucionale të 24 shteteve anëtare të përfshira në këtë studim mund të ndahen në dy grupe të mëdha: në sisteme të dyfishta dhe sisteme të njëfishta, të cilat nga ana e tyre mund të nëndahen në dy grupe secili. Këto nëngrupe do të shpjegohen në më tepër detaje më poshtë.

Shumë shpesh, por jo gjithmonë, shtetet anëtare me një ndarje të qartë ndërmjet të drejtës publike dhe civile kanë **sistem të dyfishtë të rishikimit të prokurimit publik**. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare (shih Tabelën 1) kanë këtë sistem të dyfishtë rishikimi. Në një shtet me sistem të dyfishtë rishikimi, disa dëmshpërblime (zakonisht për dëme) mund të kërkojnë vetëm në gjykatat e zakonshme ose civile. Plus, ky dëmshpërblim zakonisht është i disponueshëm vetëm pas përfundimit të kontratës. Pra, përfundimi i kontratës shpesh është pika kyçe që ndan juridiksionet e të dy organeve të rishikimit, secili prej të cilëve kalon në tri nivele. Dëmshpërblimet për arsye të tjera të ndryshme nga dëmet, në veçanti pezullimi dhe lënia mënjanë e vendime të prokurimeve publike, rishikohen nga një grup i veçantë i organeve të rishikimit. Këto mund të jenë gjykatat e zakonshme administrative, të tilla si në Suedi. Nga ana tjetër, organet e specializuara të rishikimit për prokurimin publik rishikojnë çështjet në shkallën e parë, dhe vendimi i tyre mund të apelohej në gjykatën më të lartë administrative, si për shembull në Austri, Qipro dhe Republikën Çeke. Në Francë dhe Luksemburg, dallimi i qartë ndërmjet të drejtës publike dhe asaj civile është shumë i rëndësishëm. Autoritetet kontraktuese dhe ndërmarrjet publike në Francë mund të kërkojnë rishikim në gjykatat administrative, ndërsa në Luksemburg kjo zbatohet vetëm për autoritete kontraktuese. Në Francë janë gjykatat e zakonshme ose civile ato që rishikojnë vendimet e prokurimeve të ndërmarrjeve private, ndërsa në Luksemburg po të njëjtat gjykata rishikojnë të gjitha ndërmarrjet.

Shtetet e tjera anëtare janë pjesë e kategorisë së **organeve të rishikimit të prokurimit publik në një rrugë të vetme** që japin dëmshpërblimet e disponueshme (shih Tabelën 1), ku përfshihen, ndërmjet të tjerësh, Bullgaria, Irlanda, Letonia dhe Mbretëria e Bashkuar. Danimarka përfaqëson një rast të veçantë, pasi dëmet mund të vlerësohen si nga gjykatat e zakonshme dhe nga një organ i specializuar i rishikimit të prokurimeve publike. Lloji i organit të rishikimit dhe i numrit nivelit të rishikimit ndryshon shumë në këtë lloj sistemi. Siç dhe në rastin e sistemit të rishikimit të dyfishtë, grupi i sistemit të njëfishtë mund të ndahet në dy nëngrupe në varësi të faktit nëse shkalla e parë e rishikimit realizohet nga një organ i specializuar prokurimi publik, apo nga një gjykatë më e përgjithshme. Në disa shtete anëtare këto gjykata janë përgjithësisht **gjykata civile**, ndërsa në vende të tjera ato janë **gjykata administrative**. Një tjetër dallim i madh thelbësor lidhet me nivelin e organit të rishikimit të shkallës së parë. Në Portugali, për shembull, organet e shkallës së parë janë gjykatat administrative (rajonale) të nivelit më të ulët, ndërsa në vende të tjera, si për shembull në Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, gjykata e larta është organi i shkallës së

parë të rishikimit. Niveli i shkallës së parë të rishikimit mund të ketë pasoja mbi kostot, shpejtësinë dhe afërsinë e palëve. Proceset në një gjykatë të një niveli të lartë mund të jenë të kushtueshme, konsumojnë kohë dhe janë të shkëputura nga rajoni i prokurimit të kontratës. Këto elementë mund t'i dekurajojnë tenderuesit që të fillojnë proceset. Nga ana tjetër, proceset në një nivel të ulët gjykatë, apo në një gjykatë të shkallës së parë mund të jenë më të lira, më të shpejta dhe më afër rajonit ku është lidhur kontrata a prokurimit. Nga ana tjetër, këto organe mund të mos kenë eksperiencë dhe ekspertizë.

Tabela 1. Përmbledhje e Sistemeve të Rishikimit në Shtetet Anëtare

Sistemi/Gjykata	Gjykatat e zakonshme	Organi i specializuar i rishikimit
Sistem i njëfishtë	Irlanda, Lituania, Holanda, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar	Bullgaria, Letonia, Malta, Rumania, Sllovakia
Sistem i dyfishtë	Belgjika, Franca, Suedia	Austria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Luksemburgu, Polonia, Rumania, Sllovenia

2.3 Gjykatat e Përgjithshme dhe Organet e Specializuara të Rishikimit

Pjesa më e madhe e shteteve anëtare, pavarësisht nëse kanë një sistem të dyfishtë ose të njëfishtë, kanë krijuar **organe të posaçme të specializuara për organet e rishikimit për të menaxhuar procedurat e rishikimit:**

- Austria: zyrat federale të prokurimit publik dhe institucionet rajonale
- Bullgaria: Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës
- Qipro: Autoriteti për Rishikimin e Tenderëve
- Republika Çeke: Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës
- Danimarka: Bordi i Ankesave për Prokurimet Publike
- Estonia: Komisioni i Prokurimit Publik
- Gjermania: 17 Dhoma Prokurimi Publik
- Hungaria: Këshilli i Prokurimit Publik me organin e tij të specializuar, Komitetin e Arbitrazhit
- Letonia: Byroja e Monitorimit të Prokurimit
- Malta: Bordi i Apeleve të Departamentit të Kontratave
- Polonia: Zyra e Prokurimit Publik (menaxhimi i sistemit të arbitrave)
- Rumania: Këshilli Kombëtar për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ligjore
- Sllovakia: Zyra e Prokurimit Publik
- Sllovenia: Komisioni Kombëtar për Rishikimin e Procedurave të Dhënies së Prokurimeve Publike

Këto organe rishikimi zakonisht përbëhen nga penale ekspertësh prokurimi, të drejtuar nga një jurist i kualifikuar, si për shembull në Austri, Bullgari ose Gjermani. **Anëtarët e panelit** shpesh emërohen sipas të njëjtave procedurave, ose procedurave shumë të ngjashme të emërimit të gjyqtarëve. Plus, ata duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa, si për shembull duhet të jenë nënshtruar i shtetit anëtar në fjalë, duhet të flasin gjuhën (gjuhë) zyrtare të tij, nuk duhet të jetë dënues për kryerje veprash penale. Më tej, ata nuk mund të bëjnë punë të tjera të paguara, në përjashtim të mësimdhënies në universitete dhe nuk mund të përfitojnë në asnjë formë nga burimet e ndërmarrjeve private. Por, këto panele mund të përfshijnë ekspertë të prokurimit

publik me përvojë në fushën e ekonomisë, transportit, ndërtimit ose inxhinierisë si dhe aktorë të tjerë të cilët nuk janë juristë.

Studimi konstaton se vendimet e organeve të specializuara për rishikimin e prokurimeve publike janë **detyruese**, dhe normalisht mund të apelojnë në gjykata të zakonshme ose administrative, por ka dhe përjashtime. Në disa shtete anëtare, të tilla si Malta, Polonia ose Sllovakia, organet e specializuara të rishikimit të prokurimit publik janë pjesë e pavarur e zyrës së prokurimit publik që trajton dhe çështje të tjera të prokurimit publik, të tilla si hartimi i legjislacionit, botimin e njoftimeve të tenderëve, ose zhvillimin e politikave. Apelimi kundër vendimeve të paneleve të rishikimit të këtyre zyrave tek **kryetari** ose presidenti përkatës mund të jetë një fazë e veçantë në proceset e rishikimit. Kjo ndodh, për shembull, në Republikën Çeke dhe në Poloni. E drejta procedurale shpesh rregullohet në ligjin e prokurimit publik, ose në një akt tjetër të ndryshëm nga kodet e përgjithshme të procedurës civile ose administrative. Avantazhi i organeve të specializuara të rishikimit të prokurimit publik është që ekspertiza e prokurimit publik mund të përqendrohet dhe implikimet e saj ligjore, teknologjike, ekonomike dhe praktike trajtohen nga ekspertë të këtyre fushave. Disa shtete anëtare nuk kanë fare organe të specializuara të rishikimit të prokurimit publik, por i drejtohen gjykatave administrative dhe civile (Shih Tabelën 2). Në Belgjikë, Francë, Irlandë, Lituani, Holandë, Portugali, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar, rishikimi i vendimeve të prokurimit publik është detyra ekskluzive e **gjykatave të rregullta**. Në Portugali gjykatat administrative trajtojnë mosmarrëveshjet e prokurimit publik; në Irlandë, Lituani, Holandë, Suedie dhe Mbretërinë e Bashkuar këtë çështje trajtohen në gjykatat civile; ndërsa në Francë dhe në Luksemburg këto çështje trajtohen si nga gjykatat administrative dhe nga ato civile. Gjykata e Tregut në Finlandë është e specializuar për prokurim publik, por trajton dhe fusha të tjera të së drejtës ekonomike.

Gjykatat administrative dhe civile kanë ende rol të rëndësishëm për të luajtur në pjesën më të madhe të shteteve anëtare me mekanizma të specializuar të rishikimit të prokurimit publik, pasi vendimet e këtyre organeve të specializuara janë objekt apelimi për në **Gjykatën e Lartë Administrative** dhe madje dhe në **Gjykatën e Lartë**. Në Sllovakia, apelimet bëhen në dy shkallë të gjykatave të zakonshme, në Gjermani dhe në Danimarkë në Gjykatat e Larta të Shtetit, dhe në Hungari dhe në Poloni në **gjykata të zakonshme të shkallëve më të ulëta**. Në shumë shtete anëtare **dëmshpërblimi i dëmeve** përjashtohet nga juridiksioni i organeve të specializuara të rishikimit të prokurimit publik dhe është objekt shqyrtimi nga gjykatat civile ose të zakonshme.

Tabela 2. Rishikimi i shkallës së parë para dhe pas përfundimit të Kontratës

	Organi i specializuar i rishikimit	Gjykatë civile ose e zakonshme	Gjykatë administrative
Para përfundimit të kontratës	Austria, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Letonia, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia	Belgjika (ndërmarrjet), Danimarka, Franca (private ndërmarrje private), Irlanda, Lituania, Luksemburgu (ndërmarrje), Holanda, Mbretëria e Bashkuar	Belgjika (publike), Estonia, Franca (publike), Luksemburgu (publik), Portugalia, Suedia
Pas përfundimit të kontratës (dëmet)	Danimarka	Belgjika (ndërmarrjet), Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda (ndërmarrjet publike), Gjermania, Hungaria, Irlanda, Letonia, Lituania, Luksemburgu	Belgjika (publike), Franca (publike), Luksemburgu (publike), Portugalia, Rumania

		(ndërmarrja), Malta, Vendet e Ulëta, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar	
--	--	--	--

2.4 Apelet

Pjesa më e madhe e shteteve anëtare lejojnë apelimin kundër vendimit të rishikimit të shkallës së parë; me fjalë të tjera, ata lejojnë **një shkallë të dytë gjykimi**, e cila mund të anulohet ose ndryshohet vendimin e organeve të rishikimit të shkallës së parë, siç u diskutua në një pikë më lart. Vetëm Belgjika, Malta dhe Sllovenia nuk duket se kanë proces apelimi kundër vendimeve të rishikimit të marra para përfundimit të kontratës.

Shkallët e dyta ndryshojnë në varësi, *inter alia*, të sistemi të dyfishtë ose të njëfishtë të shteteve anëtare. Në shumë shtete anëtare ku dëmshpërblimi për dëmet kërkohet në gjykata civile pas përfundimit të kontratës, mund të përdoren **gjykatat civile të apelit** për tenderuesit të cilët nuk janë të kënaqur me vendimin e marrë pas procesit të rishikimit.

Në shtetet anëtare me një sistem të njëfishtë rishikimi gjykatat civile të apelit, të tilla si **Gjykatat e Larta** ose **Gjykatat e Apelit**, shërbejnë për shkallën e dytë të gjykimit. Në Qipro, Irlandë, dhe Danimarkë, gjykatat e larta janë gjykatat e shkallës së dytë dhe të fundit. Në Austri, Bullgari, Republikën Çeke, Finlandë dhe Portugalí, tenderuesit apelojnë drejtpërsëdrejti në **Gjykatën e Lartë Administrative**, në Austri dhe në **Gjykatën Kushtetuese**, ndërsa në Francë dhe në Suedi ka **gjykata administrative apeli të shkallës së dytë** përpara gjykatave të larta administrative të shkallës së tretë.

Vendet me një organ të specializuar rishikimi të prokurimit publik në shkallë të parë, zakonisht kanë një gjykatë (apeli) shkallë të dytë. Në kundërshtim me këtë normë, në Republikën Çeke dhe në Poloni, Kryetarët e Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Zyrës së Prokurimit publik veprojnë respektivisht si “shkallë e dytë” e veçantë rishikimi kundër vendimeve të shkallës së parë në bordet e tyre të apelit.

Në Rumani dhe Gjermani organet e specializuara të prokurimit publik janë përgjegjëse të rishikimit të shkallës së parë. Gjithsesi, si shkallë e dytë, tenderuesit janë të lirë të apelojnë në një gjykatë të përgjithshme. Në Rumani, Gjykata e Apelit ka një panel të posaçëm prokurimi dhe në Gjermani Gjykatat e Larta të Shtetit kanë senate të posaçme prokurimi që merren me këto apele.

2.5 Organet e Rishikimit të shkallës së fundit

Të gjitha shtetet objekt i këtij studimi kanë elemente të përbashkëta në lidhje me sistemet e rishikimit të prokurimit publik dhe dëmshpërblimeve kur flitet për **organet e rishikimit të shkallës së fundit**. Organi më i lartë dhe i shkallës së fundit të rishikimit si para dhe pas përfundimit të kontratës është një gjykatë administrative ose e zakonshme. Me pak përjashtime, si Malta dhe Sllovenia, bordet e specializuara të rishikimit janë shkalla e fundit e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve para përfundimit të kontratës, ndërsa mosmarrëveshjet pas përfundimit të kontratës trajtohen nga gjykatat e zakonshme. Të gjitha këto gjykata janë krijuar mbi bazën e Kushtetutave dhe akteve përkatëse të Parlamentit, dhe ato plotësojnë kërkesat e një gjykate, siç parashtrohet në vendimet për çështjen *Dorsch* dhe *Salzmann* të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Ato janë krijuar mbi bazën e një ligji ose nga një ligj, janë struktura të përhershme, vendimet e tyre janë detyruese për zbatim, procedura e tyre është procedurë *inter partes* dhe ato marrin vendime mbi bazën e rregullave ligjore. Të gjitha gjykatat janë të pavarura nga ekzekutivi dhe vendimet e tyre kanë natyrë juridike. Gjyqtarët e tyre duhet të jenë juristë me eksperiencë e të njohur. Në përgjithësi ata janë gjyqtarët më të mirë në selitë e gjykatave të shteteve të tyre. Ligjet kombëtare të shteteve anëtare kërkojnë që gjyqtarët të jenë të pavarur. Ata nuk mund të hiqen nga detyra, ose mund të hiqen vetëm në raste shumë të veçanta dhe në kushte të përcaktuara në mënyrë shumë strikte. Kryetarët e të gjitha gjykatave emërohen

nga qeveria, parlamenti ose një komision i posaçëm emërimi, ose zgjidhen nga vetë gjykatat. Gjithsesi, duhet të theksohet se dhe organet e rishikimit të shkallës së dytë në shtetet anëtare të përshkruara më lart në dy pikat e fundit i plotësojnë kërkesat e një gjykate.

Ekzistojnë dallime në lidhje me **numrin e shkallëve** ku mund të drejtohen tenderuesit. Në lidhje me rishikimin e vendimeve para përfundimit të kontratës, për tenderuesit në Belgjikë, Maltë dhe Slloveni ofrohet një shkallë rishikimi, ndërsa kolegët e tyre në Lituani, Holandë, Sllovaki dhe Mbretërinë e Madhe mund t'i drejtohen tri shkallëve të rishikimit. Të gjitha shtetet e tjera anëtare kanë procedurë rishikimi të prokurimit publik me dy shkallë para përfundimit të kontratës. Përdorimi aktual në praktikë i mundësive të apelimit në organet e rishikimit të shkallës së fundit do të diskutohen më poshtë në kuadrin e kulturës së rishikimit.

Tabela 3. Raste të rishikimit të vendimeve të prokurimeve përpara dhënies së kontratës

Shkalla	Organ i Posaçëm Rishikimi	Gjykatë Administrative	Gjykatë e Zakonshme
Shkalla e 1-rë	Austria, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Letonia, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia	Belgjika, Estonia, Franca (publike), Luksemburgu (publike), Suedia	Danimarka, Franca (ndërmarrje private), Irlanda, Lituania, Luksemburgu (ndërmarrje), Holanda, Mbretëria e Bashkuar
Shkalla e 2-të		Austri, Bullgari, Republika Çeke, Estoni, Finlandë, Francë (publike), Letoni, Luksemburg (publik), Portugali, Suedi	Qipro, Danimarkë, Francë (ndërmarrje private), Gjermani, Hungari, Irlandë, Lituani, Luksemburg (ndërmarrje), Holandë, Poloni, Rumani, Sllovaki, Mbretëria e Bashkuar.
Shkalla e 3-të		Letoni, Portugali, Suedi	Estonia, Franca (ndërmarrje private), Hungaria, Lituania, Holanda, Sllovakia, Mbretëria e Bashkuar

2.6 Dëshmitë dhe pajtimi

Në përputhje me Direktivën 92/13/KEE të KE-së, sektori i ndërmarrjeve në shtetet anëtare ka në dispozicion mekanizma **dëshmish** dhe **pajtimi**. Pavarësisht nga ekzistenca e tyre, studimi konstatoi se ato përdoren rrallë në praktikë. Në kuadrin e rishikimit aktual të direktivave do shqyrtohet heqja e këtyre instrumenteve.

2.7 Avokati i Popullit dhe Organet Këshillimore

Në disa shtete anëtare, për shembull në Holandë, **Avokati i Popullit** mund të luajë rol në mosmarrëveshjet e prokurimeve publike. Ky institucion i pavarur me akses në të gjithë degët e qeverisë mund të jetë në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet tenderuesve dhe autoriteteve kontraktuese, duke shmangur në këtë mënyrë legjislacionin e kushtueshëm dhe të zgjatur në kohë.

Në Gjermani tenderuesit lejohen të sfidojnë vendimet e prokurimeve para **Bordeve të Rishikimeve të Prokurimit Publik**. Këto borde mund të krijohen në nivelin e shteteve federale dhe të federatës dhe kanë

kompetencë të urdhërojnë organet kontraktuese, ose me anë të peticionit ose kryesisht, të anulojnë një vendim të paligjshëm ose të marrin një masë të ligjshme. Bordet nuk kanë kompetencë të pezullojnë një procedurë tenderimi. Një procedurë rishikimi para këtij bordi nuk është parakusht për mbushjen e një aplikimi për rishikim para Dhomave të Prokurimit Publik. Po ashtu, **Autoriteti Danez i Konkurrencës dhe Komisioni i Tenderave të Luksemburgut** janë organe këshillimore, dhe vendimet e tyre nuk janë as detyruese për autoritetet kontraktuese dhe as nuk mund të trajtohen në procese gjyqësore të rishikimit. Mundësitë e pajtimit jashtë gjykate mund të lejojnë një alternativë më pak konfrontuese, më pak të kushtueshme, me më pak kohë dhe më konstruktive sesa një proces klasik gjyqësor.

2.8 *Forumet kryesore të rishikimit*

Duke pasur parasysh **forumet kryesore të rishikimit të prokurimeve publike në praktikë**, ka dallime të mëdha ndërmjet shteteve anëtare në lidhje me kuadrin institucional të sistemeve të tyre të rishikimit dhe dëmshpërblimit dhe, si rezultat, klasifikimet në grupet kryesore bëhen më të vështira. Nocioni i “forumit kryesor” përshkruan institucionin e rishikimit ose organin e rishikimit ku zgjidhet në praktikë pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve për prokurimet publike. Këto mund të jenë organet kontraktuese dhe vetë subjektet, eprorë e tyre në administratë (Portugali), bordet e pavarura të rishikimit të prokurimit publik (Danimarkë, Estoni, Gjermani, Hungari, Letoni dhe Poloni), autoriteti i konkurrencës (Republika Çeke), gjykatat administrative të shkallës së parë ose të shkallës së dytë (Lituani dhe Holandë), ose gjykatat e larta (Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar).

3. **Dëmshpërblimet e disponueshme**

Studimi nuk bën dallim mbi bazën e natyrës së kontratave (kontrata publike ose koncesionare) të cilat mund të kenë ndikim mbi përfundimet e nxjerra në këtë seksion. Kjo lidhet në veçanti me shtetet anëtare ku përgjegjësitë për dëmshpërblimet në fushën e koncesioneve trajtohen në mënyrë të ndryshme në rastin e kontratave publike.

Një tjetër çështje e rëndësishme lidhet me dëmshpërblimet që përcaktojnë organet e rishikimit dhe gjykatat pas procesit të rishikimit për tenderuesin e dëmtuar nëse pretendimi i tij/saj del se është i justifikuar. Dëmshpërblimet e disponueshme që mund të jepen nga organi përkatës i rishikimit në pjesën më të madhe të juridiksioneve përfshijnë (i) **pezullimin** e çdo vendimi individual prokurimi publik, duke përfshirë dhe vendimin e dhënies së kontratës, (ii) **masat e përkohshme**, (iii) **anulimin e kontratës së përfunduar** (në disa juridiksione), dhe (iv) **dëmet**. **Pagesat e gjobave periodike** për ndërmarrjet është një formë dëmshpërblimi që nuk është e disponueshme në të gjithë shtetet anëtare.

3.1 *Pezullimi i vendimeve të prokurimit publik*

Pezullimi i një vendimi për prokurim publik të marrë gjatë një procedure prokurimi para përfundimit të një kontrate është një dëmshpërblim i zakonshëm i disponueshëm nga shtetet anëtare. Vendimet për pezullim mund të lidhen me një njoftim për kontratë të paligjshme, specifikime ose dokumente diskriminuese tenderi ose madje dhe vetë vendimi për kontratë. Më tej, organet e rishikimit mund të urdhërojnë dhe heqjen ose ndryshimin e specifikimeve dhe të dokumenteve të tjera të tenderit, ose nisjen e procedurës së prokurimit në total, ose nga një pike specifike në kohë. Ky lloj dëmshpërblimi është i disponueshëm për shtetet anëtare. Mbrojtja ligjore është e pranueshme kundrejt vendimeve **para përfundimit** të kontratës, dhe në disa shtete anëtare kjo mbrojtje ligjore është e pranueshme dhe pas përfundimit të kontratës, megjithëse kjo është më pak efektive në praktikë. Normalisht kjo kërkon një **shkelje** të ligjit të prokurimit publik ose të rregulloreve të tjera që lidhen me vendimin që aplikuesit duhet t'i pezullohet kontrata. Mund të ekzistojnë shkelje të ndryshme, të tilla si diskriminimi i tenderuesve, shkelje e parimeve të barazisë së trajtimit, mungesa e transparencës, ose përdorimi i kriterëve diskriminues për dhënien e kontratës. Barra e provës i takon aplikuesit, por ka dhe ca juridiksione të cilët parashikojnë se tenderuesit mund të pretendojnë këto lloje shkeljesh dhe në këto raste është ose autoriteti kontraktues, ose subjekti kontraktues

që duhet të provojnë që nuk ka ndodhur shkelja e pretenduar, ose duhet të jetë organi i rishikimit ai i cili duhet të japë ca prova (sistemi inkuizitor ose mbledhje provash).

Në shtetet që kanë një organ të specializuar prokurimi publik, zakonisht është ky organ që mund të lërë mënjanë ose mund të pezullojë vendimet e prokurimeve publike, por, për shembull, në Danimarkë, këtë gjë mund ta bëjnë dhe gjykatat e zakonshme. Në shtetet pa një strukturë të tillë të specializuar, ky dëmshpërblim zakonisht është i disponueshëm në shkallën e parë të rishikimit. Pezullimi i një vendimi prokurimi publik mund të bëjë të nevojshme fillimin e plotë ose të pjesshëm të procedurës. Në disa juridiksione, një kontratë e nënshkruar pavarësisht nga vendimi i një organi rishikimi në lidhje me vendimin e dhënies së kontratës, ose një vendim tjetër të marrë gjatë ushtrimit të procedurës e bën kontratën të pavlefshme dhe mund të çojë në dhënie dëmshpërblimesh. Ky është rasti në Bullgari, Estoni, Poloni dhe Rumani.

Baza ligjore për këtë dëmshpërblim shpesh mund të gjendet në ligjin e prokurimit publik ose në vetë aktin përkatës. Gjithsesi, në disa shtete anëtare baza ligjore mund të gjendet e shprehur në Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile dhe në jurisprudencë (Holandë), në veçanti kur shteti anëtar nuk ka një organ të specializuar rishikimi për prokurimin publik.

3.2 *Masat e përkohshme*

Në pjesën më të madhe të shteteve anëtare depozitimi i një ankese apo ngritja e një padie kundër një vendimi për prokurim publik nuk pezullon automatikisht vijimin e procedurës së prokurimit. Vetëm në pak sisteme rishikimi në shtetet anëtare, të tilla si Estonia, Gjermania, Polonia, Rumania dhe Sllovenia, parashikohet **efekti i pezullimit** automatik për fillimin e proceseve të rishikimit. Disponueshmëria e masave të përkohshme është parakusht për efektivitetin e sistemit të rishikimit dhe të dëmshpërblimeve, pasi pa një efekt pezullues procedura e prokurimit mund të vijojë deri në përfundimin e kontratës, pa lejuar korrigjimin e veprimeve ose vendimeve të paligjshme. Siç u tha dhe më lart, përfundimi i kontratës mund të anulohet vetëm në raste shumë të kufizuara dhe strikte të përkufizuara. Dëmet pas përfundimit të kontratës, në këtë mënyrë, janë shpesh i vetmi element që mbetet për t'u dëmshpërblyer. Është me interes të theksohet se në Estoni në vitin 2006, Ligji i Prokurimit Publik e hoqi efektin e pezullimit automatik. Pra, në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, një tenderues që është i mendimit se interesat e tij dëmtohen nga vijimi i procedurës së prokurimit duhet të aplikojë specifikisht tek organi i rishikimit për masa të përkohshme, duke i kërkuar këtij të fundit të urdhërojë, për shembull, ndërprerjen e procedurës. Më pas organi i rishikimit mund të urdhërojë masat e përkohshme në pritje të një vendimi përfundimtar, duke marrë parasysh pasojat e mundshme të masave të përkohshme për të gjithë interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik dhe vendimmarrjes kundër dhënies së masave të tilla, kur pasojat janë më të mëdha se përfitimet. Në parim, të gjitha dëmshpërblimet mund të jepen si masa të përkohshme. **Kërkesat** për këtë “vendim paraprak” apo “të ndërmjetëm” në të gjitha juridiksionet janë: një interes i mirë-bazuar i ankimesit dhe një shkelje e dyshuar, ose e pretenduar e ligjit. Në shtetet anëtare specifike mund të aplikohen kërkesa shtesë.

Periudha pezull prej zakonisht 10 ditësh nga vendimi i dhënies së kontratës dhe përfundimit të kontratës, e përmendur më lart, lidhet me efektin pezullues. Nëse nuk ka efekt automatik pezullues, ose nëse pezullimi i procedurës së prokurimit nuk mund të urdhërohet shpejt dhe lehtë nga gjyqtarët, ose anëtarët e trupit rishikues, periudha pezull dhe afatet kohore për dhënien e një vendimi duhet të sinkronizohen për të siguruar efektivitetin e rishikimit. Për shembull, nëse periudha pezull është 10 ditë, por gjyqtarit i duhen 20 ditë për të vendosur për një padi të ngritur brenda periudhës pezull, vendimi i tij/saj mund të jetë shumë i vonuar pasi kontrata mund të jetë përfunduar ligjërisht në kohën e marrjes së vendimit.

Në Gjermani dhe Slloveni, siç u theksua dhe më lart, depozitimi i një ankese ka efekt automatik pezullues. Pra, situata është e **kundërta** e asaj që ndodh në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, pasi në Gjermani autoriteti, ose subjekti kontraktues mund t'i kërkojë organit të rishikimit leje për të hyrë në kontratë gjatë proceseve të rishikimit. Organi mund t'i japë lejen pas një periudhe dy javore që prej marrjes së vendimit,

nëse është e mendimit se pasojat negative të pezullimit janë më të mëdha se përfitimet, pasi shqyrton të gjitha interesat që mund të cenohen, duke përfshirë dhe interesat publike. Në Slloveni, Komisioni Kombëtar i Rishikimit mund të vendosë për lejimin e vijimit të procedurës së prokurimit, në përjashtim të përfundimit të kontratës.

3.3 Anulimi i një kontrate të përfunduar

Anulimi i një kontrate të përfunduar, ose i një deklarimi që një kontratë është e pavlefshme nga një palë e tretë në kontratë është një mjet efektiv ligjor në disa shtete anëtare, i cili zbatohet të paktën nëse kontrata është përfunduar gjatë periudhës pezull. Kjo mundësi për të anuluar një kontratë të përfunduar është një mjet i rëndësishëm ligjor, pasi dëmet në juridiksionet pa këtë mundësi mbeten e vetmi mjet dëmshpërblimi pas përfundimit të kontratës. Pjesërisht duke marrë parasysh këtë fakt, shumë shtete anëtare kanë ndjekur Gjykatën Europiane të Drejtësisë në vendimin *Alcatel* dhe kanë prezantuar **periudhën pezull** prej rreth 10 ditësh ndërmjet vendimit të dhënies së kontratës për të filluar proceset që kërkojnë pezullimin e vendimit për dhënien e kontratës. Para prezantimit të kësaj periudhe, dhënia e kontratës dhe përfundimi i saj përbënin një akt të vetëm, ose të paktën ndodhnin në të njëjtën kohë, duke e bërë të pamundur kundërshtimin e vendimit për dhënien e kontratës dhe duke kufizuar mjetet e disponueshme ligjore për dëmet. Si rezultat, arsyeja më e rëndësishme për anulimin e kontratës së përfunduar është përfundimi i kontratës nga autoriteti kontraktues gjatë periudhës pezull, megjithëse kjo qasje nuk është e njëjtë në të gjitha shtetet anëtare. Në të gjitha rastet e tjera të ndryshme nga përfundimi i kontratës gjatë periudhës pezull, është e vështirë të sigurohet anulimi i kontratës së përfunduar, e ndonjëherë ai nuk është i mundur fare. Për shembull, në Qipro, Republikën Çeke dhe Letoni, ky anulim mund të sigurohet vetëm nga gjykata, ndërsa pezullimi i vendimeve të tjera të prokurimeve mund të bëhet nga organe të tjera të specializuara rishikimi. Sipas të drejtës administrative franceze, vetëm prefekti mund të aplikojë për anulimin e një kontrate të përfunduar. Palët në kontratë mund t'u kërkojnë gjykatës kompetente të deklarojnë të pavlefshme kontratën. Palët e treta nuk mund ta kërkojnë këtë gjë, por nëse marrin anulimin e një akti që lidhet me dhënien e një kontrate, ata mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë subjektin kontraktues të aplikojë për një deklaratë anulimi të kontratës së përfunduar mbi bazën e një akti anulimi. Në Lituanë anulimi nuk është i mundur ku klauzolat e kontratës përcaktojnë kushte të paligjshme. Në Austri anulimi është teorikisht i mundur, por nuk ka pasur kurrë raste të ndodhjes së tij në praktikë, ndërsa në Belgjikë anulimi mund të kërkojë katër deri në pesë vite. Në Holandë, nënshkrimi i kontratës mund të **anulohet** nga gjykata vetëm në rast se shkelet rendi publik (*ordre public*). Në Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar anulimi është i mundur vetëm në rast mashtrimi ose rrethanash të paligjshme. Në Irlandë teorikisht është e mundur që gjykata ta deklarojë një kontratë publike të pavlefshme nëse ajo është arritur në shkelje të ligjeve kombëtare që transpozojnë Direktivat e Prokurimit Publik. Gjithsesi, në praktikë kjo nuk ka ndodhur kurrë.

Tabela 4. Periudhat pezull ndërmjet vendimit për dhënien e kontratës dhe nënshkrimit të kontratës (në ditë)

Austri	7 ose 14	Lituanë	10
Bullgari	10	Luksemburg	15
Republika Çeke	15	Maltë	10
Danimarkë	7-10	Holandë	15
Estoni	14	Poloni	7
Finlandë	21 ose 28	Portugali	10
Francë	10	Rumani	15
Gjermani	14	Sllovaki	14
Hungari	8	Slloveni	20
Irlandë	14	Suedi	10
Itali	30		

3.4 Dëmet

Në shumë raste, tenderuesi mund të ketë qenë objekt disavantazhesh si rezultat i mos respektimit të rregullave të prokurimit publik nga autoriteti kontraktues, gjë e cila është zbuluar nga tenderuesi pas nënshkrimit të kontratës, në një fazë ku nuk ka masa efektive të disponueshme për sa i përket lënies mënjane ose pezullimit të një vendimi individual prokurimi apo dhe anulimit të kontratës. Në këto rrethana, humbja mund të kompensohet vetëm me anë të dëmshpërblimeve për dëmin. Ky kompensim është i disponueshëm thuajse në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Kërkesat për dhënien e kompensimit për dëmet, të cilat janë të njëjta për pjesën më të madhe të juridiksioneve, janë si më poshtë: humbje (materiale apo tjetër) që pësohet nga ankimesi, shkelje ligji nga autoriteti ose subjekti kontraktues, fatkeqësitë (shkak dhe pasojë – çfarë do të thotë që humbja duhet të jetë shkaktuar nga shkelja e ligjit). Kërkesat shtesë zbatohen për juridiksione individuale. Për shembull, në Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, dhe Suedi, ankuesi duhet të provojë se ai/ajo do të kishin pasur mundësi të fitonin kontratën nëse procedura do të ishte përmbyllur sipas rregullave ligjore. Baza ligjore për dëmet zakonisht gjendet në ligjin e përgjithshëm civil (në kodin civil, kodin e procedurës civile, ligjet e detyrimeve, jurisprudencë, ose në të drejtën administrative, si në rastin e Francës dhe Rumanisë. Ligji i përgjithshëm ose specifik i prokurimit publik është ligji burimor në Danimarkë, ku është Bordi i Ankesave për Prokurimet Publike organi që vendos për çështjen, ndërsa gjykatat e rregullta vendosin për dëmet mbi bazën e ligjit të zakonshëm të detyrimeve. Në rastet e tjera, janë zakonisht gjykatat civile, dhe në disa juridiksione dhe gjykatat administrative (si në Francë dhe në Rumani) të cilat kanë kompetencë të vlerësojnë dëmet, dhe jo organet e specializuara të prokurimeve publike. Në pjesën më të madhe të Shteteve Anëtare, nuk është e nevojshme që vendimi i kontestuar të pezullohet para pretendimit për dëme.

Në lidhje me **përlllogaritjen e dëmeve**, kostot e tenderit (*damnum emergens*) mund të rimbursohen në të gjitha shtetet anëtare. Për sa i përket fitimeve të munguara, ndërmjet tyre ka dhe dallime (*lucrum cessans*). Të paktën në Danimarkë, Finlandë, Gjermani, Hungari, Letoni, Lituani, Holandë, Portugali, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar, mund të dëmshpërblehen dhe fitimet e munguara, ndërsa në Francë jepet dëmshpërblim edhe nëse ankuesi ka pasur mundësi të *konsiderueshme* për të ftuar kontratën (më shumë sesa thjeshtë një mundësi). Siç u përmend më lart, në përgjithësi tenderuesi duhet të provojë se ai/ajo kanë pasur mundësi të vërtetë të fitojnë një kontratë të realizuar nga një vendim i paligjshëm. Nëse ankuesit nuk e plotësojnë këtë kusht, ato thjesht kanë të drejtë të marrin kostot e tenderit. Në Letoni, dëmet shumë rrallë shkojnë përtej kostove të tenderit dhe në pjesën më të madhe të shteteve anëtare është shumë e vështirë të ofrohen provat e kërkuara për dëmet për fitimet e humbura. Si rezultat, numri i kërkesave për dëmet është relativisht i ulët në pjesën më të madhe të shteteve, siç janë dhe vendimet në favor të ankuesve.

3.5 Gjobat materiale dhe pagimi i gjobave periodike

Sipas 92/13/KEE, Neni 2 para. 1c), në mënyrë që autoritetet dhe subjektet kontraktuese të detyrohen në zbatojnë vendimet e tyre, gjykatat dhe organet e tjera të rishikimit mund të vendosin pagesa periodike gjobash duke e ndaluar autoritetin ose subjektin kontraktues të vijojë me procedurën e dhënies deri sa të jetë ndrequr shkelja. Kjo mundësi parashikohet të paktën në Qipro, Danimarkë dhe Luksemburg; në Francë ajo parashikohet në lidhje me ndërmarrjet. Për më tepër, në Republikën Çeke, Poloni dhe Slloveni, mund të vendosen pagesa të ndryshme gjobash dhe tarifash për autoritete dhe njësitë kontraktuese. Këto pagesa nuk janë mjete dëmshpërblyese për tenderuesit, por janë pjesë e sistemeve të rishikimit të prokurimeve publike të Shteteve Anëtare.

4. Kuadri ligjor që drejton sistemet e rishikimit të Shteteve Anëtare

Kuadri legjislativ i sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit është një tjetër pikë reference e këtij studimi. Nocioni “kuadër legjislativ” përshkruan një koncept të gjerë që mbulon bazën ligjore të krijimit të organeve të rishikimit, mbulimin e sistemit dhe të drejtën procedurale. E drejta procedurale rregullon, ndër të tjera, çështje të tilla si për shembull kush lejohet të fillojë proceset (iniciativa ligjore), sa shpejt duhet t’i

fillojë ai, ose ajo këto procese (afatet kohore), efektet e fillimit të proceseve me procedurën e prokurimeve (efekti vezullues dhe periudha e pezullimit) dhe sa të kushtueshme janë këto procese. Përputhshmëria me kërkesat e përgjithshme dhe specifike të Direktivës së Dëmshpërblimeve 89/665/KEE, 92/13/KEE dhe e drejta e Komunitetit në përgjithësi do të jenë çështje e rëndësishme në këtë kuadër, pasi ato mund të japin një bazë të përbashkët për të gjitha sistemet kombëtare. Këtu përfshihet dhe çështja nëse dhe në çfarë masë sistemet e rishikimit dhe të dëmshpërblimit shtrihen tek kontratat që janë jashtë qëllimit të direktivave të prokurimit publik dhe nëse i njëjti sistem zbatohet për organet dhe ndërmarrjet publike.

4.1 Objektivi i sistemit të rishikimit dhe dëmshpërblimit

Përderisa përmendet vetëm referenca tek Direktivat e BE-së, ligji kombëtar i prokurimeve në përgjithësi dhe sistemi i rishikimit dhe i dëmshpërblimit në veçanti mund të aplikohet për të gjitha kontratat e dhëna si nga **autoritetet kontraktuese dhe ndërmarrjet publike dhe private**. Në mënyrë alternative ai mund të zbatohet dhe mbi prapen e direktivave të prokurimit publik të KE-së, ose vetëm mbi kontratat e dhëna nga autoritetet publike, ndërkohë që ekziston një sistem i veçantë për kontratat e dhëna nga ndërmarrjet, ose organet e drejtuara nga e drejta publike e që kanë statusin e një shoqërie tregtare private. Së fundmi, sistemet e rishikimit dhe të dëmshpërblimeve të disa shteteve anëtare janë zgjatuar për të zbatuar dhe kontratat jashtë fushës së aplikimit të Direktivave të Prokurimit Publik të KE-së, si për shembull koncesionet e shërbimit.

4.1.1 Mbulimi i Kontratës — mbi dhe nën prapjen e Direktivave të Prokurimit Publik të KE-së

Ka tri përgjigje të ndryshme për pyetjen nëse sistemi i rishikimit dhe dëmshpërblimit të prokurimit publik zbatohet në mënyrë të barabartë poshtë dhe mbi prapjen e Direktivave të Prokurimit Publik të KE-së. Së pari, në grupin më të madh të Shteteve Anëtare, sistemi i rishikimit dhe i dëmshpërblimeve **zbatohet në mënyrë të barabartë** mbi kontratat mbi dhe nën prapje. Ky grup përbëhet nga të paktën Qiproja, Estonia, Franca, Hungaria, Lituania, Holanda, Portugalia, Rumania, Sllovenia, dhe Suedia. Së dyti, në një grup të vogël shtetesh anëtare, sistemi i rishikimit dhe i dëmshpërblimit **zbatohet vetëm për kontratat mbi prapjen**. Ky grup përbëhet nga të paktën Gjermania, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar. Së treti, në pak shtete anëtare, ka **dallime thelbësore** për sistemin e rishikimit dhe dëmshpërblimeve për sa i përket kontratave nën prapje. Për shembull, në Republikën Çeke duhet të plotësohen kërkesa shtesë për sa i përket disa dëmshpërblimeve specifike, në Danimarkë në disa situata ekziston një bazë e ndryshme ligjore për dëmshpërblimet dhe në Finlandë ekziston një rrugë tërësisht e ndryshme për rishikimin gjyqësor.

4.1.2 Dallimet në mbulimin organizativ – autoritetet kontraktuese kundrejt ndërmarrjeve

Dallimet në sistemet e rishikimit dhe dëmshpërblimit në shtetet anëtare mund të dalin kur kontratat jepet nga një autoritet ose organ publik. Për më tepër, mund të ketë rregulla të ndryshme që zbatohen për ndërmarrjet publike dhe private. Gjithsesi, në shumë shtete anëtare, të tilla si Bullgaria, Estonia, Lituania dhe Holanda, **sistemi i dëmshpërblimit zbatohet në mënyrë të barabartë** për të gjitha autoritetet dhe ndërmarrjet kontraktuese. Në Francë ka bazë të ndryshme ligjore dhe **organe të ndryshme rishikimi** në varësi të faktit nëse kontrata jepet nga një ndërmarrjet publike ose nga një organ sipas të drejtës franceze; në Luksemburg, këto faktorë varen nëse subjekti kontraktues është ndërmarrje publik ose private. Në Letoni rishikimet dhe dëmshpërblimet e kryera nga Byroja e Monitorimit të Prokurimit nuk është e disponueshme për kontratat nën prapjen e ndërmarrjeve. Po ashtu, në Poloni nuk ka fare rishikim për kontaktet nën prapjen e dhëna nga ndërmarrjet.

4.2 E drejta procedurale

E drejta procedurale rregullon proceset në gjykata dhe në organe të tjera rishikimi. Ajo mbulon çështje të tilla si pozicionimin ligjor, pra të drejtën për të filluar proceset e rishikimit, afatet kohore, pra afatin kohor për fillimin e proceseve, tarifat dhe kostot, botimin e vendimeve dhe proceset e apelimeve. Së fundmi, e drejta procedurale përcakton çështje të rëndësishme, të tilla si aksesit në proceset e rishikimit (pozicioni juridik) dhe shpejtësinë e tyre (kufijtë kohorë). Vendi për rregullimin e së drejtës procedurale të organit të rishikimit varet nga karakteri i tij institucional. Në përgjithësi e drejta procedurale për gjykata e zakonshme ose civile rregullohet në (i) **kodet e procedurave civile të gjykatave kombëtare**, ndërsa e drejta procedurale për gjykatat administrative rregullohet në (ii) **kodet e procedurave administrative të gjykatave**, dhe e drejta procedurale e organeve të specializuara të prokurimeve rregullohet në (iii) **të drejtën publike të prokurimeve ose një kod specifik procedurash**. Në shumë shtete anëtare, shpesh kemi të bëjmë me një kombinim të burimeve të ndryshme ligjore, të tilla si:

- Në Bullgari, Republikën Çeke, Letoni, Portugali dhe Rumani, e drejta përkatëse procedurale rregullohet në të drejtën publike të prokurimeve, ose në rregulloren e kombinuar me kodin e rregullt të procedurës administrative që drejton proceset në gjykatat administrative.
- Në Gjermani, Lituani, Holandë dhe Mbretërinë e Bashkuar, e drejta ose rregullorja e prokurimit publik dhe e drejta e procedurës civile rregullojnë ligjin përkatës procedural.
- Në Francë, Hungari, Luksemburg dhe Suedi, proceset trajtohen si në kodin administrativ dhe në atë civil.
- Së fundmi, Sllovenia ka një kod të posaçëm për procedurën e rishikimit të prokurimit publik, e cila drejton procedurat e rishikimit në të gjitha shkallët e procesit.

4.2.1 Legjitimimi

Zakonisht jo çdokush lejohet të ndërpresë procedurat e prokurimit publik duke kërkuar procese rishikimi për to. Rregullat e *locus standi*, ose të legjitimitit specifikojnë se **kush mund të fillojë proceset e rishikimit**. Këto rregulla mund të jenë komplekse dhe mund të jenë të ndryshme në varësi të llojit të dëshmipërblimit që kërkohet, organit të rishikimit dhe procedurës së prokurimit për të cilën nisen proceset e rishikimit, shpesh ose para ose pas përfundimit të kontratës. Mund t'i drejtohem dhe nenit 1(3) të Direktivës që parashikon kërkesat për pranueshmërinë në lidhje me *locus standi*.

Në pjesën më të madhe të shteteve anëtare tenderuesit që duan të kundërshtojnë procedurat e tenderit duke filluar proceset e rishikimit duhet të dëshmojnë një **interes të veçantë** për kontratën në fjalë, në të kundërt ata nuk lejohen të fillojnë proceset. Shpesh janë tenderuesit që mund të provojnë këtë interes në procedurë, por në disa raste operatorët ekonomikë që nuk janë tenderues kanë *locus standi* (p.sh. shih çështjen Grossmann C-230/02). Pra, rezulton që në Estoni, për shembull, vetëm tenderuesit për kontratën në fjalë mund të fillojnë proceset. Të qenit tenderues zakonisht kërkon ofrimin e dokumentacionit të tenderit për kontratën objekt rishikimi. Në Bullgari, Qipro, Gjermani, Hungari, Irlandë, Letoni, Poloni, ata që aplikojnë për rishikim juridik duhet të dëshmojnë interes për procedurën e tenderimit, ndërsa në Holandë duhet të ekzistojë “një interes i qenësishëm”, ndërsa në Rumani duhet të ketë “interes legjitim”. Çdo furnizues ose ofruer që është i interesuar në marrjen e kontratës, dhe në rast se ai/ajo nuk ka paraqitur dokumente, mund të nisë një proces në Suedi. Në Gjermani, në rastet kur aplikuesi nuk ka paraqitur ofertë, duhet të dëshmohet se ai/ajo janë parandaluar nga tenderimi për shkak të sjelljes së autoritetit kontraktues. Në Luksemburg, çdokush që i ka plotësuar kërkesat e pjesëmarrjes në një procedurë tenderi dhe që mendon se i janë cenuar të drejtat mund të fillojë një proces. Së fundmi, në Slloveni, aplikuesi duhet të dëshmojë interes të vërtetë për dhënien e kontratës dhe duhet të japë prova për probabilitetin real se ai mund të kishte qenë objekt humbje.

Në **Francë** legjitimi varet nga lloji i proceseve. Në proceset përmbledhëse parakontraktuale kanë legjitimitet vetëm kandidatët ose tenderuesit aktualë, ose vetëm ata që mund të jenë parandaluar në mënyrë të paligjshme për të marrë pjesë në tender, si, për shembull, nëpërmjet mungesës së publikimit. Gjithsesi, në aplikimet e zakonshme për anulim legjitimitet kanë dhe palë të tjera, të tilla si anëtarët ose këshilli lokal, dhe madje dhe taksapaguesit lokalë.

Për më tepër, në disa shtete anëtare, **palët e treta** të ndryshme nga tenderuesit aktualë ose të mundshëm, ose nga subjektet kontraktuese kanë legjitimitet në proceset e rishikimit. Për shembull, Zyra Sllovaqe për Prokurimin Publik mund të fillojë procese me iniciativën e saj dhe e bën këtë gjë shumë shpesh. Ankesat drejtuar Bordit Danez të Ankesave për Prokurimin Publik mund të dërgohen me shkrim nga çdo person që ka një interes ligjor në këtë proces dhe nga Autoriteti Ligjor Danez, Ministri i Strehimit dhe Çështjeve Urbane dhe organizata (profesionale) dhe organe publike të cilat kanë pasur më parë akses në procese para Bordit nga Ministri i Ekonomisë dhe i Çështjeve të Biznesit. Aksesit për këto organizata dhe autoritete publike për këto procese u prezantua për të lejuar rishikimin e vendimeve të prokurimit në rast se asnjë tenderues individual nuk donte të depozitonte një ankesë. Proceset gjyqësore në Gjykatën e Tregut në Finlandë mund të fillohen nga pala në fjalë, që është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financës në çështje që lidhen me punën e kontraktuar ose disa çështje të tjera, dhe autoriteti publik që ka dhënë ndihmë shtetërore specifike për zbatimin e punimeve të kontratës në fjalë. Avantazhi kryesor për dhënin e legjitimitetit për të gjithë këta aktorë është që ky akses zgjidh shumë nga problemet e zgjidhura nga shumë tenderues, të cilët janë të frikësuar që një ankesë ose një padi mund të komprometojë shanset për një kontratë të mëpasshme.

4.2.2 Afatet kohore

Në disa shtete anëtare, proceset për rishikimin e prokurimit publik nuk mund të fillojnë në çdo kohë. Disa shtete anëtare nuk kanë afate kohore ose këto afate kohore interpretohen në mënyrë kaq fleksibël sa çdo vendim i marrë gjatë procedurës së dhënies së tenderit mund të kundërshtohet pas njoftimit të vendimit. Aplikuesi për procedurën e rishikimit shpesh i fillojnë proceset brenda afateve të caktuara kohore. Llogaritja e afateve fillon nga momenti kur ato mësojnë për cenimin e pretenduar të së drejtës së prokurimit. Në lidhje me **dëmshpërblimet e ndryshme nga dëmshpërblimi i dëmeve**, këto afate kohore shërbejnë për arritjen e balancës ndërmjet interesave privatë të tenderuesve, nga njëra anë, dhe interesit publik për **sigurinë ligjore** të nevojshme për të filluar ekzekutimin e kontratës, nga ana tjetër. Ankesat i dërgohet drejtpërsëdrejti autoritetit ose subjektit kontraktues brenda kuadrove shumë të shkurtra kohore, si për shembull brenda 10 ditësh. Në shumë shtete anëtare ka një afat të përgjithshëm prej 10-15 ditësh për depozitimin e ankesës tel organi kompetent i rishikimit. Afatet kohore për kërkimin e dëmshpërblimit për **dëmet** shpesh janë të gjata, në përputhje me rregullat e përgjithshme të së drejtës civile dhe për shkak të faktit se ky lloj dëmshpërblimi zakonisht nuk prek vlefshmërinë dhe ekzekutimin e kontratës. Ky afat është një vit në Suedi, pesë vjet në Holandë dhe 30 vjet në Luksemburg.

Një tjetër çështje e lidhur janë afatet kohore brenda të cilave gjykatat dhe organet e rishikimit duhet të japin vendimin. Afatet kohore për trajtimin e një ankesë për vendimet e prokurimit nga **autoritetet kontraktuese** dhe nga subjekte janë shumë të shkurtra në shumë shtete anëtare. Për shembull, në Slloveni ky afat është 15 ditë, në Poloni 10 ditë dhe në Letoni vetëm 2 ditë pune.

Organet e specializuara të rishikimit të prokurimeve publike normalisht duhet ti marrin shumë shpejt vendimet e tyre: për shembull organi i Estonisë duhet të marrë vendim brenda 10 ditësh, kolegët e tyre bullgarë duhet të marrin vendimin brenda 14 ditësh, ndërsa autoriteti hungarez i prokurimit publik vendos brenda 15 ditësh nëse nuk ka seancë dëgjimore dhe brenda 30 ditësh nëse është e nevojshme seanca. Në Poloni panelet e rishikimit të Zyrës së Prokurimit Publik kanë 15 ditë në dispozicion, ndërsa kryetari i PPO-së ka një muaj në dispozicion për të marrë vendimin. Nëse çështja është e ndërlikuar, këto afate kohore mund të zgjaten. Zyra çeke për mbrojtjen e konkurrencës vendos brenda 30 ditësh dhe në çështje komplekse vendos brenda 60 ditësh, Këshilli Kombëtar Rumun për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ligjore

vendos brenda 10 ditësh, dhe në raste të ndërlikuara brenda 20 ditësh, ndërsa dhomat e prokurimit në Gjermani zakonisht vendosin për të gjitha çështjet brenda pesë javësh.

Gjykata zakonisht kërkojnë shumë më tepër kohë për të vendosur. Për shembull, Gjykata e Lartë qipriote vendos brenda 75 ditësh, gjykatat rajonale polake vendosin brenda 75 ditësh, gjykatat rajonale polake brenda 2-3 muajsh, të tria shkallët e treta të gjykatave administrative në Letoni vendosin brenda dy vjetësh, gjykata finlandeze e tregut zakonisht kërkon 6.2 muaj për çështjet e zakonshme dhe deri në një vit për çështjet e ndërlikuara. Gjykatat civile dhe administrative suedeze janë përgjithësisht të shpejta, pasi atyre u duhen zakonisht tre deri në katër javë për të vendosur. Po ashtu, një gjykatë e lartë irlandeze zakonisht vendos brenda pak javësh.

Ia vlen të përmendet se në disa shtete, si për shembull në Finlandë, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar nuk ka kufij kohor të detyrueshëm për organet kompetente për të marrë vendime, pavarësisht nëse vendimi i referohet procesit para dhënies së kontratës ose pas përfundimit të kontratës (kërkesë për dëmtim).

4.2.3 Efekti i depozitimit të një ankese ose padie

Sistemet e rishikimit të prokurimit publik janë të ndara në dy grupe të gjera në këtë studim, në varësi të faktit nëse fillimi i proceseve në një organ rishikimi prokurimi publik ka ose jo efekt pezullues automatik. Në Estoni, Gjermani, Poloni, Rumani dhe Slloveni, fillimi i proceseve ka efekt automatik pezullues në kontratë. Në shtete të tjera anëtare, tenderuesit duhet të zbatojnë vendimin paraprak, siç diskutohet më lart në seksionin 3.2.

4.2.4 Periudha pezull

Siç u theksua dhe më lart, shumë shtete anëtare kanë prezantuar periudhën pezull nga koha e marrjes së vendimit për dhënien e kontratës dhe deri tek përfundimi aktual i kontratës, kohë pas së cilës tenderuesi ka shpesh mundësi të marrë dëmshpërblim për dëmet. Gjatë kësaj periudhe prej 8 deri në 28 ditësh në shtetet anëtare, tenderuesit kanë mundësinë e kundërshtimit të vendimit për dhënien e kontratës nëpërmjet proceseve të rishikimit. Fakti nëse periudha pezull është e efektive varet nëse fillimi i proceseve ka efekt pezullimi (shih më sipër, seksioni 4.2.3.) dhe nëse përfundimi i një kontrate gjatë periudhës pezull e bën kontratën të pavlefshme dhe vendimet zakonisht merren brenda 20 ditësh (shih më lart, seksioni 4.2.2.), atëherë periudha pezull nuk është e vlefshme.

4.2.5 Komunikimi i vendimeve

Tenderuesit, por edhe autoritetet dhe subjektet kontraktuese që depozitojnë ankesë ose padi, duhet të informohen për rezultatet e proceseve të rishikimit. Mënyra më e zakonshme e përdorur nga një organ i specializuar rishikimi ose gjykatë në një shtet anëtar për informimin e palëve për një ankesë ose akuzë kundër një vendimi për prokurim publik është **posta** e rregullt. Plus, shumë organe rishikimi i botojnë vendimet e tyre në **faqet e internetit**. Për më tepër, është e zakonshme të botohen vendimet më të rëndësishme, veçanërisht vendimet e shkallëve të larta të gjyqimit në gjykata në librat vjetorë, botimet, **fletoret zyrtare** dhe organe të tjera të shtypit juridik. Praktika mund të zbatohet në të gjitha vendimet përkatëse, ose vetëm tek disa nga vendimet më kryesore. Në lidhje me gjykata e një niveli më të ulët në Lituanë, palët duhet të kërkojnë një kopje vendimi, në këmbim të një tarife të veçantë. Në përgjithësi, palët në proceset e rishikimit të prokurimit publik mësojnë për vendimet dhe vendimet nëpërmjet postës ose nëpërmjet faqeve të internetit, ndërsa vendimet më të rëndësishme me një interes më të përgjithshëm shpesh botohen në buletine zyrtare ose në shtypin juridik.

4.2.6 Kostot, tarifat dhe depozitat

Në shumë shtete anëtare, tenderuesit që fillojnë proceset e rishikimit duhet të paguajnë tarifat e gjykatës, depozitat, tarifat e ekspertëve dhe përfaqësimin ligjor. Rregullat për këto implikime financiare të rishikimit

ndryshojnë shumë në shtetet anëtare. Ato mund të ndryshojnë dhe në varësi të organit të rishikimit, dëshmipërblimit në fjalë, vlerës së kontratës, nëse vlera e kontratës është mbi ose nën pragjeve të direktivës së prokurimit publik të EK-së, dhe nëse proceset përfshijnë furnizimin, shërbimet dhe kontratë e punimeve. Tipari i vetëm i përbashkët është se në pjesën më të madhe të shteteve anëtare ankimi për autoritetin ose subjektin kontraktues është pa pagesë. Në disa shtete anëtare nuk paguhen **tarifa gjykate** në organet dhe gjykatat përkatëse të rishikimit. Tenderuesit kanë thjeshtë rrezikun e pagimit të kostove shtesë, të tilla si tarifatat për përfaqësimin ligjor ose për ekspertët. Në disa shtete anëtare ka “**taksa të sheshta**” për të gjitha proceset, pavarësisht nga lloji ose vlera e kontratës, përkatësisht në Danimarkë (€500 për Bordin e Ankesave), Finlandë (€204) dhe Lituanë (€30). Në Slloveni ekziston një taksë e sheshtë prej rreth €420 për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve dhe një taksë e sheshtë prej rreth €840 për kontratat e punimeve nën pragjeve të Direktivave të KE-së për Prokurimin Publik. Këto shuma dyfishohen kur bëhet fjalë për kontrata mbi pragje. Në Hungari ekzistojnë tarifa të ndryshme nën dhe mi pragjet e Direktivave. Por, në shtete të tjera anëtare ekziston një depozitë e **përqindjeve të caktuara të vlerës së kontratës** që paguhen si tarifë, për shembull 3% në Estoni, 5% në Gjykatat e Larta të Shtetit të Gjermanisë, 1% në Republikën Çeke, ose 1% për një vendim të ndërmjetëm në Bullgari. Së fundmi, në shumë shtete anëtare tarifa mund të varet zakonisht në vlerën e kontratës, për shembull në Qipro ose në Mbretërinë e Bashkuar. Zyra Polake e Prokurimit Publik ka një tarifë regjistrimi që varet tek vlera e kontratës, pavarësisht nëse është nën ose mbi pragun e Direktivave të Prokurimit Publik të KE-së, dhe pavarësisht nëse është një kontratë shërbimesh, furnizimesh ose punimesh. Në lidhje me tarifatat dhe kostot e tjera (përfaqësimi ligjor, udhëtimi, ekspertët, etj.) shumë shtete anëtare kanë një rregull sipas të cilit pala që humb duhet të mbulojë kostot e plota ose të pjeshme të shpenzimeve të palës fituese.

4.2.7 *Formularët model*

Organet e rishikimit duhet të kenë ca informacion minimal, si për shembull emrin dhe adresën e aplikuesit, objekti i mosmarrëveshjes, subjekti i procedurës së tenderit, arsyet faktike dhe ligjore si dhe provat. Si rezultat, ligjet e prokurimit publik të shumë shteteve anëtare parashikojnë se ankesat dhe paditë duhet të përmbajnë informacionin minimal të detyrueshëm. Për formularët model të detyrueshëm ose jo për zbatim ka argumente të shumta dhe informacioni për modelet e formularëve të detyrueshëm ose jo për përdorim për ankesa dhe padi gjatë proceseve të rishikimit të prokurimeve publike është i kufizuar. Pavarësisht nga kjo situatë, formularët model të detyrueshëm nuk kërkohen në pjesën më të madhe të shteteve anëtare. Në Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekziston një formular specifik për proceset e prokurimit publik, por për çështjet e prokurimit publik përdoren formularët e përgjithshëm si për të gjitha çështjet e tjera të ankimit. Në Holandë ekziston një formular model për informimin e autoritetit kontraktues se është ngritur një padi kundër tij, por sërish ky formula është thjesht një formular i përgjithshëm, jo një dokument i hartuar specifikisht për prokurimin publik. Në Qipro përdoren formularë të posaçëm për procese e prokurimeve publike.

4.2.8 *Çështja e konfidencialitetit — vështrim i përgjithshëm*

Megjithëse proceset e rishikimit të gjykatave dhe të organeve të tjera të rishikimit të prokurimeve publike kanë nevojë për **hapje dhe transparencë**, kjo nevojë duhet të balancohet me kërkesat për konfidencialitet në lidhje me sekretet personale, shtetërore dhe të biznesit. Kjo është arsyeja pse shumë shtete anëtare e trajtojnë nevojën për konfidencialitet në sistemet e tyre të rishikimit dhe dëshmipërblimit. Zakonisht parimi i përgjithshëm i proceseve të hapura dhe transparente të rishikimit është subjekt i parashikimeve të përshkruara qartë dhe i përjashtimeve strikte të kufizuara. Në fushën e zbatimit të këtyre përjashtimeve, e drejta procedurale mund të lejojë procese *in camera* (sesione me dyer të mbyllura), kufizimin e aksesit në dokumente, ose vënien e pjesëmarrësve ose proceseve nën detyrimin e konfidencialitetit. Çështjet e konfidencialitetit mund të zbatohen më gjerësisht. Për shembull, në një sistem rishikimi që nuk trajton konfidencialitetit, tenderuesi mund të vendosë të mos fillojë proceset nëse atij ose asaj i duhet të bëjë të ditura sekretet e biznesit.

Zyra **Austriake** e Prokurimeve Federale mund të marrë çdo masë të nevojshme për ruajtjen e interesave të konfidencialitetit të palëve të përfshira në një procedurë prokurimi, duke përfshirë dhe akses kufizues ose përjashtues për dosjet ose dokumentet përkatëse, si dhe diskutimin e një çështje në një sesion me dyer të mbyllura. Në **Belgjikë** nuk ka mundësi specifike procedurale për të marrë parasysh nevojën e mbrojtjes së informacionit konfidencial të biznesit, por me këshillë të një auditi tek Conseil d'Etat, ky i fundit njih nevojën marrjes në shqyrtim mbrojtjen e informacionit konfidencial të biznesit. Në raste të tilla provat mund t'i dërgohen vetëm Conseil d'Etat dhe jo konkurrentëve. Stafit dhe ekspertët e jashtëm të Zyrës **Çeke** për Mbrojtjen e Konkurrencës janë të detyruar t'i mbajnë konfidenciale të gjitha çështjeve që dalin gjatë proceseve. Ky detyrim nuk zbatohet nëse këta persona ftohen të japin dëshmi para një gjykate ose organeve shtetërore të hetimit ose nëse u kërkohet t'i japin prova me shkrim për këto organe sipas dispozitave të Kodit Penal. Nëse zyra vihet në dijeni për një fakt që bie nën objektin e sekretit tregtar, ajo duhet të marrë çdo masë të nevojshme për të shmangur shkeljen. E drejta e tenderuesit për të inspektuar dokumentacionin e kontratës është subjekt i marrjes nga Zyra të marrëveshjes që përfshin të gjithë tenderuesit e përfshirë. Edhe në **Sloveni** parashikohet mundësia e mbajtjes së seancave të mbyllura, por në **Estoni** dhe në **Poloni** nuk lejohen seancat e mbyllura. Në **Francë** ata janë të mundura në raste përjashtimore, kur bëhet fjalë për ruajtjen e ligjit dhe rendit, intimitetin e jetës private ose sekretet e mbrojtura nga ligji (kjo mund të aplikohet në kuadrin e kontratave ushtarake). Gjithsesi, proceset me *dyer të mbyllura* janë mundësi shumë të vona në gjykatat administrative dhe nuk janë të thjeshta për t'u përdorur në praktikë. Në **Finlandë** gjykata mund të vendosë që të mbahet seanca dhe pa praninë e publikut, nëse është e nevojshme, kur paraqitet një dokument konfidencial ose kur informacioni i mbuluar nga pika e mos deklarimit të tij bëhet me dije gjatë seancës. Dhomat e Prokurimit në **Gjermani** duhet të mos lejojnë aksesin në dosjet e çështjes në mënyrë që të mbrohen sekretet, ose të ruhet sekreti i tregtisë ose i biznesit. Si parim, seancat dëgjimore në Këshillin e Prokurimit Publik **Hungarez** mbahen me dyer të hapura, por Këshilli mund të vendosë të mbajë seanca të me dyer të mbyllura nëse kjo gjë është e rëndësishme për arsye të sekretit shtetëror, profesional ose të biznesit. Në përjashtim të pak përjashtimeve, kryesisht për shkak të sekreteve të biznesit, aksesin tek dosja e prokurimit u garantohet plotësisht të gjitha palëve të përfshira në procese.

Sipas ligjit **lituan** për Prokurimin Publik, i gjithë informacioni që identifikohet si i tillë nga tenderuesi, ose autoriteti kontraktues konsiderohet si informacion konfidencial dhe nuk u duhet dhënë palëve të treta pa pëlqimin e tenderuesit ose të autoritetit kontraktual, në përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për aktivitete penale. Proceset "me dyer të mbyllura" janë të mundura nëse janë të nevojshme për mbrojtjen e një biznes konfidencial në **Holandë**. Gjykata mund t'i ndalojë palët dhe nga dhënia e çdo informacioni rreth proceseve në publik gjatë dhe pas proceseve të tilla. Në **Slovaki** mbikëqyrja nuk është një procedurë e hapur për publikun. Nën punësit civilë janë të detyruar të mbajnë për vete çdo informacion që ata e kanë marrë gjatë procedurës. Por, në të gjitha rastet, vendimi përfundimtar është i hapur për publikun, megjithëse fshihen të dhënat e identifikimit. Të njëjtat parime zbatohen dhe për proceset e kundërshtimit. Në **Sloveni** mundësitë procedurale marrin parasysh nevojën për mbajtjen e konfidencialitetit të biznesit, si për shembull me anë të proceseve *in camera*. Por, transparencja ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe mundësitë procedurale janë subjekt i legjislationit për aksesin publik në informacion. Në **Mbretërinë e Bashkuar**, një aplikues mund të kërkojë të **shohë** dosjen e prokurimit në përputhje me procedurën e zakonshme të marrjes së informacionit në Angli dhe Uells. Gjithsesi, gjykatës i duhet kërkuar me anë të një shkrese të mos bëjë me dije jashtë gjykate informacion konfidencial të lidhur me proceset gjyqësore. Vendimi për lejimin ose jo të informacionit merret nga gjyqtari. Po ashtu, aplikuesi mund të aplikojë për informacion në përputhje me Aktin (Ligjin) e Lirisë së Informacionit të vitit 2000. Por, autoriteti kontraktues mund të refuzojë aksesin sipas Aktit në rast se informacioni në dosjen e prokurimit është marrë me udhëzime specifike për ruajtjen e natyrës konfidenciale të këtij informacioni, pasi bërja me dije e këtij informacioni do të përbëjë shkelje të konfidencialitetit të kryer nga tenderuesi përkatës apo bërja me dije e informacionit cenon interesat tregtarë të një tjetër personi.

4.2.9 Përfshirja e ekspertëve në proceset e rishikimit

Në të gjitha shtetet anëtare gjyqtarët, duke përfshirë dhe ata që punojnë në organet e rishikimit të prokurimit publik, janë juristë. Pavarësisht nga kjo, për të paktën disa nga këto raste del nevoja e ekspertëve të tjerë të ndryshëm nga juristët si dhe për ekspertizë për proceset e rishikimit të prokurimit publik. Këtu futet financa, inxhinieria, administrimi i biznesit dhe teknologjia. Një mënyrë për të trajtuar këtë nevojë përfshirja e këtyre ekspertëve si gjyqtarë (të thjeshtë) në trupat gjykues, në senatet ose në panelet e rishikimit. Një tjetër mundësi është dëgjimi i ekspertëve të pavarur gjatë proceseve të rishikimit dhe marrja e dëshmimeve të tyre si prova. Gjithsesi, kur bëhet fjalë për përfshirjen e ekspertëve i duhet kushtuar rëndësi aspektit të kohës shtesë dhe të kostove të përfshira.

Për shembull, në **Gjermani**, në procesin e rishikimit përfshihen ekspertë teknikë dhe ekspertë të tjerë si anëtarë të Dhomave të Prokurimit Publik. Në veçanti, njëri ndër tre anëtarët e dhomës është gjithmonë anëtar i asociuar nderi me eksperiencë të spikatur në fushën e prokurimit publik. Ashtu siç kërkohet nga ligji “Për Prokurimet Publike” në Austri, personat nga popullsia e zakonshme që janë pjesë e senatit të rishikimit të Zyrës Federale të Prokurimeve janë ekspertë të fushës së prokurimeve dhe caktohen nga tenderuesit dhe nga subjektet kontraktuese.

Ekspertët mund të dëgjohen, *inter alia*, në organet e rishikimit të **Austrisë, Estonisë, Francës, etj.** Në gjykatat **belge** ekspertët caktohen gjithmonë nga gjyqtari. Po kështu ndodh dhe me kostot e ekspertëve në proceset që shqyrtohen nga Komisioni **bullgar** për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjykatat në **Holandë**, organet e rishikimit të **Rumanisë** dhe në gjykatat e **Mbretërisë së Bashkuar**. Në proceset para Zyrës **çeke** për Mbrojtjen e Konkurrencës, përfshirja e ekspertëve (të tillë si juristë ose përkthyes) vendoset nga Seksioni i Prokurimeve në bashkëpunim me Seksionin Ekonomik nëse del nevoja e përdorimit të tyre. Kostot e ekspertëve paguhën nga një buxhet i posaçëm i zyrës. Po kështu ndodh dhe në proceset para Bordit **danez** të Ankesave për Prokurimet Publike, Bordit të Apelit të Departamentit **maltez** të Kontratave, dhe Zyrës **sllovaqe** të Prokurimeve Publike.

5. Mjedisi dhe kultura e rishikimit të prokurimeve publike

Nocioni i “mjeteve efektive dëmshpërblyese, mjedisit dhe kulturës së prokurimeve publike” të shteteve anëtare përfshin çështje të ndryshme që lidhen me funksionin e sistemit në praktikë.

Së pari ky nocion lidhet me përfshirjen e **personelit** në kryerjen e proceseve të rishikimit. Aspektet përfshijnë nivelin e përgjithshëm të njohurive të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve nga radhët e popullit (jo profesionistë) në lidhje me ligjin e prokurimeve publike, në veçanti në të drejtën zakonore në përgjithësi, njohuritë e tyre për procesin e prokurimit publik, si dhe konsideratat teknike dhe financiare të përfshira. Më tej, qëndrimet drejt interesit publik nga njëra anë dhe interesat private, nga ana tjetër, dhe mënyra sesi balancohen këto dy interesa janë pika të rëndësishme që kanë ndikim mbi rezultatin e proceseve të rishikimit.

Së dyti, ky proces lidhet me **tenderuesit** që kërkojnë rishikimin e vendimeve të prokurimeve publike. Aspektet përkatëse përfshijnë njohuri për bazën ligjore, financiare dhe administrative të procesit të prokurimeve publike. Më tej, edhe qëndrimi i përgjithshëm ndaj proceseve të rishikimit është shumë i rëndësishëm. Ai mund të variojë nga qëndrimi “mos kafsho dorën që të shtrihet”, deri në qëndrimin “le të ngremë padi për të qenë në anën e sigurt”. Ky qëndrim i përgjithshëm do të jetë ndikimi mbi numrin e ankesave të suksesshme.

Së treti, kultura e mjeteve efektive dëmshpërblyese dhe e rishikimit lidhet me **organet dhe subjektet kontraktuese** që përballen me proceset e rishikimit. Këtu përfshihet njohuria e tyre ligjore për prokurimet publike dhe qëndrimi i tyre ndaj tenderuesve që depozitojnë ankesa ose kërkojnë rishikim gjyqësor të vendimeve të prokurimeve publike.

Së katërti, ky nocion lidhet me **juristët**, dhe avokatët që këshillojnë dhe përfaqësojnë si tenderuesit dhe autoritet kontraktuese në proceset e rishikimit. Në veçanti, përfshihen aspekte që lidhen me njohuritë për ligjin e KE-së dhe ligjin e prokurimeve publike.

Së pesti, ai lidhet me **politikëbërësit** në qeveri dhe legjislatura. Këtu përfshihen politika qeveritare që rrisin ndërgjegjësimin e sistemit të rishikimit dhe/ose proceset që bëhen objekt shqyrtimi në debatet parlamentare.

Së gjashti, ky nocion lidhet me monitorimin dhe lobimin e lojtarëve të tjerë nga **shoqëria civile**. Çështja që shtohet këtu është nëse ka shoqata ose organizata që janë specifikisht të interesuara në sistemin e mjeteve efektive dhe të rishikimit. Ky interes mund të ketë efekt të menjëhershëm mbi efektivitetin e sistemit. Për shembull, një shoqatë mund të paguajë për tarifatat dhe kosto të tjera të proceseve ose mund të marrë procese për qëllimin e krijimit të precedentëve. Aktorë të mundshëm këtu janë OJQ-të, të tilla si dhomat e tregtisë, shoqatat e industrive të ndërtimit ose lëvizjet antikorrupsion.

5.1. Trajnimi

Çështja thelbësore që lidhet me njohuritë e gjyqtarëve dhe anëtarëve të panelit të rishikimit që vendosin për çështje të rishikimit të prokurimeve publike, tenderuesit që kërkojnë procese rishikimi, oficerët dhe subjektet kontraktuese dhe juristët që i këshillojnë dhe përfaqësojnë ata në proceset e rishikimit është nëse në shtetet anëtare ka trajnim të disponueshëm në lidhje me kërkesat e KE-së, baza ligjore për sistemin kombëtarë të rishikimit dhe mjeteve efektive si dhe bazën ekonomike, financiare dhe teknike për prokurimet publike. Po ashtu, është shumë e rëndësishme nëse këto burime trajnimi dhe informacioni përdoren në praktikë. Burimet përkatëse të trajnimit dhe informacionit janë fakultetet ose universitetet ekonomike, juridike apo fakultete, universitetet dhe kolegje të tjera; trajnimet që ofrohen nga zyrat e prokurimit publik, ministritë; akademitë kombëtare administrative; kurset e trajnimit që ofrohen nga sektori privat; BE-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare; informacioni që përfitohet nga seminarat dhe konferencat; shoqatat kombëtare të prokurimeve ose shoqata të tjera tregtare, botime akademike ose praktike dhe faqet e internetit.

Një gamë e larmishme mundësisht trajnimi për gjyqtarët, juristët, tenderuesit dhe oficerët kontraktues ofrohet nga të gjithë shtetet anëtare, megjithëse me dallime të mëdha për sa i përket shtrirjes dhe mënyrës në të cilën organizohet dhe ofrohet trajnimi nga një vend tek tjetri. Në disa shtete anëtare në nivelin e arsimit universitar përfshihet ligji i prokurimeve publike si pjesë e arsimit në të drejtën administrative dhe në të drejtën e KE-së; ekzistojnë libra, faqe interneti, dhe botime të specializuara për prokurimet publike, di dhe shoqata kombëtare për prokurimet publike dhe kërkime në këtë fushë. Në Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar ofrohen programe pas-universitare për ligjin e prokurimeve publike, ekonomik, institutet e politikës dhe kërkimit të cilat i dedikohen posaçërisht prokurimeve publike. Një pjesë e trajnimit të prokurimeve ofrohet nga institucionet private në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet qeveritare, ndërsa organizohet shumë konferenca dhe seminare nga shoqata kombëtare ose rajonale të prokurimeve publike.

Në disa shtete anëtare nuk ka kurse universitare ose kolegji, apo qendra private trajnimi për prokurimet publike, dhe nuk ka as ndonjë botim të specializuar apo shoqatë kombëtare për këtë çështje. Pavarësisht nga kjo situatë realizohen disa seminare dhe konferenca për çështjet e prokurimeve. Është me interes të theksohet se juristët dhe autoritete kontraktuese nga Luksemburgu përfitojnë nga mundësitë e trajnimit në Belgjikë, Francë dhe Gjermani.

Në shtete të tjera anëtare, zyra qendrore e prokurimeve publike luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e trajnimit për prokurimet publike.

Gjithsesi, të gjitha shtetet anëtare raportojnë se pjesa më e madhe e gjyqtarëve, tenderuesve dhe zyrave kontraktuese – të cilat përfaqësojnë burimin kryesor të kompetencës në këtë fushë – i marri njohuritë e nevojshme për prokurimet publike gjatë “eksperiencës së tyre të punës”, pra “mësojnë duke punuar”.

5.2 *Qëndrimet dhe besueshmëria në lidhje me proceset e rishikimit*

Një tjetër çështje që duhet të trajtohet në kuadrin e kulturës së rishikimit dhe mjeteve efektive ligjore në shtetet anëtare është qëndrimi i tenderuesve, oficerëve kontraktues dhe gjyqtarëve ndaj proceseve të rishikimit.

Në shumë juridiksione tenderuesit i konsiderojnë proceset e rishikimit vetëm si **mjet të fundit**. Kjo gjë raportohet nga Austria, Republika Çeke, Finlanda, Gjermania, Luksemburgu dhe Rumania. Ajo zbatohet tek të paktën disa tenderues në Hungari, Portugali dhe Sllovaki.

Gjithsesi, për disa tenderues, **ka faktorë të tjerë** të cilët kanë ndikim mbi vendimin për të filluar proceset e rishikimit, ose për të mos i filluar ato. Për shembull, disa tenderues nuk dëshirojnë fare të fillojnë proceset e rishikimit pasi nuk duan të komprometojnë mundësitë për një kontratë tjetër.

Më tej, është raportuar nga një numër i madh i shteteve anëtare se shpesh qëllimi i vetëm i tenderuesve në bërjen e një ankese është **pengimi i** prokurimit nëpërmjet proceseve të rishikimit. Në Sllovaki, disa tenderues “nuk hezitojnë të ndërmarrin hapat e nevojshëm ligjorë për të qenë të suksesshëm në procedurën e dhënies së kontratës, edhe me çmimin e përkeqësimit të mundshëm pasues të marrëdhënieve të biznesit me organet kontraktuese të përfshira.”

Më tej, disa tenderues kërkojnë **përfitime financiare** nëpërmjet proceseve të rishikimit, duke u përpjekur të nxjerrin përfitim nga një kontratë që nuk u është dhënë atyre. Kjo është raportuar të ketë ndodhur me një numër të vogël tenderuesish në Gjermani, Portugali dhe Sllovaki.

Nivelet ekzakte të kostove nuk janë bërë me dije për Studimin, por është raportuar se disa tenderues janë **penguar** nga kërkimi i rishikimit gjyqësor nga tarifat e larta të gjykatave dhe nga kostot e larta në përgjithësi (duke përfshirë dhe përfaqësimin ligjor), ose, ndonjëherë, dhe nga koha e gjatë e vijimit të proceseve.

Qëndrimi i gjyqtarëve dhe i anëtarëve të panelit të organeve të rishikimit drejt interesave private të tenderuesve që kërkojnë rishikim, nga njëra anë, dhe e interesit publik, nga ana tjetër, në përgjithësi përshkruhet si i drejtë dhe i balancuar.

Qëndrimi i organeve kontraktuese ndryshon shumë ndërmjet shteteve anëtare. Në Austri ekziston një rezervë e caktuar për proceset e rishikimit pasi ato vonojnë ekzekutimin e kontratës, por ekziston dhe një pranim i përgjithshëm pasi ato konsiderohen se krijojnë siguri ligjore. Në Belgjikë ekziston mendimi i përgjithshëm se oficerët kontraktues kanë tendencë kundër proceseve, ndërsa në Poloni ata nuk janë “të inkurajuar”. Në shtete të tjera anëtare raportohet një situatë më pozitive: qëndrimi i tyre gjykohet si “i drejtë” në Republikën Çeke, në “përgjithësi i drejtë” në Suedi, “neutral” në Estoni dhe Letoni, “i balancuar” në Gjermani dhe “kryesisht pozitiv” në Francë. Oficerët kontraktues irlandezë dhe eprorët e tyre që merren me ankesat për tenderuesit që ngrënë padi ose kërkojnë rishikim gjyqësor për prokurimet publike përshkruhen si përgjithësisht si shumë konfident ndaj procedurave dhe të gatshëm për t’i mbrojtur ato. Ekziston “një frymë e përgjithshme respekti dhe ndërgjegjësimit për të drejtat ligjore që lidhen me ankesat dhe drejtësinë e procedurave për tenderuesit” në Portugali. Në Slloveni oficerët kontraktues dhe eprorët e tyre përshkruhen si të ndërgjegjshëm për mundësinë gjithmonë të pranishme të mbrojtjes gjyqësore të kontraktuesve. Në përgjithësi ata nuk janë negativë ndaj ankuesve, por pavarësisht nga kjo, janë kundër rishikimit të vendimeve të prokurimeve publike. Si shembull mund të themi se në Mbretërinë e Bashkuar raportohet se oficerët kontraktues kanë për detyrë të veprojnë në përputhje me rregullat e prokurimit publik, drejt dhe në mënyrë të përgjegjshme, duke respektuar parimet e zakonshme të së drejtës publike. Çdo ankesë duhet të trajtohet në përputhje me këto rregulla dhe parime.

5.3 *Funksionimi i sistemeve të rishikimit dhe mjeteve efektive dëmshpërbllyese në praktikë*

Një çështje kyçe në kuadrin e kulturës së rishikimit dhe dëmshpërblimeve në shtetet anëtare është mënyra sesi funksionon sistemi në praktikë. Këtu përfshihen pyetje të tilla si sa shpesh “përdoret” sistemi i

rishikimit dhe dëmshpërblimit nga tenderuesit, nëse vendimet e shkallës së parë janë apeluar në gjykata të shkallës së dytë apo madje dhe të shkallës së tretë, nëse tenderuesit janë të suksesshëm dhe të kënaqur me rezultatet e proceseve në përgjithësi dhe se cilat dëmshpërblime jepen aktualisht në praktikë. Mjaft nga këto aspekte janë të vështira për t'u matur në praktikë, gjithsesi, numri i ankesave, padive dhe apelimeve mund të interpretohet si tregues i besimit në sistemin e rishikimit dhe dëmshpërblimit. Një numër shumë i vogël i çështjeve i shqyrtuar nga organet përgjegjëse të rishikimit mund të jetë tregues i mungesës së besimit ose kredibilitetit, apo i kostove të larta, i gjyqtarëve që duken të njëanshëm ndaj interesit publik apo i defekteve të tjera në sistemin e rishikimit, të tilla si afatet kohore strikte për ngritjen e padive, vetë-kufizimi i tenderuesve për arsye biznesi ose mungesa e një kulture apelimi. Nga ana tjetër, kjo situatë mund të interpretohet edhe se pjesa më e madhe e kontratave të prokurimeve kryhen në mënyrë të ligjshme dhe se procedurat e rishikimit, si rezultat, thjesht nuk janë të nevojshme. Një numër i lartë procesesh mund të jetë tregues i shumë kontratave të paligjshme të prokurimeve, por mund të jenë thjesht dhe reflektimi i një shoqërie që është e drejtuar shumë drejt sistemit të drejtësisë, ose i kushton vëmendje shumë interesave të biznesit [që rezultojnë nga investimet e larta (të financuara nga fondet e BE-së) të dhëna për shtetet e reja anëtare pas ditës së pranimit]. Thuajse gjysma e 24 shteteve anëtare që kanë kthyer pyetësorët dhanë shifra dhe për funksionimin e sistemit në praktikë, përkatësisht Austria, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Letonia, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Suedia. Këto shifra ndryshojnë për sa i përket detajeve dhe vëmendjes (përqendrimit), por japin një këndvështrim të kufizuar të një numri përfaqësues të shteteve anëtare. Për informacion të mëtejshëm për shifrat e sistemit në praktikë në shtetet anëtare, mund t'i referoheni Raportit të Vlerësimit të Ndikimit për vitin 2002 përgatitur nga Komisioni. Ky raport (SEC(2006) 557) mund të gjendet në këtë adresë interneti: http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/remedies/remedies_en.htm.

Si organi kryesor i rishikimit në nivelin federal, Zyra e Prokurimeve Federale të **Austrisë** (BVA) shqyrton rreth 200 aplikime çdo vit (një total prej afërsisht 1,100 aplikimesh nga data 1 shtator 2002 dhe 31 dhjetor 2005). Nga 723 vendimet e saj gjatë kësaj periudhe, 52 janë apeluar në Gjykatën Federale Kushtetuese dhe 30 në Gjykatën e Lartë Administrative. Vetëm nëntë nga vendimet e fundit nuk janë konfirmuar plotësisht.

Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës në **Çeki** ka regjistruar 334 procese në vitin 2005, 184 me ankesë të tenderuesve dhe 152 me iniciativën Zyrës. Janë marrë 228 vendime, janë përfunduar 104 procese dhe janë dhënë 64 gjoha në fund të procesit për subjektet kontraktuese në fjalë.

Zyrës së Prokurimeve Publike të **Estonisë** iu dorëzuan 281 protesta në vitin 2005 nga 7569 procedura të trajtues. Nga këto, për 65 çështje nuk u mor vendim, 67 çështje i plotësonin kërkesat procedurale, 52 nuk i plotësonin kërkesat procedurale, 66 u pranuan nga autoriteti kontraktues, 28 u tërhoqën, dhe për katër çështje Zyra e Prokurimeve Publike vendosi të pezullonte procedurën e vendimit. Shpeshësia e rishikimit të vendimeve të prokurimit publik nga Zyra si organi kryesor i rishikimit është 4%.

Në vitin 2005 u depozituan rreth 500 ankesa kundër vendimeve të prokurimeve publike të subjekteve kontraktuese **finlandeze** dhe Gjykata e Tregjeve u shpreh me vendim për 206 çështje. Nga këto çështje 26% u miratuan, 33% u rrëzuan, 8% u lanë dhe 33% iu mbaroi afati.

Numri i çështjeve të prokurimeve (duke përfshirë mosmarrëveshjet për realizimin e kontratës) para gjykatave administrative **franceze** është rritur që prej vitit 2001: në gjykatën e shkallës së parë 4365 çështje në vitin 2001, 4627 në vitin 2002, 4743 në vitin 2003 dhe 5048 në vitin 2004; në shkallën e dytë të gjykimit u dërguan 499 çështje në vitin 2001, 683 në vitin 2002, 724 në vitin 2003 dhe 755 në vitin 2004; përpara Këshillit të Shtetit si gjykatë administrative e shkallës së fundit janë dërguar 165 çështje në vitin 2001, 128 në vitin 2002, 180 në vitin 2003 dhe 133 në vitin 2004. Gjithsesi, duhet të nënvizohet se pjesa më e madhe e çështjeve lidhet me realizimin e kontratës, të cilat janë çështje që kanë të trajtohen nga ligji francez jo nga procedurat e dhënies së kontratave.

Në lidhje me vendimet para përfundimit të kontratës, numri i vendimeve të marra ose plotësisht ose pjesërisht, në favor të aplikuesit është shumë më i lartë se i vendimeve që rrëzojnë aplikimet. Në vitin 2004 janë lëshuar 2538 vendime në favor nga gjykatat administrative të shkallës së parë, ndërsa janë

kundërshtuar 1515 aplikime. Apelimet para gjykatave administrative të apelit dhe Këshillit të Shtetit zakonisht kanë rezultat negativ. Arsyeja e konfirmimit nga gjykatat administrative e një numri të madh vendimesh të marra në një shkallë më të ulët është vëmendja e veçantë që i kushtohet nga gjykatësit administrativë tenderimit dhe detyrimeve kontraktuese të organeve kontraktuese. Numri i aplikimeve në proceset përmbledhëse para-kontraktuese para proceseve administrative të shkallës së parë ka ardhur në rritje që prej vitit 2000: 149 aplikime në vitin 2000, 173 në vitin 2001, 265 në vitin 2002, 290 në vitin 2003, dhe 474 në vitin 2004. Kjo rritje tregon se dhëniet e parregullta të prokurimeve mund të korrektohen shpejt e lehtësisht dhe se zbatimi i vendimit Alkatel në lidhje me periudhën pezull ka lejuar dëmshpërblime më efektive. Në vitin 2004, 139 vendime të gjykatave administrative dhanë pjesërisht ose plotësisht dëmshpërblimet e kërkuara dhe 174 vendime rrezuan aplikimet. Më tej, shifra prej 139 përfshin dhe vendimet pjesërisht të favorshme që e dënojnë subjektin kontraktues të paguajë vetëm shumën e kufizuara.

Në vitin 2004 Dhomave të Prokurimeve Publike të **Gjermanisë** i janë dërguar 1493 aplikime dhe janë depozituar 314 ankesa të menjëhershme para Gjykatave të Larta të Shtetit. Për pjesën më të madhe të rasteve vendimet e Këshillit të Prokurimeve Publike të **Hungarisë** nuk ankimohen në gjykatë. Duket se në **Irlandë** pjesa më e madhe e ankesave rrëzohen para se për to të merret një vendim dhe, në përgjithësi, organet kontraktuese janë të përgatitura të mbrojnë procedurat e tyre.

Ka pasur më shumë se 200 ankesa në vit për Byronë e Monitorimit të Prokurimeve të **Letonisë** gjatë viteve të fundit, nga të cilat 70% rezultuan të pabazuara. Në 30% të ankesave të depozituara në Byro, kjo e fundit ndalon përfundimin e kontratës nëse ka përcaktuar se shkeljet janë serioze dhe mund të kenë ndikim mbi vendimet në lidhje me dhënien e të drejtave të prokurimeve. Arsyet për rezultatet e ankesave përfshijnë kryesisht një qëndrim të njëanshëm të organeve kontraktuese ndaj tenderuesve dhe specifikime kufizuese teknike. Rreth 10 deri në 18 vendime të Byrosë apelohe në gjykata çdo vit. Ndërsa ende nuk është marrë vendim për pjesën më të madhe të çështjeve, rezultati thuhet gjithmonë korrespondon me vendimin e mëparshëm të Byrosë.

Organet e rishikimit të **Luksemburgut** kanë vendosur për rreth 60 deri në 70 çështje në periudhën nga viti 1997 deri në vitin 2005. Në vitin 2005 në Zyrën e Prokurimeve Publike të **Polonisë** janë depozituar gjithsej 4094 apeline, nga të cilat 308 u tërhoqën, 1714 u pranuan, 1226 u rrëzuan, 440 u kundërshtuan dhe 406 nuk u shqyrtuan për shkak të mospagimit të tarifës së regjistrimit. Në vitin 2005 janë depozituar 506 padi në gjykatat rajonale polake. Vetëm 12.5% e gjykimeve kanë rezultuar në anulimin e vendimeve të marra nga Zyra e Prokurimeve Publike.

Gjykatat administrative janë forumi kryesor për rishikimin e prokurimeve publike në **Suedi**. Në total janë filluar 1,280 çështje në vitin 2005, pjesa më e madhe e të cilave në gjykatat administrative. Vetëm pak çështje janë depozituar nga tenderuesit nga shtete të tjera anëtare, por pjesa më e madhe e kompanive ndërkombëtare kanë degë në Suedi. Më pak se 1% e të gjitha kontratave të prokurimeve publike përfunduan në ankesa. Rreth 30% e vendimeve e urdhërojnë organizimin ose subjektin kontraktues të ndreqin (13%) ose të rifillojnë procedurën. Shumë çështje nuk përfundojnë në gjykim pasi organi ose subjekti e përfundon ose ndreq procedurën ose e ka përfunduar kontratën. Pjesa më e madhe e çështjeve të rishikimit lidhen me procesin e vlerësimit.

Në vitin 2005 në Zyrën e Prokurimeve Publike të **Sillovakisë** ka pasur 1,089 protesta, duke përfshirë 83 protesta nga jashtë dhe 108 protesta që lidhen me kontrata mbi pragun e KE-së (mbi 50% në krahasim me vitin 2004). Zyra mori 500 vendime *in merito* (për themelin e çështjes) për protestat përpara përfundimit të kontratës dhe nëntë vendime pas përfundimit të kontratës (sipas Aktit të Prokurimeve Publike të vitit 2006) një protestë pas përfundimit të kontratës nuk është e pranueshme). Nga këto vendime, 44% ishin në favor të ankuesve dhe 56% u rrëzuan si të pabazuara. Proceset për 578 protestat e depozituara u ndërpre. Një numër i përgjithshëm prej 18 vendimeve të ZPP-së për protestat u dërguan në gjykata. Mbikëqyrja u përqendrua kryesisht në përdorimin e paligjshëm të procedurës së negociuar pa njoftim paraprak. Janë regjistruar gjithsej 856 procedura dhënie kontratash dhe 489 shkelje të ndryshme të ligjit. Në vitin 2005 u vunë gjopa kundër 21 autoriteteve kontraktuese dhe një subjekti kontraktues. Në vitin 2005 seancat dëgjimore në pjesën më të madhe të çështjeve kishin fiksuar që në vitin 2004. Tridhjetë gjykime të

gjykatës së shkallës së parë iu çuan Zyrës dhe në 25 çështje akuza ishte kundërshtuar ose kishin përfunduar proceset gjyqësore. Në tri çështje nga pesë çështje që nuk ishin vendosur në favor të saj, Zyra apeloj tek gjykata e shkallës së parë, 11 apele i depozitoi në gjykatën e shkallës së dytë, nga të cilat për 10 çështje vendimi u mor në favor të Zyrës.

Ndërsa jo të gjithë shtetet anëtare dërguan të dhëna të lidhura me funksionimin e sistemeve të tyre kombëtare të rishikimit dhe dëmshpërblimit, të dhënat e dërguara nga disa nga shtetet anëtare janë të paplota, ndërsa tregjet e prokurimeve, traditat ligjore dhe përmasat e shteteve anëtare ndryshojnë shumë, por, gjithsesi, mund të ngrihen disa pika të përgjithshme që lidhen me funksionimin e sistemeve të rishikimit dhe dëmshpërblimeve të prokurimeve publike në praktikë.

Tenderuesit dhe, ndonjëherë, disa aktorë të tjerë **apelojnë** vendimin e organeve të rishikimit të shkallës së parë në shkallë të dyta dhe të treta, por kjo ndodh vetëm në një numër të kufizuar rastesh.

5.4 Shoqëria civile

Përfshirja e shoqërisë civile në formën e grupeve të lobimit ose e OJQ-ve në sistemet e rishikimeve dhe dëmshpërblimeve të prokurimeve publike duket si shumë e kufizuar në pjesën më të madhe të shteteve anëtare. Shumë nga shtetet anëtare raportojnë se nuk kanë një shoqatë specifike të prokurimeve publike. Shoqatat e prokurimeve publike ekzistojnë në Francë, Gjermani, Hungari, Irlandë dhe Holandë. Më tej, në shumë shtete anëtare janë Dhomat e Tregtisë ato që mbulojnë prokurimet publike.

Seksionet përkatëse kombëtare të Transparency International u përmenden nga Bullgaria, Republika Çeke, Lituania, Sllovakia dhe Mbretëria e Bashkuar. Organizata të tjera përkatëse përfshijnë federatat e industrisë, shoqata të specializuara të industrisë së ndërtimit, arkitektë, organizata të bizneseve të vogla, shoqata të sektorëve specifike, grupe mjedisore dhe shoqata të organeve lokale. Ndërsa vëmendja kryesore e këtyre shoqatave është ndikimi mbi legjislacionin e prokurimeve publike, ato shpesh ofrojnë dhe trajnime dhe organizojnë konferenca. Ato i këshillojnë zgjedhësit e tyre për prokurimet publike në përgjegjësi dhe japin këshilla për fillimin e procedurave në nivele të ndryshme.

Shtypi dhe televizioni mbulojnë proceset e rishikimit të prokurimeve publike rregullisht në Bullgari, Republikën Çeke dhe Slloveni, dhe ndonjëherë dhe në Francë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Ka interes në rritje në Danimarkë, por nuk ka ndonjë vëmendje të posaçme të medias në Finlandë.

6. Përfundime

Pjesa më e madhe e vendeve të përmbledhura në këtë studim duket se kanë një **sistem operativ rishikimi dhe dëmshpërblimi të prokurimeve publike**, të përbërë nga organe të specializuara rishikimi, gjykata të zakonshme, gjykata civile ose administrative ose një kombinim i të dyjave. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare ofron mundësi apelimi në shkallën e dytë dhe shpesh dhe të tretë të gjykimit. Në përgjithësi jo vetëm organet e rishikimit të shkallës së fundit, por të gjitha shkallët e institucioneve të rishikimit i plotësojnë kërkesat e një gjykate siç parashikohet në Gjykatën Europiane të Drejtësisë. Ka sisteme të vetme me një rrugë rishikimi dhe sisteme të dyfishta me rishikime të disponueshme në lloje të ndryshme gjykatash. Tenderuesit e mërzitur kanë mundësinë ose detyrimin për t'u ankuar drejtpërdrejt me subjektin kontraktues para ose në të njëjtën kohë me kërkimin e rishikimit gjyqësor ose quasi-gjyqësor.

Qëllimi i sistemeve të rishikimit dhe dëmshpërblimit të prokurimeve publike të shteteve anëtare të përfshira në këtë studim mbulon gjithmonë dhe kontratat mbi pragjet e direktivave të KE-së për prokurimet publike. Në shumë vende, sistemi zbatohet në të njëjtën mënyrë dhe mbi kontratat nën pragun e KE-së. Gjithsesi, disa shtete anëtare kanë një rrugë të ndryshme dhe shpesh më bazë ose të kufizuar për këto kontrata prokurimesh. Shumë vende nuk bëjnë dallimin ndërmjet autoriteteve dhe ndërmarrjeve kontraktuese publike, ndërsa në vite të tjera ka organe të ndryshme rishikimi, kërkesa procedurale. Mbi të gjitha, natyra publike ose private e një ndërmarrje mund të përfshijë dallime.

Sistemet kombëtare lejojnë **pezullimin** e vendimeve të ndryshme individuale të marra gjatë një procedure prokurimi, duke përfshirë dhe vendimin për dhënien e kontratës. Anulimi i një kontrate të përfunduar, nëse është i mundur, bëhet në përputhje me kërkesat strikte të përcaktuara, të cilat janë të vështira për t'u plotësuar. Si rezultat, në mënyrë që t'u lejohe tenderuesve të sfidojnë dhënien e kontratës si rezultat i jurisprudencës së Alcatel-it, pjesa më e madhe e shteteve anëtare kanë prezantuar një periudhë pezull ndërmjet periudhës së dhënies së kontratës dhe përfundimit të saj. Shtetet anëtare parashikojnë masa të përkohshme në pritje të vendimit përfundimtar dhe në disa vende paditë kanë efekt automatik pezullues për vazhdimin e procedurës së prokurimeve. Të gjitha shtetet anëtare duket se i lejojnë kompensimet për dëmet. Mjetet efektive ligjore janë të disponueshme, por duhet të plotësohen kërkesa strikte për të përfutur prej tyre.

Ndërsa **qëndrimet** e gjyqtarëve dhe të anëtarëve të paneleve të tjera të rishikimit ndaj interesave të përfshirë në procese përshkruhen si të drejta dhe të balancuara, qëndrimi i tenderuesve që kërkojnë përdorimin e mjeteve efektive dëmshpërblyese ndryshon shumë në juridiksionet e shteteve të përfshira në këtë studim. Në shumë shtete tenderuesit i konsiderojnë proceset e rishikimit si mjet të fundit për vënien në jetë të interesave të tyre legjitime, ose si zgjidhje të barabartë dhe për ndreqjen e gabimeve. Gjithsesi, në disa juridiksione prezumohet se disa tenderues abuzojnë me sistemin në mënyrë që të pengojnë procedurat e prokurimit ose të detyrojnë konkurruesit të dalin nga kontrata. Mjaft nga sistemet përkatëse të rishikimit përpiqen ta parandalojnë këtë abuzim nëpërmjet afateve kohore, kufizimeve të paraqitjes ligjore, tarifave të gjykatave dhe depozitave dhe ndonjëherë dhe nëpërmjet gjobave për pretendime të pambështetura.

E drejta e KE-së për sistemet e rishikimit dhe mjeteve efektive të prokurimeve publike u kërkon shteteve anëtare të ofrojnë **trajtim të shpejtë dhe efektiv të ankesave**. Ndërsa në pjesën më të madhe të vendeve të përfshira në këtë studim të gjitha zgjidhjet ligjore, duke përfshirë dhe dëmshpërblimin e dëmeve, janë të disponueshme brenda afateve të arsyeshme kohore, në disa shtete anëtare, disa zgjidhje, si për shembull, dëmshpërblimi i dëmeve, ose anulimi i një kontrate të përfunduar, mund të kërkojë kohë. Kjo rrallë mund të shkaktohet nga afatet kohore, por nga ngarkesa e organit të rishikimit në fjalë dhe ndonjëherë nga sjellja e palëve, për shembull, kur ata shkëmbejnë informacion për muaj dhe madje dhe në muaj. Efektiviteti është çështje dhe më komplekse. Ai përfshin çështje të aksesit të tenderuesve në sistem, kënaqshmërinë e tenderuesve ndaj sistemit, disponueshmërinë e shqyrtimeve të përshtatshme për të disavantazuarit për shkak të shkeljeve të ligjit dhe mundësisht transparencën e përgjithshme dhe madje dhe thjeshtësinë së sistemit. Efektiviteti i sistemit të rishikimit dhe trajtimit të ankesave zgjerohet, *inter alia*, nga objekti i gjerë i shqyrtimit, ndarja e drejtë e çështjeve ndërmjet organeve të rishikimit dhe rregullave për sjelljen, tarifave dhe depozitat e arsyeshme (ose mungesën e tarifave), aksesit në masat e përkohshme ose efekti i pezullimit automatik të depozitimit të një ankese, mundësia e apelimit të vendimeve të shkallës së parë, gjyqtarët dhe anëtarët e ditur e të drejtë të paneleve të gjyqimit, shpërndarja e drejtë të vendimeve, mundësia e ruajtjes së konfidencialitetit dhe përfshirja e ekspertëve. Sistemet e prokurimeve publike dhe të rishqyrtimit të ankesave të pjesës më të madhe të shteteve që janë objekt i këtij studimi i kanë të gjithë këtë elementë, ose pjesën më të madhe të tyre.

SHTOJCË: RAPORTET E VENDEVE INDIVIDUALE PËR SISTEMET E RISHIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË ANKESAVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE NË SHTETET ANËTARE

1. Austria

Sistemi austriak i rishikimit dhe trajtimit të ankesave për prokurimet publike bazohet tek një **sistem i dyfishtë i rishikimit gjyqësor** nëpërmjet një organi të specializuar të prokurimeve publike vendimet e të cilit janë objekt apelimi në Gjykatën e Lartë Administrative, ose në Gjykatën Kushtetuese, nga njëra anë, dhe pretendimeve për dëme nëpërmjet gjykatave civile nga ana tjetër. Sistemi aplikohet për autoritetet dhe ndërmarrje publike dhe në kontrata mbi dhe nën pragjet e KE-së. Ndryshimet më të rëndësishme të kohëve të fundit përfshijnë zbatimin e ligjit të prokurimeve (1993), prezantimin e legjislacionit uniform të prokurimeve (2002), shtrirjen e sistemit specifik të rishikimit të prokurimit publik për kontratat nën pragjet e KE-së dhe rregulloren e afateve kohore përjashtimore për depozitimin e ankesave. Një version më i vjetër i ligjit përkatës mund të gjendet në adresën www.ris.bka.gv.at.

1.1 Ankimimi tek Autoriteti Kontraktues

Trajtimi i protestave dhe ankesave kundër vendimeve të prokurimeve publike është pjesë e organizimit të brendshëm të organeve përkatëse të **autoritetit kontraktues** dhe, si rezultat, nuk rregullohet në aktin federal të prokurimeve publike (BVergG). Nuk ka asnjë kërkesë ligjore për ta informuar autoritetin kontraktues para fillimit të një procedurë rishikimi dhe asnjë instrument ligjor nuk rregullon ankesat për organet dhe subjektet kontraktuese në Austri.

1.2 Rishikimi gjyqësor

Sipas sistemit federal të parashikuar nga Kushtetuta Federale e Austrisë, ekzistojnë dhjetë organe të ndryshme rishikimi për apeli kundër subjekteve prokuruese. Si rezultat, procedurat që duhet të ndiqen janë të parashikuara në nëntë legjislacione të shteteve të ndryshme federale (*Länder*) për rishikimet e prokurimit në nivelin rajonal dhe bashkiak (*Landesvergabekontrollgesetze*) nga njëra anë, dhe në nivelin e BVergG nga ana tjetër. Përderisa legjislacioni i *Länder-ave* është i harmonizuar me atë të BVergG në një masë të kënaqshme, përshkrimet e mëposhtme përqendrohet tek rregulloret në nivelin federal. Fakti që sistemi federal përfundon në dhjetë organe të ndryshme rishikimi që zbatojnë të njëjtën BVergG konsiderohet si disavantazhi kryesor i sistemit austriak. BVergG-u parashikon një sistem të vetëm formal rishikimi në nivelin federal, i drejtuar nga një tribunal i posaçëm administrativ dhe i pavarur që plotëson kërkesat e direktivës së BE-së për mjetet efektive ligjore dhe Nenin 6 të KEDNJ-së. **Zyra Federale e Prokurimeve** (*Bundesvergabeamt* – BVA, Praterstraße 31, 1020 Wien, www.bva.gv.at) është pjesë e sistemit të rishikimit ligjor siç parashikohet në Kushtetutën Federale dhe përbëhet nga gjyqtarë të pavarur administrativë (të cilët së pari emërohen për një periudhë tre vjeçare, dhe më pas kanë mundësinë e emërimit të përvetshëm) dhe persona të zakonshëm të cilët emërohen sipas kriterëve të barabarta për një periudhë të caktuar kohore me sugjerim të organeve kontraktuese dhe tenderuesve. Vendimet e BVA-së përgjithësisht merren në tribuna të quajtura senate, të cilët përbëhen nga një gjyqtar administrativ dhe dy persona të zakonshëm. BVA-ja ka kompetencat legjislative të parashikuara në Direktivë (anulon vendimet e organeve kontraktuese, jep masa të përkohshme). Sipas BverG-ut, BVA-ja është kompetente për mbrojtjen ligjore të tenderuesve në fazën parakontraktuese (pra në kohën para dhënies së kontratës reale) të një procedure prokurimi dhe duhet të marrë vendim brenda gjashtë javësh. Pas dhënies së një kontrate, kompetenca e BVA-së është e kufizuar në deklarata rreth përputshmërisë ose mospërputshmërisë së një procedure prokurimesh me BVergG-në. Kjo deklaratë përbën një kërkesë të domosdoshme dhe, si rezultat, përbën bazën për **padi për dëme para gjykatave civile**. Vendimet e BVA-së botohen në internet (shih <http://www.bva.gv.at>) dhe mund të ankimohen para **Gjykatës së Lartë Administrative** dhe **Gjykatës Kushtetuese**, si në Vjenë (shih <http://www.vwgh.gv.at> dhe <http://www.vfgh.gv.at>, Judenplatz 11, 1010 Wien). BVergG rregullon organizimin dhe strukturën e brendshme të BVA-së sipas Nenit 6 të KEDNJ-së. Pavarësia e gjyqtarëve administrativë (anëtarëve të përhershëm – *Senatsvorsitzende*) garantohet nga e drejta kushtetuese. Anëtarët e përhershëm emërohen nga Presidenti Federal i Austrisë; kryetari dhe

zëvendësi i tij emërohen përjetësisht. Për t'u emëruar në BVA, një personi i duhet të plotësojë kërkesa të kualifikimit profesional (njohuri të veçanta për ligjin e prokurimit publik dhe eksperiencë ligjore). Kryetari, zëvendës kryetari dhe anëtarët e përhershëm duhet të jenë juristë me të paktën pesë vjet eksperiencë si juristë, ose duhet të kenë minimalisht pesë vjet eksperiencë profesionale në prokurimet publike. BVA-ja, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Kushtetuese plotësojnë kërkesat e vendimeve *Dorsch* dhe *Salzmann*. BVA-ja vendosi rishikimin e 208 nga totali i 285 aplikimeve të marra në vitin 2003, 195 nga 266 në vitin 2004, dhe 183 nga 257 në vitin 2005. Në periudhën ndërmjet 1 shtatorit 2002 dhe 31 dhjetorit 2005, BVA-ja trajtoi 1092 nga 1,126 aplikime. Nga 723 vendimet e marra prej saj gjatë kësaj periudhe, 52 u apeluar para Gjykatës Federale Kushtetuese dhe 30 në Gjykatën e Lartë Administrative. Vetëm një nga vendimet e fundit nuk u konfirmua plotësisht. Sipas sistemit federal të parashikuar në kushtetutën austriake, ekzistojnë dhjetë organe të ndryshme rishikimi, të cilat ose janë gjykata administrative (*Unabhängige Verwaltungssenaten* në shtatë *Länder*), ose gjykata specifike për rishikimin e prokurimeve publike (në dy *Länder* dhe në nivelin federal). Organet jepen në adresën <http://www.bka.gv.at/DesktopDefault.aspx?TabID=5100&Alias=bka>. Organet e rishikimit janë krijuar mbi bazën e Kushtetutës Federale (*Bundes-Verfassungsgesetz*), që është një akt i miratuar nga Parlamenti (*Bundesvergabegesetz*), dhe kushtetutave (*Landesverfassungen*) dhe legjislativioneve (*Landesvergabekontrollgesetze*) të shteteve individuale të Austrisë.

1.3 Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve

Dy *Länder*-a, përkatësisht Carinthia (*Kärnten*) dhe Austria e Poshtme (*Niederösterreich*) kanë krijuar organe alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Rregullat janë parashikuar përkatësisht në *Kärntner Vergaberechtsschutzgesetz* (Aktin e Mbrojtjes së Prokurimeve të Karinthas <http://www.bka.gv.at/2004/4/20/kaernten-vergabe.doc>) dhe në *NÖ Vergabe-Nachprüfungsgesetz* (Akti i Rishikimit të Prokurimeve të Austrisë së Poshtme <http://www.bka.gv.at/2004/4/20/noe-vergabe.pdf>).

1.4 Mjetet efektive ligjore

Çdo vendim prokurimi i parashikuar në Nenin 2 § 16 BVergG i dhënë para përfundimit të një kontrate mund t'i dërgohet për rishqyrtim BVA-së ("vendim i kontestueshëm veçmas"). Çdo vendim tjetër para përfundimit të një kontrate që nuk përmendet në këtë nen mund të ankimohet në kombinim me një vendim pararendës që është në listë, e, si rezultat, është i kontestueshëm. Gama e vendimeve të kontestueshme veçmas mbulon **të gjitha vendimet bazë** që mund të marrë një subjekt kontraktues para përfundimit të një kontrate (njoftimet për tender, dokumentet e kontratës, përzgjedhja e më të mirëve, eliminimi i ofertave, vendimi për dhënien e kontratës, etj.). BVA-ja ka kompetencën e anulimit të vendimeve të organeve kontraktuese dhe të dhënies së **masave të përkohshme** në fazën para kontraktimit. Pas dhënies së një kontrate, kompetenca e BVA-së është e kufizuar në **deklaratat rreth përputhshmërisë** ose mos-përputhshmërisë së një procedure prokurimi të një organi kontraktues me BVergG-un. Kjo deklaratë përbën një kërkesë të qenësishme dhe, si rrjedhim, është baza e padive për **dëme** para gjykata civile. Në një rrethanë të veçantë, kur një organ kontraktues jep një kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke e shkelur qartë ligjin, BVA-ja mund ta anulojë kontratën. Kompetencat e BVA-së jepen në nenin 312 të BVergG. Procedurat parashikohen në nenin 320 deri në nenin 327 (anulimi i vendimeve), nenin 328 deri në 330 (masa të përkohshme) dhe neni 331 deri në 334 (deklarata e përputhshmërisë). **Lënia mënjane** ose pezullimi i një kontrate të dhënë mund të bëhet vetëm nga gjykatat civile mbi bazën e kushteve të përgjithshme të parashikuara në të drejtën civile. Deri tani nuk është paraqitur asnjë rast i tillë në praktikë. Depozitimi i një ankese në parim **nuk ka efekte pezulluese**. Ankimesi duhet të kërkojë masat e përkohshme. **Aplikimi për masa të përkohshme** (hapja e ofertave, dhënia e kontratës dhe tërheqja e procedurës) **ka efekt pezullues vetëm në raste përjashtimore (të dhëna në BVergG)**. BVA-ja mund të japë masat e përkohshme të kërkuara nga një operator ekonomik për aq kohë sa ato janë të përshtatshme dhe të nevojshme për të parandaluar dëmin (shih nenin 328 të BVergG-së). Gjykata ose organe të tjera të rishikimit mund të marrin parasysh pasojat e mundshme të masave të përkohshme për të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë interesin publik, dhe mund të vendosë për të mos dhënë masa të tilla kur pasojat e tyre negative janë më të mëdha se përfitimet. Njohja e dëmeve rregullohet në

Allgemeines Bürgerliches Gesetzbuch (ABGB, Kodi Civil). Pas dhënies së një kontrate, kompetenca e BVA-së kufizohet në deklaratat rreth përputhshmërisë ose mospërputhshmërisë së një procedure prokurimesh të një organi kontraktues. **Kjo deklaratë përbën kërkesë themelore dhe, si rezultat, përbën dhe bazën e dëmeve para gjykatave civile.** Dëmet nuk janë të kufizuara në kostot e tenderimit; ato në raste të caktuara përfshijnë interesin e kontratës ose fitimin e saj. Nuk ka dispozita për pagesat e gjobave periodike. Jurisprudenca është e kufizuar, por ka një rëndësi shumë të madhe për shkak të sistemit që përbëhet si nga kodifikimi dhe nga jurisprudenca.

1.5 Procedura

Çështjet procedurale rregullohen nga **BVergG** dhe nga legjislacionet e shteteve federale të përmendura më lart (*Landesvergabekontrollgesetze*). Nëse BVergG nuk parashikon rregullim, atëherë zbatohet *Allgemeines Verwaltungsverfahrensgesetz* – AVG (**Akti i Përgjithshëm i Procedurës Administrative**, shih <http://www.ris.bka.gv.at/englische-rv/>). Çështjet mund të depozitohen nga tenderuesit, ofertuesit, dhe nga operatorët ekonomikë me kushtin që ata të kenë interes në përmbylljen e kontratës në fjalë dhe që kërkuarit të jenë cenuar ose nën rrezik cenimi nga shkelja e pretenduar e ligjit (të prokurimeve). Tenderuesit duhet të ankohen para BVA-së brenda **14 ditësh**. Në raste të veçanta (në raste të procedurave nën prag, procedura urgjente, etj.) këto afate **shkurtohen deri në shtatë ditë**. Siç kërkohet nga BVergG, personat e zakonshëm në senatin e rishikimit janë ekspertë të fushës së prokurimeve. Ekspertë të posaçëm mund të përfshihen me kërkesën e BVA-së. Rimbursimi i kostove rregullohet nga AVG-ja (shih nenin 52 e **pasues**) sipas Aktit të Caktimit të tarifave. Për çdo ankesë të paraqitur para BVA-së, duhet të paguhet **shuma të përgjithshme fikse** sipas Shtojcës XIX BVergG. Tarifa minimale është €200 për kontrata të drejtpërdrejta dhe €5000 për kontrata pune mbi pragun e KE-së. BVA-së nuk i duhen paguar tarifa të tjera ligjore. Në lidhje me rregulloren që kanë të bëjnë me tarifat e përgjithshme fikse do të bëhet një ndryshim i vogël për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Do të duhet të paguhet tarifa shtesë administrative tek organet federale shtetërore të rishikimit. Tenderuesit kanë të drejtë të kërkojnë përfaqësim ligjor, por duhet t'i mbulojnë vetë kostot. Një tenderues i suksesshëm ka të drejtën e marrjes së **rimbursimit** të shumave fikse. BVA-ja vendos për këto kosto. BVA-ja mund të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e konfidencialitetit të palëve të përfshira në një procedurë prokurimi, duke përfshirë kufizimin, ose përjashtimin e aksesit në dosjet dhe dokumentet përkatëse si dhe diskutimin e një çështje me dyer të mbyllura. Vendimet shpërndahen ose në versionin e shkruar, me anë të një fakti ose e-mail-i për palët dhe më pas botohen në Internet (shih <http://www.bva.gv.at>). BVA-ja duhet të japë vendimin e saj për çështjet e anulimit brenda gjashtë javësh dhe duhet të shprehet për masat e përkohshme brenda një jave. Shpejtësia relative e BVA-së në krahasim me një sistem të gjykatave civile kur bëhet fjalë për dhënien e vendimeve, konsiderohet si avantazhi kryesor i sistemit austriak të rishikimit. Nuk ka formularë model detyrues apo dokumente të tjera detyruese për procedurat e rishikimit.

1.6 Kultura e rishikimit

Nuk ka **trajnim** zyrtar (qeveritar) për çështjet e prokurimit publik, ose të drejtën e KE-së. Studimet universitare për juridikë përfshijnë ligjin e prokurimeve publike si pjesë të së drejtës administrative dhe të drejtës së KE-së. Pjesa më e madhe e trajnimeve për prokurimet ofrohet nga institucionet private në bashkëpunim me universitetet (*Vergaberechtslehrgänge*) dhe nga programet e veçanta për trajnim profesional (në lodhje me përdorimin e marrëveshjeve kuadër, partneriteteve publike-private, etj.). **Qëndrimi i gjyqtarëve** dhe i penalistëve të organeve të rishikimit të prokurimeve publike drejt interesave private, nga njëra anë, dhe interesave private të tenderuesve, nga ana tjetër, përgjithësisht konsiderohet si e balancuar, me një tendencë të vogël drejt interesave të tenderuesve. Disa tenderues nuk duan të fillojnë procedurat e rishikimit pasi ata nuk duan të komprometojnë shanset për kontrata të tjera në të ardhmen (në veçanti kur bëhet fjalë për kontrata me vlera të vogla). Disa tenderues kanë si synim të pengojnë prokurimet nëpërmjet proceseve të rishikimit, ndërsa të tjerë nuk kërkojnë rishikim gjyqësor për shtat të kostove të larta (duke përfshirë dhe përfaqësimin ligjor, etj.). Njohuritë e oficerëve kontraktues për aspektin ligjor ose njohuritë e prokurimeve publike janë të ndryshme dhe varen nga autoriteti kontraktues përkatës. Ndërsa në nivelin federal autoritetet e mëdha kontraktuese mund të përballojnë ofrimin e

nevojshëm, në nivelin bashkiak/lokal ka probleme në ofrimin e një stafi të trajnuar. Në përgjithësi oficerët kontraktues janë kundër procedurave të rishikimit, pasi ato vonojnë dhënien e kontratës në fjalë. Pavarësisht nga kjo, ka një pranim të përgjithshëm të procedurave të rishikimit pasi ato ofrojnë siguri ligjore. Ekzistojnë dy gazeta ligjore që merren me çështjet e prokurimeve publike: *Zeitschrift für Vergaberecht und Beschaffungspraxis* (ZVB, shih www.manz.at) dhe *Recht und Praxis der öffentlichen Auftragsvergabe* (RPA, shih www.verlagoesterreich.at). Ligji i prokurimeve publike është temë diskutimi në konferencat dhe seminarët akademike dhe profesionale në Austri. Konferenca më e rëndësishme është *Vergabeforum*, e cila organizohet çdo vit nga një institut privat për trajnim profesional dhe *Vergaberechtstag*-u i cili organizohet çdo vit nga BVA-ja; kjo e fundit shërben kryesisht si forum për gjyqtarët dhe gjyqtarët administrativë të cilët trajtojnë çështje të prokurimit publik. Në Austri ekziston një shoqatë kombëtare për ligjin dhe politikën për prokurimet publike e quajtur Club Austria (shih www.tenderclub.at). Për çështjet e prokurimit nuk ka një organizatë specifike për lotimin, por Dhoma e Tregtisë (shih www.wko.at) dhe Federata e Industrisë e Austrisë (shih www.iv-net.at) punojnë, ndër të tjera, si lotues për interesat e përgjithshme të tenderuesve. Në përgjithësi vendimet e GJED-së kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi proceset e prokurimit pasi formulimi i BVergG është në pjesën dërrmuese të tij i harmonizuar me formulimin e Direktivës; si rezultat, thuajse çdo interpretim i Direktivave nga GJED-ja përbën dhe interpretim të BVergG-ut. Vendimet reflektohen dhe në legjislacionin kombëtar të prokurimeve (pra në BVergG dhe në *Landesvergabekontrollgesetze*). Në praktikë, palët shpesh i referohen vendimeve përkatëse. Një raport për pjesën më të madhe të këtyre çështjeve përfshihet në raportin e aktivitetit vjetor – *Tätigkeitsbericht* të BVA-së (shih www.bva.gv.at, në gjermanisht).

2. Belgjika

Vendimet administrative individuale, të tilla si një vendim prokurimesh, mund të ankimohen si para **gjykatave civile** dhe tribunaleve (gjykatave të posaçme) dhe para një **gjykate administrative**, d.m.th, Këshillit të Shtetit. Duhet të bëhet një dallim ndërmjet mundësive të një rishikimi kombëtar para dhe pas njoftimit të vendimit të prokurimit tek tenderuesi i përzgjedhur (përfundimi i kontratës). **Para njoftimit të vendimit**, një tenderues i mërzitur mund të ankimojë vendimin ose para Këshillit të Shtetit nëpërmjet një kërkesë për pezullim urgjent, ose para gjykatave civile nëpërmjet një njoftimi urgjent. Falë këtyre proceseve përmbledhëse para kontraktuese, tenderuesi ka mundësinë e parandalimit të nënshkrimit të kontratës. **Pas njoftimit të vendimit**, një tenderues i mërzitur mund të ankimojë vendimin tek Këshilli i Shtetit vetëm nëpërmjet një kërkesë për anulim (e cila mund të marrë katër ose pesë vjet, madje dhe më shumë), ose gjykatave civile dhe tribunaleve. Proceset e fundit mund të përdoren dhe për të kompensuar një tenderues të refuzuar gabimisht me kusht që ai/ajo të provojë që atij/asaj i është mohuar mundësia e vërtetë i fitimit të kontratës dhe, në raste të caktuara, mund të pezullojë ose të deklarojë të pavlefshme kontratat e dhëna në mënyrë të parregullt. Këshilli i Shtetit është kompetent vetëm për dhënien e vendimeve të organeve administrative. Disa organe kontraktuese nuk mund të kualifikohen si organ administrativ. Në raste të tilla, tenderuesi i pakënaqur mund të ankimojë për një vendim prokurimesh publike vetëm para gjykatave civile dhe tribunaleve. Nuk ka dallim ndërmjet kontratave për të cilat zbatohen direktivat dhe kontratave për të cilat nuk zbatohen direktivat. Po ashtu, nuk ka dallim në sistemin e ndërmarrjeve.

2.1 Ankimimi për autoritetin kontraktues

Në Belgjikë nuk është e detyrueshme që tenderuesit të kundërshtojnë/protëstojnë/ankimojnë formalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë tek organi kontraktues si parakusht për të kërkuar rishikim. Nuk ekzistojnë rregulla specifike. Një tenderues mund të ankohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek organi kontraktues. Gjithsesi, çdo organ kontraktues mund të vendosë për mënyrën sesi të trajtojë këto ankesa. Nuk ekzistojnë instrumente specifike ligjore që rregullojnë ankesat formale të tenderuesve.

2.2 Rishikimi gjyqësor

Organet belge të rishikimit janë krijuar mbi bazën e neneve 144-161 të Kushtetutës. Ekziston një gjykatë e përgjithshme/e zakonshme e shkallës së fundit që rishikon vendimet për prokurime publike, *Cour de*

cassation (Palais de Justice, Place Poelaert 1, 1000 Brussels; Phone +32 508 61 11, website: <http://www.cass.be>). Sipas nenit 152 të Kushtetutës belge, gjyqtarët janë të palëvizshëm. Në *Cour de cassation* (gjykatën e kasacionit), e cila është gjykata e apelit e shkallës së fundit, ekzistojnë pesë *Cours d'appel*/gjykata apeli (për më shumë detaje shihni në faqen e internetit <http://www.cass.be>), të cilat janë në nivel apeli, dhe 27 *Tribunaux de premier instance*, të cilat janë gjykata të shkallës së parë. Ekziston një gjykatë administrative e shkallës së fundit e cila rishikon vendimet e prokurimeve publike, *Conseil d'Etat* (Rue de la Science 37, 1040 Bruksel; telefon +32 2 234 96 11, website: <http://www.raadvst-consetat.fgov.be>). Sipas nenit 70, § 4 të ligjeve të koordinuara të Këshillit të Shtetit të datës 12 janar 1973, gjyqtarët administrativë të *Conseil d'Etat* janë të përjetshëm në atë pozicion. Nuk ka gjykata administrative nën nivelin e shkallës së fundit (*Conseil d'Etat*). Kryetarët dhe anëtarët e tjerë të organeve të rishikimit të nivelit të fundit si në gjykatat administrative dhe të ato të zakonshme kanë eksperiencë ligjore të shumtë dhe duhet të kalojnë provimet e organizuara nga *Hoge Raad voor Justitie* (të zakonshme) ose nga *Conseil d'Etat* (administrative). Të gjitha këto gjykata plotësojnë kërkesat e vendimeve të *Dorsch* dhe *Salzmann*. Në Belgjikë nuk ekzistojnë **organe të përgjithshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve** të ngarkuar me detyrën e rishikimit të vendimeve të prokurimit publik. Gjithsesi, në lidhje me sektorin e shërbimeve, Belgjika ka transponuar mekanizmin e vërtetimit (nenet 3 deri në 7 të Direktivës 92/13/KEE) dhe mekanizmin e pajtimit (nenet 9 deri në 11 të Direktivës 92/13/KEE) me nenet 113-121 të Dekretit Mbretëror të 10 janarit 1996.

2.3 Mjetet efektive ligjore

Çdo vendim me efekt ligjor i lidhur me prokurimet publike mund të ankimohet nga tenderuesit (specifikimet, dhënia e kontratës, etj.). Gjithsesi, vetëm vendimet që mund të cilësohen si akte ligjore administrative të zbatueshme mund të ankimohen para Këshillit të Shtetit. Si gjyqtarët e zakonshëm (gjykatat dhe tribunalet e zakonshme) dhe gjyqtarët administrativë, përkatësisht gjyqtarët e Këshillit të Shtetit, janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të direktivës së KE-së për mjetet efektive ligjore. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Shtetit rregullohen nga ligjet organike për Këshillin e Shtetit, të koordinuar nga Dekreti Mbretëror i datës 12 dhjetor 1973 (http://raadvt-consetat.fgov.be/En/whatwedo_en.htm) dhe dekretet zbatuese të tij. Eksperiencia e Këshillit konsiderohet një pikë shumë e fortë e sistemit belg. Këshilli i Shtetit ka kompetencën e anulimit të vendimeve të administratës, duke përfshirë dhe organet kontraktuese. Për shkak të mbingarkesës së Këshillit të Shtetit, afati i vendimit në rast të një kërkesë për anulim zakonisht është katër deri në pesë vite. Kjo periudhë e gjatë kohore shpesh konsiderohet si pikë e dobët e sistemit belg. Po ashtu, para Këshillit të Shtetit mund të dërgohet kërkesa për **anulim**, *kërkesa për pezullim*, madje dhe për shkak të nevojës urgjente. Në mënyrë të merret një abstenim, ankimesi duhet të provojë shkaqe serioze dhe dëm serioz që është i vështirë të riparohet. Këshilli i Shtetit mund të vendosë dhe **pagesa periodike gjore**. Një tenderues i pakënaqur nuk mund të marrë **dëme** financiare në Këshillin e Shtetit. Kjo konsiderohet si një tjetër pikë e dobët e sistemit belg. Dëmet mund të jepen vetëm nga gjykatat dhe tribunalet e zakonshme, të cilat përmenden në Kodin Gjyqësor. Vetëm gjykatat dhe tribunalet e zakonshme kanë juridiksion të merren me veprimet për dëmshpërblime. Dëmet financiare mund të përcaktohen vetëm në gjykatat dhe tribunalet e zakonshme. Nuk ka një sistem ligjor të veçantë për vlerësimin e dëmeve që lidhen me prokurimet publike. Neni 1382 e *pasues* të Kodit Civil parashikojnë parimet e përgjithshme të dëmshpërblimit dhe janë të zbatueshme për dhënien e dëmeve në fushën e prokurimit publik. Ky koncept ligjor dhe Kodi Civil japin parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe është goxha i zhvilluar si në jurisprudencë dhe në doktrinë. Sipas nenit 1382 të Kodit Civil dëmet mund të pretendohen kur plotësohen tri kërkesa: prania e një gabimi, prania e dëmeve dhe prania e një lidhje shkak-pasojë ndërmjet gamës së pretenduara dhe dëmeve të shkaktuara. Sipas ligjit belg, ankesat që lidhen me dëmet janë të pavarura nga ankimi për pezullimin ose anulimin e vendimeve vjetore “para kontraktuese”; që lidhen me prokurimet publike. Gjithsesi, anulimi i vendimit në lidhje me prokurimin publik nga Këshilli i Shtetit provon *ipso facto* gabimin e autoritetit kontraktues para gjykatave dhe tribunaleve. Në këtë rast, ankuesi do të duhet të provojë dëmtimet dhe lidhjen ndërmjet gabimit dhe dëmtimeve. Ankuesit nuk i duhet të presë për vendimin për kërkesën për anulimin e Këshillit të Shtetit në mënyrë që të kërkojë dëmshpërblim për dëme

para gjykatave dhe tribunaleve, por në këtë rast ankimuesi duhet të provojë gabimin e organit kontraktues përveç dëmeve dhe lidhjes shkak-pasojë. Në lidhje me përlllogaritjen e dëmeve, ankimuesit i duhet të vlerësojë dhe të justifikojë shumën e dëmeve që kërkohet, ndërsa gjyqtarët bëjnë vlerësimin sipas rastit. Pjesa më e madhe e dëmshpërblimeve për dëmet që janë dhënë për shkak të ankesave që lidhen me prokurimet publike janë thjesht kompensime për humbjen e një mundësie/rasti. **Gjithsesi, neni 15 i Ligjit, datë 24 dhjetor 1993, parashikon sistemin e një kompensimi fiks prej 10% të çmimit të tenderit për ankesa të prezantuara nga një tenderues i kualifikuar, oferta a të cilit a “çmimin më të ulët” kur kjo bazë kompensimi është e detyrueshme** (“aanbesteding”). Më tej, duhet të theksohet se përderisa marrëveshjet nuk mund të konsiderohen akte të njëanshme, ato nuk bien nën objektin e juridiksionit të Këshillit të Shtetit. Në këtë kuadër mund të japin dëmshpërblime vetëm gjykatat e zakonshme. Mundësitë për pezullimin dhe/ose anulimin e kontratave të përfunduara janë objekt diskutimi. Më tej, *apelimi urgjent* (neni 584, i Kodit Gjyqësor) i prezantuar para gjykatave dhe tribunaleve mund të përdoret për të kërkuar ndalim ose kufizim për organin kontraktues. Në këtë mënyrë, organi kontraktues mund të **urdhërohet** të veprojë ose të marrë një vendim të caktuar. Pra, gjykata mund të marrë masa të caktuara në pritje të vendimit të gjyqtarit për themelin e çështjes, ose të Këshillit të Shtetit për kërkesën për pezullim. Përputhje me këtë urdhër mund të sigurohet me anë të pagesave periodike të gjobave. Kohët e fundit është miratuar një Akt për Prokurimet Publike (4 maj 2006) i cili përmban ca risi. Janë theksuar zgjidhje ligjore të caktuara, si për shembull **pezullimi ligjor**. Gjatë kësaj vonese fikse, ankuesi mund të kërkojë pezullimin (tek Këshilli i Shtetit, degë e gjykatave dhe tribunaleve të zakonshme) të dhënies së kontratës, pa një dëm serioz që është i vështirë për t’u riparuar. Mund të merret parasysh dhe interesi publik, megjithëse nuk ekziston asnjë kërkesë ligjore për këtë gjë. Akti i Prokurimit Publik, i botuar së fundmi, e përmend shprehimisht këtë mundësi. Nëse kontrata është dhënë para se të skadojë periudha pezull, ankuesi mund t’i kërkojë kryetarit të gjykatës që të anulojë kontratën. Kjo mundësi konsiderohet si avantazh i rëndësishëm i sistemit belg dhe konsiderohet si risia më e madhe e tij gjatë viteve të fundit. Pasi të jetë dhënë kontrata, ajo as mund të anulohet dhe as mund të pezullohet për shkak të një parregullsie në procedurën e dhënies së kontratës (imuniteti i kontratës). Pagesa e një gjobe periodike mund të përcaktohen si nga gjyqtari gjyqësor (gjykatat dhe tribunalet e zakonshme) dhe gjyqtari administrativ (Këshilli i Shtetit). Koncepti ligjor i pagesës së gjobave periodike që mund të vendoset nga gjykatat dhe nga tribunalet është specifikuar në Aktin Gjyqësor (nenin 1385 bis *e pasues*). Kushtet për pagesat periodike të gjobave të urdhëruara nga Këshilli i Shtetit parashikohen në Dekretin Mbretëror të datës 2 prill 1991, kur flitet për procedurën gjyqësore të administratës së Këshillit të Shtetit në seksionin e pagimit të gjobës periodike.

2.4 Procedura

Instrumentet ligjore që trajtojnë të drejtën procedurale të organeve të rishikimit të prokurimeve publike janë Kodi Gjyqësor (“code judiciaire”) dhe ligjet organike të Këshillit të Shtetit, të koordinuara nga Dekreti Mbretëror, datë 12 janar 1973 dhe aktet në zbatim të tij (përkthim: <http://www.raadvst-consetat.be/En>). Vetëm palët që kanë interes efektiv për të përfunduar kontratën dhe që mund të cenohen nga parregullsia e pretenduar si dhe vetë organet kontraktuese kanë **juridiksion** për ngritjen e padive për ndreqjen e parregullsive para kontraktuese. Palët në kontratë, tenderues potencialë ose të përjashtuar dhe disa palë të treta mund të kërkojnë anulimin e vendimeve para përfundimit të kontratës. Duhet të theksohet se kërkimi i anulimit nga palët e treta është i kontestueshëm (kërkimi i anulimit të kontratës tek një gjyqtar (cf. supra, psh Akti i ri i Prokurimeve Publike përcakton imunitetin e kontratës në disa raste). Palët në kontratë kërkojnë kryesisht dëmet në çështje të tilla. Kërkesa për anulim ose pezullim (për shkaqe urgjente) duhet të depozitohet tek Këshilli i Shtetit brenda 60 ditësh pas njoftimit të vendimit të zbatueshëm. Për bërjen e ankimit para gjykatave ose tribunaleve janë të zbatueshme kushtet e përgjithshme të parashtrimit. Për disa çështje parashikohet nga neni 10 periudha pezull, e cila parashikon afatet kohore brenda të cilave tenderuesit duhet të fillojnë proceset e rishikimit (10 ditë, cf. po ashtu në Aktin e Prokurimit Publik). Depozitimi i një ankimi nuk ka **efekt pezullues**. Nuk ekzistojnë dispozita specifike që lidhen me afatet *detyruese* kohore për vendimet që kanë të bëjnë me prokurimet publike. Rregullat e zbatueshme parashikojnë afate kohore të ndryshme, por asnjëra prej tyre nuk është e detyrueshme (nëse gjyqtari e tejkalon afatin kohor, vendimi i lëshuar mbetet në fuqi). Për shkak të

vonesave në Këshillin e Shtetit, afati për një vendim në rastin e një kërkesë për pezullim është rreth dy deri në dhjetë muaj. Mundësinë e caktimit të një **eksperti** e vlerëson gjithmonë gjyqtari. Kostot paguhen paraprakisht nga pala e interesuar, por në fund të procesit shpenzimet mbulohen nga pala që humb. Kushtet për Këshillin e Shtetit citohen në Dekretin e Princit Regent, datë 21 gusht 1948, në veçanti mbi bazën e nenit 20 deri 25. Dispozitat që zbatohen për ekspertët e caktuar nga gjykatat dhe tribunale të parashikohen në Kodin Gjyqësor, në veçanti në nenin 962 deri në 991. **Kostot** e lidhura me thirrjet në gjyq dhe me procedurën (e gjykatave dhe të tribunalit), tatimet (Këshilli i Shtetit) dhe tarifatat e sondazheve duhet të paguhen nga aplikuesi. Nuk ka kosto të tjera specifike shitesë të ndryshme nga rishikimi i zakonshëm gjyqësor për tenderuesit që kërkojnë rishikim gjyqësor në kuadrin e çështjeve të prokurimit publik. Kur kërkohet përfaqësimi ligjor, secila nga palët në proceset e rishikimit duhet të paguajë juristët e vet, por në parim kostot e tjera gjyqësore mbulohen nga pala që e humb procesin. Por, në rrethana të caktuara edhe tarifatat e avokatëve mbulohen nga pala që humb. Nuk ka përgjegjësi specifike procedurale për të marrë parasysh nevojën e mbrojtjes së informacionit konfidencial të biznesit; gjithsesi, pranohet nga opinioni i audituesit (“auditoraatsverslag”) në Conseil d’Etat se nevoja për të mbrojtur informacionin konfidencial të biznesit mund të merret parasysh. Në raste të tilla, provat mund t’i dërgohen vetëm Conseil d’Etat dhe jo konkurrenseve. Nuk ka formularë dhe dokumente model të detyrueshme të përdorura për rishikim të prokurimeve publike dhe dëmshpërblime, por në çdo kërkesë duhet të përmenden disa rregulla formale e të detyrueshme. Vendimet e Këshillit të Shtetit mund të gjenden në faqen zyrtare të tij në internet në adresën (<http://www.raadvst-consetat.be>). Për vendimet e gjykatave dhe të tribunaleve nuk bëhet ndonjë botim sistematik. Jurisprudenca është e kufizuar, por ka rëndësi shumë të madhe për shkak të një sistemi që përbëhet si nga kodifikimi dhe nga jurisprudenca.

2.5 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët dhe panelistët e organeve të rishikimit të prokurimeve publike dhe juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit, ose subjektet kontraktuese në proceset e rishikimit i marrin njohuritë e tyre për të drejtën e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e Komunitetit në përgjithësi dhe për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë dhe se cilat janë implikimet teknike dhe financiare nëpërmjet studimeve universitare ose arsimit të vazhdueshëm, librave dhe artikujve për prokurimet publike, juristëve me eksperiencë në këtë fushë, kurseve të ofruara nga Ministria e Drejtësisë ose nga organizatat private ose faqet e tilla të internetit të tilla si <http://www.simap.eu.int/>, <http://www.jepp.be>, <http://www.binnenland.vlaanderen.be/overheidsopdrachten/index.htm>. E njëjta gjë aplikohet dhe për tenderuesit të cilët marrin informacion nëpërmjet juristëve, konsulentëve ose organizatave profesionale. Tijdschrift voor Aannemingsrecht (T.Aann.) është gazetë që merret specifikisht me të drejtën e prokurimeve publike. E drejta e prokurimeve publike është temë diskutimi në shumë konferenca dhe seminare akademikë dhe profesionalë. Vlaamse vereniging voor aanbestedingsrecht (<http://www.vva-vzw.be>) dhe Esimap, Centre d’études, de services et d’information en matière de marchés publics et domaines connexes (www.esimap.be) janë shoqata kombëtare për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike. Ekzistojnë disa shoqata kombëtare për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike. Shoqëria civile për monitorimin e prokurimeve publike dhe lobimet për to me aktorë të tjerë dhe përfshirjet në mënyra të tjera lidhen me organizimin e konferencave për prokurimet publike, me informimin dhe këshillimin, të tilla si Nationale Confederatie van het Bouwbedrijf dhe Vlaamse Confederatie Bouw. Për shembull, oficerët e prokurimeve publike mund të marrin pjesë në disa nga programet e trajnimit të Vlaamse vereniging voor aanbestedingsrecht.

3. **Bullgaria**

Pas ndryshimit të ligjit për prokurimet publike (LPP), i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2006, sistemi i rishikimit të prokurimeve publike përbëhet nga shkalla e parë e gjykimit para **Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK)** dhe shkalla e dytë dhe e fundit e rishikimit gjyqësor para **Gjykatës së Lartë Administrative (GjLA)**. Në lidhje me kontratat mbi dhe poshtë pragut mund të jepen dëmshpërblime të natyrave të ndryshme. Për shkak se këto parashikime janë shumë të reja, deri tani ka pak eksperiencë operative.

3.1 *Ankimimi në organin ose subjektin kontraktues*

Një ankesë tek organi ose autoriteti kontraktues në vetvete nuk përbën një etapë detyruese të sistemit të dëmshpërblimit. I vetmi detyrim për ankuesin është dërgimi i një kopje të ankesës tek organi ose subjekti përkatës.

3.2 *Rishikimi thuajse-gjyqësor*

KMK-ja është një organ i pavarur rishikimi prokurimesh publike të shkallës së parë. Çdo vendim, veprim ose mosveprim nga ana e subjekteve kontraktuese në procedurën e dhënies së kontratave publike **përpara përfundimit** të kontratës publike ose marrëveshjes kuadër është subjekt i rishikimit ligjor para **KMK**-së. **KMK**-ja nuk ka juridiksion pas përfundimit të kontratës. Anëtarët e tij nuk kanë status të krahasueshëm me atë të gjyqtarëve. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, subjekti përbëhet nga shtatë persona të zgjedhur dhe të votuar nga Parlamenti kombëtar për një periudhë prej pesë vjetësh. Ata mund të rizgjidhen për një mandat tjetër pesë vjeçar. Kryetari duhet të jetë jurist me eksperiencë në fushë për të paktën dhjetë vjet. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë nënshtetas bullgarë me diplomë universiteti në juridik ose ekonomik dhe me praktikë prej të paktën pesë vitesh e që gëzojnë cilësi të larta të etikës profesionale, që nuk janë dënuar për krime me paramendim. Ata nuk mund të kenë asnjë punë tjetër përveçse mund të jenë të përfshirë në aktivitete shkencore dhe mësimdhënie. Ata nuk mund të përfitojnë në asnjë formë nga ndërmarrjet.

3.3 *Rishikimi gjyqësor*

Gjykata e Lartë Administrative është **gjykatë administrative e shkallës së fundit** për rishikim të vendimeve të prokurimeve publike. Përpara 1 korrikut të vitit 2006, gjykatat civile kishin juridiksion mbi kontratat e prokurimeve publike. Vendimet e GjLA-së janë objekt apelimi para një komiteti të GjLA-së të përbërë prej tre personash. Gjykata e garanton **pavarësinë** e saj duke përcaktuar emërimin, mandatin, kualifikimet e anëtarëve, financimet, etj. GjLA-ja është krijuar mbi bazën e Kushtetutës dhe Akteve të Parlamentit dhe përmbush kërkesat e gjë gjykate, të parashikuara nga vendimet në çështjen *Dorsch* dhe *Salzmann*. Ajo është e pavarur nga ekzekutivi, administrata, ose pjesë të tjera të qeverisë dhe vendimet e saj kanë natyrë juridiksionale. Gjyqtarët e saj duhet të jenë juristë me eksperiencë dhe të mirënjohur. Gjyqtarët emërohen sipas një procedure të përgjithshme. **Kryetari** i GjLA-së emërohet për një periudhë shtatë vjeçare nëpërmjet një urdhri të parashikuar në Ligjin për Sistemin Gjyqësor (LSGj), dhe nuk gëzon të drejtën e rizgjedhjes. Së bashku me funksionet menaxhuese, gjyqtarët kryejnë detyra ligjore të lidhura me zbatimin e autoritetit gjyqësor që i njihet prej Kushtetutës dhe ligjeve (neni 125a, paragrafi 4 LJS). Kryetari duhet të ketë të paktën tetë vjet eksperiencë në praktikën ligjore.

3.4 *Mjetet efektive ligjore*

Të gjitha **mjetet efektive ligjore** parashikohen në LPP. Sipas nenit 120, çdo vendim ose mosveprim nga ana e subjektit kontraktues në procedurën e dhënies së kontratës para përfundimit të kontratës publike, ose marrëveshjes kuadër është objekt i rishikimit gjyqësor para **KMK**-së. Në momentin kur fillohen proceset para **KMK**-së nuk ka **efekt automatik pezullues**. Gjithsesi, sipas nenit 121a, paragrafi 1, pas një kërkesë të arsyeshme nga ankuesi dhe në rast të një dëmi real për një dëm serioz në interesin e publikut, ose interesat e palëve dhe duke marrë parasysh pasojat e pafavorshme të vonesës së procedurës së dhënies së kontratës publike **KMK-ja mund të vendosë pezullimin** e dhënies së kontratës publike si masë e përkohshme. Kundër vendimit të **KMK**-së mund të depozitohet tek Gjykata e Lartë Administrative brenda 14 ditësh nga komunikimi i vendimit për palët, ndërsa rishikimi nuk duhet të pezullojë ekzekutimin. Sipas nenit 120a, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, çdo person që ka aktualisht ose ka pasur në të shkuarën interes në marrjen e një kontrate të veçantë mund të ngrejë padi për **deklarimin nul** të një kontrate publike dhe mund të kërkojë marrjen e dëmshpërblimeve për **dëmet** nëse ai/ajo është cenuar si rezultat i shkeljes së LPP-së sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile. Një kontratë publike deklarohet nul dhe e pavlefshme nëse kontrata publike përmbillet ndërmjet palëve ndërsa palët nuk kanë ndjekur rregullat e parashikuara. Bullgaria ka një sistem ligjor të kodifikuar, por jurisprudenca nuk ka shumë rëndësi për shkak të interpretimeve të legjislacionit që jepen në vendimet e gjykatës. Ndikimi i vendimeve të Gjykatës

Europiane të Drejtësisë për prokurimet publike është i kufizuar, por do të rritet për shkak të pranimit të Bullgarisë në BE.

3.5 *E drejta procedurale*

E drejta procedurale rregullohet nga Ligji për Prokurimet Publike, ligji për KMK-në dhe Kodi i Proceseve Administrative në Gjykatë. Provat me shkrim, shpjegimet me gojë dhe mendimet e ekspertëve lejohen në proceset para KMK-së. Kur mendimet e ekspertëve paraqiten në proceset para KMK-së, burimet për pagimin e ekspertëve parashikohen paraprakisht nga pala që ka kërkuar ekspertizën. Kur fillohet ekspertiza nga KMK-ja, kostot për tarifat e ekspertëve i jepen pretenduesit. Pra, ankesa mund të bëhet nga çdo person që ka, ose mund të ketë pasur një interes të veçantë në marrjen e një kontrate brenda një periudhe dhjetë ditore pas njoftimit prej tij/saj të një vendimi ose veprimi, i cili është subjekt rishikimi, ose, nëse personi nuk është njoftuar, nga data që ai/ajo është vënë në dijeni të vendimit, ose të datës në të cilën ka mbaruar afati kohor për një veprim të caktuar. LPP-ja parashikon se për vendosjen e masave të përkohshme ankuesi duhet të paraqesë një **depozitë** prej 1% të vlerës së kontratës publike, por jo më shumë se 50,000 BGN si depozitë monetare në llogarinë bankare të KMK-së ose një garanci bankare. KMK-ja do të përcaktojë shumën e depozitës deri në 50,000 BGN në rastet kur nuk mund të përcaktohet vlera e kontratave publike. Nëse palët vendosin të mbrohen nga avokatë, atyre u duhet të paguajnë tarifat e kërkuara, por ky përfaqësim është opsional. KMK-ja shpreh një mendim për ankesën brenda 2 muajve nga fillimi i proceseve. Vendimi, i shoqëruar nga motivimi, hartohet dhe shpallet brenda 14 ditësh pas shprehjes së një mendimi për ankesën. Vendimet e organeve të rishikimit njoftohen dhe **botohen** në faqen e internetit të organit përkatës të rishikimit. GjLA-ja i shpërndan vendimet sipas parashikimeve të ligjit për SAC.

3.6 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët, anëtarë e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe administrata e tyre si dhe juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit ose organet/subjektet kontraktuale në proceset e rishikimit i marrin njohuritë për ligjin e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e komunitetit në përgjithësi kryesisht nga studimet e tyre universitare, por edhe nëpërmjet kurseve të organizuara nga BE-ja, ose organizatat ndërkombëtare, ose PPA-ja, si dhe nëpërmjet “të mësuarit gjatë procesit të punës”. Ata marrin në praktikë njohuri për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike, përveç aspekteve financiare dhe teknike të përfshira, gjatë kurseve që ofrohen nga BE-ja ose organizatat ndërkombëtare; disa prej tyre marrin pjesë në kurset e ofruara nga qeveria dhe nga agjencia e prokurimeve publike. Qëndrimi i gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të organeve të rishikimit të prokurimeve publike drejt interesit publik, nga njëra anë, dhe interesave privatë të tenderuesve, nga ana tjetër, konsiderohet si i balancuar, megjithëse ndonjëherë me tendencë ndaj interesit të publikut ose interesave të tenderuesve. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i marrin njohuritë e tyre për bazën ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë nga qeveria, nga BE-ja ose organizatat ndërkombëtare, ose nëpërmjet organizatave profesionale, si, për shembull, nga dhomat e tregtisë. Sipas sistemit që ka funksionuar më parë, deri në qershor 2006 disa tenderues nuk dëshironin të fillonin procedurat e rishikimit pasi ata nuk donin t'i hiqnin vetes mundësinë e marrjes së një kontrate tjetër dhe disa pengoheshin nga kërkimi i rishikimit gjyqësor për shkak të kohëzgjatjes së proceseve.

Nuk ekziston ndonjë gazetë specifike për botime në fushën e prokurimeve publike. Ligji i prokurimeve publike diskutohet në konferenca dhe seminare akademike dhe profesionale. Nuk ka shoqata kombëtare për prokurimet publike në Bullgari, por grupe të tjera përkatëse interesi, të tilla si dhomat e tregtisë, shoqata e industrive kombëtare të ndërtimit, Konfederata e Industrive të Bullgarisë, Dhoma Industriale e Bullgarisë, Shoqata Bullgare e Biznesit Ndërkombëtar, Dhoma Bullgare e tregtisë dhe e Industrisë dhe OJQ-të, të tilla si seksioni kombëtar i Transparency International të cilat llojnë, informojnë, japin informacion dhe/ose këshillojnë për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me prokurimet publike. Shtypi dhe televizioni mbulojnë procese të rishikimit të prokurimit publik nëse ka interes të madh publik për çështjen.

4. Qiproja

Sistemi i rishikimit dhe i trajtimit të ankesave për prokurimet publike në Qipro mund të nëndahet në tri elementë: ankesa për autoritetin kontraktues, rishikimi jo-gjyqësor nëpërmjet Organit të Rishikimit të Tenderuesve (ORT) dhe rishikimi gjyqësor nëpërmjet Gjykatës Supreme të Qipros.

4.1 Ankesat për organin kontraktues

Ligji qipriot parashikon shprehimisht se para depozitimit të një ankese për rishikim në ORT (të përshkruar më lart), çdo person i interesuar, brenda pesë ditësh nga data kur vihet në dijeni të një akti ose vendimi të tillë, **njofton autoritetin kontraktues me shkrim** dhe i dërgon një kopje të njoftimit organit kompetent (Thesarit të Republikës) në lidhje me shkeljen e pretenduar dhe synimin e tij/saj për bërjen e një kërkesë për rishikim. Autoriteti kontraktues i shqyrton pretendimet dhe nxjerr një vendim të arsyetuar brenda pesë ditësh nga marrja e njoftimit. Nëse pretendimet konstatohen se janë të justifikuara, autoriteti merr masat e nevojshme. Nëse ORT-ja nuk merr masa brenda pesë ditësh, prezumohet se autoriteti e ka rrëzuar pretendimin. Aplikimi për rishikim depozitohet brenda dhjetë ditësh nga dita kur njoftimi i bëhet me dije aplikuesit ose pas përfundimit të periudhës prej pesë ditësh, e cila përmendet më lart. Ligji nuk specifikon se kush brenda autoriteteve kontraktuese merret me aplikimet për rishikim në ORT. Por, praktika e krijuar është se oficerët kontraktues të tenderit në fjalë, të cilët janë në dijeni të këtyre çështjeve, merren me shqyrtimin e brendshëm të këtyre pretendimeve.

4.2. Rishikimi jo gjyqësor

ORT-ja, organi jo gjyqësor i rishikimit, u krijua më 1 dhjetor 2003, bazuar në një vendim të Këshillit të Ministrave. Ai ka kompetenca të rishikojë vendimet e marra nga organet kontraktuese para përfundimit të çdo kontrate publike për një shkelje të pretenduar të ligjit. Pra, ekziston një organ rishikimi i prokurimeve publike, i cili është i pavarur nga qeveria. Gjithsesi, anëtarët e këtij organi nuk kanë një status të krahasueshëm me statusin e gjyqtarëve. ORT-ja ka pesë anëtarë, duke përfshirë dhe kryetarin.

4.3 Rishikimi gjyqësor

Më tej, ligji qipriot parashikon se çdo person i pakënaqur nga një vendim i ORT-së, ose nga çdo vendim i marrë nga një organ kontraktues para ose pas përfundimit të kontratës mund të ankimojë këtë vendim para **Gjykatës së Lartë të Qipros**. Dëshmëpërblimet mund të jepen vetëm nga gjykata. Këto çështje trajtohen nga Kushtetuta e Republikës. Çdo person i interesuar mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për të bërë një ankimim në Gjykatën e Lartë të Qipros në vend që të aplikojë për rishikim në ORT, me kusht që këto dy procedura nuk bëhen në të njëjtën kohë. Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe kryetari i saj janë gjyqtarë dhe statusi i tyre parashikohet nga Kushtetuta. Gjykata plotëson kërkesën e një gjykate të përmendur në vendimet *Dorsch* dhe *Salzmann*.

4.4 Trajtimi i ankesave

ORT-ja mund të **lërë mënjanë/pezullojë** një vendim të paligjshëm të marrë para përfundimit të një kontrate publike dhe mund të urdhërojë heqjen e një amendimi që përmban specifikime diskriminuese teknike, ekonomike ose financiare në dokumentet e kontratës, ose në çdo dokument tjetër të lidhur me procedurën e dhënies së kontratës. Më tej, ORT-ja, pas depozitimit të një ankimi për rishikim dhe me kërkesë të ankuesit, mund të urdhërojë **masa të përkohshme** në mënyrë që të parandalojë dëme të tjera në llogari të interesave përkatës, duke përfshirë masat për pezullimin ose sigurimin e pezullimit të procedurës që çon në dhënien e një kontrate publike ose zbatimin e vendimit të marrë nga autoriteti kontraktues deri sa të merret një vendim përfundimtar. Në kuadrin e masave të përkohshme, ORT-ja mund të marrë parasysh pasojat e mundshme tek interesat e palëve që mund të cenohen, duke përfshirë interesin publik, dhe mund të vendosë të mos marrë masa të tilla kur pasojat negative të tyre janë më të mëdha se përfitimet. Gjykata e Lartë mund të marrë vendime si çdo gjykatë tjetër, duke përfshirë dhe masat e përkohshme, për **dëmet**, lënien mënjanë të thirrjes për tender, lënien mënjanë të vendimit për dhënien e kontratës, anulimin e kontratës ose pagesat periodike të gjobave, shpagimin e dëmeve, etj. Një kontratë e përfunduar mund të anulohet vetëm me një vendim gjykate.

4.5 *Procedura*

Çdo person që ka ose ka pasur më parë interes në marrjen e një kontrate publike të caktuar, ose që ka qenë i rrezikuar të dëmtohej, ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar nga një akt ose vendim i një autoriteti kontraktues mund të aplikojë për rishikim tek ORT-ja para përfundimit të kontratave të tilla publike. Nuk ka dallim ndërmjet kontratave për të cilat zbatohen direktivat dhe kontratave për të cilat nuk zbatohen direktivat. Kjo nuk cenon të drejtën e personit të interesuar për të depozituar një kërkesë për rishikim gjyqësor tek Gjykata e Lartë e Qipros në vend që të bëjë ankim tek ORT-ja. Nuk ka dallim ndërmjet kontratave tek të cilat zbatohen direktivat dhe kontratat tek të cilat nuk zbatohen direktivat. Për ORT-në, pjesët e ligjeve për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave publike (Pjesa IV e ligjeve N11(I)/2006 dhe N12(I)/2006) rregullojnë procedurën e rishikimit. Në këtë kuadër duhet të përmendet dhe Rregullorja nr. 745/2003 që lidhet me krijimin dhe funksionimin e ORT-së. Tarifat e parashikuara bazohen në vlerën e tenderit që është përzgjedhur. Më specifikisht, nga CYP £1-£100 000 tarifa është £500, nga CYP £100 001-£500 000 tarifa është £1 500, nga CYP £500 001-£1 000 000 tarifa është £2 000, nga CYP £1 000 001-£5 000 000 tarifa është £3 000 dhe nga CYP £5 000 001 dhe më lart tarifa është £4 000. Kostot për aplikimin për masat e përkohshme janë £1000. Nëse aplikimi për rishikim paraprind dorëzimin e tenderëve tarifa është £1 000. ORT-ja mund të urdhërojë çdo aplikues ankimet e të cilat janë rrëzuar të mbulojnë kostot e proceseve, si dhe plus një gjobë që ajo e sheh të arsyeshme në varësi të rrethanave të çështjes. Tarifat e ORT-së janë të parimbursueshme. ORT-ja merr vendim brenda 30 ditësh nga depozitimi i aplikimit për rishikim. Sipas Seksionit 146 të Kushtetutës, çdo person i interesuar mund të depozitojë kërkesë për rishikim gjyqësor tek Gjykata e Lartë e Qipros brenda 75 ditësh nga data e botimit të veprimit, ose vendimit, ose nga data në të cilën personi është vënë në dijeni të një botimi të tillë. Vendimet e ORT-së i shpërndahen palëve dhe publikut nëpërmjet botimit në faqen e internetit (www.tra.gov.cy) dhe i dërgohen me shkrim palëve kontraktuese, tenderuesit dhe organit kompetent (Thesarit të Republikës). Vendimet e Gjykatës së Lartë botohen në volume, të cilat mund të blihen nga Zyra e Botimeve Qeveritare. Po ashtu, ekziston dhe një firmë, Leginet Ltd. (www.leginet.com), e cila është mbajtësjja e dy bazave të mëdha të të dhënave të legjislacionit dhe jurisprudencës në Republikën e Qipros, në të cilën të interesuarit mund të abonohen. Gjithsesi, të gjitha çështjet e fundit jepen vetëm në gjuhën greke, në përjashtim të çështjeve më të vjetra të dhëna në periudhën kohore 1883-1989, të cilat janë të disponueshme dhe në anglisht. Më tej, Gjykata e Lartë pritet të kenë gati bazën e saj të të dhënave që do të përmbajë, ndër të tjera, dhe çështje/vendime, në rreth dy vite kohë. Aktualisht po përgatitet një ligj i ri për koordinimin e procedurave të rishikimit.

4.6 *Kultura e rishikimit*

Formularët model për rishikimin e prokurimeve publike nga ORT-ja mund të shihen në adresën e internetit www.tra.gov.cy. Njohuria e oficerëve kontraktues me formim juristi a profesionesh të tjera të lidhura me prokurimet publike përshkruhet si shumë e mirë. Ligji për prokurimet publike diskutohet në konferencat dhe në seminarat akademike dhe profesionale. Ekziston trajnim profesional për ligjin e prokurimeve publike, ndërsa e drejta për prokurimet publike nga zyrtarët përshkruhet/mësohet nëpërmjet trajnimit në punë dhe nëpërmjet disa seminareve dhe konferencave. Vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë përdoren si instrumente për të gjetur zgjidhje për çështjet e komplikuar.

5. **Republika Çeke**

Prokurimet Publike (PP) në Republikën Çeke trajtohen nga Akti 40/2004 Coll. për Kontratat Publike (përkthimi në anglisht mund të gjendet në adresën <http://www.compet.cz/English/VZ/Zakony/Rozcesti.htm>), por Direktivat e reja të KE-së janë zbatuar nëpërmjet Aktit 137/2006 Coll. (Zákon o veřejných zakázkách), i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2006. Akti 139/2006 Coll. mbulon dhënien e koncesioneve. Sistemi i rishikimit dhe i trajtimit të ankesave në Republikën Çeke bazohet në një sistem të përzier kontrolli administrativ, quasi-gjyqësor dhe gjyqësor. Aktori kryesor është **Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës** (Úřad Pro Ochranu Hospodářské Soutěže, Joštova 8, 601 56 Brno; telefon +420 542 161233; faks +420 542 210023, E-mail: posta@compet.cz,

Website: www.compet.cz), e cila pason ish Ministrinë e Konkurrencës dhe u krijua si organ i pavarur qeveritar nëpërmjet Aktit 273/1996 Coll. (përkthimi në anglisht mund të gjendet në adresën http://www.compet.cz/English/LEGI/Zakon273_en.htm). Kontrolli ekstra gjyqësor është i disponueshëm dhe në sektorin e shërbimeve, pasi si Akti i mëparshëm dhe ai aktual kanë zbatuar mekanizmin e pajtimit të prezantuar nga Direktiva e KE-së 92/13 (§ 124 e Aktit të PP të 2006-ës). Nuk ekziston një organ specifik arbitrimi të cilit i është besuar misioni i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën e prokurimeve publike.

5.1 Rishikimi i vendimeve të prokurimeve

Sipas Aktit të vitit 2004, ekzistojnë katër etapa për rishikimin e vendimeve në lidhje me procedurën e tenderimit. Në **fazën e parë**, përpara përmbylljes së kontratës, çdo tenderues ka të drejtë të depozitojë me shkrim një ankesë për organin kontraktues brenda 15 ditësh pas marrjes së njoftimit të dhënies së kontratës, ose vendimit për përjashtim nga procedura. Nën pragun e KE-së, e drejta e tenderuesit për të depozituar një ankesë duhet të shoqërohet me të dëshmuarin se tenderuesi ka, ka pasur ose ka të ngjarë të jetë cenuar nga shkeljet e pretenduara e të parashikuara në Aktin e 2004-ës. Në të dyja rastet, depozitimi i një ankese paraprake për autoritetin kontraktues është parakusht për kërkimin e rishikimit të një shkelje të pretenduar para Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës. Ky detyrim nuk zbatohet në rastet kur është përfunduar kontrata. Brenda 10 ditësh nga marrja e ankesës, organi kontraktues njofton ankuesin për vendimin e arsyetuar. Organi kontraktues mund të pranojë ose të rrëzojë ankesën, ose mund të sugjerojë një zgjidhje të ndryshme nga ajo çfarë kërkohet nga ankuesi. Një kontratë e përmbyllur në shkelje të detyrimit të përmendur më lart konsiderohet e pavlefshme. Dispozitat e lidhura me etapën parë janë ndryshuar pak me anë të Aktit të vitit 2006; sipas këtij Akti, çdo tenderues ka të drejtë të ankohet zyrtarisht tek autoriteti kontraktues, pavarësisht nga vlera e vlerësuar e kontratës, ndërsa periudha prej 60 ditësh është ndryshuar në 45 ditë. Në **fazën e dytë**, nëse rezultati i ankesës së mëparshme nuk është i favorshëm për ankuesin, mosmarrëveshjet mund t'i çohen Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës. Zyra është një organ i pavarur qeveritar, kryetari i së cilës emërohet për një mandat gjashtë vjeçar nga Presidenti i Republikës Çeke me propozim të qeverisë. Po ashtu, kryetari nuk mund të jetë anëtar i asnjë partie politike dhe jo dosmodoshmërisht duhet të jetë jurist me eksperiencë. Tenderuesit mund të kundërshtojnë çdo akt të organit kontraktues që ka të ngjarë të detyrimet e transparencës dhe mos-diskriminimit, të tilla si kushtet e dhënies së kontratës, njoftimet/ftesat e kontratës për tenderët, llojin e procedurës së tenderimit, vendimin e përjashtimit dhe dhënien e kontratës (§ 97.3 të Aktit të vitit 2004). Kërkesa duhet të bëhet brenda dhjetë ditësh pas vendimit të organit kontraktues kur ankesa e mëparshme i është njoftuar ankuesit. Në çdo rast, ankesa duhet të depozitohet jo më vonë se 25 ditë nga depozitimi i ankesës paraprake të organit kontraktues. Edhe Akti i vitit 2004 e lejon zyrën të fillojë procese me iniciativën saj jo më vonë se tre vjet pasi të ketë ndodhur shkelja e Aktit. Në vitin 2005 janë filluar 334 procese, nga të cilat 184 me kërkesë dhe 152 me iniciativën e zyrës. Pasi janë filluar procedurat dhe pasi autoritetit kontraktues i është kërkuar të japë dokumentacionin e nevojshëm (si për shembull dosjen e prokurimeve), zyra ka 30 ditë (në raste të vështira 60 ditë) për të nxjerrë një vendim për një kërkesë. Sipas Aktit të vitit 2006, ky afat kohor fillon me fillimin e proceseve para zyrës. Kërkesa trajtohet nga Seksioni i Prokurimeve të zyrës, i cili drejtohet nga një jurist. Në **etapën e tretë** vendimi i Seksionit të prokurimit mund të apelohej para kryetarit të zyrës, i cili jep vendim mbi bazën e një propozimi të bërë nga “Komiteti i Apelit”, që është një bord këshillimor i krijuar brenda zyrës dhe i përbërë nga zyrtarë të organit si dhe ekspertë të jashtëm. Nuk ka dispozita specifike në Aktin e vitit 2004 që merren me këtë fazë, por janë të zbatueshme dispozitat e përgjithshme në Aktin 500/2004 Coll. – Kodi i Procedurës Administrative. Nuk ka më apeline të tjera kundër vendimeve të marra nga zyra, por ekziston trajtimi përjashtimor i ankesave në **etapën e katërt**. Në veçanti, Gjykata e Lartë Administrative mund të rishikojë vendimet e zyrës pa kërkesës për rishikim (kasacion). Gjykata e Lartë Administrative është organ i pavarur dhe permanent kushtetues si dhe organ rishikimi i shkallës së fundit për çështjet administrative (Nejvyšší správní soud, Masarykova 31, 657 40 Brno; telefon +420 542 532 311; Faks +420 542 532 361, E-mail: podatelna@nssoud.cz, Website: <http://www.nssoud.cz/en/index.php>).

5.2 *Trajtimi i ankesave*

Sipas Aktit të vitit 2004 dhe pavarësisht nga vlera e përlogaritur e kontratës, trajtimi i ankesave kundër akteve të organeve kontraktuese mund të bëhet para, ose pas përmbylljes së një kontrate, ose nga Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës (masa të përkohshme dhe korrektuese, pezullimi i performancës së kontratës, gjobat), ose nga gjykatat e zakonshme (dëme). Para përfundimit të proceseve dhe deri në masën e nevojshme për ruajtjen e qëllimit, Zyra ka të drejtë të japë **masa të përkohshme**, ose mbi bazë e ankimit të depozituar, ose me iniciativë të saj në mënyrë që të parandalohen dëme të mëtejshme apo ndonjë rrezik i menjëhershëm për interesat e ankimuesit. Në veçanti, për një periudhë kohe të specifikuar në urdhrin përkatës, por jo më vonë se data e lëshimit të një vendimi përfundimtar, zyra mund 1) t'i kërkojë organit kontraktues të mos përfundojë një kontratë pas procedurës së tenderimit; 2) të pezullojë procedurën e tenderimit dhe 3) të pezullojë realizimin e një kontrate të përfunduar. Zyra mund të marrë parasysht pasojat e mundshme të masave të përkohshme për të gjithë interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik, dhe mund të vendosin të mos marrin këto masa kur pasojat e tyre negative i tejkalojnë përfitimet. Në parim, depozitimi i kërkesës nuk ka efekt pezullues mbi procedurën vijuese të tenderimit, por kur rezultati i fazës së parë (ankesa e mëparshme për organin kontraktues) nuk është i favorshëm për ankimuesin, kontrata nuk do të përfundohet për një periudhë 30 ditore (sipas Aktit të vitit 2006: 45 ditë) nga marrja e ankesës. Plus, Akti i vitit 2004 thotë se kur organi kontraktues cenon me dashje detyrimet e tenderimit në keqbesim, procedura do të konsiderohet e **pavlefshme** që nga fillimi. Apelimet kundër urdhrave që japin masa të përkohshme nuk kanë efekt pezullues për zbatimin e këtyre urdhrave. Nëpërmjet vendimit të saj përfundimtar dhe para përfundimit të një kontrate, zyra, pasi konfirmimit me shkrim të shkeljes së Aktit të Prokurimeve Publike, vendos për një **masë korrigjuese** për organin kontraktues, d.m.th., pezullon vendimin e kontratës kur shkelja ka cenuar ose ka pasur të ngjarë të cenojë vlerësimin e ofertave. Pas përfundimit të kontratës dhe mbi të njëjtat baza siç ato që përmenden në çështjen e sipërpërmendur, zyra ka të drejtë të **ndalojë realizimin** e një kontrate të përfunduar dhe të vërë **gjobë** në proceset e përbashkëta për shkelje detyre, të cilës i referohet neni § 102 i Aktit të vitit 2004 (për shembull: mospërputhja me detyrimet e tenderimit; përfundimi i një kontrate në shkelje me Aktin e vitit 2004; braktisje e pajustificuar e një procedure tenderimi; mos regjistrimi i procedurës së tenderimit ose mosdhënia e informacionit për dhënie kontratash). Në vitin 2005 u vunë gjashtëdhjetë e katër gjoba me një shumë totale prej CZK 2 569 000. Gjithsesi, anulimi i një kontrate të dhënë njoftohet vetëm me anë të një vendimi të një gjykate të zakonshme sipas kushteve të parashikuara në Kodin Tregtar. Në parim, duhet të ketë lidhje të mjaftueshme ndërmjet shkeljes së pretenduar të Aktit të Prokurimeve Publike dhe dëmit (aktual ose potencial të interesave të ankimuesve. Gjithsesi, dhënia e dëmshpërblimeve nuk është objekt i një vendimi të mëparshëm të zyrës që pezullon aktin e pretenduar të organit kontraktues. Së fundmi, ka masa disiplinore (të tilla si gjobat periodike) që mund të vendosen kundër organit kontraktues ose zyrtarëve të prokurimeve nga organi kompetent administrativ (§ 104 i Aktit të vitit 2004).

5.3 *Procedura*

Proceset para Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës rregullohen nga Akti i vitit 2004 (që prej 1 korrikut 2006: i quajtur ndryshe dhe Akti i 2006-ës) dhe nga Kodi i Procedurës Administrative (Akti 500/2004 Coll.). Fillimi i proceseve bëhet vetëm pasi depozitohet një **depozitë** në llogarinë e zyrës dhe pasi bëhet pagesa e **tarifës administrative** prej CZK 30 000 (rreth €1 000). Depozita e ka vlerën tek rreth 1% e çmimit të tenderit, por nuk e kalon shumën prej 1 000 000 koronash çeke. Nëse kërkesa pranohet, depozita i rimbursohet ankimuesit (së bashku me interesat). Në rast refuzimi/rrëzimi të saj, depozita konsiderohet si e ardhur në buxhetin e shtetit. Tarifa administrative nuk është e rimbursueshme. Sipas aktit të vitit 2006 nuk ekziston asnjë detyrim për të paguar një tarifë administrative, por shuma e depozitës tani është 1% e çmimit të tenderit dhe nuk e kalon kufirin prej CZK 2 000 000. Fillimi i proceseve gjyqësore nuk kërkon përfshirjen e një profesionisti (d.m.th të një përfaqësuesi ligjor), por është objekt i pagimit të një tarife gjykate. Në rast të pretendimeve për dëme, shuma e gjykatës shkon deri në 1% të shumës së përlogaritur të dëmit. Në rast të proceseve para Gjykatës së Lartë Administrative, tarifa e gjykatës është CZK 2 000. Në rastin e fundit zbatohet Kodi i Drejtës Administrative. Tarifat e gjykatës si dhe kosto të tjera të lidhura, mund të rimbursohen nga pala që humb me anë të një vendimi të gjykatës. Në proceset para zyrës,

përfshirja e **ekspertëve** (të tillë si juristë ose përkthyes) duhet të vendoset nga Seksioni i Prokurimit në bashkëpunim me Seksionin Ekonomik nëse një gjë e tillë del e nevojshme. Kostot për ekspertët paguhen nëpërmjet një buxheti të veçantë të zyrës. Stafit i zyrës si dhe ekspertët e jashtëm janë të detyruar të ruajnë **konfidencialitetin** e të gjitha çështjeve që dalin gjatë proceseve. Ky detyrim nuk zbatohet nëse këta persona ftohen të japin dëshmi para gjykatës, ose nëse u kërkohet të shprehen nga organet shtetërore të hetimit, ose nëse u kërkohet të japin prova me shkrim për organet e sipërpërmendura sipas parashikimeve të Kodit Penal. Nëse zyra vihet të dijëni të një fakti që është pjesë e **sekretit tregtar**, ajo duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur shkeljen e mbajtjes së sekretit tregtar. E drejta e tenderuesit për të inspektuar dokumentacionin e kontratës është objekt i zyrës që ka marrë miratimin e të gjithë tenderuesve të përfshirë. Vendimet e zyrës i shpërndahen palëve në procese nëpërmjet postës dhe botohen në një përmbledhje vjetore të vendimeve të zyrës si dhe në faqen e internetit të zyrës.

5.4 Kultura e mjeteve efektive ligjore

Zyrtarët e Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe administrata e tyre, si dhe juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit ose organet/subjektet kontraktuese në proceset e rishikimit i marrin njohuritë për ligjin e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e komunitetit në përgjithësi kryesisht nga studimet e tyre universitare, por edhe nëpërmjet kurseve të organizuara organet qeveritare (si për shembull Ministria për Zhvillimin Rajonal), ose nga BE-ja (në veçanti në kuadrin e projekteve të binjakëzimit). Qëndrimi i gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të organeve të rishikimit të prokurimeve publike konsiderohet i drejtë. Jurisprudenca është e kufizuar, por ka një rëndësi shumë të madhe për shkak të një sistemi që përbëhet si nga kodifikimi dhe jurisprudenca drejt interesit publik nga njëra anë, dhe interesave privatë të tenderuesve nga ana tjetër. Sistemi konsiderohet si i balancuar, megjithëse ndonjëherë me tendencë ndaj interesit të publikut, ose interesave të tenderuesve. Tenderuesit marrin njohuritë e tyre për bazën ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë nga qeveria, nga BE-ja ose organizatat ndërkombëtare, ose nëpërmjet institucioneve privatë të trajnimit. Pjesa më e madhe e tenderuesve janë të gatshëm të fillojnë proceset e rishikimit në mënyrë që të marrin një zgjidhje të drejtë, por disa prej tyre duan thjesht të pengojnë procedurën e tenderimit. Të tjerë duket se nuk janë shumë pro zgjidhjes gjyqësore ose për shkak se ata nuk duan të komprometojnë. Megjithëse nuk ka trajnim profesional të posaçëm, informacioni i përgjithshëm i oficerëve kontraktues konsiderohet i mjaftueshëm. Në përgjithësi, rishikimi i proceseve të tenderimit konsiderohet si metodë efektive monitorimi për ligjshmërinë e dhënies së vendimeve.

Ekziston një gazetë specifike për botime në fushën e prokurimeve publike. Shoqëria civile luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e rregullave të prokurimeve publike. Për shembull, ndryshimet e kohëve të fundit në Aktin e PP-së e kanë zanafillën në diskutimet e filluara na shoqata e industrive kombëtare të ndërtimit dhe seksioni kombëtar i Transparency International. Media i mbulon rregullisht proceset e rishikimit të PP-ve. Ndikimet e vendimeve të GJED-së janë shumë të rëndësishme dhe reflektohen në kërkesat që depozitohen nga tenderuesit. Sistemi i rishikimit dhe parashtrimit të ankesave është zhvilluar shumë që prej pranimit të republikës Çeke në BE.

6. Danimarka

Prokurimet publike në Danimarkë rregullohen nga dy urdhra qeveritarë të datës 16 shtator, 2004, të cilat janë nxjerrë në zbatim të Direktivës së KE-së për prokurimet, dhe kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2005 (Shih: <http://www.ks.dk/english/procurement/legislation/pro/>). Nën pragun e KE-së, prokurimet publike rregullohen nga Akti i 2005-ës për Procedurat e Tenderimit për Punët Publike si dhe nga qarkorja ministrore e vitit 2002 në lidhje me mallrat dhe shërbimet. Sistemi danez i rishikimit dhe trajtimit të ankesave bazohet në kontrollin gjyqësor dhe atë ekstra-gjyqësor. Aktorët kryesorë janë **Bordi i Ankesave për Prokurimet Publike** (Klagenævnet for Udbud, Sekretariatet, Kampmannsgade 1, DK-1780 Copenhagen V; telefon +45 3330 7621; faks +45 3330 7799, Website: <http://www.klfu.dk>), i cili është një organ i pavarur administrativ quazi-gjyqësor dhe **Autoriteti i Konkurrencës** (Konkurrencestyrelsen, Nyropsgade 30, DK-1780 Copenhagen V; Telefon +45 7226 8000; Faks +45 3332 6144, E-mail:

ks@ks.dk, Website: <http://www.ks.dk/english>), i cili është një agjenci nën Ministrinë e Ekonomisë dhe Çështjeve të Biznesit. Mbi çështjet e prokurimeve publike kanë juridiksion dhe gjykatat e zakonshme, por në praktikë ndodh se ato rrallë ndërhyjnë.

6.1 Kontrolli jashtëgjyqësor

Autoriteti Danez i Konkurrencës (ADK) drejton një **sistem informal “zgjidhjes problemi”**. Megjithëse Autoriteti nuk ka kompetencë të nxjerrë vendime që janë detyruese nga aspekti ligjor, ose të pezullojë/korrigjojë një procedurë tenderimi, shumë tenderues preferojnë t’i referojnë çështjet e tyre më shumë tek ADK-ja sesa tek Bordi i Ankesave. Sistemi “informal” duket se ka më shumë avantazhe pasi ai konsiderohet i të njëjtës rëndësi me sistemin formal (lëshimin e **rekomandimeve**, të cilat përgjithësisht respektohen), siguron një zgjidhje më të shpejtë dhe shpesh më pak burokratike të mosmarrëveshjeve (afërsisht dy muaj për çështje), është më fleksibël (çështjet mund të depozitohen nga çdo person/korporatë ose dhe me iniciativë të ADK-së; nuk është nevoja e përfaqësimit ligjor) dhe është sistem pa pagesë. Si pasojë, ADK-ja trajton rreth 30 çështje prokurimesh në vit. Autoritetit kontraktues mund t’i kërkohej t’i përgjigjet akuzave dhe të lejojë shikimin e dosjes së prokurimit, gjithmonë duke pasur parasysh përjashtimet e parashikuara në të drejtën e përgjithshme administrative (sekretet e biznesit, etj.). rekomandimi vendoset nga eksperti ligjor i ADK-së. Në rastet kur një organ kontraktues nuk arrin ose dështon të respektojë rekomandimet e nxjerra nga ADK-ja, kjo e fundi ka kompetencën e referimit të çështjes tek Bordi i Ankesave. Autoriteti kontraktues mund të kundërshtojë rekomandimin para gjykatave të zakonshme. Përveç këtij sistemi, në të drejtën e brendshme është parashikuar mekanizmi i pajtimit i parashikuar nga Direktiva e KE-së 92/13, por në fakt ajo nuk është zbatuar kurrë në praktikë. Tenderuesit mund të bëjnë ankesë të drejtpërdrejtë tek autoriteti kontraktues, por nuk ka dispozita të qarta në lidhje me faktin se kush brenda autoritetit është personi që duhet të trajtojë këto ankesa. Së fundmi, zgjidhja e problemeve që dalin në prokurimet ndërkufitare janë të mundura brenda kuadrit të Rrjetit të Prokurimeve Publike (PPN, <http://www.ks.dk/english/procurement/network>).

6.2 Kontrolli gjyqësor

Pavarësisht nga vlera e përcaktuar e kontratës, vendimet e autoriteteve kontraktuese në lidhje me një procedurë tenderimi si në sektorin klasik dhe në atë të shërbimeve mund të kundërshtohen para **gjykatave të zakonshme** ose tek **Bordi i Ankesave për Prokurimet Publike**. Opsioni i parë zbatohet radhë në praktikë. Bordi është krijuar në vitin 1991 dhe aktualisht drejtohet nga Akti nr 415, datë 31 maj 2000, i ndryshuar (më poshtë Akti i vitit 2000 – versioni në anglisht mund të gjendet në adresën <http://www.ks.dk/english/procurement/legislation/act/>), si dhe nga Urdhri Ekzekutiv, i nxjerrë në zbatim të aktit – versioni në anglisht mund të gjendet në adresën <http://www.ks.dk/english/procurement/legislation/415/>). Bordi nuk ka juridiksion mbi çështjet e prokurimeve që përfshijnë përdorimin e një zone gjeografike për qëllim të planifikimit për ose nxjerrjen e naftës, gazit, qymyrit dhe lëndëve të tjera të djegshme (seksioni 3.2 i Aktit të vitit 2000) dhe duhet të mos i pranojë ankesat që lidhen me to (ankesat e tilla duhet të depozitohen në Gjykatën Detare dhe Tregtare). Bordi përbëhet nga një kryetar, tre zëvendës dhe disa anëtarë në nivel ekspertësh, të cilët kanë kualifikime të vërtetuara në fushën e ndërtimit, prokurimeve, transportit dhe aktiviteteve të tjera të lidhura. Të gjithë anëtarët janë të emëruar nga Ministri i Ekonomisë dhe Çështjeve të Biznesit dhe kanë mandat katër-vjeçar (të rinovueshëm). Kryetari dhe zëvendësit e tij duhet të jenë anëtarë të gjyqësorit. Kryetari mund të autorizojë një zëvendës të tij për të vepruar në emër të tij, ose saj dhe përcakton mënyrën në të cilën botohen vendimet. Vendimet e bordit (me përjashtimin e ankesave që rrëzohen në mënyrë automatike sipas seksionit 3.2 të Aktit të vitit 2000) mund të apelojnë para gjykatave të zakonshme brenda një kufiri prej tetë javësh që prej njoftimit të tyre nga palët. Nëse pas përfundimit të afatit kohor nuk është depozituar asnjë ankesë, vendimi i bordit nuk mund të apelohej më. Në shkallën e fundit, **Gjykata e Lartë** (Højesteret) mund të ketë juridiksion mbi çështjet e prokurimeve, gjë e cila radhë ndodh në praktikë, pasi në përgjithësi vendimet e bordit respektohen. Gjykata e Lartë është një organ i përhershëm, i pavarur nga ekzekutivi (seksioni 64 i Kushtetutës Daneze), vendimet e së cilës janë detyruese nëse nxirren sipas një

procedure *inter partes*. Një vendim bordi nuk mund të çohet para një organi tjetër administrativ (seksioni 8.1 i Aktit të vitit 2000).

6.3 Mjetet efektive ligjore

Sipas seksionit 6.1 të Aktit të vitit 2000, Bordi i Ankesave ka kompetencë të mos pranojë një ankesë, ose ta pranojë atë plotësisht ose pjesërisht mbi bazën e themelit të çështjes. Në veçanti, para miratimit të kontratës bordi mund 1) të **pezullojë** procedurën e tenderimit; 2) të **lërë mënjanë** një vendim të paligjshëm; 3) ti kërkojë një autoriteti kontraktues të **respektojë** detyrimet tenderuese, p.sh., të korrigjojë një procedurë të paligjshme, dhe 4) të **japë dëmshpërblim për dëmet**. Njohja e dëmeve konsiderohet si risi e madhe e sistemit danez. Para miratimit të Aktit të vitit 2000, tenderuesit duhej të kërkonin dëmshpërblim para gjykatave të zakonshme. Bordi nuk kishte kompetencë të anulonte një kontratë të përfunduar. Kjo procedurë duhet të kryhej para gjykatave të zakonshme, por në praktikë, në fakt nuk ndodhte asnjëherë kështu. Gjithsesi, ligji është ndryshuar që prej tetorit të vitit 2006, duke lejuar prezantimin e periudhës së detyrueshme **pezull** ndërmjet dhënies së kontratës dhe përfundimit të saj (e cila erdhi si rezultat i vendimit për çështjen “Alcatel”). Ankesat nuk kanë efekt pezullues automatik, por bordi mund të urdhërojë pezullimin e përkohshëm të procedurës së tenderimit nëse një gjë e tillë është e nevojshme. Mbeten të zbatueshme parimet e përgjithshme të së drejtës daneze. Por, bordi mund të marrë parasysh pasojat e mundshme të pezullimit të të gjithë interesave që ka të ngjarë të shkelen, duke përfshirë dhe interesin publik, dhe mund të vendosin të mos lëshojnë asnjë urdhër në rastet kur pasojat negative shkojnë përtej përfitimeve. Njohja e dëmeve paraprihet nga një vendim paraprak për substancën e çështjes, për shembull, një vendim që pranon një ankesë kundër shkeljes së rregullave të prokurimit publik. Paditë për dëme vendosen sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës daneze. Në varësi të rrethanave të çështjes, dëmet mund të jenë të barabarta me kostot e tenderit (damnum emergens), ose me fitimin e humbur (lucrum cessans). Bordi mund t’u kërkojë palëve të japin të gjithë informacionin e nevojshëm për lëshimin e vendimit. Moszbatimi i këtij urdhri i jep të drejtë bordit të vërë **gjoba ditore**, të cilat mund të mblidhen në përputhje me rregullat për mbledhjen e tatimeve personale.

6.4 Procedura

Proceset para Bordit të Ankesave rregullohen nga Akti i vitit 200 dhe Urdhri Ekzekutiv i vitit 2000. Ankesat mund të depozitohen me shkrim nga 1) çdo person që ka interes ligjor në të; 2) nga Autoriteti Danez i Konkurrencës; 3) nga Ministria e Strehimit dhe e Çështjeve Urbane dhe 4) nga organizatat (profesionale) dhe organet publike të cilave u jep akses tek proceset para Bordit Ministri i Ekonomisë dhe Biznesit (këto subjekte jepen në shtojcën e Urdhrit Ekzekutiv). Kategoria e katërt u prezantua për të lejuar rishikimin e vendimeve të prokurimit në rastet kur asnjë tenderues nuk dëshiron të ankimojë. Nuk është e detyrueshme që tenderuesit të depozitojnë një ankesë paraprake për autoritetin kontraktues, por ekziston detyrimi i **informimit** të autoritetit, paralelisht me depozitim të një ankese, se kanë filluar proceset ligjore. Nuk ekzistojnë afate kohore të detyrueshme për bërjen e një ankese para bordit, si dhe kundër nuk ka as formularë model. Ankesa i duhet njoftuar të paditurit, i cili, brenda periudhës kohore të specifikuar nga bordi, duhet të depozitojë një deklaratë për aspektet faktike dhe ligjore të çështjes. Bordi ose kryetari me iniciativën e tij mund të lejojë një palë të tretë ose organin publik për të cilin çështja konsiderohet se ka rëndësi të madhe të **ndërhijë** në mbështetje të ankuesit, të paditurit ose të ndonjë pale të tretë për të prodhuar të gjithë informacionin e lidhur me çështjen. Ankuesi dhe çdo palë tjetër që ndërhyr në proces mund të shohë deklaratën e përmendur më lart si dhe të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me çështjen, në përjashtim të rasteve kur ligji nuk lejon marrjen e këtyre dokumenteve. Atyre u jepet mundësia të kundërpërgjigjen. Palët në procese njoftohen për vendin dhe kohën e seancave dhe kanë të drejtën e të qenit të shoqëruar nga një avokat, llogaritar ose përfaqësues tjetër në nivel ekspert. **Seancat** nuk janë të hapura për publikun, në përjashtim të rasteve kur palët vendosin ndryshe. Nëse seancat janë të hapura për publikun Autoriteti Danez i Konkurrencës duhet të njoftohet për këtë gjë. Çështjet të cilat nuk debatohen me gojë do të trajtohen nga Bordi me shkrim, mundësisht gjatë një takimi. Bordi përbëhet prej të paktën dy anëtarë ekspertë të cilët zgjidhen nga kryetari prej listës zyrtare të ekspertëve. Urdhri Ekzekutiv i vitit 2000 parashikon se “në rastet kur një vendim kërkon vërtetim të punës, certifikimin e personave, sisteme ose

produkteve, ose inspektim, të paktën një ndër anëtarët ekspertë duhet të ketë njohuri të posaçme për fushën në fjalë” (Seksioni 5.3). Kostot e ekspertit mbulohen nga buxheti i bordit. Tarifa është 4000 DKK **fee** (rreth €500). Kostot e avokatëve, aty kur janë të aplikueshme, mbulohen nga pala e përfaqësuar. Nuk ekziston ndonjë parim i përgjithshëm suksesi. Sipas Aktit të vitit 2000, në rastet kur ankesa pranohet plotësisht ose pjesërisht, bordi mund të urdhërojë autoritetin kontraktues të **rimbursojë** kostot që dalin nga ankimuesi në lidhje me fillimin e proceseve. Nuk ka afate kohore të detyrueshme për nxjerrjen e vendimeve. Bordi në përgjithësi vendos brenda pesë deri në gjashtë muajsh. Vendimet u njoftohen palëve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe botohen në faqen e internetit (www.klfu.dk, Danish version). Disa prej tyre mund të gjenden në rishikimet gjyqësore.

6.5 *Kultura e mjeteve efektive ligjore*

Anëtarët e Bordit të Ankesave mund të kenë studiuar të drejtën e prokurimeve publike si pjesë të studimeve të tyre universitare, ose në kuadrin e seminareve dhe konferencave të organizuara nga institucionet publike dhe private. Edhe praktika profesionale është faktor i rëndësishëm. E njëjta gjë është e vërtetë dhe për tenderuesit, të cilët mund të ndihmohen dhe nga organizatat përkatëse profesionale. Si parim, shumë tenderues i shohin proceset e tenderimit si burim të fundit dhe mund të pëlqejnë më shumë të ankohen drejtpërdrejt tek ADK-ja. Edhe pse sistemi danez i prokurimeve është i strukturuar mbi bazën e një modeli të centralizuar dhe praktikave të blerjes ka të ngjarë të ndryshojnë nga një subjekt tek tjetri, njohuria e përgjithshme e zyrtarëve të prokurimeve konsiderohet si pozitive. Çështjet e trajtuara nga ADK-ja kanë dëshmuar për një shkallë të lartë profesionalizmi në fushën e prokurimeve publike. Po ashtu, organizohen seminare profesionale nga ADK-ja (për shembull për Direktivat e reja të Prokurimeve të KE-së), si dhe nga organizata të tjera. Gjithsesi, nuk ka as shoqata kombëtare prokurimesh dhe as botime të specializuara për prokurimet. Qëndrimi i anëtarëve të organeve të rishikimit drejt çështjeve të prokurimit konsiderohet si e balancuar. Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar, por shumë të madhe, për shkak të një sistemi që përbëhet si nga kodifikimi dhe nga interpretimi gjyqësor. Vendimet e GJED-së kanë ndikim të rëndësishëm dhe shpesh përmenden në vendimet e Bordit të Ankesave si dhe në rekomandimet e ADK-së. Së fundmi, ekziston një interes në rritje i çështjeve të prokurimeve publike ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, OJQ-ve dhe medias.

7. **Estonia**

Sistemi i ankesave dhe i rishikimit në Estoni përfshin si rishikimin gjyqësor dhe rishikimin e varur ekzekutiv. Një reformë e vazhdueshme do të prezantojë një kombinim të rishikimit gjyqësor dhe të rishikimit të varur ekzekutiv. Sistemi mund të ndahet në ankesa para dhe pas përfundimit të kontratës. Gjithsesi, nuk ka dallime në lidhje me rishikimin e kontratave të sektorit publik ose të shërbimeve ose në lidhje me rishikimin e kontratave mbi ose nën pragjet/kufijtë e KE-së.

7.1 *Ankesat për autoritetet kontraktuese*

Autoritetet kontraktuese nuk merren me ankesa, në përjashtim të rasteve kur ankesa u është drejtuar specifikisht atyre dhe jo Zyrës së Prokurimeve Publike (ZPPO). Gjithsesi, nuk është e detyrueshme që ankesat të bëhen për autoritetin kontraktues. Në përgjithësi tenderuesit ia çojnë ankesat drejtpërdrejt ZPP-së. Nuk ka rregulla specifike në fushën e prokurimeve publike të cilat trajtojnë ankesat për autoritetin kontraktues. Gjithsesi, sipas procedurave për menaxhimin e procedurave (të shtetit, të agjencive të qeverive vendore ose personave ligjorë) të gjitha letrat duhet të marrin përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh nga data e marrjes së tyre.

7.2 *Rishikimi jogjyqësor*

Para përmbylljes së kontratës tenderuesit mund të kundërshtojnë një vendim për prokurimet publike duke bërë ankimim tek **ZPP-ja** brenda 10 ditësh pune nga data e vënies në dijeni të dhënies së kontratës në fjalë. ZPP-ja është krijuar sipas Aktit të Prokurimeve Publike dhe është **zyrë ekzekutive shtetërore**. Anëtarët e këtij organi nuk kanë status të krahasueshëm me statusin e gjyqtarëve. Procedura e rishikimit në ZPP duhet të përfundojë brenda 10 ditësh pune. Gjatë kësaj periudhe procedura e prokurimeve **pezullohet**. Autoriteti

kontraktues ka të drejtë të zgjedhë ndërmjet proceseve me shkrim, mbi bazën e dokumenteve të parashtruara ose mbi bazën e një sesioni publik ku janë të pranishëm të paktën përfaqësuesi i ZPP-së, personi që ka bërë ankesën dhe autoriteti kontraktues. ZPP-ja mund të anulohë vendimin e prokurimit publik për të cilin është bërë ankesë. Tenderuesit mund të apelojnë vendimin e ZPP-së para një gjykate administrative, siç u tha më lart. Ata mund të kundërshtojnë një vendim nëpërmjet proceseve paralele në ZPP dhe në gjykatën administrative. Procedura e rishikimit për ZPP-në jepet në APP (Kreu 9, paragrafët 61-67). Aktualisht ZPP-ja është organi kryesor i rishikimit: në ZPP për vitin 2005 u dorëzuan 281 ankesa nga totali i 7569 procedurave për kontrata prokurimesh. Gjashtëdhjetë e pesë prej tyre nuk janë trajtuar ende, 67 i plotësonin kërkesat procedurale, 52 nuk i plotësonin kërkesat procedurale, 66 u pranuan nga autoriteti kontraktues, 28 u tërhoqën, dhe, së fundmi, në katër çështje ZPP-ja vendosi të linte mënjanë/pezullonte procedurën e kontratës. Shpeshësia e rishikimit të vendimeve të prokurimeve publike nëpërmjet ZPP-së është 4%. Por, ZPP-ja ka edhe **funksione mbikëqyrëse dhe këshillon organet kontraktuese**. Gjithsesi, ekziston një konflikt i mundshëm interesi. Procedura e rishikimit në ZPP është relativisht e shpejtë dhe e lirë (siç u diskutuar dhe më lart), kështu që palët që janë vërtetë të interesuar për të kundërshtuar një vendim të paligjshëm mund ta bëjnë këtë gjë pa vonuar procedurën e dhënies së kontratës. Projekt Akti i Prokurimeve Publike i vitit 2006 thotë se ankesat duhet të trajtohen nga një **Komision i Prokurimeve Publike (KPP)** i krijuar rishtazi, i cili është i pavarur nga ZPP-ja, në mënyrë që të mos ketë më konflikte interesi ndërmjet funksioneve ekzekutive dhe të rishikimit.

7.3 Rishikimi gjyqësor

Tenderuesit mund të depozitojnë një padi në **gjykatën administrative** kundër një vendimi të marrë nga një autoritet kontraktues në lidhje me një procedurë tenderi, ose si apel kundër vendimit të ZPP-së. Gjykata mund të japë masa të përkohshme, duke përfshirë dhe pezullimin e procedurës së dhënies së kontratës. Si hap pasues, apeli mund të ndërmerret kundër një vendimi të një gjykate administrative në **Gjykatën Rajonale të Estonisë – që me fjalë të tjera është gjykata e apelit**. Së fundmi, vendimet e Gjykatës së Apelit mund të anulohen nga **Gjykata Kombëtare e Estonisë** në Tartu. Ky rishikim gjyqësor me tre shkallë mund të fillohet në të njëjtën kohë me një ankesë në ZPP. Gjithsesi, sipas draftit të ri të Aktit të Prokurimeve Publike, ankesa për KPP-në e krijuar rishtazi do të bëhet parakusht për rishikimin gjyqësor. Po ashtu, **mundësisht** gjykata administrative nuk do të jetë më në gjendje të japë masa të përkohshme, të tilla si pezullimi i procedurave të dhënies së kontratave. E drejta procedurale për Gjykatën administrative mbulohet nga Kodi i procedurës së Gjykatës Administrative. Organi i rishikimit i shkallës së fundit për vendimet e prokurimeve publike është Gjykata Kombëtare e Estonisë, e cila është krijuar sipas Kushtetutës dhe realizon kërkesën për një gjykatë, e cila përmendet në vendimet për çështjet *Dorsch* dhe *Salzmann*. Organi duhet të drejtohet nga juristë me eksperiencë dhe me emër. Dëmet mund të pretendohen vetëm para një gjykate pasi të jetë përmbyllur kontrata mbi bazën e **Aktit të Përgjegjësive Shtetërore ose Ligjit për Aktin e Përgjegjësive**. Në bazë të APP-së, një tenderues mund të kërkojë dëmshpërblim për shpenzimet për përgatitjen e tenderit, nëse ai ose ajo mund ta provojë dëmin dhe se autoriteti kontraktues ka shkelur ligjin dhe se kontrata i duhej dhënë atij ose asaj. Projekt Akti i prokurimeve Publike i vitit 2006 parashikon rishtazi se dëmet mund të kërkohen para gjykatës administrative dhe gjykata mund të vendosë për dëmshpërblimin vetëm nëse tenderuesi mund të provojë se ai/ajo do të kishte fituar kontratën nëse nuk do të ishte shkelur ligji nga autoriteti kontraktues. Vendimi i kontestuar duhet të deklarohet i paligjshëm, por kjo gjë nuk cenon vlefshmërinë e kontratës së përfunduar. **Pavarësia** e sistemit gjyqësor estonez (**rrethet** dhe gjykatat administrative, **Gjykata Rajonale, Gjykata Kombëtare**) bazohet tek Kushtetuta. Gjyqtarët marrin emërim të përjetshëm dhe mund të hiqen nga detyra vetëm pas një vendimi të gjykatës. Ata duhet të kenë përfunduar një kurrikul të akredituar të studimeve akademike në juridik, të kenë moral të lartë dhe të kenë aftësitë dhe karakterin e nevojshëm për të qenë gjyqtar. Deri tani **GJED-ja** nuk ka qenë e përfshirë në rishikimet kombëtare dhe në sistemin e trajtimit të ankesave. Ajo nuk ka trajtuar ende ndonjë çështje të lidhur me shkeljet e procedurave të çuar nga **Komisioni Europian. Gjykata e Arbitrazhit** që trajton ankesat e **ZPP-së** u hoq në vitin 2001 dhe u zëvendësua nga rishikimi gjyqësor i përshkuar më lart.

7.4 Mjetet efektive juridike

Të gjitha mjetet efektive ligjore në përjashtim të atyre që janë të disponueshme pas përfundimit të kontratës bazohen në APP dhe mund të jepen nga gjykatat dhe nga ZPP-ja. Procedura e dhënies së kontratës mund të pezullohet ose mund të lihet mënjanë dhe vendimet specifike të autoritetit kontraktues mund të anulohen. Baza ligjore për lënien mënjanë ose për pezullimin e procedurës së dhënies së kontratës është Akti i Prokurimeve Publike. Sipas APP-së aktuale, procedura e dhënies së kontratës duhet të pezullohet gjithnjë gjatë kohës së proceseve në ZPP ose në gjykatë. ZPP-ja ose gjykata mund të marrin parasysh pasojat e mundshme të masave të përkohshme për të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë interesin e publikut, dhe të vendosin të mos i marrin këto masa kur pasojat e tyre negative i tejkalojnë përfitimet që mund të sillen prej tyre. Gjithsesi, kjo bëhet rrallë. Drafti i APP-së i vitit 2006 e heq këtë efekt automatik. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktues pengohet të përfundojë kontratën para përfundimit të procedurës në Komisionin e ri. Në rast se autoriteti kontraktues nuk e ndjek këtë rregull, kontrata bëhet automatikisht e pavlefshme. Vetë kontrata nuk mund të anulohet mbi bazën e APP-së në raste të tjera. Gjithsesi, kjo mund të bëhet mbi bazën e një ligji kontraktimi (Ligji për Aktin e Detyrimeve). Pasi të jetë përfunduar kontrata nuk ka më masa të përkohshme të disponueshme për t'u përdorur nga palët e interesuara. Nuk ka bazë ligjore për urdhërimin e pagesave të gjobave periodike.

7.5 Procedura

E drejta procedurale i lejon ekspertët të përfshihen si në ZPP dhe në proceset gjyqësore. Në përgjithësi ekspertët i japin mendimet e tyre me shkrim. Ndonjëherë mendimet jepet dhe me gojë gjatë seancave të rishikimit. Ai që e humb çështjen nuk paguan kosto. Aktualisht ankesa mund të depozitohet nga një tenderues ose çdo person tjetër, i cili është i interesuar për të marrë pjesë në një procedurë tenderimi. Sipas draftit të APP-së të vitit 2006, ankesa mund të depozitohet nga një tenderues, një kandidat ose çdo person që është i interesuar për të marrë pjesë dhe ka mundësi të marrë pjesë në një procedurë tenderimi. Tarifat për depozitim të ankesës jepen në Aktin e Tarifave Shtetërore. Aktualisht, tarifa për depozitim të një ankesë tek ZPP-ja është rreth 192 euro, kur vendimi i kontestuar është vendim për dhënie kontrate dhe 6 euro në të gjitha rastet e tjera. Kur bëhet padi në gjykatën administrative, në rast të një apelimi të një tenderi të depozituar nga personi i prekur, tarifa është 3% e vlerës së tenderit, por në asnjë rast nuk është më pak se 6 euro dhe jo më shumë se 320 euro. Në mungesë të një tenderi të depozituar nga personi që bën padinë, tarifa është 6 euro. Drafti i APP-së i vitit 2006 parashikon se tarifa kur bëhet një ankesë për ZPP-në është rreth 639 euro, ku vlera e përlllogaritur e kontratës publike është më pak se pragjet e KE-së dhe rreth 1 278 euro në rast se vlera e përlllogaritur e kontratës publike është e barabartë me pragjet ose më e lartë se to. Kur depozitohet një padi në gjykatën administrative, në rastin e tenderit të lidhur me personin që depoziton apelimin, shuma është 1% e vlerës së tenderit, por jo më pak se rreth 959 euro dhe jo më shumë se rreth 12 782 euro. Në mungesë të një tenderi të lidhur me personin që bën padinë, tarifa është më e vogël. Përfaqësimi ligjor nuk është i detyrueshëm, megjithëse është i preferueshëm, në veçanti në gjykata. Kostoja e marrjes së juristëve në punë është shumë e ndryshueshme. Pala humbëse mbulon kostot e saj si dhe rimbursion palën që fiton procesin për të gjitha kostot e saj: tarifat, përfaqësimin ligjor dhe ekspertët. Ankesat në ZPP duhet të dërgohen brenda 10 ditësh, paditë në gjykata brenda 30 ditësh duke filluar nga data në të cilën personi që bën ankimin vihet në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni të shkeljes së të drejtave ose dëmtimit të interesave të personit, por jo pasi të ketë hyrë në fuqi një kontratë prokurimesh. Ankesat lidhur me dokumentacionin e tenderit duhet të depozitohen para se autoriteti kontraktues të hapë tenderët. Nuk ka mundësi për procese *in camera* (me dyer të mbyllura) në fushën e prokurimeve publike. Të gjitha vendimet e ZPP-ës dhe vendimet e gjykatës i dërgohen palëve me anë të postës dhe botohen në faqet përkatëse të internetit. Gjithsesi, një gjykatë mund ta deklarojë të mbyllur një sesion nëse kjo gjë kërkohet nga interesat e një pale, por kjo ndodh vetëm në raste përjashtimore, të tilla si mbrojtja e sekreteve shtetërore, ose e urdhrave publike. Vendimet e **Gjykatës Kombëtare të Estonisë** botohen në faqen e internetit të gjykatës si dhe në fletoren zyrtare për aktet legislative dhe vendimet e Gjykatës Kombëtare. Tenderuesit mund të kundërshtojnë thirrjet për tender, dokumentacionet e tenderëve dhe të gjitha vendimet e marra brenda procedurës së dhënies së kontratës duke përfshirë vendimet për kualifikim dhe vendimet për dhënie kontrate. Projekt APP-ja e vitit 2006 **mbase do të shtojë** të gjitha veprimet e

marra brenda procedurës së dhënies së kontratës nga organi kontraktues – si për shembull hapja e tenderëve – në këtë listë. Kontratat e përfunduara nuk mund të kundërshtohen mbi bazën e APP-së, por dëmshpërblimet mund të kërkohen mbi bazën e Ligjit për Aktin e Detyrimeve. Ka afate kohore të detyrueshme si për ZPP-ë dhe për gjykatat për dhënien e një vendimi. ZPP-ja shpesh ndjek një kufi, në përjashtim të rasteve kur duhet marrë mendimi i një eksperti. Gjykatat rrallë i ndjekin kufijtë për shkak të ngarkesës së madhe të gjykatave në përgjithësi. Nuk ka pasoja ligjore për mosrespektimin e afateve kohore. Nuk përdoren formularë model të detyrueshëm. Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar për shkak të interpretimit të legjislacionit që parashikohet në vendimet e gjykatës.

7.6 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët, penalistët e ZPP-së dhe juristët që përfaqësojnë tenderuesit ose subjektet kontraktuese i marrin njohuritë e tyre për të drejtën e prokurimeve publike dhe të drejtën e komunitetit kryesisht si pjesë e studimeve universitare. Gjyqtarët kanë detyrimin e ndjekjes së arsimit vazhdues ndërsa shumë kurse ofrohen nga Ministria e Financës dhe disa subjekte private. Qëndrimi i gjyqtarëve dhe i panelistëve të ZPP-së për organet e rishikimit publik drejt interesit publik nga njëra anë dhe interesat private të tenderuesve nga ana tjetër konsiderohet i drejtë dhe i balancuar. **Tenderuesit** që kërkojnë rishikimin e vendimeve të prokurimit publik i marrin njohuritë e tyre për informacionin ligjor, financiar dhe administrativ për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë kryesisht në punë. Trajnimet ofrohen nga Ministria e Financës dhe shpesh juristët konsultohen gjatë punës së tyre. Tenderuesit janë të mirë informuar për mundësitë e tyre për të ankimuar një procedurë ankimi. Disa prej tyre duan t'i pengojnë proceset e tenderimit nëpërmjet proceseve të rishikimit. Kuadri ligjor kombëtar duhet t'ia bëjë të vështirë ndërhyrjet e subjekteve që animojnë proceset e prokurimeve publike që nuk veprojnë në mirëbesim dhe përpiqen të dëmtojnë konkurrentët e tyre nëpërmjet këtyre proceseve. **Oficerët kontraktues** mundohen të arsimohen në mënyrë vijuese dhe të marrin pjesë shpesh në kurset e trajnimit. Shpesh kurset ku ata marrin pjesë kanë natyrë teorike, kështu që kuadri ligjor shpesh është i njohur mirë. Qëndrimi i oficerëve kontraktues dhe i eprorëve të tyre që merren me ankesat e depozituara nga tenderuesit ose me kërkesat për rishikim gjyqësor është neutral. Nuk ka **gazeta** specifike për prokurimet publike. Ndodh ndonjëherë që artikujt për ligjin e prokurimeve publike botohen në gazetën ligjore “Juridica” (www.juridica.ee). Ligji i prokurimeve publike nuk diskutohet shpesh në konferenca ose seminare akademike dhe profesionale në Estoni. Po ashtu, në Estoni nuk ka asnjë shoqatë kombëtare për ligjin dhe politikën e prokurimeve publike. Grupet kombëtare të interesit nuk përfshihen në proceset e rishikimit. **Trajnimi profesional** për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike për oficerët e prokurimeve publike ofrohet nga Ministria e Financës dhe nga disa subjekte private. **Vendimet e GJED-së** merren parasysh, por rrallë përmenden.

8. *Finlanda*

Sistemi i **ankesave dhe i rishikimit të prokurimeve publike** në Finlandë bazohet në rishikimin e pavarur gjyqësor. Sistemi mund të ndahet në ankesat para dhe pas përfundimit të kontratës: ka dy rrugë të veçanta me dy shkallë rishikimi gjyqësor për kontratat mbi dhe nën pragjet e KE-së.

8.1 *Autoriteti kontraktues*

Nuk është e detyrueshme t'i drejtohet një ankesë **autoritetit ose subjektit kontraktues**. Nuk ka rregulla specifike në fushën e prokurimeve publike që trajtojnë ankesat për autoritetin kontraktues. Gjithsesi, është e mundur të përdoret kjo mënyrë për zgjidhjen e kundërshtimeve/ankesave. I njëjti legjislacion zbatohet dhe për subjektet publike dhe private kur merren vendimet e prokurimeve publike. Sipas ligjit për prokurimet publike (<http://www.finlex.fi/en/laki/kaannokset/1992/en19921505.pdf>), ankimesi informon subjektin kontraktues me shkrim për qëllimin e tij para se të depozitohet ankimi tek Gjykata e Tregut (e diskutuar më sipër).

8.2 *Rishikimi gjyqësor*

Që prej vitit 2002, Gjykata e tregut në Helsinki ka shërbyer si forumi kryesor për rishikimin e prokurimeve publike në Finlandë. Në Gjykatën e Tregut u depozituan 508 ankesa kundër vendimeve të prokurimeve

publike të vitit 2005, dhe u dhanë 206 vendime. 26% e ankesave u miratuan, 33% u kundërshtuan, 8% u rrëzuan dhe 33% skaduan. Në periudhën kohore ndërmjet vitit 1994 dhe 2002, Këshilli i Konkurrencës kishte juridiksion për të dhënë vendime për çështjet e prokurimeve publike. Kur të hyjë në fuqi legjislacioni i ri, Gjykatat e Tregut nuk do të ketë më juridiksion për çështjet nën pragjet kombëtare. Në shkallën e dytë dhe të fundit, kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë mund të ankimohen në **Gjykatës së Lartë Administrative** në Helsinki. Paditë për dëme mund të bëhen në **gjykatat e përgjithshme të shkallës së parë**. Këto gjykata janë të pavarura nga ekzekutivi, nga administrata ose pjesë të tjera të qeverisë dhe vendimet e tyre kanë karakter juridiksional. Të gjitha gjykatat finlandeze ushtrjnë kompetenca gjyqësore. Ato janë të pavarura dhe përgjegjëse vetëm për të respektuar ligjin. Në vendimmarrjen e gjykatave nuk mund të ndërhyjë asnjë palë e jashtme; pavarësia e gjykatave gandohet nga Kushtetuta. Kryetari dhe anëtarët e organit të rishikimit të shkallës së fundit kanë njohuri dhe ekspertizë të madhe në fushën e të drejtës administrative. Gjykatat janë krijuar mbi bazën e Kushtetutës, nga legjislacioni specifik për gjykatat e përgjithshme dhe Akti i Gjykatave të Tregut (<http://www.finlex.fi/en/laki/kaannokset/2001/en20011527.pdf>). Të gjithë gjyqtarët duhet të jenë juristë me eksperiencë dhe të njohur. Gjyqtarët emërohen sipas një procedure të përgjithshme.

8.3 *Mjetet efektive ligjore*

Mbrojtja ligjore është e pranueshme për çdo vendim të prokurimeve publike, si p.sh. për përzgjedhjen e një procedure të veçantë të dhënies së kontratës, vendimet për përzgjedhjen e subjekteve në një listë të shkurtuar, ose vendimet për kualifikim. Sipas Seksionit 9 LPP-së, Gjykata e Tregut mund (1) të lërë mënjanë plotësisht ose pjesërisht një vendim të një subjekti kontraktues; (2) të mos i lejojë subjektit kontraktues të përdorë një seksionin në një dokument të lidhur me një kontratë si shkak për procedurë të parregullt; (3) t'i kërkojë subjektit kontraktues të rregullojë një procedurë të parregullt, ose (4) të urdhërojë subjektin kontraktues të paguajë dëmshpërblim për një palë që mund të kishte pasur mundësi aktuale të fitimit të një kontrate nëse do të ishte kryer procedura në mënyrë korrekte.

Gjykata e Tregut mund të marrë vendim për gjobë të kushtëzuar në përputhje me Aktin e Gjobave të Kushtëzuara (1113/1990) në mënyrë që të theksojë rëndësinë e përputhjes me ndalimet e parashikuara në seksionin 9(1)(2) dhe me detyrimin që përmendet në Seksionin 9(1)(3). Depozitimi i një ankese nuk ka efekt automatik pezullues. Pasi të bëhet padia, Gjykata e Tregut mund të ndalojë, ose të pezullojë zbatimin e një vendimi ose urdhri për pezullimin e dhënies së kontratës për periudhën gjatë së cilës çështja është në shqyrtim si masë e përkohshme. Ndalimi i përmendur në Seksionin 9(1)(2) dhe detyrimi që përmendet në Seksionin 9(1)(3) mund të përdoren si masa të përkohshme për periudhën gjatë së cilës trajtohet çështja në Gjykatën e Tregut. Kur merret vendim për miratimin e një mase që përmendet në nënseksionit 2, Gjykata e Tregut siguron se masat nuk shkakton më shumë dëme për palën kundërshtare, ose të drejtat e palëve të tjera në rastet urgjente.

Sipas Seksionit 8 nënseksioni 1 i LPP-së, ai që i ka shkaktuar dëm një kandidati, tenderuesi ose kontraktuesi nëpërmjet përdorimit të një procedure që është në kundërshtim me ligjin duhet të detyrohen të paguajnë dëmet. Sipas nënseksionit 2, kur bëhet padi për dëmshpërblim të dëmeve që përfaqësojnë kostot e pjesëmarrjen në një procedurë tenderimi, kandidatit ose tenderuesit i kërkohet të provojnë vetëm një procedurë jo korrekte siç përmendet në nënseksionin 1 dhe duhet të provojë që ai/ajo do të kishte pasur mundësi të fitonte kontratën nëse do të kishte ekzistuar një procedurë e rregullt në mënyrë që të përfitojë dëmshpërblimin. Dëmet e përmendura në nënseksionin 1 nuk janë të kufizuara vetëm tek kostot e tenderuesit për pjesëmarrjen në një procedurë tenderimi, por mund të përfshijnë dhe dëmshpërblimin për humbjen e kontratës. Nuk është e nevojshme që vendimi i kontestuar të lihet mënjanë para se të kërkohet dëmshpërblimi i dëmeve. Finlanda ka prezantuar **procedurën e pajtimit**, të përshkruar në Kreun 4 të Direktivës 92/13/KEE.

Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar për shkak të interpretimit të legjislacionit që parashikohet në vendime. Vendimet e GJED-së kanë ndikim të madh në proceset e rishikimit të prokurimeve publike dhe shpesh përdoren në procese si rregulla interpretimi. Gjatë pesë viteve të fundit, Gjykata e Tregut nuk i ka

parashtruar asnjë kërkesë për vendim paraprak GJED-së. Në dy vitet e fundit Komisioni European ka dhënë pesë opinione të arsyetuara kundër Finlandës lidhur me çështjet e prokurimeve publike.

8.4 Procedura

Dispozitat e Aktit Administrativ të Procedurës Gjyqësore (<http://www.finlex.fi/en/laki/kaannokset/1996/en19960586.pdf>) mbulojnë kryesisht procesin e apelimit në çështjet e prokurimeve publike. Sipas Seksionit 9 b të LPP-së, e drejta për të bërë padi dhe për të filluar proceset gjyqësore i pakon palës së interesuar, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Financës për çështje lidhur me punën e kontraktuar ose për çështjet e përmendura në Seksionin 5(4) dhe organit publik që ka dhënë ndihmë të lidhur specifikisht me kontratën për zbatimin e punëve të kontratës në fjalë. Padia ose kërkesa duhet të bëhet brenda 14 ditësh nga data në të cilën tenderuesi është njoftuar me shkrim për vendimin në fjalë dhe ka marrë udhëzime me shkrim për referim tek Gjykata e Tregut (udhëzimet për ankesat). Pala që merr iniciativën për një çështje duhet të paguajë një tarifë të përgjithshme prej 204 eurosh për proceset në Gjykatën e Tregut. LPP-ja përmban një dispozitë që i vendos autoritetet, d.m.th. gjykatat administrative, nën detyrimin e sigurimit të ekzaminimit të duhur të çështjes. Si rezultat, palët në procese në përgjithësi janë në gjendje të ndjekin çështjet e tyre pa ndihmë ligjore profesionale, e cila ndihmon depozitim të apelimit dhe aksesin në mjete efektive juridike. Ekziston parimi i suksesit në lidhje me kostot, por parimi zbatohet rrallë nga autoritetet publike. Sipas Seksionit 74, nënseksioni 3 i Aktit Administrativ të Procedurës Gjyqësore, një person fizik nuk është përgjegjës për kostot e autoritetit publik në përjashtim të rasteve kur individit ka bërë padi shprehimisht të pabazuar. Vendimet e Gjykatës së Lartë Administrative i dërgohen palëve të përfshira në çështje me postë tradicionale. Vendimet që lidhen më vonë me zbatimin e ligjit në mënyrë identike ose të ngjashme ose që kanë interes të posaçëm publik botohen në Botimin Vjetor të Gjykatës së Lartë Administrative. Fillimisht janë palët e përfshira që vendosin për pjesëmarrjen e ekspertëve teknikë ose të ekspertëve të tjerë në proceset e rishikimit. Në këto raste kostot e përfshirjes së tyre mbulojnë nga vetë palët. Në raste të caktuara janë palët ato që mbulojnë kostot e përfshirjes së tyre. Gjykata mund të vendosë për realizimin e seancës me dyer të mbyllura kur e sheh të nevojshme kur diskutohet për një dokument konfidencial ose informacion të konsideruar si konfidencial. Informacioni konfidencial i biznesit mbrohet nga Akti për Hapjen e Aktivitetëve Qeveritare. Nëse informacionet përmbajnë të dhëna rreth një biznesi privat ose sekreti profesional, apo informacionet që përmbajnë të dhëna të tjera të krahasueshme me biznesin privat, nëse marrja e këtij informacioni çon në humbje ekonomike, ato konsiderohen si sekrete, në përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe dhe me kusht që ky informacion nuk është i rëndësishëm për ruajtjen e shëndetit të konsumatorit, ruajtjen e mjedisit, nxitjen e interesave për personat e interesuar për ndjekje biznesi dhe kur ky informacion nuk lidhet me detyrat e biznesit dhe kryerjen e këtyre detyrave. Nuk ka afate kohore detyruese për gjykatat për lëshimin e një vendimi. Në vitin 2005, Gjykata e Tregut i ka dhënë vendimet e saj rreth 6.2 muaj pas ngritjes së padisë. Koha mund të ndryshojë në varësi të vështirësisë të çështjes.

8.5 Kultura e rishikimit

Gjyqtarët dhe juristët që përfaqësojnë tenderuesit, ose subjektet kontraktuese i marrin njohuritë e tyre për të drejtën e prokurimeve publike dhe të drejtën e komunitetit kryesisht si pjesë e studimeve universitare, nga trajnimet profesionale, trajnimet vazhduese, kurset e organizuara nga subjektet private dhe publike, jurisprudenca dhe trajnimi në punë. Gjyqtarët kanë detyrimin e ndjekjes së arsimit vazhdues ndërsa shumë kurse ofrohen nga Ministria e Financës dhe disa subjekte private. Qëndrimi i gjyqtarëve dhe i panelistëve të organeve të rishikimit publik drejt interesit publik, nga njëra anë, dhe interesat private të tenderuesve, nga ana tjetër, konsiderohet i drejtë dhe i balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikimin e vendimeve të prokurimit publik i marrin njohuritë e tyre për informacionin ligjor, financiar dhe administrativ, për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë kryesisht në punë, nëpërmjet juristëve, konsulentëve dhe organizatave të tyre profesionale. Pjesa më e madhe e tenderuesve e shohin rishikimin ligjor si mjet të fundit. Njohuritë e oficerëve kontraktues për çështjet juridike, ose çështjet e tjera që lidhen me prokurimet publike, përshkruhen si “kryesisht të mira”. Qëndrimi i oficerëve kontraktues dhe i eprorëve të tyre që merren me ankesat kundër tenderuesve që bëjnë ankesa ose kërkojnë rishikim gjyqësor

për vendimet e prokurimeve publike përshkruhet si “kryesisht pozitiv”. Nuk ekzistojnë botime ose gazeta akademike që merren specifikisht me çështjet e prokurimeve publike duke përfshirë dhe rishikimin e prokurimeve publike dhe mjeteve ligjore efektive ligjore. Ligji për prokurimet publike diskutohet shpesh në seminare. Nuk ka asnjë shoqatë kombëtare për ligjin dhe politikën e prokurimeve publike dhe çështjet e prokurimeve publike nuk shihen me shumë interes nga media. Nuk ka trajnime profesionale për ligjin dhe politikën e prokurimeve publike për oficerët e prokurimeve publike. Pika e fortë e sistemit është se thuajse nuk ka fare pengesa për tenderuesit për të kërkuar rishikim të çështjes nga Gjykata e Tregut, e cila ka njohuri shumë të mira për çështjet që kanë të bëjnë me prokurimet publike. Kohëzgjatja e proceseve mund të jetë pikë e dobët në të ardhmen pasi numri i çështjeve që do t’i dërgohen Gjykatës së Tregut pritet të jetë më i lartë në të ardhmen. Sistemi i rishikimit dhe mjeteve efektive ligjore nuk konsiderohet si produktiv nëse kohëzgjatja e proceseve është e njëjtë me kohëzgjatjen e periudhës së prokurimeve në sektorin publik (që zakonisht është një vit).

9. Franca

Sistemi i rishikimit të prokurimeve publike dhe mjeteve efektive dëmshpërblyese në Francë bazohet tek rishikimi i pavarur gjyqësor. Ndarja e të drejtë franceze në të drejtën private dhe publike luan një rol shumë të rëndësishëm. Kontratat që jepen nga shteti, nga organet publike shtetërore me karakter administrativ, organet lokale ose organet publike lokale janë objekt i Kodit të Prokurimeve Publike (“**Code des marchés publics**” – **CMP, Dekreti nr. 2006-975, datë 1 gusht, 2006**, i cili mund të gjendet në faqen e internetit: <http://www.legifrance.gouv.fr>). Këto kontrata kanë gjithmonë natyrë publike (“contrats administratifs”). Mosmarrëveshjet që dalin nga këto kontrata bien nën juridiksionin e gjykatave administrative. Nga ana tjetër, kontratat që jepen nga organet publike të ndryshme nga ato që mbulohen nga KMP-ja, organet private ligjore që i plotësojnë kriteret e “organeve që rregullohen nga e drejta publike” në kuptimin e Direktivave të KE-së për Prokurimet si dhe subjektet e një natyre specifike (të tilla si Banque de France) dhe operatorët e shërbimeve janë objekt i **Urdhresës nr 2005-649, datë 6 qershor 2005**. Kjo urdhresë ka dalë në bazë të dy dekreteve (Dekreti nr 2005-1742, datë 30 dhjetor 2005 për autoritetet kontraktuese në sektorin klasik; dhe Dekreti nr 2005-1308, datë 20 tetor 2005 për operatorët e shërbimeve). Këto kontratat kanë natyrë publike ose private, në varësi të natyrës publike, ose private të tyre. Mosmarrëveshjet që dalin nga këto kontrata janë pjesë e juridiksionit administrativ, ose e juridiksionit të gjykatave të zakonshme (civile). Në të dyja rastet tenderuesit e pakënaqur mund të nisin procese përmbledhëse para kontraktimit për marrjen e masave të përkohshme nga gjyqtari. Në parim, nuk ekziston nevoja e njoftimit të ankesave paraprake për autoritetin kontraktues. Proceset e përgjithshme mund të përdoren për pezullimin e procedurës së dhënies së kontratës, ose të deklarohen të pavlefshme një kontratë të dhënë në mënyrë të parregullt. Dëmshpërblimet për dëmet mund të kërkojnë në mënyrë të pavarur për paditë e përmendura më lart, në përjashtim të proceseve përmbledhëse para kontraktuese, dhe bazohen tek provat që një tenderuesi i është mohuar mundësia reale e fitimit të kontratës.

9.1 *Kontrolli jashtëgjyqësor*

Çdo tenderues mund t’u drejtohet organeve kontraktuese për të kërkuar rishikim administrativ të procedurës së prokurimeve. Për më tepër, **Rrjeti i Prokurimeve Publike (RrPP)** mund t’i ndihmojë tenderuesit në lidhje me prokurimet ndërkufitare: në rastet kur një kompani që e ka bazën në një shtet të RrPP-së merr pjesë në një procedurë tenderimi të filluar në një shtet tjetër të rrjetit haset me vështirësi, pika e kontaktit e rrjetit kombëtar mund të ofrojë ndihmë para se të jepet dhe të nënshkruhet kontrata. Për më tepër, në përputhje me Direktivën e KE-së 92/13/KEE për sektorin e shërbimeve janë në dispozicion dhe mekanizmat e **vërtetimit** (qarkorja e datës 24 shtator 2001) dhe **pajtimit** (urdhri i datës 20 shtator 2001). Gjithsesi, në praktikë këto mekanizma përdoren rrallë.

9.2 *Rishikimit gjyqësor*

Përpara përfundimit të kontratës, tenderuesit mund të kundërshtojnë çdo vendim në lidhje me procedurën e tenderimit, si dhe çdo vendim që refuzon ofertën e tyre. Ata mund të kërkojnë dëmshpërblime në rastet kur autoriteti kontraktues e ka braktisur procedurën tenderuese. **Pas** përfundimit të kontratës tenderuesit e

refuzuar mund të kërkojnë anulimin e akteve që lidhen me procedurën e dhënies së kontratës (p.sh., vendimi për rrëzimin, vendimi që autorizon nënshkrimin e kontratës). Tenderuesi i suksesshëm mund të kundërshtojë çdo akt të autoritetit kontraktues në lidhje me zbatimin, ndryshimin ose braktisjen e kontratës. Në lidhje me **natyrën** (publike ose private) të kontratës dhe pavarësisht nga vlera e përafërt e kontratës, secili nga vendimet/aktet e organeve kontraktuese mund të kundërshtohet para gjykatave administrative ose të zakonshme. **Rrjeti administrativ gjyqësor** parashikohet në Kodin e Drejtësisë Administrative (“Code de justice administrative” - CJA). Ai përmban 37 tribunale administrative (të shkallës së parë), tetë gjykata administrative apeli (të shkallës së dytë) dhe *Conseil d’État* (shkalla e fundit, Palais Royal, 75100 Paris 01 SP; telefon: +33 1 40 20 80 00; Website, <http://www.conseil-etat.fr>). Numri i çështjeve të prokurimeve të diskutuara para gjykatave administrative ka ardhur në rritje që prej vitit 2001 (shifrat përfshijnë mosmarrëveshje që lidhen me performancën e kontratës): në shkallën e parë, 4365 çështje në vitin 2001, 4627 në vitin 2002, 4743 në vitin 2003 dhe 5048 në vitin 2004; shkalla e dytë, 499 çështje në vitin 2001, 683 në vitin 2002, 724 në vitin 2003 dhe 755 në vitin 2004; para *Conseil d’État*, 165 çështje në vitin 2001, 128 në vitin 2002, 180 në vitin 2003 dhe 133 në vitin 2004. Numri i vendimeve të nxjerra plotësisht ose pjesërisht në favor të aplikuesve është shumë më i madh se e vendimeve që rrëzojnë aplikime (në lidhje me vendimet para përfundimit të kontratës). Në vitin 2004, tribunalet administrative morën 2538 vendime në favor të aplikuesve dhe 1515 kundër tyre. Apelimet para gjykatave administrative të apelit dhe në shkallën e fundit para *Conseil d’État* kanë në përgjithësi rezultat negativ. Gjyqtarët administrativë i kushtojnë vëmendje të veçantë detyrimeve tenderuese dhe kontraktuese të organeve kontraktuese; pra gjykatat administrative të shkallëve më të larta kanë tendencë të konfirmojnë vendimet që merren në shkallët më të poshtme të gjykimit. **Rrjeti i zakonshëm (gjyqësor) i drejtësisë** parashikohet në Kodin e Organizimit Gjyqësor (“Code de l’organisation judiciaire” - COJ). Ai përmban 473 *tribunaux d’instance* (shkalla e parë për mosmarrëveshje që kanë një vlerë prej më pak se €7600) dhe 181 *tribunaux de grande instance* (shkalla e parë për mosmarrëveshjet me vlerë mbi €7600), 35 gjykata apeli (shkalla e dytë) dhe *Cour de Cassation* (shkalla e fundit e gjykimit, 5, Quai de l’Horloge, 75055 Paris 01 SP; telefon: +33 1 44 32 50 50; Website: <http://www.courdecassation.fr>). Si *Conseil d’État* dhe *Cour de cassation* parashikohen nga ligji dhe janë organe të përhershme dhe të pavarura nga ekzekutivi, administrata ose nga çdo pjesë tjetër e qeverisë. Procedura para tyre është *inter partes*. Gjyqtarët e të dy organeve të rishqyrtimit të shkallës së fundit janë të pazëvendësueshëm. Kryetari dhe anëtarë të tjerë janë juristë të kualifikuar dhe nëpunës civilë të ardhur, ose nga *École Nationale de la Magistrature* (gjyqtarët e gjykatave të zakonshme), ose nga *École Nationale d’Administration* (gjyqtarët të gjykatave administrative). Ata emërohen nga ekzekutivi (nga presidenti ose nga qeveria e Republikës së Francës). Organet e rishikimit nën nivelin e shkallës së fundit lëshojnë vendime të një natyre juridiksionale.

Edhe vendimet për dhënie kontrate mund të rishikohen nga **gjykatat penale** (p.sh., me disa përjashtime, gjykatat e zakonshme në funksionin e tyre të lidhur me të drejtën penale) kur këto vendime lidhen me krimet e parashikuara në Kodin Penal. Në veçanti, Neni 432-14 i kodit i dënon “*délit de favoritisme*” (krimet e vogla të favorizimit), që në fakt është një dispozitë që lidhet me dhënien e avantazheve të paligjshme dhe që paragjykon transparencën dhe barazinë në procedurën e dhënies së një kontrate. Së fundmi, **gjykata disiplinore fiskale dhe financiare**, me juridiksion për të gjithë organet që janë objekt i kontrollit të Zyrës së Kontrollit Shtetëror, mund të caktojnë sanksione për zyrtarët publikë përgjegjës për parregullsitë në një procedurë të dhënies së kontratës.

9.3 Mjetet efektive ligjore

Në përputhje me rregullat kombëtare që zbatojnë Direktivën e KE-së, **proceset përmbledhëse para kontraktuese** mund të ndërmerren nga persona që kanë interes në marrjen e një kontrate dhe që ka të ngjatë të cenohen nga një kontratë e parregullt, duke paragjykuar transparencën dhe barazinë, nga një organ kontraktues, ose një subjekt kontraktues. Tenderuesit që kanë pakënaqësi kanë dhjetë ditë në dispozicion për të filluar proceset në lidhje me kundërshtimin zyrtar të ofertës së tyre (periudha pezull), por tenderuesit mund të kërkojnë procese përmbledhëse para kontraktuese nga dita e reklamimit deri në ditën e dhjetë pas kundërshtimit zyrtar të ofertës së tyre. Juridiksioni i gjykatës varet nga natyra (private ose

publike) e kontratës. Në rastet e kontratave të së drejtës publike, nuk është e nevojshme që palët t'i njoftojnë ndonjë ankesë paraprake autoritetit kontraktues. Dispozitat përkatëse janë si më poshtë:

Në **sektorin klasik** (Direktiva e KE-së 89/665/EEC): Neni L. 551-1 i Kodit të Drejtësisë Administrative (proceset përmbledhëse para kontraktuese para tribunaleve administrative ku kontrata është publike); Neni 24 § 1° i Urdhëresës nr 2005-649, datë 6 qershor 2005 (proceset përmbledhëse para kontraktuese para gjyqtarit të zakonshëm kur kontrata është private).

Në **sektorin e shërbimeve** (Direktiva e KE-së 92/13/KEE): Neni L. 551-2 i Kodit të Drejtësisë Administrative (proceset përmbledhëse para kontraktuese, para tribunalit administrativ kur kontrata është publike); Neni 33 § 1° i Urdhëresës nr 2005-649, datë 6 qershor 2005 (proceset përmbledhëse para kontraktuese para gjyqtarit të zakonshëm kur kontrata është private).

Këto rregulla parashikojnë referencën tek një gjyqtar i vetëm; d.m.th. referencën tek kryetari i tribunalit administrativ/gjykatës së zakonshme komente ose përfaqësuesit të tij/saj. Aplikimet nuk kanë efekt pezullues. Gjyqtarët vendosin para nënshkrimit të kontratës nëse ajo është nënshkruar në përputhje me detyrimet e reklamuar dhe konkurruese të tenderimit. Në rast se kontrata nënshkruhet para se të merret vendimi, çështja konsiderohet e hequr nga gjyqtari. Ky rregull konsiderohet si pika e dobët kryesore e sistemit francez. Si rezultat, nenet L. 551-1 dhe 551-2 të Kodit të Procedurës Administrative e autorizojnë gjyqtarin të shtyjë nënshkrimin e kontratës sipas referimit të çështjes, për një periudhë maksimale prej 20 ditësh. Ky opsion përdoret në mënyrë automatike dhe ka si synim të ndreqë dobësitë. Për të arritur në një vendim, gjyqtari shqyrton shumë rrethana (si për shembull arsyet e përjashtimit të një tenderuesi, ligjshmërinë e përbërjes së komisionit të tenderimit). Gjithsesi, gjyqtari nuk ka të drejtë të vendosë për meritat përkatëse të tenderuesit, ose për kapacitetin statusor për të konkurruar për një kontratë. Në **sektorin klasik**, gjyqtari mund të urdhërojë autoritetin kontraktues të respektojë detyrimet dhe të pezullojë procedurën e dhënies së kontratës ose ekzekutimin e vendimeve që lidhen me këtë procedurë. Ai ose ajo mund të anulojë vendime të tilla dhe mund të anulojë kushtet dhe afatet kohore të synuara për t'u futur në kontratë, kur ato janë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara. Në **sektorin e shërbimeve**, gjyqtari mund të urdhërojë subjektin kontraktues të plotësojë detyrimet e tij brenda një afati kohor të caktuar. Ai ose ajo mund të vendosin dhe një gjobë të përkohshme ditore në momentin kur përfundon afati kohor i specifikuar. Gjithsesi, gjyqtari duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm të kësaj mase të fundit mbi interesat e përfshirë, duke përfshirë dhe interesin e publikut, dhe kufizohet në dhënien e urdhrit në rastet kur pasojat negative i tejkalojnë përfitimet. Në rast se shkelja nuk ndreqet deri në kohën kur fillon gjoba ditore e përkohshme, pasojat kanë të ngjarë t'i kalojnë përfitimet. Në rast se shkelja nuk ndreqet deri në momentin kur fillon llogaritja e gjobës ditore të përkohshme, gjyqtari mund të vendosë për gjobë fikse. Gjoba, pavarësisht nëse është e përkohshme ose e përhershme, është e pavarur nga dëmshpërblimet. Gjoba e përkohshme ose e përhershme hiqet pjesërisht ose plotësisht kur konstatohet se mos respektimi ose respektimi me vonesë i urdhrit të gjyqtarit është shkaktuar pjesërisht ose plotësisht për shkak të ndikimit të jashtëm të subjektit kontraktues. Në të dyja sektorët, gjyqtari vendos në proceset e përmbledhura, d.m.th. të përshpejtuara, në mënyrë që të mos cenojë progresin e negociatave para dhënies së kontratës. Vendimi mund të arrihet brenda 20 ditësh pas referimit të çështjes. Çdo kalim i këtij afati kohor i lejon organit kontraktues të nënshkruajë kontratën dhe në këtë mënyrë çështja konsiderohet e hequr nga gjyqtari. Për sa i përket tribunaleve administrative, vendimet merren brenda afateve kohore (mesatarisht 24 ditë në vitin 2001, 20 në vitin 2002, 23 në vitin 2003 dhe 19 në vitin 2004). Vendimi mund të apelohej para organit kompetent të shkallës së fundit të rishikimit (*Conseil d'État* për kontratat e të drejtës publike ose *Cour de cassation* për kontratat e së drejtës private). Numri i aplikimeve për proceset përmbledhëse para kontraktimit para tribunaleve administrative ka ardhur në rritje që prej vitit 2000: 149 aplikime në vitin 2000, 173 në vitin 2001, 265 në vitin 2002, 290 në vitin 2003 dhe 474 në vitin 2004. Kjo tregon se brenda sistemit francez dhëniet e parregullta të kontratave mund të ndreqen shpejt dhe lehtë. Gjithsesi, shpesh konstatohet se procese të tilla shpesh fillohen si mjete të bllokimit të procedurës së dhënies së kontratës. Kjo mbase është arsyeja pse rezultati në përgjithësi nuk është i favorshëm për ankimesin (në vitin 2004, 139 vendime të tribunaleve administrative që kanë dhënë pjesërisht ose plotësisht dëmshpërblimet e kërkuara; 174 vendime që kundërshtojnë aplikimet).

Proceset e përgjithshme mund të fillohen dhe nga palët kontraktuese në mënyrë që një kontratë e dhënë në mënyrë të paligjshme **të deklarohet e pavlefshme**. Për më tepër, **palët kontraktuese**, ashtu siç edhe **palët e treta** kanë interes në kontratë (si për shembull tenderuesit e rrëzuar), dhe kanë të drejtë të kërkojnë pezullimin dhe **anulimin e akteve** të lidhura me dhënien e kontratës (p.sh., masat reklamuese, vendimin që autorizon nënshkrimin e kontratës), ose zbatimin e saj. Kërkesat për anulim mund të depozitohen brenda dy muajve nga botimi ose njoftimi i akteve të pretenduara. Afati kohor zbatohet vetëm para gjyqtarit administrativ. Kërkesat për anulim nuk kanë efekt pezullues (Neni L. 4 i Kodit të Drejtësisë Administrative). Vendimet duhet të arrihen brenda një “afati të arsyeshëm kohor”. Në rast të eksessit të pajustificuar mund të kërkojë dëmshpërblim. Në parim, anulimi i akteve ose vendimeve të lidhura me kontratën ka të ngjarë t’i japë të drejtë paditësit të kërkojë dëmshpërblim financiar. Para gjykatave të zakonshme, palët e treta mund të ngrenë padi vetëm në rast se ato justifikojnë një interes në kontratë ose një motivim publik (motif d’ordre public, motivacion që rrjedh nga rregulla të një natyre të detyrueshme) për anulim. Avantazhi kryesor i proceseve të përgjithshme është se ato mund të përdoren atëherë kur fillimi i proceseve përmbledhëse para kontraktimit është bërë i pamundur për shkak të nënshkrimit të kontratës.

Sipas ligjit francez, **aplikimi për dëme** për shkak të një vendimi ose akti të parregullt është i **pavarur** nga aplikimet për proceset përmbledhëse para kontraktimit dhe mund të jetë i pavarur nga kërkesat për të anuluar aktet e lidhura me kontratën. Në lidhje me natyrën e kontratës dhe juridiksionin e gjykatës, dëmshpërblimi rregullohet ose nga e drejta e zakonshme (Kodi Civil), ose nga jurisprudenca administrative. Nevojitet një ankesë paraprake formale për autoritetin kontraktues. Në parim, akti ose vendimi i pretenduar duhet të deklarohet i paligjshëm para njohjes së dëmeve. Tenderuesit që e konsiderojnë veten se janë refuzuar pa të drejtë mund të marrin dëmshpërblim nëse japin prova të mjaftueshme se:

- Autoriteti kontraktues ka kryer një vepër penale; dhe
- Ata kishin mundësi reale të fitimit të kontratës. Aplikuesit që nuk e plotësojnë këtë kusht zor se kanë të drejtë të marrin rimbursim për kostot e tenderimit.

Aplikuesit duhet të vlerësojnë dhe të justifikojnë vetë se cila është masa e dëmeve të kërkuara. Gjyqtarët e kontrollojnë këtë vlerësim ad hoc.

9.4 Procedura

Në proceset para gjykatave administrative zbatohet Kodi i Drejtësisë Administrative (“Code de justice administrative”- CJA). Në proceset para gjykatave (civile) administrative janë të zbatueshme si Kodi i Ri i Procedurës Civile (“Nouveau Code de procedure civile” - NCPC përkthimi në anglisht mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit: <http://www.legifrance.gouv.fr>) dhe në Kodin e Organizimit Gjyqësor (“Code de l’organisation juridique” - COJ). Nuk ka formularë/dokumente të detyrueshme në lidhje me mjetet efektive ligjore të lidhura me prokurimet publike. Gjithsesi, aplikuesit duhet të respektojnë disa rregulla dhe pika formale të detyrueshme. Sipas neneve R.621-1 deri në R.621-14 të KDA-së dhe neneve 232 deri në 284-1 të KOGj lejohet marrja e ekspertëve. Nuk ka mundësi të posaçme procedurale për të marrë parasysh nevojën për mbrojtjen e informacionit konfidencial, të tillë si proceset me dyer të mbyllura (*huis clos*), në përjashtim të çështjeve me dyer të mbyllura. Nuk ka tarifa gjykatash. Nuk ka kosto të tjera shtesë në lidhjen e ankesave për prokurimet publike. Ashtu si edhe në rishikimet e zakonshme gjyqësore, kur kërkojë përfaqësim ligjor aplikuesit duhet të paguajnë avokatin e tyre vetë. Atyre u duhet të paguajnë dhe kostot për aktet procedurale të kryera nga avokatët [(*avoué*), përmbartuesit (*huissier*)], si dhe shpenzimet e udhëtimit, nëse ka, të avokatëve, tarifat e ekspertëve, kompensimet e dëshmitarëve, etj. Secila palë duhet ta paguajë avokatin e saj në mënyrë të pavarur. Pala që e humb procesin paguan të gjitha shpenzimet e tjera (“*dépenses*”, të tilla si tarifat e ekspertëve) dhe kostot ligjore. Vendimet e gjykatave, duke përfshirë dhe vendimet e nxjerra nga organet e rishikimit të shkallës së fundit u njoftohen palëve me anë të dërgimit me postë. Vendimet më të rëndësishme ose botohen në internet (<http://www.legifrance.gouv.fr>), ose në buletinet zyrtare (“*Recueil Lebon*” për *Conseil d’État*, “*Bulletin civil*” për *Cour de cassation*). Më tej, çdokush që është i interesuar mund të kërkojë kopje të një vendimi të zyrës së gjykatës përkatëse.

9.5 *Kultura e mjeteve efektive ligjore*

Gjyqtarët dhe juristët e kanë studiuar të drejtën e prokurimeve dhe të KE-së si pjesë të kurrikulës së tyre universitare. Të tjerë të interesuar për këtë fushë duhet të kërkojnë të marrin pjesë në trajnime, kurse dhe seminare të organizuara nga firmat private ligjore, organet qeveritare, të tilla si Ministria e Drejtësisë, ose institucionet ndërkombëtare, të tilla si BE-ja. Specializimet për çështjet e prokurimeve janë rritur shumë gjatë viteve të fundit (Mastera të specializuar, konferenca në nivel universitar). Shumë periodikë ligjorë kanë një seksion për prokurimet. Ekzistojnë tri botime ligjore që merren ekskluzivisht me çështjet e prokurimeve “Kontratat publike – Actualité de la Commande et des Contrats Publics” (CP-ACCP) botuar nga Moniteur Publications; e përmuajshmeja “Contrats et Marchés publics” e botuar nga Juris-Classeur Publications; dhe botimi periodik një herë në dy muaj i “Bulletin juridique des contrats publics” (BJCP) botuar nga EFE Publications. Kompanitë mund të njihen me të drejtën e prokurimeve ose nëpërmjet trajnimit dhe konferencave, ose nëpërmjet ndihmës së dhëna nga organizatat profesionale (të tilla si dhomat e tregtisë). Trajnimi i zyrtarëve të prokurimeve publike sigurohet kryesisht nga Instituti për Menaxhimin Publik dhe Zhvillimin Ekonomik, (IGPDE), i cili është pjesë e Ministrisë së Financës së Francës si dhe nga Shoqata e Blerjeve në Sektorin Publik (“Association Pour l’Achat dans les Services Publics”- APASP, <http://www.apasp.com>), e cila është shoqata më e rëndësishme kombëtare për prokurimet publike franceze dhe të BE-së. APASP-i organizon dhe konferenca ndërkombëtare dhe boton udhëzime dhe rekomandime mbi bazën e praktikave më të mira. Ka shumë forume për çështje që lidhen me prokurimet publike: Konfederata Franceze e Biznesit (“Mouvement des entrepreneurs de France”), Federata Kombëtare e Kompanive të P[ziara Publik dhe Private (“Fédération nationale des sociétés d’économie mixte”), Asambleja e Dhomave Franceze të Tregtisë dhe Industrisë (“Assemblée des chambres françaises de commerce et d’industrie”), Konfederata e Industrisë së Punës me Dorë dhe Kompanive të Vogla të Ndërtimit (“Confédération de l’artisanat et des petites entreprises du bâtiment”), Konfederata e Përgjithshme e SME-ve (“Confédération générale des petites et moyennes entreprises”), Bordi Kombëtar i Arkitektëve (“Conseil national de l’ordre des architectes”), Federata Franceze e Ndërtimit (“Fédération française du bâtiment”), Federata Franceze e Punëve Publike (“Fédération nationale des travaux publics”), Sindikata e Shtypit Lokal të Përditshëm (“Syndicat de la presse quotidienne régionale”), Shoqata e Konsulentëve të Komunikimit (“Association des agences conseils en communication”), etj. Opinione dhe organizata të sipërpërmendura merren parasysh për bërjen e rregullave të prokurimeve. Shtypi dhe media në përgjithësi i mbulojnë në mënyrë sporadike proceset e rishikimit të prokurimeve publike. Ndikimi i vendimeve të GJED-së është i konsiderueshëm. Zyrtarët e prokurimeve duhet t’i respektojnë këto vendime dhe aplikuesit mund t’u referohen atyre në gjykata. Edhe jurisprudenca e brendshme ka rëndësi të madhe për shkak të strukturës së sistemit ligjor francez, i cili përbëhet si nga kodifikimi dhe nga jurisprudenca.

10. *Gjermania*

Prokurimi publik (Vergaberecht) në Gjermani trajtohet në një sërë rregullash të strukturuar në të tria nivelet: pjesa e katërt e Aktit Federal kundër Kufizimeve të konkurrencës, e njohur si **GWB** (niveli legjislativ, përkthimi në anglisht mund të gjendet në faqen e internetit http://www.bundeskartellamt.de/wEnglisch/download/pdf/GWB_7_e.pdf); Rregullorja e Prokurimit publik e vitit 2001, e ndryshuar, e njohur si **VgV** (niveli infra-legjislativ – përkthimi në anglisht i një versioni më të hershëm të VgV në: Lutz Horn, *Prokurimet Publike në Gjermani*, C.H. Beck, Bruylant, Giuffrè Editore, Ant. N. Sakkoulas, Stämpfi, 2001, f. 79 e pasuese.); dhe tre grupe rregullash në lidhje me dhënien e kontratave për punët (**VOB/A 2006**), mallrat dhe shërbimet (**VOL/A 2006**) dhe shërbimet profesionale (**VOF 2006**) (niveli infra-rregullator – përkthimi në anglisht i një versioni më të vjetër të VOB/A, VOL/A dhe VOF në: Lutz Horn, *Prokurimet Publike në Gjermani*, C.H. Beck, Bruylant, Giuffrè Editore, Ant. N. Sakkoulas, Stämpfi, 2001, f. 91 e pasuese). Rregullat e diskutuara më sipër zbatohen dispozitat përkatëse të Direktivave të prokurimit të KE-së dhe, si të tilla, janë të aplikueshme vetëm mbi pragjet e BE-së. Në pragjet, prokurimet publike rregullohen vetëm nga ligjet federale dhe bashkiake buxhetore si dhe nga disa dispozita të VOB/A-së dhe VOL/A-së. Struktura e komplikuar e sistemit gjerman i atribuohet zhvillimit historik të rregullave të brendshme të prokurimeve dhe strukturës federale të Republikës Federale të

Gjermanisë. Sistemi i rishikimit dhe ankesave bazohet si në kontrollin thuajse-gjyqësor dhe në kontrollin gjyqësor. (Shih në përgjithësi: http://www.bundeskartellamt.de/wDeutsch/download/pdf/Merkblaetter/Merkblaetter_englisch/06Informati onsblatt_E.pdf). Mbi pragjet e KE-së dhe mbi bazën e GWB-së (§ 97 VII), tenderuesve u jepen të drejta subjektive për një procedurë tenderimi transparence, konkurruese dhe jo-diskriminuese. Këto të drejta mund të ushtrohen mbi bazën e një juridiksioni të posaçëm nga **Dhomat e Prokurimeve Publike** (Vergabekammern, VK) dhe apelimi (sofortige Beschwerde) ushtohet nga **Gjykatat e zakonshme të Apelit** (Oberlandesgerichte, OLG). Nën pragjet, tenderuesit nuk kanë të drejta të posaçme dhe mund të kërkojnë dëmshpërblim vetëm përpara gjykatave civile të zakonshme. Gjithsesi, ekziston një diskutim i debatueshëm në lidhje me vendimet që kanë të bëjnë me kontratat që nuk bien brenda kategorisë së GWB ankesat për të cilat mund të çohen dhe në gjykatat administrative. Në disa shtete (Länder), gjykatat administrative e konsiderojnë veten si kompetente për të vendosur për mosmarrëveshje të tilla.

10.1 *Rishikimi jo gjyqësor*

Në sektorin e shërbimeve, tVgV-ja zbaton mekanizmat e vërtetimit, pajtimit dhe korigjimit që përcaktohen nga Direktiva 92/13 e KE-së. Nuk ka organe të posaçme arbitrazhi, por GWB-j i lejon tenderuesit të kundërshtojnë vendimet e prokurimeve para **Bordeve të Rishikimit të Prokurimeve Publike** (Vergabepflichten). Borde të tilla mund të vendosen si në nivelin e Länder-it dhe në atë të federatës, dhe kanë kompetenca të urdhërojnë, ose me kërkesë ose *ex officio* (kryesisht), autoritetet kontraktuese për të anuluar një vendim të paligjshëm ose për të marrë një masë të ligjshme. Bordet nuk kanë kompetencë të pezullojnë një procedurë tenderimi. Një procedurë rishikimi para një Bordi Rishikimi për Prokurimet Publike nuk është domosdoshmëri për të depozituar një aplikim për rishikim para Dhomave të Prokurimeve Gjyqësore. Nga ana tjetër, është e detyrueshme që tenderuesit të protestojnë në mënyrë formale tek autoritetet kontraktuese si parakusht për të kërkuar rishikim para dhomave (§ 107 III GWB). Çdo autoritet kontraktues është përgjegjës për përcaktimin e njësisë që merret me protesta të tilla.

10.2 *Rishikimi gjyqësor*

Përpara përfundimit të kontratës dhe kur vlera e përlogaritur e kontratës i arrin ose i tejkalon pragjet e KE-së, tenderuesit mund të sfidojnë **çdo vendim** të autoritetit kontraktues para një Dhome Prokurimesh Publike. Një kontratë e dhënë nuk mund të anulohet (§ 114 II GWB). Ka 29 Dhoma të Prokurimeve Publike. Dhomës i duhet të nxjerrë një vendim brenda dy javësh nga depozitimi i aplikimit. Në raste të justifikuar, ky afat kohor mund të zgjatet; kjo mundësi është përdorur në 27% të proceseve të rishikimit gjatë vitit 2005. Në rastet kur dhoma nuk ia del të respektojë afatet kohore, aplikimi do të konsiderohet si i kundërshtuar. Vendimi i dhomës mund të apelohej nëpërmjet një ankesë të menjëhershme (sofortige Beschwerde) para Senatit të Prokurimeve të gjykatës kompetente rajonale të apelit (OLG), brenda dy javësh nga shërbimi i vendimit për palët, ose deri në skadimin e afatit kohor (pesë javë) brenda së cilës dhoma duhet të kishte dhënë vendimin. Nuk ka afate kohore të detyrueshme për një OLG për të dhënë vendimin e saj. Kështu, nuk ka qoftë dhe një organ të vetëm rishikimi të shkallës së fundit që trajton rastet e prokurimeve: gjykata rajonale e apelit e secilit Land është përgjegjëse për të trajtuar vendimet e prokurimit të organeve kontraktuese që gjenden brenda shtetit. Po ashtu, OLG Düsseldorf ka juridiksion mbi çështjet e prokurimeve që përfshijnë autoritetet kontraktuese federale (të tilla si ministritë federale). OLG-të janë organe permanente të krijuara mbi bazën e ligjit. Vendimet e tyre janë detyruese nga pikëpamja ligjore dhe anëtarët e saj janë të pavarur nga ekzekutivi ose nga çdo pjesë tjetër e qeverisë (neni 97 i Kushtetutës Gjermane, Grundgesetz). Gjyqtarët emërohen ndërmjet juristëve të kualifikuar që i kalojnë dy fazat e para të provimit shtetëror. Në rastet kur OLG-ja dëshiron të shmangët nga vendimet e OLG-ve të tjera, ose të Gjykatës së Lartë Federale (Bundesgerichtshof, BGH), asaj i duhet t'i referojë çështjen Gjykatës së Lartë Federale, e cila më pas jep vendim në vend të OLG-së. Në vitin 2004 ka pasur 1493 aplikime të depozituara pra Dhomave si dhe 314 ankesa të drejtpërdrejta para OLG-së.

10.3 Mjetet efektive ligjore

Si parim, e drejta gjermane bën dallimin ndërmjet **mbrojtjes ligjore parësore** (të siguruar nga Dhomat e Prokurimeve Publike) dhe **mbrojtjes ligjore dytësore** (dëmeve). Në rast se një Dhomë e Prokurimeve Publike vendos se janë shkelur të drejtat e aplikuesit, ajo duhet të marrë **të gjitha masat e nevojshme** për të ndrequr shkeljen (p.sh., të lërë mënjanë një vendim të autoritetit kontraktues) dhe të parandalojë dëme të tjera në interesat e lidhura me shkeljen. Nuk ka dispozitë në lidhje me masat e përkohshme. Sipas § 115 I GWB, pasi Dhoma të ketë bërë aplikimin për rishikim tek organi kontraktues, ky i fundit nuk lejohet të hyjë në kontratë para vendimit të dhomës, ose para përfundimit të afatit kohor për depozitimin e një ankese të menjëhershme tek OLG-ja (**efekti i pezullimit automatik**). Një aplikim për rishikim nuk trajtohet nëse ai është i pranueshëm ose i pabazuar (§ 110 II dhe 115 II GWB). Autoriteti kontraktues mund të kërkojë leje të hyjë në kontratë gjatë proceseve të rishikimit. Dhoma mund ta japë lejen për të hyrë në kontratë brenda dy javëve nga kalimi i njoftimit për vendimin, dhe pasi ka marrë parasysh të gjithë interesat që mund të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik dhe kur është e mendimit se pasojat negative të pezullimit janë më të vogla se përfitimet. Nëse nuk jepet leja, aplikuesi mund të kërkojë rinovim të pezullimit të procedurës së tenderimit para OLG-së. Nëse leja nuk jepet, autoriteti kontraktues mund t'i kërkojë OLG-së t'i japë fund pezullimit të procedurës së tenderimit. Sipas § 115 III GWB, Dhoma mund të ndërhyjë në procedurën e tenderimit kur ka të ngjarë të shkelen të drejtat e aplikuesit për shkak të një vendimi që është i ndryshëm nga ai i përmbylljes së kontratës, p.sh. një vendim për të braktisur ose për të anuluar procedurën e tenderimit). **Dëmshtëpërblimet** mund të jepen nga gjykatat e zakonshme civile. Ka baza të ndryshme ligjore për njohjen e dëmeve, ku më të rëndësishmet prej tyre janë **§ 126 GWB** dhe §§ 311 II në lidhje me 280 I të Kodit Civil gjerman (Bürgerliches Gesetzbuch, BGB) lidhur me **përgjegjësinë para kontraktuese** (culpa in contrahendo, **CIC**). § 126 GWB zbatohet për kontratat që bien nën objektin e GWB, d.m.th., kontratat vlera e përlllogaritur e të cilave i arrin ose i tejkalon pragjet e KE-së. Sipas kësaj dispozite “kur një organ kontraktues e shkel dispozitën e synuar për të mbrojtur sipërmarrjet dhe në rast se sipërmarrja ka pasur mundësi reale të marrjes së kontratës mbi bazën e vlerësimit të ofertave dhe pa praninë e kësaj shkelje dhe kur marrja e kontratës nuk u realizua si pasojë e shkeljes, sipërmarrja mund të kërkojë dëmshtëpërblim të kostove të përgatitjes së ofertës ose të pjesëmarrjes në një procedurë dhënie kontrate. Pretendimet e tjera për dëme mbeten të paprekura”. Dispozitat e Kodit Civil në lidhje me CIC-në zbatohen për kontratat publike pavarësisht nga vlera e tyre. Si parim, dëmet e njohura mbi bazën e CIC-së mund të mbulojnë ose fitimin e humbur (lucrum cessans), nëse ankuesi provon se ai ose ajo do të kishte fituar me siguri kontratën dhe kur është bërë kontrata, ose kostot e tenderimit (damnum emergens), në rastet kur kontrata nuk është nënshkruar. Në të dyja rastet (§ 126 GWB dhe CIC), nuk është e nevojshme që vendimi në fjalë për autoritetin kontraktues të lihet mënjanë nga një vendim i një gjykate ose një Dhomë e Prokurimeve Publike. Në rastin e CIC, është e mundur që mungesa e aplikimit për mbrojtjen parësore ligjore të shihet si neglizhencë kontribuuese sipas nenit § 254 III të Kodit Civil. Së fundmi, nuk ka dispozitë në lidhje me pagesat periodike të gjobave.

10.4 Procedura

Proceset para Dhomave të Prokurimeve Publike në gjykatat rajonale të apeleve (OLG) përgjithësisht drejtohen nga pjesa e katërt e Aktit Federal kundër Kufizimit të Konkurrencës (**GWB**). Dispozita të tjera të GWB-së dhe të Kodit të Procedurës Civile (ZPO) mbeten të zbatueshme. Çdo palë që ka **interes** në kontratë dhe në vërtetimin e shkeljes së të **drejtave të tij/saj** sipas § 97 VII GWB, të drejta të cilat janë shkelur nëpërmjet mospërputhshmërisë me rregullat që parashikojnë dhënien e kontratave publike, gëzon të drejtën e depozitimit të një aplikimi para Dhomës së Prokurimeve Publike. Aplikuesi duhet të tregojë se ai ose ajo ka pësuar ose ka të ngjarë të pësojë **humbje** për shkak të shkeljes/shkeljeve të pretenduara të rregullave të përcaktuara. Një aplikues që nuk ka bërë ofertë duhet të dëshmojë se ai/ajo nuk u lejua të paraqiste ofertën për shkak të sjelljes së autoritetit kontraktues (p.sh., dhënie kontratash të parregullta de facto). Është e detyrueshme për palët të **protestojnë zyrtarisht** tek organi kontraktues si parakusht për të kërkuar rishikim para Dhomave të Prokurimeve Publike (§ 107 III GWB). Ky detyrim zbatohet dhe për kontratat e dhëna nga ndërmarrjet e privatizuara. Nuk ka afat kohor kufizues për të bërë ankese tek organi kontraktues, ose për depozitimin e një aplikimi para dhomës. GWB-ja thotë thjesht se si ankesa dhe

aplikimi mund të depozitohen pa vonesë (§ 108 I). Më tej, neni 13 i Rregullores për Prokurimet Publike (VgV) parashikon **periudhën pezull** prej 14 ditësh ndërmjet njoftimit të rezultateve të procedurës së tenderimit për tenderuesit e pasuksesshëm dhe përmbylljen formale të kontratës. Një kontratë e përfunduar në shkelje të detyrimit të sipërpërmendur konsiderohet e pavlefshme. Detyrimi i periudhës pezull u bën të mundur tenderuesve të pasuksesshëm të protestojnë zyrtarisht tek autoriteti kontraktues dhe t'i bëjnë aplikim tek dhoma para përfundimit të kontratës. Si ankesa dhe aplikimi mund të bëhen në të njëjtën kohë (nuk ekziston detyrimi për të pritur vendimin e autoritetit kontraktues). Pas kalimit të periudhës pezull dhe kur nuk është bërë asnjë aplikim gjatë kësaj periudhe, kontrata mund të nënshkruhet zyrtarisht. Tenderuesit e pakënaqur, pas kësaj periudhe, nuk kanë më të drejtë të kundërshtojnë vendimet e prokurimeve para dhomave. Nuk ka formularë model në lidhje me çështjet e prokurimeve. GWB-ja thotë se aplikimi duhet të bëhet me shkrim, së bashku me arsyet e aplikimit. Proceset para Dhomës së Prokurimeve Publike janë subjekt i pagimit të një tarife, shuma e së cilës varet nga shpenzimet personale dhe materiale të dhomës, duke marrë parasysh vlerën e përlllogaritur të kontratës. Tarifa minimale është € 2500 (§ 128 II GWB). Proceset para OLG-së janë objekt i pagimit të tarifave të gjykatës, shuma e të cilave është 5% e vlerës së përgjithshme të kontratës. Në proceset para një dhome, kostot e përfaqësimit ligjor rimbursohen nga pala që e humb procesin, nëse Dhoma është e mendimit se kostot e përfaqësimit ligjor për çështjen në fjalë janë të nevojshme. Në proceset para OLG-së përfaqësimi ligjor është i detyrueshëm dhe kostot përkatëse mbulohen nga palët që humbin në proces. Të dyja dhomat dhe OLG-ja mund të vendosin nëse do të merret ndonjë ekspert gjatë procesit të rishikimit. Kostot e ekspertëve paguhen në përputhje me vendimin e dhomës, ose të OLG-së. Në proceset e rishikimit përfshihen dhe ekspertët teknikë dhe ekspertë të tjerë si anëtarë të Dhomave të prokurimeve Publike. Në veçanti njëri ndër tre anëtarët e Dhomës është anëtar nderi me eksperiencë disa vjeçare e të mirënjohur në fushën e prokurimeve publike (§ 105 III GWB). Në lidhje me konfidencialitetin, dhomat duhet të mohojnë aksesin në dosje në rastet e mbrojtjes së sekretit ose ruajtjes së sekretit tregtar ose të biznesit (§ 111 II GWB). Dhomat nxjerrin vendim brenda pesë javësh nga dorëzimi i aplikimit. Pasi vendimi t'u jetë bërë me dije palët, ose kur nuk është dhënë asnjë vendim brenda periudhës së parashikuar kohore, secila nga palët mund të bëjë një ankesë të menjëhershme kundër vendimit (të shprehur ose të nënkuptuar) të dhomës para OLG-së kompetente. Ankesa e menjëhershme do të ketë efekt pezullues mbi vendimin e dhomës. Kohëzgjatja e këtij efekti është dy javë pasi ka përfunduar afati kohor për depozitim të një ankese të menjëhershme. Në rast se dhoma e kundërshton aplikimin për rishikim, OLG-ja, me kërkesë të ankimuesit, mund ta shtrijë efektin pezullues deri sa të merret një vendim për ankesën e menjëhershme. Në rast se dhoma e pranon aplikimin për rishikim duke ndaluar dhënien e kontratës, kontrata nuk do të nënshkruhet për aq kohë sa OLG-ja nuk lë mënjanë vendimin e Dhomës sipas §§ 121 ose 123 GWB. Vendimet e dhomave dhe të OLG-ve u shpërndahen palëve me anë të një shërbimi procesi ku palët janë të pranishme në gjykatë. Disa vendime janë të botuara në faqet e internetit të këtyre juridiksioneve.

10.5 Kultura e mjeteve efektive ligjore

Interesi për të drejtën e prokurimeve publike është rritur që pas miratimit të Aktit të vitit 1998 që ndryshon Aktin Federal kundër Kufizimeve të Konkurrencës (GWB). Organizohen shumë konferenca në nivelin akademik (shkolla verore "Vergaberecht" në universitetin e Bochumit: <http://www.ruhr-uni-bochum.de/fvv/summerschool/frmset.html>; Düsseldorf Vergaberechtstag: <http://www.ruhr-uni-bochum.de/burgi/vergaberechtstag/frmset.html>). Një rol i rëndësishëm në trajnimet për prokurimet luhet dhe nga sektori privat. Ekzistojnë të paktën tre **gazeta** ligjore të specializuara në fushën e së drejtës publike: Vergaberecht (VergabeR: Werner Verlag), Neue Zeitschrift für Bau- und Vergaberecht (NZBau: C.H. Beck) dhe Zeitschrift für deutsches und internationales Bau- und Vergaberecht (ZfBR: Bau Verlag). Ka dhe revista të shumta periodike informacione, të tilla si Vergabespezial (<http://www.vergabespezial.com>) dhe Vergabenews (e botuar nga Bundesanzeiger Verlag). Nuk ekziston asnjë shoqatë zyrtare kombëtare publike, por institucioni më i rëndësishëm privat është Forum Vergabe e.V. (Breite Straße 29, 10178 Berlin; telefon: +49 (0) 30 2028-1631, Faks: + 49 (0) 30 2028-2631, E-mail: info@forum-vergabe.de, Website: <http://www.forum-vergabe.de>). Aktorët kryesorë për procedurën e rishikimit dhe ankimimit për prokurimet publike mund ta kenë studiuar të drejtën e

prokurimeve si pjesë të kurrikulës së tyre universitare. Më tej, qëndrimi i gjyqtarëve drejt interesave konfliktuale konsiderohet si i balancuar. Gjithsesi, rëndësia e jurisprudencës konsiderohet si e kufizuar për shkak të interpretimeve të ndryshme të së drejtës ekzistuese statusore. Zyrat kontraktuese kanë njohuri relativisht të përshtatshme për prokurimet publike, të cilat kanë ende nevojë të përmirësohen, dhe i trajtojnë ankesat e dorëzuar nga tenderuesit në mënyrë të balancuar. Tenderuesit mund të njihen me praktikën e blerjes publike nëpërmjet eksperiencave të punës, ose ndihmës që jepet nga konsulentët privatë ose organizatat profesionale. Në lidhje me qëndrimin e tenderuesve në lidhje me proceset e rishikimit, disa prej tyre nuk duan të fillojnë procese rishikimi pasi ata nuk duan të cenojnë mundësinë për një kontratë tjetër. Të tjerët i shohin proceset e rishikimit si burim të fundit, ose mundohen të pengojnë prokurimin nëpërmjet proceseve të rishikimit. Së fundmi, vetëm një numër i vogël kërkon përfitime financiare nëpërmjet proceseve të rishikimit. Edhe shoqëria civile merr një rol më aktiv në përgatitjen dhe hartimin e rregullave të prokurimeve publike. Ndikimi i vendimeve të GJED-së është i konsiderueshëm. Më shumë se 170 nga 700 vendime ekzemplare të marra në vitin 2005 bazoheshin në vendimet e Gjykatës së Luksemburgut.

11. Hungaria

Prokurimet publike në Hungari trajtohen nga Akti CXXIX/2003 (më poshtë Akti i vitit 2003 i cili hyri në fuqi më 1 maj 2004). Përkthimi jozyrtar në anglisht dhe ndryshimet e mëpasshme të tij mund të gjenden në faqen e internetit të Këshillit të Prokurimeve Publike (<http://www.kozbeszerzes.hu>). Aktori kryesor është **Këshilli i Prokurimeve Publike** (Közbeszerzések Tanácsa, 1024 Budapest, Margit krt. 85; telefon: 0036 1 336 7748, <http://www.kozbeszerzes.hu>), i krijuar si organ publik i pavarur përgjegjës për aspekte të ndryshme të politikës së prokurimeve publike (që komenton projektligjet, operon në sistemin e trajtimit ligjor, botimin e njoftimeve, trajnimin, ndihmën për të interesuarit, etj.), që ka buxhet autonom dhe është përgjegjëse para parlamentit. Këshilli përbëhet prej 19 anëtarësh. Rishikimi i procedurave të prokurimeve publike bazohet në një sistem miks kontrolli quazi-gjyqësor dhe gjyqësor (Pjesa 7 e Aktit të vitit 2003). Ky sistem nuk ndryshon shumë nga sistemi i përcaktuar nga Akti i Prokurimeve Publike të vitit 1995. Mund të përdoret dhe kontrolli jo gjyqësor. Kërkesa për mbulim dëmi mund të kërkohet vetëm para një gjykate të zakonshme. Në Hungari drejtësia administrohet në një sistem me katër nivele nga Gjykata e Lartë, gjykatat rajonale të apelit, gjykatat e rretheve (duke përfshirë Gjykatën e Bashkisë së Budapestit) dhe gjykatat lokale. Në të gjitha rastet mbrojtja e tenderuesve nuk varet në vlerën e përllogaritur të kontratës. Megjithatë tenderuesit informojnë autoritetin kontraktues për qëllimin e tyre për të kërkuar rishikim gjyqësor, mosveprimi për njoftim nuk përbën rrëzim të një aplikimi.

11.1 Kontrolli jogjyqësor

Sipas Aktit të vitit 2003 ekzistojnë dy lloje procedurash pajtimi. **Procedura e posaçme e pajtimit** përdoret në sistemin e ndërmarrjeve dhe zbaton direktivat përkatëse të Direktivës 92/13/KEE (nenet 369 deri në 371). Ky lloj zbatimi aplikohet vetëm mbi pragjet e KE-së. Nga ana tjetër, **procedura e përgjithshme e pajtimit** (nenet 352 deri në 368) zbatohen si për sektorët klasikë dhe për sektorët e shërbimeve pavarësisht nga vlera e përllogaritur e kontratës. Rekursi në këtë lloj pajtimi nuk është as i detyrueshëm dhe as parakusht për të kërkuar rishikim gjyqësor, por kërkon marrëveshjen e ndërsjellë të palëve të përfshira në procesin e prokurimeve. Palët që marrin pjesë në procedurën e pajtimit mund të mos kërkojnë rishikim gjyqësor para përfundimit të procedurës së rishikimit. Kryerja e pajtimit të përgjithshëm i besohet ekspertëve të pavarur me eksperiencë në fushë (në rastin e të diplomuarve për juridik kërkohet anëtarësimi në dhomën e avokatisë). Me aplikim të tyre ata listohen në një regjistër të mbajtur nga Këshilli i Prokurimit Publik sipas kushteve të parashikuara në Aktin e vitit 2003. Vendimet e këshillit në lidhje me përfshirjen ose përjashtimin nga regjistri mund të kundërshtohen në gjykatë. Aplikimet për përputhshmëri të përgjithshme i dërgohen këshillit brenda pesë ditësh nga fillimi i afatit kohor për kërkimin e rishikimit gjyqësor dhe i njoftohen autoritetit kontraktues si dhe tenderuesve konkurrentë. Në parim, mosmarrëveshja shqyrtohet nga tre ekspertë. Aplikuesi dhe i pandehuri, caktojnë përkatësisht një anëtar paneli dhe personi i tretë përcaktohet me vendim të përbashkët. Me anë të një vendimi të përbashkët, palët mund të caktojnë një ekspert të vetëm për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Pas fillimit të procedurës së pajtimit, autoriteti

kontraktues mund të pezullojë procedurën e dhënies së kontratës ose mund të ndryshojë nënshkrimin e kontratës. Proceset regjistrohen në proces-verbal. Procedura e pajtimit përfundon ose pas marrëveshjes së arritur, kur arrihet një marrëveshje, ose në rast se vendoset për përfundimin e kontratës nga njëra nga palët. Në të gjitha rastet, procedura nuk i kalon tetë ditë pas dorëzimit të aplikimit. Mundësia tjetër është rishikimi gjyqësor i mosmarrëveshjeve. Në rastet kur bihet dakord ndryshe, palëve u duhet të mbulojnë kostot e procedurës së pajtimit në përpjesëtim të drejtë. Anëtarët e panelit kanë të drejtë të marrin shpërblim si dhe t'u rimbushen kostot e tjera.

11.2 Rishikimi gjyqësor

Tenderuesit e pakënaqur mund t'i çojnë mosmarrëveshjet që dalin nga procedura e tenderimit para **Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike**, i cili është krijuar si organ i pavarur rishikimi që funksionon paralelisht me Këshillin e Prokurimeve Publike. Në fushën e prokurimeve publike, shkalla e parë e shqyrtimit ligjor është Bordi i Arbitrazhit; rishikimi gjyqësor para gjykatës është i mundur vetëm nëse ka ndodhur rishikimi i Bordit të Arbitrazhit. Tenderuesit mund të kundërshtojnë **çdo akt** që lidhet me procedurën e dhënies së kontratës para dhe pas përfundimit të kontratës; gjithsesi, Bordi i Arbitrazhit nuk mund t'i bëjë të pavlefshme vendimet e autoritetit kontraktues pas nënshkrimit të një kontrate. Bordi i arbitrazhit financohet nga buxheti i këshillit dhe ka juridiksionin mbi të gjithë territorin e shtetit. Anëtarët e Bordit të Arbitrazhit ("komisionarët e prokurimeve publike") janë nëpunës civilë të emëruar (me të drejtë riemërimi) nga këshilli sipas kushteve të parashikuara në nenin 398 e pasues të Aktit të vitit 2003. Këshilli përcakton numrin e komisionarëve dhe cakton kryetarin si dhe zëvendës-kryetarin e Bordit të Arbitrazhit për një mandat pesë-vjeçar të rinovueshëm. Komisionerët veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Ata nuk janë objekt i asnjë lloji instruksioni, por vetëm i ligjit. Vendimet e Bordit të Arbitrazhit janë të zbatueshme dhe janë subjekt i një sistemi rishikimi me dy nivele. Akti i vitit 2003 bën dallimin ndërmjet vendimeve të marra gjatë proceseve, të tilla si dhënia e masave të përkohshme, gjobat procedurale, bashkimin e çështjeve, fillimin e vendimeve paraprake nga GjED-ja, etj, dhe vendime përmbyllëse të dhëna për thelbin e çështjes. Kjo e fundit mund të apelohej para **Gjykatës së Bashkisë së Budapestit** (1055 Budapest, Markó utca 27), me kusht që Akti i vitit 2003 ta ketë shprehimisht të parashikuar këtë gjë; nuk ekziston mundësia e ankimit të vendimit të gjykatës në një shkallë më të lartë. Situata e fundit mund të zgjidhet si më poshtë: çdo person e drejta ose interesi legjitim i të cilit është paragjykuar nga vendimi përmbyllës i Bordit të Arbitrazhit, ashtu si edhe institucioni që ka filluar proceset para Bordit të Arbitrazhit, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore para Gjykatës së Bashkisë së Budapestit (neni 346 § 1). Në këtë rast gjykata mund të vendosë a) të rrëzojë kërkesën si të pabazuar; b) të urdhërojë Bordin e Arbitrazhit të fillojë një proces të ri; ose c) të ndryshojë vendimin e marrë nga Bordi i Arbitrazhit sipas Kodit të Procedurës Civile dhe rregullave të posaçme të përsheptuara të Aktit të vitit 2003. Vendimi i gjykatës mund të kundërshtohet në shkallën e dytë para **Gjykatës së Apelit të Bukureshtit** (Fővárosi Ítéltábla, Budapest 1027, Fekete Sas u. 3). Në të dyja rastet apelimet shqyrtohen nga seksionet e së drejtës administrative të gjykatave të përmendura më lart. Në mënyrë përjashtimore, një vendim i Gjykatës së Apelit mund t'i referohet Gjykatës së Lartë brenda kuadrit të rishikimit të jashtëzakonshëm sipas kushteve të parashikuara në nenin 270 - 275, 324 dhe 340 A të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e lartë siguron uniformitet me jurisprudencën nëpërmjet vendimeve që janë detyruese për gjykatat individuale. Pra, Gjykata e Apelit e Bukureshtit është organi i rishikimit të shkallës së fundit në çështjet e prokurimit publik. Pavarësia e gjyqësorit parashikohet nga Kreu X i Kushtetutës së vitit 1949, Akti LXVII/1997 për statusin ligjor dhe shpërblimin e gjyqtarëve dhe Akti III/1952 (Kodi i Procedurës Civile). Këto rregulla parashikojnë dhe emërimin dhe heqjen nga detyra të gjyqtarëve, kualifikimet e nevojitur, shpërblimet, buxhetin e drejtësisë dhe formën e vendimeve. Çdo qytetar hungarez me diplomë në juridik që nuk është i dënuar, që ka të drejtë vote, dhe që ka kaluar një provim të lartë për fushën ligjore dhe me eksperiencë të njohur profesionale mund të bëhet gjyqtar nëse nuk ka arsye përjashtimi ose mospërputhshmërie.

11.3 Mjetet efektive ligjore

Mjetet efektive ligjore mund të ndahen në dy kategori: në mjete që jepen nga Bordi i Arbitrazhit të Prokurimit Publik dhe mjetet e dhëna nga gjykatat. Në kategorinë e parë përfshihen vendime gjatë

proceseve (masat e përkohshme: Neni 332, ose gjobat përfundimtare, bashkimi i çështjeve, fillimi i vendimeve paraprake nga GjED-ja, etj.) dhe zgjidhje të dhëna nëpërmjet vendimit përmbyllës të Bordit të Arbitrazhit (Neni 340). Për shkak se aplikimet para Bordit të Arbitrazhit nuk kanë efekt pezullues, **masat e përkohshme** mund të urdhërohen me kërkesë ose *ex officio* para përfundimit të kontratës, me kusht se ka prova të mjaftueshme për shkeljen (aktuale ose potenciale) të detyrimeve tenderuese. Megjithëse në aktin e 2003-it nuk është përfshirë asnjë dispozitë specifike, Bordi i Arbitrazhit mund të marrë parasysh pasojat e mundshme të masave të marra për të gjithë interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin e publikut, dhe mund të vendosë të mos i japë këto masa kur pasojat negative i tejkalojnë përfitimet. Bordi i Arbitrazhit mund 1) të pezullojë procedurën e dhënies së kontratës; 2) ndalojë përfundimin e kontratës (por të mos e deklarojë të pavlefshme vetë kontratën; vetëm gjykata mund të deklarojë pavlefshmërinë e një kontrate të përfunduar) dhe 3) të urdhërojë autoritetin kontraktues të ftojë aplikuesin të marrë pjesë në procedurën e tenderimit. Me iniciativën e tij, autoriteti kontraktues mund të pezullojë procedurën e dhënies së kontratës pas depozitimit të një aplikimi ose të shtyjë nënshkrimin e kontratës deri sa Bordi i Arbitrazhit të arrijë një vendim përmbyllës. Nëpërmjet **vendimit përmbyllës**, Bordi i Arbitrazhit mund 1) të vendosë vetëm nëse ka ndodhur ose jo një shkelje; 2) ku ka ndodhur shkelja, të urdhërojë autoritetin kontraktues të përmbushë detyrimet tenderuese ose të respektojë një sjellje të caktuar; 3) të deklarojë të pavlefshme çdo akt të autoritetit kontraktues që lidhet me procedurën e dhënies së kontratës, ose aktin që e deklaroi të plotësuar procedurën, me kusht që nuk është nënshkruar asnjë kontratë (autoriteti kontraktues është përgjegjës vetëm për deklarimin të pavlefshëm të të gjithë procedurës së tenderimit); dhe 4) vendosjen e një gjobe materiale në rastet e dhënies të paligjshme të kontratave, mosveprimit për të njoftuar përmbledhjen vjetore të statistikave që përmendet në nenin 16 të Aktit të vitit 2003, ose mendimi i paligjshëm ose zbatimi i kontratës së përmbyllur mbi bazën e një procedure tenderimi (nenet 303 deri në 306). Nëse Bordi i Arbitrazhit i zhvlerëson vendimet duke e deklaruar procedurën e tenderimit të plotë, autoriteti kontraktues merr një vendim të ri brenda 30 ditësh nga data kur vendimi i Bordit të Arbitrazhit bëhet i zbatueshëm, ose mund ta deklarojë procedurën e dhënies së kontratës të paplotë (dhe të fillojë një të re ose të lërë prokurimin e saj). Nëse Bordi i Arbitrazhit konstaton shkelje të detyrimeve tenderuese, autoriteti kontraktues ose tenderuesi i suksesshëm mund ta përcaktojë kontratën e përfunduar brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të vendimit nga Bordi i Arbitrazhit. Po ashtu, Bordi i Arbitrazhit ka të drejtë të vërë **sanksione** për tenderuesit (përfshirë nga procedurat e tenderimit ose listat e parakualifikimit) kur ata gjenden përgjegjës për shkelje të përsëritura të ligjit të prokurimeve publike (Neni 341). Në përgjithësi, **gjobat materiale** mund të vendosen për çdo njeri (si për zyrtarët e autoriteteve kontraktuese dhe për tenderuesit) përgjegjës për një shkelje të Aktit të vitit 2003. Apelimet kundër një vendimi përmbyllës të Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike nuk kanë efekt pezullues mbi zbatimin e këtij vendimi. Gjithsesi, Gjykata e Bashkisë së Budapestit, mund ta pezullojë zbatimin çdo herë kur kërkohet një gjë e tillë shprehimisht ose *ex officio*. Njohja dhe mbulimi i **dëmeve** mund të kërkohet para një gjykate dhe është objekt i konstatimit të mëparshëm të një shkelje procedure me anë të një vendimi të Bordit të Arbitrazhit, ose të gjykatës në rastet apelimit kundër këtij vendimi (neni 350). Sipas nenit 351, tenderuesit e pakënaqur mund të kërkojnë rimbursimin e kostove të tyre të tenderimit nëse provohet se 1) autoriteti kontraktues ka shkelur të drejtën e prokurimeve; 2) autoriteti kishte mundësi reale të fitonte kontratën dhe 3) se shkelja cenon të drejtën e tyre për të fituar kontratën. Ata mund të kërkojnë dëme dhe për fitimin e munguar nëse janë të aftë të japin prova të mjaftueshme në këtë kuadër, në varësi të dispozitave të Kodit Civil të vitit 1959 (neni 339: “një person që i shkakton në mënyrë të paligjshme dëme një personi tjetër duhet të riparojë dëmet e shkaktuara. Përgjegjësia përjashtohet nëse provohet se veprimi pritej në rrethana të caktuara”).

11.4 Procedura

Proceset para Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike si në sektorët klasikë dhe në ato të shërbimeve drejtohen nga Kreu IX i Aktit të 2003-it, si dhe nga Akti CXL/2004 për rregullat e përgjithshme për procedurat administrative. Aplikimet mund të depozitohen nga 1) **autoriteti kontraktues** si dhe nga çdo **tenderues**, kandidat ose person tjetër i interesuar, e drejta ose interesi legjitim i të cilit ka qenë ose ka të ngjarë të paragjykohej nga një veprim ose mosveprim që bien ndesh me Aktin e vitit 2003; në rastin e

fundit, autoriteti kontraktues informohet për qëllimin e fillimit të proceseve. Mosrespektimi i këtij detyrimi nuk ka efekt mbi pranimin e aplikimit; 2) **ex officio**, pra me kërkesë të çdo personi/institucioni të dhënë më poshtë të cilët janë vënë në dijeni, gjatë kryerjes së punës të tyre, për shkeljen kundër Aktit të vitit 2003: një anëtar ose kryetari i Këshillit të Prokurimeve Publike; Zyra e Kontrollit Shtetëror, Zyra e Kontrollit Qeveritar; zyra administrative e rrethit ose e qytetit të Budapestit; thesari i shtetit, komisioneri parlamentar për të drejtat civile, komisioneri parlamentar për të drejtat për pakicat kombëtare dhe etnike, si dhe komisioneri për mbrojtjen e të dhënave; subjekti që i jep subvencion një prokurimi, ose subjekti që merr pjesë sipas një dispozite ligjore në përdorimin e këtij subvencion; dhe organi kryesor i blerjes. Çdo akt i lidhur me procedurën e dhënies së kontratës mund të rrëzohet (më shpesh në praktikë kundërshtohen kushtet e njoftimit të kontratës si kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit, specififikimet teknike dhe përcaktimi i fituesit ose përfundimi me sukses i procedurës së tenderimit) Aplikimet duhet të bëhen brenda 15 ditësh nga ndodhja e shkeljes dhe brenda tetë ditësh nga njoftimi i rezultateve në rast të vendimeve që e deklarojnë procedurën e tenderimit të përfunduar. Në rast se shkelja bëhet me dije në një datë të mëvonshme, afati kohor do të fillojë në atë datë, dhe në çdo rast nuk e kalon afatin kohor prej 90 ditësh nga data kur ka ndodhur shkelja. Mosrespektimi i afateve kohore të përmendura më lart nënkupton heqjen e të drejtave për procese. Në lidhje me Zyrën e Kontrollit të Shtetit, Zyrën e Kontrollit Qeveritar, Thesarin e Shtetit, subjektin subvencionues, ose subjektin që merr pjesë në përdorimin e subvencionimit, proceset nisen brenda një viti, ose në rast të dhënies së drejtpërdrejtë të paligjshme brenda tre vjetësh nga data në të cilën ka ndodhur shkelja. Nuk ka formularë model për aplikim tek Bordi i Arbitrazhit. Neni 324 § 1 i Aktit të vitit 2003 liston elementët të cilët duhet të reflektohen në aplikim (emri i aplikuesit dhe i të akuzuarit, data e shkeljes, etj.). Si rregull, seancat dëgjimore realizohen të hapura për publikun, por Bordi i Arbitrazhit mund të vendosë të realizojë seanca të mbyllura nëse kjo gjë është e nevojshme për arsye të sekretit shtetëror ose profesional/të biznesit (Neni 336 § 2). Me pak përjashtime, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me sekrete të biznesit, aksesit tek dosja e prokurimeve u garantohet të gjitha palëve të përfshira në proces (neni 337). Me kërkesë, ose *ex officio*, Bordi i Arbitrazhit mund t'i kërkojë një ekspert të japë mendimin e tij të pavarur për çështje teknike ose ligjore. Proceset para Bordit të Arbitrazhit janë subjekt i një tarife administrative, shuma e së cilës varet nga vlera e prokurimeve publike dhe lloji i vendimit të kundërshtuar (900 000 HUF në rast të procedurave të tenderimit mbi pragjet e KE-së, me përjashtim të kërkit të përmirësimit të përmbytjes së një thirrje për tender; 150 000 HUF në të gjitha rastet e tjera). Duke pasur parasysh faktet e çështjes, Bordi i Arbitrazhit vendos se cila palë paguan tarifën dhe kostot e tjera procedurale. Në rast të proceseve *ex officio* kur nuk është përcaktuar ende shkelja, të gjitha kostot i ngarkohen shtetit. Tarifat e ekspertëve paguhen paraprakisht nga pala që kërkon aktin e ekspertizës, por në fund të procesit paguhen nga pala që humb. Nëse Bordi i Arbitrazhit cakton një ekspert *ex officio*, tarifat e ekspertit paguhen nga shteti. Bordi i Arbitrazhit duhet të arrijë në një vendim përmbyllës brenda afateve kohore të përcaktuara për këtë qëllim: 1) në rast të mungesës së proceseve, 15 ditë që prej fillimit të proceseve; 2) nëse ndodhin proceset, 30 ditë nga fillimi i proceseve. Në çështje të justifikuara, këto afate kohore mund të shtrihen deri në dhjetë ditë. Vendimi përmbyllës i njoftohet palëve, si dhe personave/institucioneve të tjera të interesuara. Vendimet përfundimtare botohen në "Buletinin e Prokurimeve Publike", i cili është organi zyrtar i Këshillit të Prokurimeve Publike (versioni on-line gjendet në adresën www.kozbeszerzes.hu). Botimet janë të mundura dhe pas zhvillimit të seancave me dyer të mbyllura, ose pasi është bërë apelimi kundër vendimeve të Bordit të Arbitrazhit.

Proceset në Gjykatën e Bashkisë së Budapestit trajtohen në Kreun XX të Kodit të Procedurës Civile (neni 324 - 341), në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 347 - 349 të Aktit të vitit 2003. **Apelet kundër vendimet e marra nga Bordi i Arbitrazhit të Prokurimeve Publike gjatë proceseve** mund të parashtrihen brenda tetë ditësh nga nxjerrja e vendimeve. Apelimet e kësaj natyre duhet të depozitohen tek Bordi i Arbitrazhit, i cili është përgjegjës për dërgimin e tyre dhe të dosjes së çështjes pa vonesë në gjykatë (neni 345 § 2). **Apelimet kundër vendimeve përfundimtare të Bordit të Arbitrazhit** mund të bëhen nga çdo person, e drejta ose interesi legjitim i të cilit është paragjykuar nga vendimi dhe nga institucioni që ka filluar proceset para Bordit të Arbitrazhit, brenda 15 ditësh nga njoftimi i vendimit përfundimtar (neni 347 § 1). Në këtë rast apelet do të trajtohen si të kishin përparësi mbi çështjet e tjera, por nuk ka dispozita në lidhje me afatet kohore brenda të cilave gjykata duhet të marrë vendimin e saj.

Proceset me dyer të mbyllura kryhen në kushtet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (për raste të sekretit shtetëror ose të biznesit, raste të privacisë). Vendimi i Gjykatës së Bashkisë së Budapestit mund të apelohe më tej para Gjykatës së Apelit të Budapestit nga pala e interesuar, nga palë të tjera që ndërhyjnë në procese, ose çdo person i prekur nga dhënia e një vendimi (neni 233 i Kodit të Procedurës Civile). Prezantimi ligjor kërkohet vetëm para Gjykatës së Apelit. Ekspertiza është e disponueshme nën kushtet e ngjashme me ato që zbatohen para Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike. Vendimet e gjykatave janë publike, u njoftohen palëve me shkrim brenda 30 ditësh nga lëshimi i tyre dhe botohen në ‘Buletinin e Prokurimeve Publike’. Sipas Aktit XCIII të vitit 1990, tarifa për të gjitha proceset e gjykatës kundër vendimeve administrative (të tilla si rezoluta e Bordit të Arbitrazhit) është 16 500 HUF. Në përgjithësi, kostot e gjykatës përfshijnë shpenzime të lidhura me procese racionale dhe “*bona fide*” (në veçanti: tarifat e dëshmitarëve, ekspertëve dhe përkthyesve’ kostot e përkthimit, kostot për vizitat në terren, kostot që lidhen me marrjen e dokumenteve; kostot e lidhura me përfaqësimin ose këshillimin ligjor; udhëtimin dhe kostot postare). Si parim, pala humbëse urdhërohet të paguajë kostot që lidhen me fillimin e proceseve gjyqësore, si dhe me kosto të tjera procedurale.

11.5 *Kultura e mjeteve efektive ligjore*

Gjyqtarët dhe zyrtarët e prokurimeve mund të përfitojnë njohuri për ligjin e prokurimeve publike si pjesë e kurrikulës së tyre universitare, ose nëpërmjet seminareve të organizuara nga institucionet qeveritare. Ekziston një trajnim i posaçëm prej 220 orësh (nga “oficerët e prokurimit publik”), i njohur nga shteti. E drejta e përgjithshme e KE-së është lëndë e detyrueshme për studentët e juridikut. Edhe provimet e avokaturës e përfshijnë këtë fushë. Këshilli i Prokurimeve Publike u ofron mundësi zyrtarëve, duke përfshirë dhe komisionarët e prokurimeve publike, të marrin pjesë në kurset pasuniversitare të trajnimit, si dhe në konferenca me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të specializuar në fushën e të drejtës së prokurimeve publike. Zyrtarët e Këshillit të Prokurimeve Publike marrin pjesë në mënyrë të rregullt në seminarët e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, të tilla si Instituti Europian i Administratës Publike (EIPA). Seminarët organizohen dhe nga sektori privat (konsulentët, organizatat e trajnimit). Tenderuesit mund të jenë njohur me prokurimet publike nëpërmjet eksperiencës së tyre të punës dhe mund të marrin pjesë dhe në seminarët dhe konferencat e përmendura më lart. Ata asistohen nga një seksioni i posaçëm i krijuar nga Këshilli i Prokurimeve Publike. Qëndrimi i gjyqtarëve dhe i komisionarëve për sa i përket konflikteve të interesave konsiderohet i drejtë dhe i balancuar. Zyrtarët e prokurimeve konsiderohen se kanë njohuri të mjaftueshme të ligjit të prokurimeve. Disa tenderues i shohin proceset e rishikimit si mjet të fundit. Të tjerë synojnë të pengojnë prokurimet nëpërmjet proceseve të rishikimit. Në disa raste tenderuesit nuk shkojnë tek Bordi i Arbitrazhit të Prokurimeve Publike, por i kërkojnë anëtarit të organizatës përkatëse profesionale në Këshillin e Prokurimeve Publike të kërkojë nisjen e një procedure *ex officio*. Ka botime të shumta, ku përfshihen dhe “Buletini i Prokurimeve Publike”, si dhe rishikime të tjera të botuara nga organizatat private (p.sh., “Letrat e Prokurimeve Publike”, të botuara nga Shoqëria e Prokurimeve Publike). Për të njëjtën fushë kanë dalë botime të ndryshme. Ekzistojnë shoqata të ndryshme prokurimi të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur (Fondacioni për Kulturën e Prokurimeve Publike, Shoqata e Konsulentëve Zyrtarë të Prokurimet Publike), ose brenda një organizate mëmë (të tillë si Seksioni i Prokurimeve Publike, ose Dhoma e Avokatëve). Jurisprudenca ka rëndësi të madhe. Rreth 20% e vendimeve të Bordit të Arbitrazhit apelohe në një nivel më të lartë gjykimimi. Shtypi ndonjëherë mbulon çështje të prokurimeve publike, në veçanti kur janë në diskutim interesa të mëdha financiare. Bordi i Arbitrazhit dhe gjykatat e tjera i marrin parasysh vendimet e GJED-së.

12. **Irlanda**

Sistemi i **trajtimit të ankesave dhe i rishikimit** të Irlandës bazohet në rishikimin e pavarur gjyqësor. Ekziston një sistem me dy shkallë për rishikimin gjyqësor për kontratat që janë mbi pragun e KE-së.

12.1 *Ankesat tek autoriteti kontraktues*

Nuk është e detyrueshme që ankimimi të bëhet së pari tek **autoriteti kontraktues ose tek subjekti kontraktues**. Në fushën e prokurimeve publike nuk ka rregulla specifike që rregullojnë ankesat për

autoritetin kontraktues. Por, gjithsesi, është e mundur që kundërshtimet të mund të zgjidhen duke ndjekur këtë rrugë. Njësia Kombëtare për Politikën e Prokurimeve Publike (NjKPPP) mundohet ta mbajë nevojën për procese formale në minimum duke i inkurajuar organet të japin informim konstruktiv vullnetar për kandidatët dhe tenderuesit e pasuksesshëm. Udhëzimet për dhënien e informacionit dhe informimi i kandidatëve mund të shihen tek faqja kombëtare e internetit për prokurimet publike (www.etenders.gov.ie) tek seksioni Guides/General Procurement Guidance (Udhëzime/Udhëzim i Përgjithshëm për Prokurimet).

12.2 Rishikimi gjyqësor dhe mjetet efektive ligjore

Nëse tenderuesi nuk është i kënaqur me vendimin e autoritetit ose subjektit kontraktues, ai mund të kërkojë rishikim gjyqësor nga **Gjykata e Lartë**, ose nga një gjykatë e përgjithshme, ose e posaçme vendimet e së cilës kanë natyrë të detyrueshme ligjore. Në vitin 2003 Gjykata e Lartë krijoi një strukturë të posaçme për të trajtuar më shpejt çështjet tregtare, duke përfshirë dhe çështjet e prokurimeve publike. Kjo Gjykatë Tregtare përdor metodat më të shpjegues për të përshpejtuar procesin dhe ka si synim të marrë një vendim nëse ka arsye të vlefshme për rishikim brenda javësh, dhe jo në disa muaj, siç ka qenë rastin në të shkuarën. Në mjaft raste, ankimesi e ndalon procesin pas një përgjigje nga autoriteti kontraktues. Gjykata e Lartë mund të anulojë, ose të ndryshojë një kontratë dhe të japë vendim për dëmshpërblim për kostot, humbjet, ose dëmet. Çdo vendim prokurimi mund të rishikohet dhe të anulohet. Të gjitha këto masa mund të jepen dhe si masa të përkohshme duke marrë parasysh pasojat e tyre të mundshme për të gjithë interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik; Gjykata e Lartë mund të vendosë të mos i japë këto masa kur pasojat e tyre negative i tejkalojnë përfitimet. Njohja e dëmeve bëhet mbi bazën e jurisprudencës, dhe nuk është e nevojshme që vendimi për dhënie kontrate të pezullohen para se gjykata të urdhërojë pagimin e dëmeve. Gjykata ka diskrecion për çështjet e tjera. Nuk ka dispozita për pagesat e gjobave periodike. Ekspertët teknikë dhe ekspertët e tjerë mund të përfshihen sipas rasteve mbi përzgjedhjen e palëve të procese. Kostot përcaktohen nga gjykata. Paditë mund të ngrihet për çdo palë që mendon se i është cenuar e drejta. Për ngritjen e padive nuk paguhet asnjë tarifë. Tarifat e avokatëve ndryshojnë shumë, por gjykata mund të urdhërojë organin, ose subjektin kontraktues të paguajë tarifën e avokatit të tenderuesit nëse ky autoritet/subjekt e humb procesin e gjykimit. Tenderuesit kanë zakonisht tre muaj në dispozicion për të ngritur padi që nga momenti i vënies në dijeni për shkeljen, por ky afat kohor mund të shtyhet dhe më tej me vendim të gjykatës. Nuk ka pezullim automatik të procedurës së prokurimit në momentin që Gjykatës së Lartë i është dërguar një padi, por udhëzimet theksojnë nevojën e autoritetit përkatës kontraktues të ushtrojnë kujdes para proceseve. Nuk ka afat kohor për Gjykatën e Lartë për të nxjerrë vendim. Koha ndërmjet depozitimit të një padie për rishikim juridik dhe vendimit të fundit zakonisht është disa javë. Nuk ka parashikime në lidhje me shërbimet që rrjedhin nga këto organe kontraktuese. Nuk ka as formularë model që duhen plotësuar. Vendimet botohen nga vetë gjykata. Sistemi i rishikimit mund të merret me çështje të shkeljeve të qarta e të manifestuara. Në përgjithësi këto janë shkelje të kryera pa qëllim dhe në përgjithësi ndreqen nga autoriteti kontraktues kur ky i fundit vihet në dijeni të tyre. Çështjet që e kalojnë ciklin e plotë janë përgjithësisht shkelje teknike, të cilat lidhen me interpretimin e rregullave. Prania e një sistemi konsiderohet si pengues për organet kontraktuese për të mos shkelur rregullat dhe, si rezultat, i jep një lloj besimi tenderuesve. Por, sistemi i gjykatave konsiderohet i shtrenjtë për tenderuesit. Një vendim i Gjykatës së Lartë mund të apelohe në **Gjykatën e Lartë** të Dublinit nëse rezultatet e tij nuk janë të kënaqshme. Pavarësia e Gjykatës së Lartë garantohet nga mandati i juristëve të kualifikuar, të cilët shërbejnë si gjykatës të saj. Vendimet e saj lexohen në gjyq dhe botohen. Është plotësuar pjesa më e madhe e kërkesave për vendimet e çështjes *Dorsch* dhe *Salzmann*, por duket se procedura nuk është procedurë *inter partes*. Tenderuesi mund t'i kërkojë Komisionit të BE-së të hetojë mbi një procedurë tenderimi.

12.3 Kultura e rishikimit

Gjyqtarët dhe juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit ose subjektet kontraktuese në proceset e rishikimit i marrin njohuritë e tyre për të drejtën e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e Komunitetit në përgjithësi si pjesë e studimeve të tyre ligjore dhe të trajnimeve vijuese profesionale. Qëndrimi i gjyqtarëve dhe i penalistëve për organet e rishikimit të prokurimeve publike ndaj

interesit të publikut, nga njëra anë, dhe interesave private të tenderuesve, nga ana tjetër, përshkruhet si e balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i përfitojnë njohuritë për mënyrën ligjore, financiare dhe administrative të mënyrës sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë nga udhëzimet e Njesisë së Politikave të Prokurimeve Publike, në forumet e prokurimeve publike, në seminare dhe në aktivitete të ngjashme të organizuara nga organizata profesionale, tregtare dhe komerciale. Njohuritë e oficerëve kontraktues për bazën ligjore dhe bazat e tjera të prokurimeve publike përshkruhen si të mira në këtë fazë. Oficerët kontraktues dhe eprorët e tyre që merren me trajtimin e ankesave ndaj tenderuesve që bëjnë animime, ose që kërkojnë rishikim juridik të vendimeve të prokurimeve publike, në përgjithësi janë të informuar mirë për procedurat e tyre dhe janë të gatshëm t'i mbrojnë këto procedura. Që prej vitit 1992 nuk ka pasur asnjë botim ose gazetë akademike që trajton në mënyrë specifike çështje të prokurimeve publike, duke përfshirë dhe rishikimet dhe ankesat për prokurimet publike. Forumi për Industrinë e Ndërtimit dhe Forumi për Prokurimet Publike në Irlandë merren me çështje të prokurimeve publike. Instituti i Administratës Publike ofron një kurs diplome në lidhje me një organ konsultimi në sektorin privat që merret me prokurimet publike. Në shtator të vitit 2006 do të organizohej një kurs profesional i nivelit të tretë nga Njësia Kombëtare e Politikave të Prokurimeve Publike dhe ka kurse të shkurtra trajnimi që ofrohen nga konsulenca e sektorit privat dhe nga organet e trajnimit. Kurset dyditore për prokurimet publike, të cilat organizohen një herë në tre muaj, janë pjesë e programit të trajnimit të Qendrës Kryesore të Trajnimit të Qeverisë. Vendime e GJED-së kanë ndikim mbi proceset e rishikimit të prokurimeve publike. Palët ose organet e rishikimit u referohen atyre.

13. Letonia

Letonia ka një sistem jo-gjyqësor dhe gjyqësor rishikimi. Së pari ankesat rishikohen nga Byroja e Monitorimit të Prokurimeve (BMP). BMP-ja është “organ administrativ shtetëror i drejtpërdrejtë”, i cili varet nga ministria e financës dhe që funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimeve Publike të vendit (LPP). Në mënyrë që të shqyrtojë ankesat, BMP-ja, e cila trajton dhe çështje të tjera të lidhura me prokurimet, ka krijuar një komision për shqyrtimin e ankesave (KShA), i cili përbëhet prej të paktën tri anëtarësh. Së dyti, si shkallë e dytë, palët në proceset para Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mund të apelojnë vendimin e tij në një gjykatë administrative. Ky apel nuk e parandalon kontratën nga realizimi. Në lidhje me kontratat që jepen nga organet publike të kontraktimit, nuk ka dallim ndërmjet kontratave brenda ose jashtë fushës së zbatimit të Direktivave të KE-së. Në lidhje me shërbimet, BMP-ja shqyrton vetëm kontrata mbi pragjet e KE-së. Për kontrata nën këto pragje nuk ka organ të posaçëm rishikimi. Sistemi i rishikimit të prokurimeve publike në Letoni duhet të jetë në përputhje me Direktivën që në vitin 2002. Para kësaj periudhe mund të kundërshtoheshin vetëm disa lloje të caktuara vendimesh të autoriteteve kontraktuese, të cilat janë përkatësisht vendimi për përzgjedhjen e metodës së prokurimit, dhënia e kontratës, kriteret e përzgjedhjes dhe kundërshtimi i të gjithë tenderëve. KSHA-ja e BMP-së nuk ka funksionuar para vitit 2002. Në të kohë ankesat rishikoheshin nga një departament i ministrisë së financës.

13.1 Ankesat tek Autoriteti Kontraktues

Një ankesë është e detyrueshme për t'ju paraqitur autoritetit kontraktues vetëm në raste të dokumenteve të paligjshme gjyqësore. Ky dokument i duhet çuar autoritetit kontraktues jo më vonë se gjashtë ditësh pune para mbarimit të afatit kohor për dërgimin e tenderëve. Nëse brenda një periudhe prej dy ditësh pune pas marrjes së ankesës, autoriteti kontraktues nuk e korrigjon shkeljen e përmendur në ankesë, ose nuk i jep një përgjigje me shkrim ankuesit, ky i fundit, deri në fund të afatit kohor për depozitimin e tenderëve, mund t'i dërgojë një ankesë BMP-së. Ankesa të tjera të veçanta për organet kontraktuese nuk rregullohen në mënyrë specifike.

13.2 Rishikimi jo-gjyqësor

Ankesat shqyrtohen nga KSHA-ja e Byrosë. BMP-ja është një institucion shtetëror administrativ i drejtpërdrejtë, i cili varet nga ministria e financës. KSHA-ja e formuar nga BMP-ja nuk ka status që mund të krahasohet me statusin e gjyqtarëve. Por, siç u theksuar dhe më lart, diskutimet e MBP-së mund të kundërshtohen në tri nivele të tjera në gjykatat administrative. Në mënyrë që të shqyrtojë ankesat, BMP-ja

fton **specialistë ose ekspertë të prokurimeve**. Këta specialistë ose ekspertë marrin pjesë në takimet e KShA-së pa pasur të drejta votimi dhe shprehin tek komisioni për shqyrtimin e ankesave mendimin e tyre profesional dhe të pavarur në lidhje me faktet e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës. Më tej, ata mund të japin një opinion në lidhje me pyetje specifike të KShA-së. Personat të cilët më parë kanë dhënë konsultime në lidhje me prokurimin e përmendur në ankesë, ose të cilët janë të interesuar në marrjen e të drejtës të kryerjes së prokurimit, ose të cilët lidhen me dërguesin e ankesës, ose me një tenderues tjetër, **mund të mos jenë anëtarë të KShA-së**, ose ekspertë që marrin pjesë në takimet e tyre. Ndonjëherë ka vështirësi në gjetjen e ekspertëve të përshtatshëm për këto procese. Para shqyrtimit të ankesës të gjithë anëtarët e KShA-së dhe ekspertët e tjerë nënshkruajnë deklaratën përkatëse. Çdo vit ka më shumë se **200 ankesa**. BMP-ja lejon përfundimin e një kontrate nëse kontrata është e pabazuar (~70% çështje gjatë pak viteve të fundit) ose **ndalon përfundimin e saj** nëse ajo konstaton shkelje të cilat janë domethënëse dhe që mund të cenojnë vendimin në lidhje me dhënien e të drejtave të prokurimeve (~30% të të gjitha çështjeve gjatë pak viteve të fundit). Arsyet për rezultatet e ankesave kundër vendimeve të prokurimeve publike përfshijnë një qëndrim të pabarabartë të organeve kontraktuese për tenderuesit dhe specifike teknike kufizuese. Koha e kaluar nga depozitimi i një ankese, ose i një padie dhe vendimit përfundimtar zakonisht është **një muaj**. Kjo periudhë relativisht e shkurtër kohe konsiderohet si pikë e fortë e sistemit të Letonisë.

13.3 *Rishikimi gjyqësor*

Vendimet e KShA-së së BMP-së mund të apelojnë në **gjykatat administrative**. Këto gjykata nuk janë **tribunale të posaçme për prokurimet publike**, por trajtojnë të gjithë aspektet e të drejtës administrative në përgjithësi. Apeli kundër një vendimi të KShA-së nuk e pezullon zbatimin e tij. Me fjalë të tjera, nëse, për shembull, komisioni lejon përfundimin e një kontrate, përfundimi i kontratës nuk pezullohet në rast të një apeli. Por, një gjykatë mund të vendosë që një autoritet kontraktues të mos e përfundojë një kontratë, megjithëse kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë në praktikë. Ligji për Kompetencat Gjyqësore parashikon se **një kompetence gjyqësore** ekziston në Republikën e Letonisë paralelisht me kompetencat legjislative dhe ekzekutive dhe se gjyqtari është i pavarur dhe subjekt vetëm i ligjit. Kjo dispozitë i referohet dhe gjykatës administrative të shkallës së tretë (Gjykatës së Lartë). Aplikimet për postin e një gjyqtari në Gjykatën e Lartë janë të hapura për gjyqtarët e kualifikuar të një rrethi gjyqësor, ose për një person që ka të paktën 15 vite eksperiencë në punë në një pozicion akademik në fushën ligjore në një institucion të arsimit të lartë, është avokat i betuar ose profesor. Gjykatat administrative plotësojnë kërkesat e përcaktuara për një gjykatë, të parashikuara në vendimet për çështjet *Dorsch* dhe *Salzmann* judgements. **Çdo vit në gjykata apelojnë 10-18 vendime të BMP-së**. Ndërsa pjesa më e madhe e çështjeve janë ende të pavendosura, rezultati thuhet gjithmonë korrespondon me BMP-së e mëparshme. Koha që kalon nga depozitimi i një ankese ose i një padie dhe vendimit përfundimtar është zakonisht një **muaj**. Kalimi i të tria shkallëve të gjykatave administrative në përgjithësi kërkon më shumë se **dy vjet**.

13.4 *Mjetet efektive ligjore*

KShA-ja e MBP-së **e ndalon përfundimin** e një kontrate nëse konstaton shkelje domethënëse të LPP-së, të cilat mund të kenë ndikim mbi dhënien e të drejtave të prokurimeve. Në raste të tilla Komisioni lëshon një vendim në lidhje me masat që duhet të merren për të ndrequr shkeljen. Nëse është përfunduar kontrata, vetëm gjykata mund ta **anulojë kontratën** dhe **mund të japë dëmshpërblime** mbi bazën e ligjit “Për Kompetencat Gjyqësore dhe Procedurën Administrative”. Lënia mënjandë e vendimit të kontestimit nuk është kërkesë për dhënien e dëmshpërblimit. Dëmshpërblimet mund të pretendohen dhe pas përfundimit të një kontrate. Ndodh shumë rrallë që dëmet të shkojnë përtej **kostove të tenderimit**. Gjykata (dhe BMP-ja) merr parasysh pasojat e mundshme të **masave të përkohshme** mbi të gjitha interesat që mund të cenohen, duke përfshirë dhe interesin e publikut dhe vendos të mos të vendosë për marrjen e këtyre masave kur pasojat negative i tejkalojnë përfitimet e shkaktuara prej tyre.

13.5 *Procedura*

LPP – Kreu XI dhe XII dhe Ligji për Prokurimet për Nevojat e Ofruesve të Shërbimit Publik – Kreu XV trajtojnë të drejtën procedurale në lidhje BMP-në, ndërsa e Drejta e Procedurës Administrative – Pjesa C (e

disponueshme në versionin në anglisht) është baza e proceseve në gjykatat administrative. Një person që është i interesuar, ose që ishte i interesuar në të shkuarën në marrjen e një kontrate prokurimesh, ose që pretendon fitimin e një procedure prokurimi, i cili, sipas procedurës specifike të prokurimeve të cilës i referohet LPP-ja dhe Ligji për Prokurimin për Nevojat e Ofrimit të Shërbimit Publik, pretendon se i janë **shkelur të drejtat e tij/saj** ose që ka shkelje të mundshme të të drejtave të tilla për shkak të një shkelje të mundshme të legjislacionit të BE-së ose legjislacioneve të tjera, gëzon të drejtën e bërjes së një ankese kundër rregullave për përzgjedhjen e kandidatit ose tenderuesit, specifikimet teknike, ose kërkesa të tjera që lidhen me procedurën specifike të prokurimeve, ose për aktivitetet e autoritetit kontraktues, ose komisionit të prokurimeve gjatë kryerjes së procedurës së prokurimeve. Në BMP nuk paguhet **asnjë tarifë** apo kosto tjetër. Sipas nenit 124 të Ligjit të Procedurës Administrative, vetëm në rastet kur apelohej një KShA në një gjykatë administrative paguhet një tarifë shtetërore prej dhjetë LVL që lidhet me dorëzimin e një aplikimi që ka të bëjë me fillimin e një çështje në gjykatë, si dhe paguhet një tarifë shtetërore prej pesë LVL në lidhje me ankesën në apel. Nuk kërkohet asnjë pagesë në lidhje me ankesat në kasacion (shkalla e tretë e gjykimit), ose për ankesa ndihmëse. Më tej, tenderuesit që kërkojnë rishikim gjyqësor në kuadrin e çështjeve të prokurimeve publike duhet të paguajnë tarifën e avokatëve, në veçanti atëherë kur në sallën e gjyqit kërkohet përfaqësim ligjor, në varësi të çdo rasti. Ekziston një parim suksesi. Pala që fiton mbulon kostot që rimbursohen nga pala që humb. Ankesat mund të depozitohen deri në përfundim të kontratës së prokurimeve. Pas përfundimit, ankuesi mund të apelojë vendimet e autoritetit kontraktues në një gjyq brenda **një muaji**. KShA-ja e shqyrton ankesën brenda një muaji pas marrjes së ankesës. Nëse, për shkak objektivë, nuk është e mundur të respektohet ky afat kohor, komisioni mund ta shtyjë afatin nëse nuk është e mundur, për arsye objektivë, që të respektohet ky afat kohor. Shtyrja ose zgjatja e afatit bëhet duke njoftuar si ankimuesin dhe palën tjetër në të njëjtën kohë. Proceset në gjykatën administrative në të tria shkallët mund të marrin më shumë se një vit. BMP-ja i shqyrton ankesat në lidhje me sektorin e shërbimeve pasi të ketë përfunduar kontrata, por jo më vonë se dy muaj pas përfundimit të saj. Pas këtij afati kohor ankesat bëhen objekt shqyrtimi nga gjykatat. LPP-ja thotë se ankesa duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë titullin dhe adresën e ankimuesit; titullin dhe adresën e autoritetit kontraktues për të cilin bëhet ankesa, faktet që justifikojnë depozitim të ankesës, që përfshijnë shkeljen dhe pretendimin e ankimuesit. Vendimet e KShA-së botohen në faqen e internetit të BMP-së: www.iub.gov.lv. Në lidhje me proceset e gjykatës, nëse një çështje gjykohej nëpërmjet një procedure me shkrim, palët në proces njoftohen në kohë të arsyeshme për datën në të cilën mund të merret një kopje zyrtare e vendimit nga zyra e sekretarit të gjykatës. Kopja zyrtare e vendimit mund të dërgohet me postë, ose, nëse ka, me mjete të tjera, nëse bëhet kërkesë për këtë gjë nga pjesëmarrësit në proces. Një kopje e vendimit u dërgohet palëve në proceset e gjykatës administrative që nuk kanë marrë pjesë në sesionet e gjykatës brenda tri ditësh pas shpalljes së vendimit.

13.6 *Kultura e rishikimit*

Nuk ekziston asnjë institucion i posaçëm për trajnimin e anëtarëve të KShA-së, ose të gjyqtarëve që merren me çështje të prokurimeve publike. Ekzistojnë vetëm seminare në BMP ose në Shkollën e Administratës Publike. Nëpunësit civilë të MBP-së marrin pjesë në seminare të organizuara nga BE-ja për prokurimet publike. “Trajnimet në punë”/“të mësuarit gjatë punës” përbëjnë bazën më të rëndësishme të njohurive. **Qëndrimi** i gjyqtarëve dhe i panelistëve për KShA-në e BMP-së drejt interesit të publikut, nga njëra anë, dhe interesave private të tenderuesve, nga ana tjetër, përshkruhet si i drejtë dhe i balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikimin e vendimeve të prokurimeve publike i përftojnë njohuritë e tyre për çështje ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi realizohen prokurimet publike në praktikë në seminare dhe gjatë konsultimeve (me shkrim ose nëpërmjet telefonit) që ofrohen nga BMP dhe nëpërmjet juristëve dhe konsulentëve. Tenderuesit konsiderohen si **shumë aktivë**. Vetëm një pakicë ngurron të fillojë proceset e rishikimit, pasi ata nuk duan të cenojnë mundësitë për kontrata të tjera në të ardhmen. Ndonjëherë proceset ankimuese përdoren si mundësi për të parandaluar konkurrencën nga përmbyllja e kontratave. Njohuritë e oficerëve kontraktues varen nga lloji i autoritetit kontraktues për të cilin ata punojnë, p.sh. një ministri e madhe kundërshtojnë një kopshti. Për shkak të faktit që prokurimet në Letoni janë të centralizuara, shumë autoritete kontraktuese (në veçanti autoritetet e vogla kontraktuese) kanë njohuri të kufizuara në çështjet e

prokurimeve publike. Qëndrimi i oficerëve kontraktues dhe i eprorëve të tyre që merren me ankesat e tenderuesve, ose me kërkesat për rishikim gjyqësor të vendimeve të prokurimeve publike përshkruhet si neutral. Nuk ka botime ose gazeta neutrale që trajtojnë specifikisht çështje të prokurimeve publike. Ndodh ndonjëherë që në shtypin e përditshëm të ketë artikuj për çështje të prokurimeve. Ligji për prokurimet publike diskutohet nga BMP-ja dhe disa organizata private. Nuk ekziston ndonjë organizatë specifike kombëtare për çështje të së drejtës dhe politikave të prokurimeve publike. BMP-ja është e vetmja pikë kombëtare e vëmendjes. Disa organizata, të tilla si Shoqata Letone e Ndërtuesve, Shoqata e Qeverive Lokale dhe Rajonale, Shoqata e Shitësve të Autorizuar të Automobilitave, Shoqata e Siguruesve dhe organizata “Green Liberty/Liri e Gjellbër” janë të interesuar për të marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të prokurimeve, ose në procesin legjislativ. Ligji i prokurimeve publike diskutohet në seminare të posaçme prokurimesh të ofruara nga BMP-ja, Shkolla e Administratës së Shtetit, dhe disa organizata private. Përderisa vendimet e GJED-së janë të detyrueshme, ata kanë një rol shumë të madh në zhvillimin e legjislacionit të prokurimeve publike të Letonisë. Organet dhe palët në rishikim u referohen këtyre vendimeve. Deri tani nuk ka pasur asnjë proces të lidhur me nenin 234 ose 226 të Traktatit të KE-së që përfshin prokurimet publike të Letonisë.

14. Lituania

Sistemi i ankesave dhe i rishikimit të prokurimeve publike në Lituani bazohet në rrugën e tri shkallëve të rishikimeve gjyqësore. Kjo mënyrë përdoret për kontratat mbi dhe nën pragjeve të KE-së. Parakusht për rishikimin gjyqësor është depozitimi i një ankese për organin ose subjektin kontraktues. Po ashtu, ekziston një procedurë pajtimi për shërbimet. Roli i Zyrës së Prokurimeve Publike (ZPP) është e kufizuar tek një vendim i mundshëm për pezullimin e procedurës së prokurimeve ndërsa ankesa për subjektin kontraktues është pezull.

14.1 Ankimi tek Autoriteti Kontraktues

Depozitimi i ankesës tek **autoriteti ose subjekti kontraktues** është i detyrueshëm. Ankesa mund të bëhet nga çdo furnizues, ose ofrues shërbimi, i cili ka interes në kontratë, ose beson se autoriteti ose subjekti kontraktues ka shkelur Ligjin për Prokurimet Publike. Të gjitha llojet e vendimeve mund të kundërshtohen deri në momentin e përfundimit të kontratës. Sipas nenit 121 të LPP-së “[...] pas marrjes së ankesës me shkrim, autoriteti kontraktues i pezullon procedurat e prokurimit derisa të shqyrtohen plotësisht ankesat dhe derisa të merret një vendim. Procedurat e prokurimit nuk pezullohen me marrjen e autorizimit nga ZPP-ja nëse furnizuesi vuan humbje shumë më të rënda nga ato që kërkohen nga furnizuesi që bën ankesën me pezullimin e procedurës së prokurimit.” Autoriteti kontraktues duhet të marrë një vendim në lidhje me ankesën brenda pesë ditësh dhe duhet të njoftojë ankimesin për vendimin në ditën pasardhëse të punës. Nuk ka informacion nëse në përgjithësi ky afat kohor respektohet. Deri në marsin e vitit 2003 ankimi për rishikim gjyqësor tek “Komisioni i Pavarur për Mosmarrëveshjet” ishte i detyrueshëm dhe nuk ekzistonte detyrimi aktual për bërjen e ankimit para autoritetit ose subjektit kontraktues.

14.2 Rishikimi gjyqësor

Në rast të një vendimi negativ, ose pjesërisht negativ, të autoritetit, ose subjektit kontraktues, ose mos marrjes së një vendimi të tillë brenda afateve kohore, furnizuesi ose ofruesi i shërbimit mund t’i çojë çështjet **në gjykatat e zakonshme rajonale (civile)** në Vilnius, Kaunas, Klaipėda, Šiauliai, ose Panevėžys në shkallën e parë, dhe mund t’i bëjë objekt apeli për Gjykatën e Apelit në Vilnius në shkallën e dytë. Si shkallë e tretë dhe e fundit, **Gjykata e Lartë e Lituanisë** në Vilnius është e vetmja gjykatë kasacioni. Të gjitha gjykatat janë krijuar mbi bazën e Kushtetutës dhe Akteve të Parlamentit dhe plotësojnë kërkesat e gjykatave, siç parashikohen në çështjen *Dorsch* dhe *Salzmann*, në përjashtim të faktit se procedurat e tyre nuk janë *inter partes*. Të gjitha gjykatat janë të pavarura nga ekzekutivi, administrata, ose pjesë të tjera të qeverisë dhe vendimet e tyre kanë natyrë detyruese. Gjyqtarët duhet të jenë juristë me eksperiencë dhe të njohur. Gjyqtarët emëroren sipas një procedure të përgjithshme. Kushtetutat, gjykatat dhe ligjet e tjera garantojnë pavarësinë ose gjyqtarët; gjyqtarët mund të hiqen vetëm në raste shumë përjashtimore. Anëtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili përzgjidhet ndërmjet anëtarëve të gjykatës,

janë ndërmjet juristëve më të kualifikuar dhe emërohen (dhe mund të hiqen) nga Seimas (Parlamenti) me propozimin e Presidentit të Republikës së Lituanisë. Furnizuesi ose ofruesi i shërbimit mund të bëjnë aplikim për **pajtim** nëse prokurimi bie nën kërkesën e Direktivës 2004/17/KE. Çdo kandidat ose tenderues i cili beson se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kërkesat e LPP-së dhe ka shkelur ose do të shkelë interesat e tij/saj të ligjshme gëzon të drejtën për t'ju drejtuar Komisionit Europian dhe për të kërkuar pajtim para miratimit të vendimit për tenderuesin e suksesshëm (siç përsëritet në Direktivën të 92/13/KEE-së). Kërkesa për pajtim mund të depozitohet tek ZPP-ja, e cila nga ana e saj ia dërgon kërkesën Komisionit Europian. Pajtimi është procedurë shtesë për rishikimin gjyqësor.

14.3 Mjetet efektive ligjore

Mjetet efektive ligjore përfshijnë anulimin e çdo vendimi për prokurimet publike, masat e përkohshme dhe dëmet. Një furnizues, ose një ofrues shërbimi, i cili është cenuar nga shkelja e LPP-së nëpërmjet autoritetit ose subjektit kontraktues mund të marrë dëmshpërblim për dëmet e provuara. Kjo mbulon normalisht kostot e tenderit, por mund të mbulojë dhe fitimet e humbura nëse aplikuesi mund t'i provojë ato. Përfundimi i kontratës mund të anulohet në rastet kur klauzolat e kontratës përcaktojnë kushte të paligjshme. Më tej, sipas LPP-së, kontrata mund të mos përfundojë deri në përfundimin e afateve kohore për depozitim dhe padive dhe ankesave të furnizuesve.

14.4 Procedura

Në lidhje me autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike, e drejta procedurale rregullohet nga Kodi i Procedurës Civile dhe pjesërisht nga Kreu V i LPP-së (për shembull, për afatet kohore; versioni në anglisht http://www3.lrs.lt/pls/inter3/dokpaieska.showdoc_l?p_id=273790). Proceset mund të fillohet nga çdo tenderues potencial. Tarifat rregullohen nga Kodi i Procedurës Civile. Tarifa e pullës është e fiksuar në rreth €30. Në mosmarrëveshje me interesa materiale, tarifatat përcaktohen si shuma të përgjithshme në varësi të ankesës së posaçme. Pala që humb më pas e rimbursion palën që fiton për tarifatat dhe kostot e tjera të lidhura. Pretendimet i depozitohen autoritetit kontraktues me shkrim brenda pesë ditëve nga data në të cilën tenderuesi vihet në dijeni, ose duhet të ishte vënë në dijeni të shkeljes së interesave të tij/saj të ligjshme. Tenderuesit i duhet të fillojë proceset gjyqësore brenda dhjetë ditësh nga data në të cilën ai/ajo është vënë në dijeni, ose duhet të ishte vënë në dijeni të vendimit ankimues të autoritetit, ose subjektit kontraktues. Në rast të paaftësisë së këtij të fundit për të rishikuar ankesën brenda kohës së përcaktuar, tenderuesit mund të hapin proces brenda dhjetë ditësh nga data në të cilën duhet të ishte rishikuar ankesa. Sipas LPP-së, i gjithë informacioni që përcaktohet si konfidencial nga tenderuesit, ose autoriteti kontraktues konsiderohet si i tillë (konfidencial) dhe mund t'u bëhet me dije palëve të treta pa pëlqimin e tenderuesit, ose të autoritetit kontraktues. Ka disa përjashtime që kërkojnë përdorimin e informacionit konfidencial në rastet e përshkruara në ligje, në veçanti në lidhje me aktivitetet kriminale. LPP-ja rregullon ankesat formale ose jo formale në lidhje me ndërmarrjet e privatizuara. Nuk ka efekt automatik pezullues kur një palë hap një proces. Gjykata e vendos këtë gjë rast pas rasti. Gjykata duhet të shqyrtojë padinë ose apelin brenda 60 ditësh nga data e fillimit të procesit ose nga pranimi i apelit. Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar, por të madhe për shkak të sistemit që përbëhet nga kodifikimi dhe nga jurisprudenca. Vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë botohen në buletin zyrtar dhe në faqen e internetit. Gjithsesi, për të marrë këtë informacion duhet të paguhet një tarifë. Përveç palëve në çështje, vendimet e gjykatave rajonale janë të disponueshme nëse bëhet kërkesë paraprake për to dhe kur paguhet tarifa e përcaktuar për këtë shërbim.

14.5 Kultura e rishikimit

Gjyqtarët dhe juristët i marrin **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike gjatë punës. ZPP-ja boton një buletin tremujor për prokurimet publike dhe informon vazhdimisht të gjitha palët e interesuara rreth lajmeve në fushën e prokurimeve publike në faqen e saj të internetit. Ndonjëherë organizohen dhe seminare ndërkombëtare në bashkëpunim me organe të ndryshme ndërkombëtare, si për shembull me OECD/SIGMA, TAIEX etj. Seminaret lokale organizohen nga ZPP-ja dhe nga sektori privat. Nuk ka një

shoqatë kombëtare për prokurimet publike. Seksioni kombëtar i Transparency International monitoron proceset e prokurimeve publike. Më specifikisht, ky organ merret me çështjet antikorrupsion.

15. Luksemburgu

Prokurimet publike në Luksemburg trajtohen kryesisht nga Akti, datë 30 qershor 2003 (i ndryshuar), si dhe nga disa rregullore zbatuese. Sistemi i rishikimit dhe i ankesave bazohet në rishikimin e pavarur gjyqësor. Akti i datës 13 mars 1993 (i ndryshuar) dhe Akti i 27 korrikut 1997 zbatojnë, përkatësisht Direktivat 89/665/KEE dhe 92/13/KEE të KE-së. Është i disponueshëm dhe kontrolli jo gjyqësor. Ekziston një faqe zyrtare interneti në frëngjisht në adresën <http://www.marches.public.lu>.

15.1 Kontrolli jo gjyqësor

Tenderuesit e pakënaqur mund të ankohen kundër një akti dhënie kontrate drejtpërdrejt tek autoriteti kontraktues si dhe tek eprori i autoritetit (“recours gracieux”). Ky ankimim nuk përbën parakusht për të kërkuar rishikim gjyqësor. Me këto ankesa merren personat përgjegjës për përfaqësimin ligjor që janë detyruar për autoritetin. Në të drejtën e brendshme janë zbatuar dhe mekanizmat e vërtetimit dhe të pajtimit të Direktivës 92/13/KEE në lidhje me kontratat mbi pragjet të cilave u referohet Direktiva 93/38/KEE e KE-së. Për zgjidhjen e një mosmarrëveshje që ka të bëjë me procedurën e dhënies së një kontrata mund të kërkohet dhe ndihma e Avokatit të Popullit (36, rue du Marché-aux-Herbes, L-1728 Luxembourg; telefon: +352 26 27 01 01, faks: +352 26 27 01 02, www.ombudsman.lu) sipas kushteve të parashikuara në Aktin e datës 16 korrik 2003. Gjithsesi, institucioni më i rëndësishëm është Komisioni i Tenderëve, i cili e ka selinë në Ministrinë e Punëve Publike (Commission des Soumissions, Ministère des Travaux Publics, 4 Bd F.D. Roosevelt, L-2450 Luksemburg; Telefon: +352 478 3312/ 478 3315, Faks: +352 46 27 09, E-mail: commission.soumissions@tp.etat.lu). Komisioni përbëhet prej nëntë anëtarësh, nga të cilët pesë, duke përfshirë dhe kryetarin, përfaqësojnë organet kontraktuese dhe katër përfaqësojnë organizatat profesionale. Detyrat e komisionit përfshijnë kontrollin e përputhshmërisë së procedurave të tenderimit me dispozitat ligjore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ngrihen nga palët e përfshira në një proces prokurimi dhe aktivitetet konsultuese me kërkesë të autoritetit kontraktues, ose *ex officio* (në veçanti kur parashikohet kryerja e një procedure të negociuar, ose kur autoriteti kontraktues ka si synim të shmangë një procedurë tenderimi, ose të vendosë për një kontratë). Fillimi i një gjykimi nuk ka efekt pezullues mbi një procedurë dhënie kontrate; gjithsesi, autoritetet kontraktuese jo gjithmonë vijnë me përfundimin e një kontrate derisa komisioni të ketë nxjerrë një vendim. Proceset para Komisionit drejtohen nga Akti i datës 30 qershor 2003 për prokurimet publike. Autoritetet kontraktuese që shkelin ligjin e prokurimeve publike mund të kërkojnë tërheqjen e aktit të shkelur. Gjithsesi, komisioni është organ këshillimor, dhe vendimet e tij (“avis”) nuk janë as detyruese për organet kontraktuese dhe as të sfidueshme në proceset e rishikimit gjyqësor. Formularët model për dërgimin e kërkesave mund të gjenden online (<http://www.marches.public.lu/commissionsoumissions/index.html>), por ato rrallë përdoren në praktikë. Nuk ka tarifa për procedurat e ngritura para komisionit.

15.2 Rishikimi gjyqësor

Rishikimi gjyqësor i vendimeve që lidhen me procedurat e kontratës ndodh në proceset normale (të përgjithshme) dhe në procese përmbledhëse në përputhje me Direktivat e KE-së për mjetet efektive ligjore. Në lidhje me natyrën ligjore të autoritetit kontraktues, mosmarrëveshjet që dalin nga procedurat e dhënies së kontratave mund të çohen ose para gjykatave administrative, ose para gjykatave të zakonshme (civile). Sipas rregullave që zbatojnë dy Direktivat, opsioni i parë zbatohet për organet klasike kontraktuese, si dhe për operatorët e shërbimeve në formën e së drejtës publike (Akti i vitit 1993). Opsioni i dytë zbatohet për operatorët e shërbimeve në formën e parashikuar në të drejtën private (Akti i vitit 1997). Zhvillimet e mëposhtme lidhen vetëm me proceset para gjykatave administrative sipas rregullave të përgjithshme (Akti i vitit 1996 për drejtësinë administrative) dhe aktet që zbatojnë Direktivën 89/665/KEE (Akti i vitit 1993). Para se të përfundojë një kontratë dhe pavarësisht nga vlera e përlogaritur e saj, tenderuesit e pakënaqur mund të kundërshtojnë çdo vendim të organit kontraktues që ka karakter të përcaktuar/përfundimtar (pra, jo hapat ndërmjetëse para arritjes së një vendimi përfundimtar) para Gjykatës Administrative (“tribunal

administrativ”, 1 rue du Fort Thüngen, L-1499 Luksemburg; telefon: + 352 42 105 78 55, faks: +352 42 105 72 78). Në proceset e parashikuara në Aktin e vitit 1993, urdhri i kryetarit të gjykatës mund të mos apelohej. Në proceset normale, vendimi i gjykatës mund të rrëzohet në shkallën e dytë dhe të fundit të gjykimit para Gjykatës Administrative të Apelit (Cour administrative, 1 rue du Fort Thüngen, L-1499 Luksemburg; Telefon: + 352 42 105 78 50, Faks: +352 42 105 78 88 – pas reformës së vitit 1996, *Conseil d’État* nuk ka më funksione gjyqësore). Gjykata Administrative e Apelit është gjykatë e përhershme që gëzon garancitë e pavarësisë dhe të paanësisë brenda kuptimit të Kushtetutës së vitit 1868 dhe që jep vendime detyruese ligjore. Gjyqtarët e saj janë juristë të kualifikuar të emëruar sipas kushteve të përcaktuara në Aktin e vitit 1996 për drejtësinë administrative.

15.3 Mjetet efektive ligjore

Brenda kuadrit të Aktit të vitit 1993, kryetari i Gjykatës Administrative mund të marrë masa të përkohshme për ndreqjen e shkeljes sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe për të parandaluar dëme të mëtejshme për interesat e përfshira. Në veçanti, kryetari mund të vendosë të pezullojë procedurën e dhënies së kontratës derisa autoriteti kontraktues të përmbushë detyrimet e tij tenderuese, si dhe të anulojë specifikimet diskriminuese teknike, ose financiare në dokumentet e tenderit, specifikimet e kontratës ose dokumente të tjera përkatëse. Kryetari mund të marrë parasysh pasojat e mundshme të masave që kërkohen për të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë interesin e publikut, dhe mund të vendosë për mos marrjen e masave të tilla, kur pasojat negative të tyre janë më të mëdha se përfitimet e shkaktuara. Masat e përkohshme janë të zbatueshme, por nuk kanë karakter përfundimtar. Gjykata, në procese normale, është kompetente vetëm për lëshimin e një vendimi përfundimtar në lidhje me anulimin e dhënies së kontratës. Në rastet kur autoriteti kontraktues nuk i realizon detyrimet e tij tenderuese, gjykata ka të drejtë të vendosë **sanksione periodike materiale** për të siguruar përputhshmërinë e autoritetit me vendimin. Dëmspërblimet mund të kërkohen vetëm para gjykatave civile, në përjashtim të rasteve kur palët arrijnë një marrëveshje jashtë gjykate për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga shkelja e të drejtës së prokurimeve publike. Është e mjaftueshme për tenderuesit e pakënaqur të japin prova për dëmin aktual të shkaktuar. Në parim shumica e dëmit vlerësohet nga ekspertët dhe mund të përfshijë kostot e tenderit si dhe fitimet e humbura.

15.4 Procedura

Brenda kuadrit të Aktit të vitit 1993, aplikimet për kryetarin e Gjykatës Administrative mund të bëhen para përfundimit të kontratës nga çdo person që i plotëson kërkesat e marrjes pjesë në procedurën e tenderimit dhe që e konsideron veten si i cenuar nga shkelja e një ligji të prokurimeve publike. Aplikime nuk kanë efekt pezullues për procedurën e dhënies së kontratës, por aplikuesi mund të bëjë kërkesë të posaçme në këtë drejtim. Po ashtu, autoritetet kontraktuese respektojnë periudhën pezull prej 15 ditësh ndërmjet njoftimit të të gjithë tenderuesve për dhënien e kontratës dhe përfundimit formal të kontratës. Ky rregull konsiderohet si një ndër evolucionet më të rëndësishme të kohëve të fundit. Në proceset normale, aplikimet duhet të bëhen brenda tre muajsh nga njoftimi i vendimit për dhënien e kontratës nga çdo person që justifikon një interes individual të drejtpërdrejtë dhe aktual. Proceset në këtë çështje rregullohen nga Akti i vitit 1996 për drejtësinë administrative (si dhe rregulloret që zbatojnë këtë akt). Në lidhje me njohjen e dëmeve, proceset rregullohen nga kodi i procedurës civile dhe fillohen brenda 30 vjetësh nga njoftimi i vendimit për dhënie kontrate (afati i zakonshëm kohor për rastet jokontraktuale). Në të gjitha rastet, përfshirja e një eksperti, si dhe kostot e ekspertizës, mund të vendosen nga gjykatat. Nuk ka dispozita në lidhje me afatet kohore brenda të cilave gjykata duhet të japë vendim. Për sa i përket proceseve të parashikuara në Aktin e vitit 1993, vendimet e kryetarit të Gjykatës Administrative në përgjithësi jepen brenda dy javësh. Nuk ka **tarifa** gjykate. Palët duhet të kenë përfaqësim ligjor dhe duhet të mbulojnë kostot e përbarimit. Në parim, janë gjykatat ato që vendosin se cilat palë mbulojnë kostot e procesit; kostot për përfaqësimin ligjor mund të rimbursohen pjesërisht me urdhër të gjykatës. Nuk ka formularë model për aplikimet për gjykatat në çështjet e prokurimeve publike. Palët në proceset e gjykatës informohen për vendimet nga nëpunësi i gjykatës. Vendimet e gjykatës mund të gjenden online (në faqen e

Gjykatave Administrative, në adresën: <http://www.jurad.etat.lu>; nuk përmenden emrat e palëve) dhe çështjet më të rëndësishme përfshihen në “Pasicrisie”, që është buletini zyrtar i drejtësisë administrative.

15.5 Kultura e mjeteve ligjore efektive

Gjyqtarët dhe juristët i marrin njohuritë për të drejtën e prokurimit publik si pjesë e kurrikulës së tyre universitare. Ata mund të marrin pjesë dhe në konferenca dhe kurse të arsimit vazhdues, të organizuar nga vendet kufitare. Në Luksemburg nuk organizohen sesione të posaçme trajnimi. Anëtarët e Komisionit të tenderimit dhe gjykatat administrative konsiderohen se posedojnë shumë eksperiencë në këtë fushë. Tenderuesit mund të njihen me prokurimet publike nëpërmjet organizatave të tyre profesionale (dhomave të tregtisë). Organizata të tilla shpesh punojnë së bashku me delegatë nga ministritë (ministra e punëve publike, e brendshme, etj.). **Qëndrimi** i gjyqtarëve ndaj interesave konfliktuale konsiderohet i drejtë. Kompetenca e zyrtarëve të prokurimeve është e mjaftueshme dhe theksohet nëpërmjet trajnimit të detyrueshëm profesional që organizohet nga ministria e shërbimit civil dhe reforma administrative. Pjesa më e madhe e tenderuesve i kërkojnë proceset e rishikimit gjyqësor si mjete të fundit. Të tjerë mund të kërkojnë të pengojnë procedurën e tenderimit. Nuk ka botime të specializuara si dhe nuk ekziston asnjë shoqatë kombëtare prokurimesh. Konferencat dhe seminarët organizohen nga ministria e punëve publike (në veçanti në rastin e ndryshimit të ligjit të prokurimeve publike) si dhe organizatat profesionale. Ndikimi i vendimeve të GJED-së është shumë i rëndësishëm.

16. Malta

Malta ka një sistem të dyfishtë rishikimi, ku ekziston mundësia e kërimit të dëmshpërblimeve në **gjykatat civile** dhe mundësia e përdorimit të proceseve të tjera të rishikimit nga organe të tjera të specializuara të prokurimeve publike. Ka dallim ndërmjet kontratave nën dhe mbi kufirin e Lm 20 000 (rreth €47 000). Të gjitha ankesat për kontratat mbi këtë shifër dëgjohen nga **Bordi i Apelit të Kontratave Publike**, ndërsa **Komiteti i Përgjithshëm i Kontratave** shqyrton ankesa që lidhen me kontrata nën pragun e Lm 20 000 (Pjesët IX dhe X të Rregulloreve të Kontratave Publike të vitit 2005 parashikojnë përbërjen dhe funksionet e Komitetit të Përgjithshëm të Kontratave). Rregullat zbatohen njëjloj si për autoritetet kontraktuale dhe për ndërmarrjet. Këto organe rishikimi janë krijuar nga Rregulloret e Kontratave Publike të vitit 2005 (njoftimi ligjor 177/2005). Para prillit të vitit 2002, Komiteti i Përgjithshëm i Kontratave jepte kontrata dhe dëgjonte dhe ankesat. Ndryshimi më i rëndësishëm i kohëve të fundit ka qenë ndarja e detyrave nga Komiteti i Përgjithshëm i Kontratave, i cili është përgjegjës për dhënien e kontratave) dhe Bordi Publik i Apelit të Kontratave. Në Maltë të gjitha kontratat nën pragun e Lm 20 000 jepen nga autoritetet individuale kontraktuese, ndërsa të gjitha kontratat mbi këtë shifër jepen nga Departamenti i Kontratave, i cili është një institucion qendror qeveritar. Pra, Komiteti i Përgjithshëm i Kontratave vepron si autoritet kontraktues për kontratat mbi Lm 20 000 dhe si organ rishikimi për kontratat nën këtë shifër. Transparenca dhe hapja e procesit, duke i dhënë akses të plotë vendimeve për mos-rekomandime, etj., konsiderohen si pika të forta të sistemit të rishikimit të Maltës.

16.1 Autoriteti kontraktues

Oficerët brenda autoritetit kontraktues janë përgjegjës për trajtimin e ankesave, dhe është e detyrueshme për tenderuesit të ankohen zyrtarisht e drejtpërdrejt tek autoriteti kontraktues në mënyrë që të kërkojnë rishikim (LN 177/2005 klauzola 83: Procedura për depozitimin e apeliave).

16.2 Rishikimi jo gjyqësor

Dhënia e një kontrate publikohet çdo të mërkurë dhe të premte në tabelën e njoftimeve të departamentit dhe në faqen e internetit. Tenderuesit mund ta marrin këtë informacion dhe me anë të faksit. Një tenderues i pakënaqur mund të kundërshtojë dhënien e një kontrate tek **Bordi i Apeliave të Kontratave Publike** brenda dhjetë ditësh kalendarike nga data e dhënies së kontratës nëpërmjet një letre të motivuar që jep arsytet për kundërshtimin e dhënies së kontratës, plus një depozitë (Bordi i Apeliave të Kontratave Publike, Departamenti i Kontratave, Notre Dame Ravelin, Floriana CMR02). Anëtarët e **Bordit të Apelit të Kontratave Publike** emërohen nga kryeministri dhe detyrat e tyre parashikohen në Pjesën

XIV e Rregulloreve të Kontratave Publike 2005. Nuk ka kërkesa në lidhje me kryetarin dhe anëtarët e Bordit të Apelimit të Kontratave Publike të përmendura në Rregulloret e Kontratave Publike të 2005-ës, me përjashtim të faktit që ata të gjithë emërohen nga kryeministri. (Ju lutem shihni bashkëngjitur LN 177/2005 Pjesa XIV). Në ndryshim me Komitetin e Përgjithshëm të Kontratave, i cili është pjesë e Departamentit të Kontratave, Bordi i Apelimeve Publike është organ i veçantë dhe i pavarur rishikimi.

16.3 Rishikimi gjyqësor

Ka një **gjykatë të zakonshme** që rishikim vendimet për prokurimet publike si shkallë e fundit gjykimi. Kjo gjykatë nuk mund të kthejë rezultatet e Bordit të Apeleve Publike, por mund t'u japë dëmshpërblim palëve të pakënaqura. Gjykatat e zakonshme i realizojnë kërkesat e vendimeve *Dorsch* dhe *Salzmann*. Pika 84 (19) e Rregullave të Kontratave Publike të vitit 2005 parashikon: “Çdo tenderues që depoziton një ankesë, i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të marrë nga Bordi i Apelit, i referon çështjen shkallës së parë të gjykatës civile (Malta Law Courts). Gjithsesi, ky rekurs nuk e vonon Drejtorin e Kontratave ose Shefin e organit kontraktues në zbatimin e vendimit përfundimtar të Bordit të Apeleve”.

16.4 Arbitrazhi

Në Maltë ekziston **Paneli i Arbitrazhit**, Qendra e Arbitrazhit të Maltës (Adresa: Palazzo Laparelli, 33, South Street, Valletta; telefon +356 21222557; faks +356 21230672; adresa në internet: <http://www.mac.com.mt/>; Email: malta.arbitration@mac.com.mt) për të trajtuar çështjet që dalin gjatë zbatimit të kontratës, por jo gjatë procesit të dhënies së kontratës. Qendra e Arbitrazhit të Maltës u krijua për të nxitur dhe për të inkurajuar kryerjen e arbitrazhit të brendshëm dhe të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Ai administrohet nga një bord guvernatorësh të caktuar nga presidenti i Maltës, por është organ i pavarur. Parashikohet dhe formimi i Dhomave të Arbitrazhit ndërmjet vendasve dhe jo rezidentëve në Maltë për qëllim të arbitrazhit ndërkombëtar.

16.5 Mjetet efektive ligjore

Tenderuesit mund të kundërshtojnë vendimet për përzgjedhjen e disa subjekteve për të marrë pjesë në procedura të mëtejshme për zgjidhje, ose vendimet për kualifikim gjatë proceseve të rishikimit në Bordin e Apelimeve të Kontratave Publike. Njoftimi ligjor nr. 177/2005 dhe Njoftimi ligjor nr 178/2005 përbëjnë bazën ligjore për Bordin e Apeleve për të pezulluar dhënien e një kontrate. **Rekomandimi për dhënien e një kontrate mund të anulohet.** Pas dhënies së kontratës, gjykatat civile mund të japin **dëmshpërblim** për tenderuesit e pakënaqur, dëmshpërblim i cili mund të shkojë përtej kostove të tenderit. Në kuadrin e vendimeve të gjykatave civile, jurisprudenca ka rëndësi shumë të madhe pasi nuk ka legjislacion dhe të gjitha parimet duhet të përcaktohen në praktikën gjyqësore. Vendimi i Bordit të Apelimit është përfundimtar.

16.6 Procedura

Ka dy procedura të ndara – njëra për kontrata mbi pragun e Lm 20 000 dhe tjera për kontrata nën vlerën e LM 20 000.

Për kontrata publike mbi vlerën Lm5 000 dhe **deri në Lm 20 000**, procedura është si më poshtë: tenderuesi i pakënaqur duhet të paguajë Lm100 në mënyrë që të kërkojë rishikim. Nëse pranohet apelimi, tenderuesit të pakënaqur i rimburohet shuma e depozituar. Tenderuesit i duhet të kundërshtojë brenda tri ditësh nga njoftimi për dhënien e kontratës. Për sa i përket përfundimit të periudhës së kohës që lejohet për depozitim të një ankese, autoriteti kontraktues i çon Drejtorit të Kontratave letrën e ankesës, faturën e depozitimit si dhe të gjitha dokumentet që lidhen me kontratën publike në fjalë. Drejtori i Kontratave ia referon çështjen Komitetit të Përgjithshëm të Kontratave, i cili e shqyrton çështjen në mënyrë të drejtë e të balancuar dhe vendos për ankesën duke e pranuar ose rrëzuar atë. Vendimi me shkrim i Komitetit të Përgjithshëm të Kontratave ngjitet në tabelën e njoftimeve nga autoriteti kontraktues, dhe kopje të tij i dërgohen të gjitha palëve të përfshira. Në shqyrtimet e tij komiteti ka të drejtën të marrë, në çdo mënyrë të konsideruar si të përshtatshme për të, çdo informacion që nuk i është ofruar nga autoriteti kontraktues. Vendimi i Komitetit të Përgjithshëm të Kontratave është përfundimtar dhe detyrues për autoritetin

kontraktues dhe për operatorin ekonomik të interesuar, të cilit nuk i jepet rekurs tjetër (LN 177/2005, pika 20). Për kontrata publike mbi pragun prej Lm20 000, procedura është si më poshtë (LN 177/05 Pjesa XIII). Çdo tenderues që nuk ndihet i kënaqur me propozimin për dhënien e kontratës dhe çdo person që ka aktualisht ose që ka pasur më parë **interes** në marrjen e një kontrate për një shërbim publik të caktuar ose për punë publike, dhe që rrezikon ose ka rrezikuar të cenohet nga shkelja e pretenduar, **brenda dhjetë ditësh kalendarike nga botimi i vendimit**, depoziton një **kërkesë rrëzimi** tek Departamenti i Kontratave, ose tek autoriteti kontraktues i përfshirë, në varësi të rastit. Kërkesa për rrëzim është e vlefshme vetëm nëse shoqërohet nga një **depozitë** ekuivalente me 1% të vlerës së vlerësuar të tenderit, me kusht që në asnjë rast depozita nuk do të ishte më pak se Lm 200 ose më shumë se Lm 25 000. Shefi i autoritetit kontraktues njofton menjëherë drejtorin e autoritetit për depozitim të kërkesës për rrëzim, duke **pezulluar** procedurën e dhënies së kontratës. Departamenti i Kontratave ose autoriteti kontraktues i përfshirë, sipas rastit, **përrjashtohen nga përfundimi i kontratës** gjatë periudhës prej **dhjetë ditësh kalendarike** që lejohet për parashtrimin e apelimeve. Procesi i dhënies së kontratës **pezullohet** nëse parashtrrohet kërkesa. Pra, ekziston një pezullim automatik i procedurës përmes Bordit të Apelimeve Publike (në rastin e gjykatave civile nuk bëhet pezullim çështjesh). Brenda tri ditësh pune nga përfundimi i periudhës dhjetë ditore që lejohet për depozitim të një kërkesë për rrëzimin e kontratës, **çdo tenderues tjetër dhe çdo person që ka pasur ose ka interes** i përfshirë në thirrjen për tender mund të regjistrojë një interes për proceset. Regjistrimi i interesit është i vlefshëm vetëm nëse shoqërohet nga një **depozitë** që ka vlerën e depozitës së paguar sipas nënregullit (1). Tenderuesi që është cituar në vendimin e drejtorit, ose nga autoriteti kontraktues si tenderuesi të cilit do t'i jepej kontrata, konsiderohet se ka interes të regjistruar, por atij nuk i duhet të paguajë depozitë. Emrat e tenderuesve dhe të personave të tjerë që kanë aktualisht ose kanë pasur më parë interes në marrjen e një kontrate të caktuar publike e që regjistrojnë interesin e tyre **bëhen publike** në ditën e parë të punës pas përfundimit të afatit kohor të specifikuar më lart. Brenda tri ditësh pune pas botimit të listës së personave që regjistrojnë një interes, tenderuesi që depoziton kërkesën për rrëzimin e kontratës dërgon një letër të arsyetuar kundërshtimi, ku shpjegon arsyet e dështimit. Letra që kërkon prishjen e kontratës bëhet publike dhe i shpërndahet të gjithë personave që kanë interes të shprehur. Brenda pesë ditësh nga botimi i letrës për prishje kontrate, çdo tenderues me interes të shprehur mund të dërgojë një përgjigje të arsyetuar për letrën që kërkon prishjen e kontratës. Përgjigjja bëhet publike dhe qarkullohet tek të gjithë tenderuesit që kanë interes të shprehur dhe tek të gjithë tenderuesit që kanë ankimuar. Brenda dhjetë ditësh pune nga botimi i përgjigjeve, drejtori ose shefi i autoritetit kontraktues përgatit një raport (Raportin e Analizës) që analizon letrën për prishjen e kontratës dhe përgjigjet e shkruara për këtë letër. Ky raport u shpërndahet personave që depozitojnë ankimin, e që kanë interes të shprehur për çështjen. Pas përfundimit të procesit përgatitor, shefi i autoritetit kontraktues i dërgon Drejtorit të Kontratave të gjithë dokumentacionin që lidhet me thirrjen për tenderët në fjalë, duke përfshirë dosjet, tenderët e dorëzuara, kopje të faturave të depozitave, çdo letër të motivuar, raportin e analizës, etj. Drejtori i dërgon të gjithë dokumentacionin e lidhur me çështje apelimi kryetarit të **Bordit të Apeleve**, i cili më pas vijon ashtu siç parashikohet në Pjesën XIII. Drejtori ose shefi i autoritetit kontraktues botojnë një kopje të vendimit të Bordit të Apeleve në departamentin e tij/saj ose në ambientet e autoritetit kontraktues përkatës, sipas rastit. Kopje të vendimit i dërgohen tenderuesit ankimues, çdo personi të regjistruar, ose që ka interes të nënkuptuar dhe autoritetit kontraktues të përfshirë kur ai përmendet në Tabelën 2 e LN 177/2005.

Bordi i Apeleve mund të përdorë **ekspertë** për ndihmë për të kuptuar situatën. Departamenti i Kontratave nuk paguan asnjë kosto për përfshirjen e tyre. Ekspertët nga marrësit e kontratave, nga tenderuesit e zëmëruar, nga departamentet/subjektet relativisht përfituese paguhen nga palët përkatëse. Çdo vendim i Komitetit të Përgjithshëm të Kontratave (ose i një Komiteti të Posaçëm Kontratash) dhe çdo vendim i autoritetit kontraktues **bëhet publik** në Departamentin e Kontratave, ose në zyrën e autoritetit kontraktues para dhënies së kontratës. Letra për rrëzimin e kontratës depozitohet në përputhje me nënpikën (1) dhe bëhet publike jo më vonë se një ditë pune pas depozitimit të saj. Nuk ka **formularë model**, ose dokumente të detyrueshme për sistemin e rishikimit dhe ankesave të prokurimeve publike. Palët njoftohen me faks. Vendimet **botohen** në faqen e internetit të Departamentit të Kontratave (<http://www.contracts.gov.mt>). Vendimi përfundimtar i marrë nga Bordi i Apeleve Publike u shpërndahet të gjitha palëve të interesuara nëpërmjet faksit, ose e-mail-it.

16.7 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët dhe juristët e organeve të rishikimit të prokurimeve publike, si dhe juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit, ose subjektet kontraktuese në proceset e rishikimit i marrin **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e komunitetit në përgjithësi gjatë punës. Po ashtu çështjet teknike dhe financiare të prokurimeve publike trajtohen “gjatë punës” dhe nëpërmjet legjislacionit. Gjyqtarët dhe panelistët veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i marrin njohuritë e tyre për çështje ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike nëpërmjet juristëve dhe konsulentëve dhe nëpërmjet organizatave të tyre profesionale, të tilla si dhoma e tregtisë. Disa tenderues pengohet nga kostot e larta për të kërkuar rishikim gjyqësor (duke përfshirë përfaqësimin ligjor, kostot administrative, etj.). Në përgjithësi, oficerët kontraktues janë kompetentë në procedura dhe legjislacion. Gjithsesi, në pjesën më të madhe të rasteve merret ndihma e Prokurorit të Përgjithshëm. Qëndrimi i oficerëve kontraktues që merren me ankesat e tenderuesve ose që kërkojnë rishikim gjyqësor përshkruhet si normal dhe profesional, e që u jep ndihmë maksimale tenderuesve të pakënaqur me procedurën. Drejtori i Kontratave nxjerr **botim të përvitshëm** për çështjet e dëgjua nga Bordi i Apeleve të Kontratave Publike dhe nga Komiteti i Përgjithshëm i Kontratave. Çështje të prokurimeve publike diskutohen dhe në **konferenca dhe seminare** të organizuara nga Dhoma e Tregtisë dhe nga Ndërmarrja e Maltës. Nuk ka asnjë **shoqatë** kombëtare për të drejtën dhe politikën e lidhura me prokurimet publike. Kohët e fundit kanë filluar të organizohen trajnime në vendin e punës për zyrtarët e prokurimeve publike për Rregulloret e Prokurimeve Publike. Por, nuk janë organizuar ende trajnime specifike për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike. Ndikimi i vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë për proceset e rishikimit të prokurimeve publik është shumë e rëndësishme, por referencat tek vendimet ndodhin rrallë.

17. **Holanda**

Sistemi i rishikimit dhe ankesave të prokurimeve publike në Holandë (Vendet e Ulëta) bazohet në **rishikimin gjyqësor** në tri shkallë gjykimi në gjykatat civile. Sistemi zbatohet mbi kontrata brenda dhe jashtë fushës së zbatimit të Direktivave të KE-së. Sistemi zbatohet në të njëjtën mënyrë si për organet kontraktuese publike dhe për ndërmarjet. Në Holandë ekziston arbitrazhi dhe mekanizma të tjerë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

17.1 *Ankimimi tek autoritetet dhe subjektet kontraktuese*

Sistemi holandez bazohet në rishikimin gjyqësor. Por, nëse një tenderues dëshiron të ankohet vetëm për sjelljen e autoritetit kontraktues, ai/ajo mund të depozitojnë një ankesë tek vetë autoriteti, ose subjekti kontraktues. Nëse autoriteti kontraktues nuk e trajton në mënyrë të kënaqshme ankesën formale, atëherë tenderuesi mund t'i drejtohet Avokatit të Popullit (“Nationale Ombudsman”).

17.2 *Rishikimi gjyqësor*

Një tenderues që kërkon dëmshpërblim financiar, pezullimin e ekzekutimit të një kontrate ose të një procedure tenderimi ose anulimin e kontratës duhet të bëjnë padi në një **gjykatë civile**. Pezullimi i kontratës ose i procedurës së tenderit (masa të përkohshme) mund të kërkojë në **proceset paraprake** (ose proces të ndërmjetëm të përkohshëm) që trajtojnë çështjen në kuadrin e përkohshëm dhe afatshkurtër (procedura “kortgeding” ose procedura “voorlopige voorzieningen” procedure). Në shkallën e parë, çështja do të rishikohet nga një **gjykatë e shkallës së parë** (“rechtbank”). Vendimi i shkallës së parë mund të apelojë në **Gjykatën e Apelit** (“Hof”). Vendimi i Hof-it mund të apelojë në **Gjykatën e Lartë** (“Hoge Raad”). Në përgjithësi sistemi i gjykatave në Holandë rregullohet në Aktin e Parlamentit të quajtur “Wet op de Rechterlijke Organisatie”. Hoge Raad është gjykatë e përgjithshme e shkallës së fundit që rishikon vendimet e prokurimeve publike, e cila, ashtu si *rechtbank* dhe *Hof* plotëson kërkesat e ligjit, të parashikuara në vendimet *Dorsch* dhe *Salzman*. Garanci për pavarësinë e gjyqtarëve për të tria shkallët e gjykimit përfshijnë emërimin e përjetshëm, kualifikimet e gjyqtarëve (realizim i suksesshëm për gjashtë

vjet, ose një numër i caktuar vitesh pune në profesionin ligjor), financimin e rregulluar nga ligji (financimi vetëm nga qeveria), dhe detyrat dhe kompetencat që rregullohen nga ligji.

17.3 Arbitrazhi

Gjithsesi, të dyja palët e kanë të mundur që konfliktin e tyre ta çojnë para një paneli arbitrazhi ose para një organi tjetër që merret me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Parlamenti po diskuton një ligj të ri për të ndaluar arbitrazhin në konfliktet rreth përdorimit të rregullave për prokurimin e kontratave publike për të mbajtur të drejtat e tenderuesve në procedurat e prokurimeve. Nëse ky ligj nuk miratohet nga parlamenti, atëherë të gjitha konfliktet rreth përdorimit të rregullave për prokurimin e kontratave publike duhet të trajtohen vetëm nga gjykatat civile, siç përshkruhet më lart.

17.4 Mjetet efektive ligjore

Ka shumë mjete efektive ligjore në dispozicion, të cilat mund të përdoren nga sistemi holandez, si, për shembull, dëmshpërblimi, pezullim i një procedure tenderimi, përfundimi i procedurës së tenderimit, rifillimi i një procedure tenderimi, kualifikimi i tenderuesit për kontratën, pezullimi ose përfundimi i ekzekutimit të kontratës, etj. I takon tenderuesit të përcaktojë mjetin ligjor që kërkon në momentin që ai ose ajo bën padi në gjykatë dhe kur i çon kësaj të fundit provat për të mbështetur padinë. **Të gjitha vendimet dhe veprimet e autoritetit kontraktues (ose të autoritetit të prokurimit) mund të kundërshtohet**, madje edhe në rastet kur është përmbjllur kontrata. Baza ligjore është neni 162 “Boek 6, Burgerlijk Wetboek” (Kodi Civil) dhe “Wetboek van Burgerlijke Rechtsvordering” (Kodi i Procedurës Civile) dhe jurisprudenca (në një masë të konsiderueshme). Ligji i kodifikuar, në kombinim me jurisprudencën, është baza ligjore për autorizimin e një gjykate për të lënë mënjanë, ose për të pezulluar dhënien e një kontrate. Për pezullimin ose lënien mënjanë të dhënies së kontratës (**vendim paraprak**) kërkesat janë si më poshtë: një interes i konstatuar mirë (point d’intérêt), urgjenca dhe shkelja e ligjit. Gjykata **lë mënjanë** dhënien e kontratës (në mënyrë të përkohshme ose jo) vetëm nëse ajo arrin në përfundimin se ka pasur shkelje edhe nëse ajo është e mendimit se kjo shkelje duhet të kompensohet duke lënë mënjanë dhënien e vendimit. Përfundimi i kontratës mund **të anulohet** nga gjykata vetëm nëse shkelja e ligjit konsiderohet se lidhet me rendin publik (“ordre public”). Në rrethana të tjera gjykata e urdhëron subjektin e prokurimit të përfundojë kontratën, të mos përfundojë kontratën (me një palë të caktuar ose në përgjithësi), të mos e ekzekutojë kontratën, të fillojë një procedurë (tjetër) prokurimi, të pranojë një ndërmarrje në procedurë, të pranojë ofertën e një ndërmarrje si të pranueshme, etj. Ligji i kodifikuar, në kombinim me jurisprudencën, përbën bazën ligjore për **dëmshpërblimet**. Dëmshpërblimet mund të kërkojnë edhe në rast se vendimi nuk është lënë mënjanë. Kërkesat për këtë gjë janë: që ankimuesi të ketë vuajtur një humbje (materiale ose humbje tjetër), të ketë pasur shkelje ligji, të ekzistojë lidhja shkak-pasojë (në kuptimin që humbja duhet të jetë shkaktuar nga shkelja e ligjit) dhe të ketë përgjegjshmëri (“fajësi”). Jurisprudenca holandeze tregon se këto dëme mund të shkojnë shumë më tej se kostot e tenderimit. Ligji i kodifikuar dhe jurisprudenca përbëjnë bazën e masave të përkohshme. Gjykata ose paneli i arbitrazhit merr parasysh pasojat e mundshme të **masave të përkohshme** për të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin e publikut, dhe vendos që mos i japë këto masa kur pasojat e tyre negative i tejkalojnë përfitimet. Jurisprudenca tregon se gjykata ka të ngjarë të arrijë në një përfundim të tillë vetëm nëse një kontratë ekzekutohet plotësisht, ose thuhet plotësisht, kur fillohen procedurat para gjykatës. **Pagesat e gjobave** janë mundësi të përdorura në Holandë në mënyrë që të sigurohet se vendimi i gjykatës ushtrohet nga autoriteti, ose subjekti i prokurimit. Gama e madhe e mjeteve efektive ligjore të mundshme konsiderohet si pikë e rëndësishme e fortë e sistemit të mjeteve efektive ligjore të Holandës.

17.5 Procedura

Kodi i Procedurës Civile trajton të drejtën procedurale të gjykatave civile. Çdokush që pretendon një **point d’intérêt** mund të fillojë proceset. Pra, në këtë mënyrë nuk është e nevojshme që një individ ose një kompani të kenë bërë një ofertë, etj. Proceset mund të fillohen pa hyrë në proceset e prokurimit. Duhet të paguhet një **tarifë e përgjithshme gjykate** që shkon nga €26 deri në €4563. Shuma e saktë ndryshon në varësit të shkallës së gjykimit dhe të interesit financiar të lidhur me çështjen. Nuk ka tarifa në procedurën e

ankesave që lidhen me vetë subjektin kontraktues. Tarifat rregullohen me anë të ligjit. Kostot, përveç tarifave të gjykatave përfshijnë kostot e avokatëve, të përmbartesve dhe të ekspertëve, dhe ato mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Rezultati i proceseve ka ndikim mbi kostot e palëve. Nëse aplikuesi fiton për të gjitha argumentet, subjekti kontraktues duhet të paguajë kostot e plota të proceseve, duke përfshirë dhe tarifat e gjykatave dhe të avokatëve. Nëse gjykimi është në favor të secilës prej palëve, të dyja palët duhet të paguajnë pak a shumë të njëjtën pjesë kostoje. Gjykata vendos për kërkesa që lidhen me **këshillat e ekspertëve** të bëra nga palët dhe vendos se cila palë duhet të paguajë kostot përkatëse. Proceset e gjykatave për dëmshpërblime mund të nisen në çdo kohë brenda pesë vitesh pas ndodhjes ose njoftimit të shkeljes së ligjit. Proceset “me dyer të mbyllura” janë të mundshme nëse është e nevojshme të ruhet konfidencialiteti i biznesit. Po ashtu, gjykata mund t’u ndalojë palëve t’u japin informacion rreth proceseve palëve të tjera në rastet e proceseve me dyer të mbyllura (nenet 27 dhe 29 Wetboek van Burgerlijke Rechtsvordering). **Vendimet** jepen me dyer të hapur. Po ashtu, vendimet u shpërndahen palëve, botohen në faqen e internetit (kur ato nuk përmbajnë informacion konfidencial) dhe botohen në gazeta të ndryshme juridike (nëse në vendim përfshihet një pikë interesante ligjore). Përzullimi i procedurës së prokurimit duhet të kërkohej në mënyrë specifike si masë e përkohshme para gjykatës. Proceset e ndërmjetme vendosen brenda pak ditësh. Në procese normale gjyqësore, duhen disa javë për të filluar procesin, ndërsa proceset në vetvete mund të kërkojnë disa muaj (në varësi të argumenteve, vështirësisë së çështjes, shumës, ose gamës së këshillave të ekspertëve, kohës që i kërkojnë palët gjykatës për të parashtruar një argument, ose një provë, etj.). Pas fillimit të proceseve gjykatës i duhen pak javë deri sa të shpallë vendimin. Shpejtësia e proceseve të gjykatës shihet si një pikë e fortë e rëndësishme e sistemit të rishikimit dhe e mjeteve ligjore të parashikuara në legjislacionin holandez. Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar, por të madhe për shkak të një sistemi që përbëhet nga kodifikimi dhe nga jurisprudenca. Gjykata përdor një **formular** të posaçëm për të filluar proceset. Ky është model i përgjithshëm për të gjitha proceset (pavarësisht nëse proceset lidhen me prokurimet ose jo). Në parim, të gjitha vendimet e gjykatës janë publike dhe janë të disponueshme për të gjithë. Vendimet jepen në publik. Vendimet u shpërndahen palëve, botohen në internet dhe në gazeta të ndryshme juridike. Gjykata mund të bëjë përfundime bazuar në çështje të privacisë dhe konfidencialitetit. Shpesh ekzistojnë dhe versionet elektronike të shumë vendimeve, si për shembull në adresat www.rechtspraak.nl dhe www.jol.nl.

17.6 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët dhe juristët që përfaqësojnë tenderuesit, ose subjektet kontraktuese në procesin e rishikimit të prokurimeve publike i marrin gjatë **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike në veçanti dhe për të drejtën e komunitetit në përgjithësi si pjesë e studimeve të tyre universitare; si pjesë e trajnimeve vazhduese; trajnimeve profesionale; kurseve të ofruara nga qeveria, si për shembull kurseve të ofruara nga ministria e drejtësisë; kurseve të ofruara nga BE-ja dhe nga organizatat ndërkombëtare dhe gjatë eksperiencës së tyre të punës. **Qëndrimi i gjyqtarëve** ndaj interesit publik nga njëra anë, dhe ndaj interesave private të tenderuesve nga ana tjetër përshkruhet si i drejtë dhe i balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i marrin njohuritë e tyre për çështje ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike nëpërmjet juristëve dhe konsulentëve. Numri i proceseve lidhur me çështjet e prokurimeve është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Ekzistojnë disa arsye që i bëjnë tenderuesit të mos përzgjedhin proceset gjyqësore. Në përgjithësi çështjet e tyre nuk janë mjaftueshmërisht të forta (shkelja e rregullave nuk është e sigurt, ose është për gjëra të vogla). Disa tenderues duan të pengojnë procesin e prokurimeve publike dhe pjesa më e madhe e tenderuesve kërkojnë përfitime financiare nëpërmjet proceseve të rishikimit. Disa prej tyre pengohen nga kostot e larta për të kërkuar rishikim gjyqësor (duke përfshirë përfaqësimin ligjor, kostot administrative, etj.), ose nga kohëzgjatja e këtyre proceseve. **Botimet** dhe gazetat akademike që merren specifikisht me rishikimin dhe ankimin e prokurimeve publike përfshijnë “Tijdschrift voor Aanbestedingsrecht”, “Tijdschrift voor Bouwrecht”, “Tijdschrift voor Europees recht”, faqe të ndryshme interneti (të tilla si, www.Ovia.nl), “Nieuwsbrieven IOEA” dhe “Nieuwsbrieven Kenniscentrum Europa Decentraal”. Sektori privat organizon shumë **seminare dhe konferenca** për prokurimet publike. Po ashtu, universitete të ndryshme kanë kurse që merren me prokurimet publike. Këto kurse janë të hapura për të gjithë (jo vetëm

për studentët me kohë të plotë). Holanda ka një shoqatë kombëtare për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike, e cila quhet Nederlandse Vereniging voor Aanbestedingsrecht. Grupet kombëtare të interesit, të tilla si shoqatat e subjekteve ekonomike (VNO/NCW, MKB Nederland, Bouwend Nederland, etc.) llojnë dhe merren me informo për prokurimet publike. Ka edhe organizata formale dhe informale këshillimore, të tilla si Nederlandse Vereniging voor Aanbestedingsrecht, InnovatiePlatform, Regieraad Bouw, etj., që janë aktive në këtë fushë. Vendimet e GJED-së kanë ndikim mbi proceset e rishikimit, për shkak se ato janë pjesë e rregullave për prokurime publike. Organet e rishikimeve u referohen këtyre proceseve të rishikimit.

18. Polonia

Prokurimet publike në Poloni trajtohen nga Akti i datës 29 janar 2004, i ndryshuar (versioni i përkthyer në anglisht gjendet në adresën: http://www.uzp.gov.pl/english/PPL_29_January_04.doc), por Direktivat e reja të BE-së janë harmonizuar në ligjin e brendshëm nëpërmjet Aktit të datës 7 prill, 2006 (i cili ka hyrë në fuqi më 25 maj 2006). Sistemi i rishikimeve dhe i trajtimit të ankesave të prokurimeve publike në Poloni bazohet në një sistem të përzier rishikimi gjyqësor administrativ, quazi-gjyqësor dhe gjyqësor. Në sektorin e shërbimeve, rishikimi i vendimeve të prokurimeve bëhet vetëm për vlera mbi pragjet e BE-së. Aktori kryesor është **Zyra e Prokurimeve Publike** (më poshtë **ZPP**; Urząd Zamówień Publicznych, Al. Szucha 2/4, 00-582 Varshavë; telefon +48 22 458 77 77; faks: +48 22 458 77 00, E-mail: uzp@uzp.gov.pl, website: <http://www.uzp.gov.pl>), e cila përfaqëson një organ të pavarur qeveritar të krijuar që prej vitit 1995 me juridiksion mbi politikëbërjen dhe koordinimin në fushën e prokurimeve publike. Zyra është përgjegjëse dhe për botimin e Buletinit të Prokurimeve Publike, i cili është instrumenti reklamues për kontrata nën pragjet e KE-së, dhe për monitorimin e vendimeve të autoriteteve kontraktuese në sektorin klasik dhe në atë të shërbimeve (në rastin e fundit vetëm mbi pragjet e KE-së). Kryetari i ZPP-së emërohet me një mandat 5-vjeçar nga kryeministri pas një ftese për personat e interesuar për të aplikuar për pozicionin. ZPP-ja përbëhet prej një sekretariatit të kryetarit, departamentit ligjor, departamentit të kontrollit, departamentit të trajnimeve dhe të botimeve, bashkëpunimit ndërkombëtar, departamentit të studimeve dhe analizave, byrosë së apeleve dhe byrosë organizative dhe financiare. Për sektorin e shërbimeve mund të përdoret kontrolli jo-gjyqësor (mekanizmi i pajtimit në Direktivën 92/13). Nuk ka asnjë organ arbitrazhi që cilit i është besuar misioni i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në fushën e prokurimeve publike.

18.1 Rishikimi i vendimeve të prokurimit

Në lidhje me vlerën e vlerësuar të kontratës dhe para se të ketë përfunduar kontrata, mund të ketë tre faza rishikimi vendimesh për një procedurë tenderimi. Në **fazën e parë**, çdo person që është i interesuar në marrjen e kontratës (tenderues, kandidat, pjesëmarrës), të cilit i është cenuar ose ka të ngjarë t'i cenohet nga veprimi ose mos veprimi i palës kontraktuese sipas një mënyre, e cili, sipas mendimit të tij/saj, është në kundërshtim me Aktin e Prokurimit publik, ka të drejtën e depozitimit të një **ankimimi** (proteste) me shkrim për autoritetin kontraktues brenda shtatë ditësh nga dita në të cilën ai/ajo kanë marrë dijeni për shkeljen e pretenduar. Ka disa përjashtime për këtë rregull: 1) ankesat kundër njoftimeve të kontratave ose/dhe specifikimeve të kontratave në procedura të hapura depozitohen brenda shtatë ditësh në rast të kontratave nën pragjeve të KE-së, ose brenda 14 ditësh në rast të kontratave mbi pragjet e KE-së, duke filluar nga data në të cilën kontrata është botuar në Buletinin Kombëtar të Prokurimeve Publike (për kontrata nën pragjet e KE-së), ose në gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian (për kontrata mbi pragjet e KE-së) dhe/ose kur specifikimet e kontratës janë vendosur për konsultim nëpërmjet faqes së internetit të autoritetit kontraktues; 2) ankesat kundër specifikimeve të kontratës në procedura, të ndryshme nga procedura e hapur, do të depozitohen brenda shtatë ditësh nga data e marrjes së këtyre specifikimeve nga tenderuesi, dhe në çdo rast, jo më vonë se a) tre ditë para skadimit të afatit kohor për parashtrimin e tenderëve në rast të kontratave nën pragjet e KE-së dhe b) gjashtë ditë para skadimit të afatit kohor për parashtrimin e kërkesave për kontratat mbi pragjet e KE-së. Ankesa duhet të depozitohet para se të përfundojë kontrata. Ankimimet mund të bëhen nga shumë organizata (të tilla si dhomat e tregtisë, organizatat artizanale, institucionet e pavarura të shumë institucioneve [sipërmarrësit, arkitektët,

inxhinierët e ndërtimit, urbanistët], organizatat e punëdhënësve)] jo më vonë se data përfundimtare e dorëzimit të ofertave. Lista e institucioneve të përmendura më lart mund të ndryshohet nga kryetari i ZPP-së dhe botohet në Buletinin Kombëtar të Prokurimeve Publike. Ankesat trajtohen nga kreu i autoritetit kontraktues, ose nga një zyrtar i autorizuar i autoritetit. Autoriteti kontraktues lëshon një vendim të arsyetuar të ankesës brenda 10 ditësh nga marrja e saj. Mos aftësia e lëshimit të një vendimi brenda këtij afati kohor konsiderohet si rrëzim i ankimit. Faza e parë është procedura e vetme e rishikimit për kontratat, vlera e të cilave nuk e tejkalon shumën prej €60 000. Në lidhje me kontratat që kanë vlerë më të madhe dhe €60 000, ekziston një **fazë e dytë**. Personat që kanë depozituar ankimim tek autoriteti kontraktues mund të **apelojnë** vendimin para ZPP-së brenda pesë ditësh nga dhënia e vendimit të përmendur më lart, ose pas skadimit të afatit kohor brenda të cilit autoriteti kontraktues duhet të japë vendimin. Personat që nuk kanë bërë ankimim paraprak nuk janë të pranueshëm në proceset e ZPP-së. Shqyrtimi i një apeli është objekt i pagimit paraprak të një tarife regjistrimi. Apeli trajtohet nga një panel i zyrës, i përbërë nga tre arbitra të emëruar nga kryetari i ZPP-së. Arbitrit jo domosdoshmërisht janë juristë, ose ekspertë ligjorë. Disa prej tyre janë ekspertë në fusha të caktuara, si, për shembull, në ndërtim, ose në sistemin e teknologjisë dhe informacionit. Për çdo procedurë rishikimi caktohet një panel i veçantë arbitrazhi. Kjo mund të konsiderohet si dobësi e sistemit polak të rishikimit, pasi vendimet e nxjerra nga panelet e arbitrazhit zakonisht janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Megjithatë paneli duhet të zbatojë dispozitat e Procedurës Civile në Poloni në lidhje me arbitrazhin, dhe pse arbitrit nuk varen nga kryetari i ZPP-së, proceset para panelit nuk kanë lidhje me metoda të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, por janë pjesë e sistemit formal të rishikimit. Paneli nuk vendos *ultra petita* dhe ai duhet të nxjerrë një vendim brenda 15 ditësh nga data në të cilën i është bërë ankimimi ZPP-së. Në vitin 2005 në ZPP u dorëzuan 4094 apeline, nga të cilat 308 u tërhoqën, 1714 u pranuan, 1226 u rrëzuan, 440 u kundërshtuan dhe 406 nuk u shqyrtuan për shkak të mos pagimit të tarifës së regjistrimit. Mesatarisht, panelet e arbitrazhit lëshojnë vendim brenda 13 ditësh (të dhënat e vitit 2005). Në **fazën e tretë**, vendimi përfundimtar i panelit të arbitrazhit mund të kundërshtohet para një gjykate rajonale ose nga ankimesi i fazës së parë, ose nga vetë autoriteti kontraktues. Gjykatat rajonale janë organet e rishikimit të shkallës së fundit në çështje të prokurimeve publike. Juridiksioni territorial i gjykatës varet nga vendi ku gjendet autoriteti kontraktues. **Ankesa** duhet të parashtrohet nëpërmjet kryetarit të ZPP-së brenda shtatë ditësh nga dhënia e vendimit përfundimtar të panelit të arbitrazhit për palët. Më pas kryetari duhet t'i japë palës kundërshtare një kopje të ankesës dhe duhet t'ia dërgojë ankesën dhe dosjen e çështjes gjykatës kompetente brenda shtatë ditësh nga data e bërjes së ankesës. Pasi ka marrë ankesën, gjykata merr vendim sipas afateve kohore, por jo më vonë se pas një muaji (sipas ligjit të mëparshëm të prokurimeve publike deri në tre muaj) nga marrja e ankesës. Shkelja e afatit kohor nuk e bën vendimin të pavlefshëm. Mesatarisht, gjykatat rajonale lëshojnë një vendim brenda 2.73 muajsh (të dhënat e vitit 2005 sipas ligjit të mëparshëm të prokurimeve publike). Gjenden 45 gjykata rajonale të shpërndara në shumë qytete. Gjykatat rajonale janë organe të përhershme të cilat lëshojnë vendime detyruese dhe që përbëhen nga anëtarë të gjyqësorit, pavarësia e të cilëve garantohet nga Kushtetuta (neni 173 dhe 178). Sipas ligjit, çdo shtetas polak që është të paktën 29 vjeç, i cili ka eksperiencë të njohur në fushën e së drejtës mund të emërohet gjyqtar. Në vitin 2005, u depozituan 506 ankesa në gjykatat rajonale. Vetëm 12.5% e vendimeve të marra çuan në anulimin e vendimeve të marra nga panelet e arbitrazhit.

18.2 Mjetet efektive ligjore

Fillimi i një procedure rishikimi ka **efekt automatik pezullues** mbi procedurën vijuese të tenderimit nga faza e parë. Autoriteti kontraktues nuk e përmyll kontratën para se të përdoren të gjitha mjetet e disponueshme për mbrojtje ligjore, çfarë do të thotë që një gjykatë rajonale të ketë lëshuar një vendim për një ankimim kundër një apeli të panelit të arbitrazhit. Kontrata e përmyllur në shkelje të detyrimit të sipërpërmendur konsiderohet e pavlefshme. Gjithsesi, autoriteti kontraktues mund të përfundojë kontratën nëse kjo vendoset nga kryetari i ZPP-së me kërkesë të autoritetit dhe pasi janë marrë parasysh pasojat e mundshme të pezullimit mbi të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin publik. Autoriteti kontraktues ka po ashtu të drejtën të përfundojë në kontratë nëse ankimesi nuk e çon procesin në fazën e dytë ose të tretë. Nëpërmjet vendimit të tij përfundimtar, **paneli i arbitrazhit** mund l

të rrëzojë apelimin kundër vendimit të autoritetit kontraktues për ankesën paraprake; 2) të pranojnë apelimin dhe të urdhërojnë autoritetin kontraktues të lëshojë një akt ose të anulojë aktin e pretenduar; dhe 3) të anulojë aktin e autoritetit kontraktues. Rrethanat që ka të ngjarë të çojnë në anulimin e vendimit të dhënies së kontratës shqyrtohen nga paneli *ex officio*. **Gjykata rajonale** mund 1) të rrëzojë çështjen nëse kërkesa është e pajustificuar; 2) të ndërpresë proceset, çfarë do të thotë të ndalojë rishikimin e proceseve për arsye formale; dhe 3) të pranojë kërkesën dhe të ndryshojë vendimin e panelit të arbitrazhit. Në skenarin e tretë gjykata e shqyrton çështjen që nga fillimi dhe merr vendim për themelin e çështjes. Para se të japë vendimin përfundimtar dhe sipas kushteve të parashikuara në vendimin përfundimtar të përmendur në Aktin e Prokurimeve Publike, me kërkesë të autoritetit kontraktues, gjykata mund ta lejojë autoritetin kontraktues të përfundojë kontratën. Mjetet ligjore të përmendura më lart jepen nga të dyja organet e rishikimeve para përfundimit të kontratës. Anulimi i një kontrate të përfunduar është në juridiksionin e gjykatave rajonale. **Gjobat financiare** mund të vendosen nga një vendim administrativ i kryetarit të ZPP-së në çështjet e përmendura në nenin 200 të Aktit të Prokurimeve Publike (dhënie të parregullt e kontratës; paaftësia për të botuar një njoftim për kontratën; shmangie e parregullt e procedurës së tenderimit; lëshimi i akteve të caktuara pa pëlqim të mëparshëm të kryetarit të ZPP-së; ndryshimi i parregullt i një kontrate të përfunduar). **Dëmshtëpërblimet** mund të jepet në përputhje me rregullat e përgjithshme të Kodit Civil.

18.3 *Procedura*

Proceset para paneleve të arbitrazhit trajtohen nga Kodi i Procedurës Civile në lidhje me arbitrazhin. Proceset para gjykatave rajonale mbulohen nga dispozitat e këtij kodi në lidhje me apelimet. Depozitimi i një ankimi paraprak tek autoriteti kontraktues nuk është objekt i pagesës së tarifës administrative. Nga ana tjetër, fillimi i proceseve para panelit të arbitrazhit është objekt i pagesës së një tarife regjistrimi, shuma e të cilës varet nga vlera e kontratës (mesatarisht: 3138 PLN në vitin 2005). Para Aktit të 2006-ës, tarifa e regjistrimit nuk varet tek vlera e kontratës; d.m.th. tarifa është e njëjtë si për kontratat e mëdha dhe për kontratat e vogla. Sipas Aktit të vitit 2006, tarifa e regjistrimit në rast të kontratave mbi pragjet e KE-së është 20 000 PLN për kontratat e mallrave dhe shërbimeve, dhe 40 000 PLN për kontrata punimesh. Tarifa e regjistrimit në rast të kontratave nën pragjet e KE-së është 10 000 PLN për kontratat e mallrave dhe shërbimeve, dhe 20 000 PLN për kontratat e punimeve. Sipas Aktit të datës 28 korrik 2005 për kostot e gjykatave, fillimi i proceseve para gjykatave rajonale është objekt pagese të një tarife gjykate që shkon deri në 3000 PLN. Vlera relativisht e vogël e tarifave të aplikueshme konsiderohet si avantazh i madh i sistemit polak të rishikimit. Në fakt, tarifat e regjistrimit të aplikimeve ishin të ulëta para Aktit të 2006-ës, dhe mund të shtrohet pyetja a janë vërtetë kaq të ulëta tarifat e regjistrimit? Në fakt, tarifat janë rritur në mënyrë domethënëse për et ulur abuzimin e rekursit të masave të rishikimit. Nuk ka kosto të tjera të detyrueshme, por palët mund të duan të bëjnë rekurs për prezantimin ligjor. Mesatarisht, kostoja e përfaqësimit ligjor para paneleve të regjistrimit në vitin 2005 ishte rreth 694 PLN për autoritetet kontraktuese dhe rreth 1776 PLN për tenderuesit. Në parim, kostot në lidhje me proceset para organeve të rishikimit rumbursohen nga pala që humb. Nuk ka formularë model për parashtrimin e apeliimeve/animimeve, por ekziston një listë elementesh të detyrueshëm (të tillë si citimi i vendimit të kundërshtuar, përshkrimi i fakteve, masat që kërkohen, etj.). Në lidhje me proceset në gjykatat rajonale, janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Në lidhje me ekspertizën, panelet e arbitrazhit mund të caktojnë një ekspert nga lista e ekspertëve të gjykatave rajonale të Varshavës nëse njohuritë e specialistëve janë të nevojshme për të vlerësuar, ose për të përcaktuar faktet e çështjes. Në këtë rast, kostot e ekspertëve paguhën nga pala që e humb procesin. Nuk ka dispozita specifike në lidhje me proceset me fyer të mbyllura. Vendimet e paneleve të arbitrazhit dhe të gjykatave rajonale arsyetohen dhe shpallen në publik. Vendimet e gjykatave rajonale u njoftohen palëve pas kërkesës së këtyre të fundit brenda shtatë ditësh nga shpallja e vendimit. Vendimet e panelit të arbitrazhit u njoftohen menjëherë palëve. Vendimet më të rëndësishme botohen në faqen e internetit të ZPP-së.

18.4 *Kultura e mjeteve efektive ligjore*

Programet afatgjata të trajnimit dhe arsimimit organizohen nga ZPP-ja. Po ashtu, zyra, qoftë më vete, ose së bashku me organizata të tjera (publike ose private), realizojnë konferenca periodike trajnimi për gjyqtarët

dhe arbitrit, si dhe për autoritetet kontraktuese dhe subjekte të tjera të interesuara. Zyra organizon çdo vit një konferencë të madhe ndërkombëtare (megjithëse jo të gjitha konferencat merren me temën e mjeteve efektive ligjore). ZPP-ja ka qenë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të financuara nga KE-ja në lidhje me blerjet qeveritare, të tilla si PHARE 2002/2003. Faqja e internetit të ZPP-së është burimi fillestar dhe më i mirë i informacionit në fushën e politikës së prokurimeve në nivelin kombëtar dhe të BE-së. Tenderuesit, ose oficerët kontraktues mund të konsultohen me ekspertët e ZPP-së nëpërmjet zyrës së kontaktit të ZPP-së çdo ditë. Kompanitë private dhe konsulentët ofrojnë shumë seminare dhe ka shumë programe pas-universitare që përfshijnë lëndën e prokurimeve publike. Eksperienca në punë luan një rol të rëndësishëm në qëndrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për proceset e rishikimit. Në përgjithësi, gjyqtarët konsiderohen se kanë një këndvështrim të balancuar të interesave të përfshirë në një çështje prokurimi. Gjithsesi, jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar për shkak të një sistemi që përbëhet kryesisht nga interpretimi i të drejtës ekzistuese statusore. Qëndrimi i tenderuesve për proceset e rishikimit varet zakonisht në vlerën e përlogaritur të kontratës. Tenderuesit për kontrata me vlera të vogla janë më pak të njohur me ligjin e prokurimeve sesa tenderuesit që konkurrojnë për projekte të mëdha dhe kanë eksperiencë në blerjet qeveritare. Në disa raste, tenderuesit i fillojnë proceset me qëllimin e pengimit të vijimësisë së procesit të filluar të tenderimit. Në përgjithësi, familjarizimi me të drejtën e prokurimeve sigurohet kryesisht nga sektori privat. Agjencia Polake për Zhvillimin e Ndërmarrjeve (PAED) ka përgatitur dhe kurse në internet të cilat janë pa pagesë për tenderuesit e interesuar. Kompetenca e oficerit kontraktues në fushën e të drejtës së prokurimeve varet nga niveli në të cilin autoriteti kontraktues blen mallra dhe shërbime. Për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të nxitur profesionalizmin, oficerët marrin pjesë në kurse që ofrohen nga institucione të ndryshme, por nuk ekziston një trajnim zyrtar për prokurimet publike. Oficerët kontraktues duhet të respektojnë Aktin e Prokurimeve Publike, por nuk duket se i inkurajojnë proceset e rishikimit. Ekziston një gamë e madhe e botimesh zyrtare të lidhura me ligjin e prokurimeve, të tilla si komentet zyrtare për Aktin e Prokurimeve Publike, udhëzimet dhe rekomandimet për praktikën më të mira të nxjerra nga ZPP-ja, etj. Pjesa më e madhe e tyre mund të gjenden online (në faqen e internetit të ZPP-së). Ka edhe gazeta juridike profesionale të specializuara në këto çështje, të tilla si “Zamówienia Publiczne Doradca”, “Monitor zamówień publicznych” dhe “Prawo Zamówień Publicznych”. Nuk ka asnjë shoqatë kombëtare zyrtare për prokurimet, por ka organizata të shumta tregtare, të tilla si “Ogólnopolskie Stowarzyszenie Konsultantów Zamówień Publicznych” (Shoqata Kombëtare Polake e Konsulentëve për Prokurimet Publike), ose “Polski Związek Rzeczoznawców Zamówień Publicznych” (Unioni Polak i Ekspertëve për Prokurimet Publike), të cilat shpesh luajnë rol këshillimor në këtë aspekt. Shoqëria civile luan një rol më aktiv në zhvillimin e rregullave të prokurimeve publike, në veçanti nëpërmjet opinioneve që jepen nga organe të ndryshme profesionale, të tilla si “Polska Izba Informatyki i Telekomunikacji” (Dhoma Polake e Teknologjisë së Informacionit dhe e Telekomunikacioneve), “Stowarzyszenie Architektów Polskich” (Unioni i Arkitektëve të Polonisë) dhe “Stowarzyszenie Kosztorysantów Budowlanych” (Shoqata e Vlerësuesve të Ndërtimit). Ndikimi i vendimeve të GJED-së është i rëndësishëm, në veçanti që prej pranimit të Polonisë në BE. Polonia ka dërguar dy herë vëzhgime me shkrim para GJED-së (çështjet C-220/05, Jean Auroux dhe C-410/04, ANAV), por nuk ka pasur referime nga gjykatat e brendshme sipas parashikimit të nenit 234 të KE-së. Vëmendja e Komisionit Europian është tërhequr për pesë çështje polake (mos zbatimi i Direktivave të Prokurimeve të KE-së, sjellje diskriminuese për blerje kompjuterësh, dhe moszbatimi i procedurave të zbatueshme të tenderimit). Këto çështje po diskutohen në fazën formale. Para GJED-së nuk është çuar asnjë çështje në përputhje me nenin 226 të KE-së. Qeveria polake po shqyrton disa propozime për ndryshime me synimin e racionalizimit të sistemit aktual të rishikimit. Në veçanti, ndryshimet më domethënëse përfshijnë: 1) krijimin e një organi unik profesional arbitrazhi që zëvendëson panelet ekzistuese të arbitrazhit; dhe 2) krijimin e një gjykate të specializuar rishikimi që merr përsipër detyrën që aktualisht i është besuar 45 gjykatave rajonale. Qëllimi i ndryshimeve të sugjeruara është zgjerimi i mundësive për zgjidhjen homogjene të mosmarrëveshjeve, pasi në sistemin që është aktualisht në fuqi vendimet e organeve të rishikimit në përgjithësi janë të ndryshme nga njëri-tjetri.

19. Portugalia

Sistemi i rishikimit dhe i ankimimit të prokurimeve publike në Portugali bazohet në **rishikimin gjyqësor në dy nivele në gjykatat administrative**. Kjo zbatohet për kontrata nën dhe mbi pragjet e KE-së. Por, pjesa më e madhe e çështjeve duket se zgjidhen në fazën para kontraktuese. Portugalia ka sistem ligjor tradicional të shkruar, i cili konsiderohet si mjedisi i përshtatshëm për kërkimin e mjeteve efektive ligjore nga tenderuesit. Procedura plotësohet nga një sistem modern dhe i hapur administrativ. Qytetarët kanë akses në dokumente dhe procedura që i prekin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sistemi të jep mundësinë e ankimimit të çdo vendimi administrativ.

19.1 Ankimimi tek autoriteti kontraktues

Tenderuesit mund të bëjnë ankesë drejtpërsëdrejti tek **autoriteti kontraktues** përkatës, ose tek eprorët e tyre (recurso hierárquico facultativo) në çdo etapë të procedurës deri në dhënien e kontratës. Ky rishikim administrativ (ekzekutiv) me dy nivele është forumi kryesor i rishikimit në praktikë. Por, ai nuk është parakusht i detyrueshëm për rishikimin gjyqësor të përshkruar më poshtë. Tenderuesit mund të bëjnë ankimim të drejtpërdrejtë dhe mund të hapin proces gjyqësor në të njëjtën kohë.

19.2 Rishikimi gjyqësor

Tenderuesit mund të hapin procese për rishikim gjyqësor në lidhje me kontratat e prokurimeve publike nën dhe mbi pragjet e Be-së në **gjykatat administrative**, ose në gjykatat e shkallës së parë. Në çdo distrikt të Portugalisë ka gjykatë administrative. Vendimet e gjykatave administrative mund të apelojnë në **Gjykatën e Lartë Administrative** në Lisbonë në shkallën e dytë dhe të fundit të gjykimit. Këto gjykata administrative janë të pavarura nga ekzekutivi, administrata, ose nga ndonjë pjesë e qeverisë, dhe vendimet e tyre kanë natyrë detyruese. Të gjitha gjykatat janë krijuar mbi bazën e Kushtetutës dhe të akteve të parlamentit dhe plotësojnë kërkesat e gjykatës të parashikuara në vendimet *Dorsch* dhe *Salzmann*, në përjashtim të faktit se procedura e tyre nuk është *inter partes*. Gjyqtarët duhet të jenë juristë me eksperiencë dhe të njohur. Ata emërohen sipas një procedure të zakonshme. Kushtetuta dhe ligjet e tjera garantojnë pavarësinë e gjyqtarëve. Anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative si dhe kryetari i kësaj gjykate i cili përzgjidhet ndërmjet tyre duhet të jenë juristë shumë të kualifikuar. Në praktikë, ka pak raste të vendimeve për rishikimin gjyqësor të prokurimeve. Mund të përdoret **procedura e arbitrazhit** e kryer nga panele me një vete e të ngritura rast pas rasti, me kusht që dokumentet e tenderit ta kenë përcaktuar këtë opsion. Dy gjyqtarë zgjidhen nga palët, ndërsa gjyqtari i tretë përzgjidhet nga gjyqtarët e tjerë. Vendimi i panelit është i detyrueshëm vetëm për palët dhe është objekt i procedurës së ankimimit. Po ashtu, vendimi i arbitrazhit nuk e përjashton një tenderues nga fillimi i proceseve para gjykatës administrative. Ekziston dhe **procedura e pajtimit** për ndërmarrjet e krijuara sipas DL nr. 223/2001, datë 9 gusht, por kjo procedurë nuk e përjashton të drejtën e fillimit të proceseve para gjykatave administrative.

19.3 Mjetet efektive ligjore

Mjetet efektive ligjore përfshijnë anulimin e vendimeve të prokurimit, anulimin e të gjithë procedurës së prokurimeve, një urdhër për të rifilluar procedurën dhe dëmet. Që prej vitit 2003 ka qenë e mundur të anulohen kontratat vjetore të përmyllura. Vendimet individuale të prokurimeve mund të kundërshtohen deri në pesë ditë pas marrjes së tyre. Vendimi për dhënien e kontratës mund të kundërshtohet deri pas dhjetë ditësh pas marrjes së vendimit; pas kësaj kontrata nënshkruhet. Proceset kundër një vendimi për dhënie kontrate para një gjykate administrative pengojnë nënshkrimin e një kontrate. Të gjitha mjetet ligjore parashikohen në ligjin administrativ. Në mënyrë që të anulohet një procedurë, ose një kontratë ajo duhet të jetë e paligjshme për shkak të shkeljeve shumë të mëdha të ligjit, si për shembull shkelje e parimit të ligjshmërisë (kur një subjekt vepron *contra legem*). Gjykata administrative mund të përcaktojë pezullimin e vendimit ose të procedurës (Ligji 15/2002, datë 18/02/2003 – Código de Processo nos Tribunais Administrativos) mbi bazën e Decreto Lei 197/99, datë 8/06, Kodi i Procedurës Administrative dhe Kodi i Procedurës së Gjykatës Administrative. Kërkesat janë që kërkesa e tenderuesit të jetë arsyeshmërisht e pranueshme si e vlefshme dhe që ai/ajo të argumentojnë se interesat e tij/saj do të komprometohen seriozisht nëse pezullohet procedura. Në rastet e **mbizotërimit të interesit publik**,

gjykata administrative nuk e pezullon procedurën. Parimi i përgjegjshmërisë së shtetit për vendimet ligjore i përcaktuar në të drejtën administrative dhe në të drejtën civile përbën bazën e dhënies së dëmshpërblimeve. Tenderuesi duhet të provojë shkelje serioze. Normalisht kostot e tenderit rimbursohen, por është e vështirë të prodhohen provat për kompensimin e fitimeve të humbura.

19.4 Procedura

E drejta procedurale përkatëse parashikohet në Kodin e Procedurës për Gjykatën Administrative (Código de Processo nos Tribunais Administrativos). Gjykata mund të pranojë kërkesën për pjesëmarrje të ekspertëve teknikë, të cilët paguhen nga pala që ka bërë kërkesën. Po ashtu, gjykata mund të vendosë të përfshijë ekspertët dhe të mbulojë kostot e tyre. Çdo palë e interesuar në procedurë mund të fillojë procedurat, por pala duhet të provojë kapacitetin e tij/saj. Normalisht është e nevojshme që pala të ketë qenë kandidat për kontratën në fjalë. Procesi duhet të hapet brenda një muaji pas kohës që tenderuesi është vënë në dijeni të vendimit në fjalë. Pala që e humb procesin mbulon kostot e gjykatës dhe të palës që fiton. Portugalia ka sistem ligjor të kodifikuar, ndërsa jurisprudenca përdoret vetëm për interpretim, duke mos ekzistuar rregulli i precedentit. Nuk përdoren formularë model. Palët njoftohen rregullisht për vendimet, të cilat më pas botohen.

19.5 Kultura e rishikimit

Gjyqtarët, juristët dhe tenderuesit i marrin **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike në gjatë studimeve të tyre universitare në lëndët e të drejtës kushtetuese dhe të drejtës administrative. Gjyqtarët ndjekin “*magistratura judicia*”, e cila është një rrugë e veçantë e trajnimit ligjor specifike për gjyqtarët dhe e ndarë nga kurrikula e avokatëve. Gjyqtarët, juristët dhe tenderuesit i marrin njohuritë sesi funksionojnë prokurimet publike në praktikë si pjesë të studimeve të tyre universitare, trajnimet profesionale, arsimet vazhdues dhe trajnimet e ndryshme të organizuara nga qeveria, BE-ja, organizatat ndërkombëtare dhe “*gjatë punës*”. **Qëndrimi** i gjyqtarit ndaj interesave të përfshira varen nga situata, nga çështja dhe nga gjyqtari individual. Ka ekspertë shumë kompetentë dhe të drejtë, po ashtu siç ka dhe persona që nuk janë të ndjeshëm ndaj interesit të publikut. dhe panelistët veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i marrin njohuritë e tyre për çështje ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike nëpërmjet juristëve dhe konsulentëve dhe nëpërmjet organizatave të tyre profesionale, të tilla si dhoma e tregtisë. Disa tenderues nuk duan të fillojnë proceset e rishikimit pasi nuk duan të cenojnë mundësitë për kontrata pasuese; disa të tjerë i konsiderojnë proceset e rishikimit si mjete të fundit; të tjerë pengohet nga kostot e larta për të kërkuar rishikim gjyqësor (duke përfshirë përfaqësimin ligjor, kostot administrative, etj.), ose nga tarifat e larta të gjykatave, të tjerë tenderues pengohen nga kohëzgjatja e proceseve. Disa **oficerë kontraktues** i kanë marrë njohuritë e tyre për aspektet ligjore dhe aspekte të tjera të prokurimeve publike në universitete; disa prej tyre kanë marrë pjesë në trajnime të jashtme dhe të brendshme. Përvoja e marrë nga kolegët e tyre është po ashtu një instrument goxha i dobishëm. Nuk ekzistojnë gazeta të posaçme akademike, por ligji i prokurimeve publike diskutohet gjerësisht në konferenca dhe seminare profesionale. Portugalia nuk ka një shoqatë kombëtare për prokurimet publike. Gjykatat janë të vetëdijshme për rëndësinë e vendimeve të GJED-së dhe i përdorin gjerësisht vendimet e saj në vendimmarrjen e tyre.

20. Rumania

Prokurimet publike në Rumani trajtohen në Urdhëresën Urgjente nr. 34/2006, e cila hyri në fuqi më 30 qershor 2006 (ka edhe dispozita të tjera shtesë në lidhje me prokurimet elektronike: <http://www.e-licitatie.ro>). Sistemi i rishikimit dhe trajtimit të ankesave bazohet në kontrollin quazi-gjyqësor dhe në kontrollin gjyqësor. Ky sistem mund të ndahet në **ankesa para dhe ankesa pas** përfundimit të një kontrate. Procesi i **dëmshpërblimeve** është i pavarur dhe mund të kërkohej para ose pas përfundimit të një kontrate. Në të gjitha rastet, mbrojtja gjyqësore nuk varet nga vlera e përlllogaritur e kontratës. Për tenderuesit është e detyrueshme të ankimojnë formalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë tek autoriteti kontraktues si parakusht për kërkimin rishikimit. Çdo vit ka mesatarisht 700 aplikime kundër

akteve të autoriteteve kontraktuese. Megjithëse aplikimet shpesh përfundojnë me rezultate të dëshirueshme për tenderuesit e pakënaqur, vetëm 1% e akteve të prokurimeve rishikohen çdo vit.

20.1 Rishikimi gjyqësor

Para se të përfundojë një kontratë, tenderuesit mund të bëjnë rekurs ose në **Këshillin Kombëtar për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve** (më poshtë këshilli), ose tek **gjykatat administrative**. Tenderuesit mund të kundërshtojnë çdo akt, duke përfshirë dhe paaftësinë ose refuzimin e nxjerrjes së një akti në lidhje me një procedurë dhënie të kontratës. Këshilli është krijuar nëpërmjet Urdhëresës Urgjente të Qeverisë nr. 34/2006 (Kreu IX). Ai ka kompetenca administrative dhe juridiskionale. Këshilli është veçanërisht kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore para përfundimit të një kontrate, për dhënien e opinionëve për ligjshmërinë dhe përputhshmërinë me procedurat e dhënies së kontratës të deklaruara nga autoriteti kontraktues (e cila është një procedurë e ngjashme me mekanizmin e vërtetimit) dhe për dhënien e mendimeve për mosmarrëveshjet e dërguara në gjykatat administrative nga tenderuesit e pakënaqur. Anëtarët e këshillit janë nëpunës publik me status të posaçëm (pavarësi, procedurë përzgjedhje dhe emërimi, mospërputhshmëritë dhe ndalimet, pagat) dhe me eksperiencë në fushën e së drejtës së prokurimeve. Vendime të këshillit janë të detyrueshme për palët dhe mund të apelojnë në Gjykatën e Apelit që gjenden në zonën e autoritetit kontraktues. Gjykata e Apelit është organ i përhershëm i krijuar sipas ligjit dhe është e pavarur nga ekzekutivi, nga administrata, apo çdo pjesë tjetër e qeverisë. Vendimet e saj merret mbi bazën e rregullave ligjore dhe janë të detyrueshme *inter partes*. Në përbërje të Gjykatës së Apelit është një panel i specializuar që merret me trajtimin e çështjeve të apelitit të vendimeve. Vendimet e marrë nga ky panel nuk mund të apelojnë. Pas përfundimit të një kontrate, tenderuesit e pakënaqur mund t'i drejtohen gjykatës, në përputhje me Ligjin 544/2004 për çështjet administrative. Paditë për dëme mund t'i dërgohen një gjykate vetëm në përputhje me Ligjin 544/2004 për çështje administrative, pavarësisht nëse mosmarrëveshja ka ndodhur para ose pas nënshkrimit të kontratës.

20.2 Mjetet efektive ligjore

Aplikimet tek këshilli kanë efekt pezullues. Më tej, këshilli ka të drejtë të 1) anulojë plotësisht ose pjesërisht aktin e autoritetit kontraktues; 2) urdhërojë autoritetin kontraktues të respektojë detyrimin ose të lëshojë një akt; 3) marrë masa të mëtejshme që konsiderohen të nevojshme për ndreqjen e shkeljes së ligjit të prokurimeve publike të kryer nga autoriteti kontraktues; 4) anulojë ose rifillojë procedurën e dhënies së kontratës në kuadrin e fakteve për një çështje të re; 5) vërë gjobë kundër zyrtarëve të lartë të autoritetit kontraktues për të siguruar zbatimin e masave të marra ose të vendimeve të lëshuara dhe 6) rifillojë procedurën e dhënies së kontratës nëse aplikimi rrëzohet për shkak të mungesës së shkaqeve. Vendimet e këshillit janë të detyrueshme për palët dhe mund të zbatohen nëpërmjet një **gjobe** (shih pikën 5 më lart). Nëse autoriteti kontraktues nuk e merr parasysh vendimin dhe vazhdon me nënshkrimin e kontratës, kontrata konsiderohet e pavlefshme. Aplikimet në gjykatat administrative para nënshkrimit të një kontrate nuk kanë efekt pezullues. Gjithsesi, aplikuesi mund të kërkojë pezullimin e procedurës së dhënies së kontratës. Këshilli ose gjykatat mund të marrin parasysh pasojat e mundshme të masave që kërkohen për të gjitha masat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë dhe interesin e publikut dhe mund të vendosin të mos i japin këto masa kur pasojat e tyre negative janë më të mëdha se përfitimet që mund të merren prej tyre. Para ose pas përfundimit të kontratës, **dëmshpërblimet** duhet të jepen nga një gjykatë administrative sipas këtyre kushteve: 1) konstatim i shkeljes së një procedure tenderimit lidhur me një tender; 2) akti i pretenduar është akt administrativ; dhe 3) aplikuesi ka qenë subjekt i humbjes materiale ose morale.

20.3 Procedura

Në përgjithësi, çdo person që është i mendimit se i janë cenuar të drejtat e tij/saj, ose që kanë interes të legjitimuar në një akt të autoritetit kontraktues që mendohet si i paligjshëm gëzon të drejtën e kërkimit të rishikimit qoftë në këshillit ose në gjykatë. Në rast të ankimit për dëme, aplikuesi duhet të provojë se 1) janë shkelur dispozitat përkatëse të legjislacionit; 2) ai/ajo kishin mundësi reale të fitonin kontratën; dhe 3) shkelja e pretenduar e ka penguar atë nga mundësia e fitimit të kontratës. Proceset para këshillit dhe gjykatës parashikohen përkatësisht në Urdhëresën Urgjente nr. 34/2006 dhe Ligjin 544/2004 për çështjet

administrative. Një procedurë para këshillit fillon me një aplikim që dërgohet nga tenderuesi i interesuar. Aplikimi duhet të bëhet brenda dhjetë ditësh që prej momentit kur tenderuesi është vënë në dijeni të aktit që mendohet si i parregullt prej tij/saj. Aplikimi duhet të përmbajë emrin dhe adresën e aplikuesit, objektin e mosmarrëveshjes, subjektin e procedurës së tenderimit, shkaqet faktike dhe ligjore dhe provat (nëse ka). Aplikimi duhet të nënshkruhet e të shoqëroret nga dokumente plotësuese, nëse ka. Një kopje e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur duhet t'i dërgohen autoritetit kontraktues. Procedura e dhënies së kontratës pezullohet automatikisht që në momentin e njoftimit. Autoriteti kontraktues duhet të lëshojë një opinion me shkrim në lidhje me mosmarrëveshjen. Opinioni i dërgohet këshillit, ndërkohë që aplikuesi njoftohet për këtë akt. Më pas këshilli urdhëron autoritetin kontraktues të dërgojë dosjen e prokurimit. Proceset zhvillohen me shkrim. Palëve mund t'u jepet mundësia të shprehen (e të dëgjohen) nëse një vendim i tillë merret prej këshillit. Më tej, këshilli mund të administrojë prova administrative dhe mund t'u kërkojë palëve të japin shpjegime me shkrim rreth çështjeve dhe të japin informacion të mëtejshëm për të përcaktuar faktet. Ai mund t'i kërkojë dhe një ekspert të pavarur të japë mendimin e tij për çështjen (në veçanti për çështje teknike dhe financiare). Kohëzgjatja e ekspertizës nuk e kalon afatin kohor brenda së cilit këshilli duhet të arrijë vendimin. Kostot e ekspertëve paguhen nga pala që kërkon aktin e ekspertizës. Proceset nuk duhet ta kalojnë afatin prej dhjetë ditësh që prej kohës së transferimit të dosjes së prokurimit tek këshilli. Në raste të justifikuar, ky afat kohor mund të shtyhet për 20 ditë të tjera. Vendimet duhet të jenë të arsyetuara. Ata u njoftohen palëve dhe mund të gjenden në internet. Nuk paguhen tarifa. Nëse kërkohet, këshilli mund të urdhërojë palën që e humb procesin të paguajë shpenzimet procedurale të palës tjetër.

20.4 Kultura e rishikimit dhe e mjeteve efektive ligjore

Gjyqtarët dhe juristët e organeve të rishikimit të prokurimeve publike i marrin **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike gjatë eksperiencës profesionale, ose gjatë seminareve të organizuara nga institucionet shtetërore. Gjyqtarët dhe panelistët veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të balancuar. Tenderuesit mund të jenë njohur me eksperiencën e tenderimit nëpërmjet punës së tyre të përditshme. Po ashtu ata mund të ndihmohen nga juristë dhe konsulentë, ose nga organizatat përkatëse profesionale. Gjithsesi, në përgjithësi tenderuesit nuk duan të përfshihen në çështje rishikimi të prokurimeve për të mos kompromentuar mundësitë e tyre për të ardhmen. Disa tenderues i përdorin procedurat e rishikimit vetëm për të bllokuar proceset e prokurimeve. Në përgjithësi proceset e rishikimit zgjasin shumë në kohë, e konsiderohen si zgjidhje e fundit. Kjo është arsyeja pse është krijuar Këshilli Kombëtar për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ligjore. Proceset në këtë organ janë pa pagesë dhe pritet të jenë të shpjgjeta. Për shkak se ky është organ i krijuar rishtazi, nuk është përcaktuar ende nëse ky subjekt do të respektojë efektivisht afatet kohore brenda të cilave ajo duhet të marrë një vendim. Jurisprudenca nuk është e zhvilluar. Organizohen shumë seminare si nga sektorët publikë dhe nga ata privatë, dhe ndonjëherë organizohen dhe konferenca për këtë temë. Nuk ka as botim të specializuar dhe as shoqatë kombëtare për prokurimet publike. Trajnimi i zyrtarëve të prokurimeve sigurohet nga Instituti Kombëtar i Administrimit. Ndikimi i vendimeve të GJED-së ende nuk mund të vlerësohet.

21. Republika e Sllovakisë

Sistemi i rishikimit dhe ankimimit të prokurimeve publike në Republikën e Sllovakisë mund të ndahet në **tri faza**: së pari, rishikimi nëpërmjet autoritetit, ose subjektit kontraktues në fjalë; së dyti, rishikimi jo-gjyqësor nëpërmjet divizionit të rishikimit të Zyrës për Prokurimet Publike (ZPP); dhe, së fundmi, rishikimi gjyqësor nëpërmjet gjykatave të zakonshme. Ky sistem parashikohet nga Titulli i Katërt i Aktit të Prokurimit Publik (APP), Akti i Parlamentit/Ligji: 25/2006 Coll. www.uvo.gov.sk. Nuk ka rregullime specifike për shërbimet. Përgjithësisht ekzistojnë vetëm dallime të vogla ndërmjet kontratave mbi të cilat zbatohen Direktivat e KE-së dhe kontratave mbi të cilat nuk zbatohen këto Direktiva. Sipas nenit 140 të PPA, kontratat nën pragje quhen kontrata “nën kufi”. Sipas nenit 4, kontratat e prokurimeve publike janë nën prag dhe kontratat me vlerë të vogël nuk janë objekt ankimimi sipas PPA-së, por ato janë objekt i kontrollit të brendshëm pa paragjykuar kompetencat mbikëqyrëse të ZPP-së.

21.1 *Autoriteti kontraktues*

Sipas nenit 136 (1) të PPA-së, procedura e rishikimit mund të fillohet nëpërmjet një komunikimi ndërmjet tenderuesve, ose një personi tjetër i cili beson se të drejtat e tij/saj janë cenuar, ose mund të ishin cenuar nga autoriteti, ose subjekti kontraktues në formën e një “kërkese për rishikim” të lidhur me faktet ose vendimet e autoritetit, ose subjektit kontraktues. Është e **detyrueshme** për tenderuesit t’i ankohen zyrtarisht autoritetit ose subjektit kontraktues, pasi ky hap përbën parakusht për të kërkuar më tej rishikimin e procedurës: neni 138 (1) i PPA-së.

21.2 *Rishikimi jo gjyqësor*

Nëse kërkesa për rishikim drejtuar për autoritetin, ose subjektin kontraktues nuk është pranuar prej këtij të fundit brenda afateve kohore të parashikuara, tenderuesi ose personi tjetër që beson se i janë prekur, ose mund t’i ishin prekur të drejtat e tij/saj mund të bëjnë ankim në **ZPP**, duke kërkuar heqjen e parregullsisë brenda objektit shterues të dhënë në nenin 138 (2) e APP-së. ZPP-ja është pjesë e qeverisë. Anëtarët e saj nuk kanë status të krahasueshëm me statusin e gjyqtarëve. ZPP-ja u krijuar në vitin 2000, pas hyrjes në fuqi të APP-së. Në vitin 2005 u bënë 1089 ankimime, duke përfshirë 83 ankimime nga jashtë dhe 108 që lidhen me kontrata mbi pragjet e KE-së (deri në 50% në krahasim me vitin 2004). Zyra ka dhënë 500 vendime *in merito* për animimet para nënshkrimit të kontratave dhe nëntë vendime pas nënshkrimit të kontratave (sipas Aktit të Prokurimeve Publike të 2006-ës, ankimimet pas përmbylljes së kontratës nuk janë më të pranueshme). Dyzet e katër për qind e vendimeve ishin në favor të aplikuesve dhe 56% u rrëzuan si të pabazuara. Procesi u ndërpre për 578 ankimime të depozituara. 18 vendime të ZPP-së u kundërshtuan në gjykatë (shih më poshtë). Mbikëqyrja u përqendrua kryesisht në përdorimin e paligjshëm të procedurës së negociuar pa njoftim paraprak. Në totalin prej 856 procedurash për dhënie kontratash u deklaruan 489 shkelje të ndryshme të ligjit. Shuma e përgjithshme e gjobave të vëna në vitin 2005 është SKK 25 318 492 (21 autoritet kontraktuese dhe një subjekt kontraktues).

21.3 *Rishikimi gjyqësor*

Gjykatat e zakonshme shërbejnë si shkalla e tretë dhe e fundit e gjykimit për rishikimin e vendimeve për prokurimet publike. Vendimet e ZPP-së mund të apelohe në **Krajský súd** në Bratislavë (**Gjykata rajonale** në qytetin e Bratislavës) dhe në **Najvyšší súd** (**Gjykata e Lartë** e Republikës së Sllovakisë).

Pavarësia e gjyqësorit garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Sllovakisë. Kërkesat në lidhje me emërimin e kryetarit ose presidentit, ose të anëtarëve e tjerë të këtyre gjykatave parashikohen në legjislacionin përkatës dhe në Urdhrat e Procedurave. Të dyja gjykatat plotësojnë kërkesat e vendimeve *Dorsch* dhe *Salzmann*. Këto gjykata mund të rishikojnë vendimet e ZPP-së të cilat pezullojnë dhënien e kontratave për shkak të një shkelje të ligjit, e cila mund të ketë pasur ndikim të madh mbi rezultatin e procedurës së dhënies së kontratës (p.sh., mos realizimi i të paktën një kushti mbi bazën e të cilit mund të justifikohet përdorimi i procedurës jo konkurruese për dhënien e kontratave). Në vitin 2005 ka pasur seanca dëgjimore për pjesën më të madhe të çështjeve të filluara në vitin 2004. 30 vendime të gjykatës së shkallës së parë iu dërguan ZPP-së. Në 25 çështje u rrëzuan akuzat, ose për to përfunduan afatet e proceseve. Në tri çështje (nga numri i përgjithshëm i pesë çështjeve) për të cilat vendimi nuk ishte në favor të ZPP-së, ZPP-ja ankimoi në gjykatën e shkallës së dytë. Në çështjet e vendosura nga gjykata e shkallës së parë në favor të zyrës u filluan 11 apeline në gjykatën e shkallës së dytë. Në dhjetë çështje, vendimet iu çuan zyrës nga gjykata e shkallës së dytë.

21.4 *Mjetet efektive ligjore*

Para përfundimit të një kontrate ZPP-ja mund të marrë vendimet e parashikuara në nenin 139 (2) të APP-së. ZPP-ja mund të **urdhërojë anulimin** e procedurës së kontratës së dhënies, ose të projektimit të konkursit në bazë të kushteve diskriminuese në të gjitha dokumentet e tenderit, njoftimet e kontratave, etj.; mund të marrë vendimin për përjashtimin e një tenderuesi dhe mund të urdhërojë përfshirjen e tij/saj; mund të merret me përzgjedhjen e kandidatëve dhe mund të urdhërojë ripërzgjedhjen; si dhe mund të urdhërojë anulimin e vlerësimit të tenderit dhe mund të urdhërojë rivlerësimin. Pas përfundimit të kontratës ZPP-ja

mund të shprehet vetëm për shkeljet e APP-së dhe, në rastet e parashikuara në Nenin 149 të APP-së, mund të fillojë procese administrative që çojnë në një vendim për të vënë një gjobë. Vendimet e ZPP-së mund të kontrollohen nga gjykata (duke përfshirë gjobat e vëna nga autoriteti/subjekti kontraktues). Sipas nenit 148 të APP-së, kontrata e përfunduar mund të anulohet nga gjykata kur ajo është mbyllur në kundërshtim me APP-në. **Masat e përkohshme** merren nga zyra në rastin e proceseve të rishikimit para përfundimit të kontratës, në përputhje me nenin 146 të APP-së, në bashkëpunim me nenin 138 të APP-së. Për kohëzgjatjen e një mase të tillë, autoriteti ose subjekti kontraktues detyrohet të abstenojë nga të vepruarit në çdo procedurë dhënie kontrate dhe ndërpret afatet kohore. ZPP-ja nuk është e detyruar të nxjerrë masa të përkohshme, megjithëse një vendim i tillë në procese para përfundimit të kontratës është shumë i zakonit. Baza ligjore për **dëmshpërblimet** përben rregullat e përgjithshme për dëmshpërblimet, të parashikuara në nenin 420 të Kodit Civil (i cili do të rishikohet gjatë pesë viteve në vijim). Për vendimet e paligjshme të marra nga administrata shtetërore në ushtrimin e kompetencave ekzekutive publike, dëmshpërblimet mund të njihen mbi bazën e Aktit nr. 514/2003 Coll. Një ndër procedurat e rishikimit është **pezullimi i procedurës së dhënies së kontratës**. Mbikëqyrja mund të fillohet para përfundimit të kontratës (motivuar vetëm nga ZPP-ja), ose më pas (në rast të motivimit nga zyra ose nga një person tjetër i cili nuk mund/nuk kishte të drejtë të bënte ankimim; kjo strukturë ligjore justifikohet me faktin se ky lloj procesi rishikimi nuk duhet t'i përkasë kandidatit/tenderuesit i cili i ka përdorur [ose mund t'i kishte përdorur] mundësitë e tij/saj ligjore më parë).

21.5 Procedura

E drejta përkatëse procedurale rregullohet nga APP-ja. **legjitimiteti:** Tenderuesit, ose çdo person tjetër që beson se i janë shkelur, ose mund t'i ishin shkelur të drejtat apo interesat e tij/saj, të cilat janë të mbrojtura nga ligji, kanë të drejtën e fillimit të proceseve gjyqësore. Mocioni për procedurën e rishikimit (mbikëqyrjen) bëhet vetëm nga një person që nuk ka marrë pjesë në procedurën përkatëse të tenderimit, d.m.th persona të cilët nuk kanë pasur mundësi të ankimojnë. I papranueshëm për mbikëqyrje është një mocion nga një person i cili ka paraqitur një kërkesë për dokumentet e kontratës, por nuk ka bërë ofertë. ZPP-ja mund të fillojë dhe një procedurë rishikimi me iniciativën e saj. **Ekspertët:** ZPP-ja mund të ftojë ekspertë nga fusha përkatëse e aktivitetit në rast të vendimeve për një ankimim, ose në rast të animimeve të bëra kundër gjobave të zëna nga zyra; ZPP-ja bulon kostot bazuar në vendimin e kryetarit. **Tarifat:** Në rast të një ankimit, aplikuesi detyrohet të depozitojë një garanci (neni 138 (16) i APP-së). Mocioni për mbikëqyrje nuk varet nga tarifa; zyra ushtron shumë aktivitet *ex officio*. Çdo veprim para gjykatës është objekt tarife (sipas një rregulloreje të veçantë). **Rregulli i suksesit:** depozita për proceset në ZPP është e rimbursueshme në rast se fitohet procesi: Neni 138 (17) i APP-së. Për proceset në gjykata, tarifat dhe kostot (për avokatët) janë të rimbursueshme. **Afatet kohore:** kërkesa për rishikim duhet të depozitohet brenda shtatë ditësh (neni 136 (3) deri në (8) PPA), ose në çdo kohë para përfundimit të kontratës (neni 136 (3) g) i APP-së). Edhe afati kohor për depozitim të një ankese është shtatë ditë (neni 138 (5) i APP-së). **Konfidencialiteti:** Mbikëqyrja është procedurë e cila nuk është e hapur për publikun; nëpunësit civilë janë të detyruar të mbajnë për vete dhe të mos japin informacion për gjërat që mësojnë gjatë procedurës. Gjithsesi, vendimi përfundimtar jepet publikisht, megjithëse të dhënat e identifikimit hiqen. Të njëjtat parime zbatohen dhe për proceset e ankimit. E drejta e qytetarëve për marrje informacioni parashikohet në Aktin nr 211/2000 Coll., i ndryshuar. **Efekt i pezullues:** vetë depozitimi i një padie në gjykatë nuk ka efekt pezullimi automatik. Realizimi i kontratës mund të pezullohet vetëm nga gjykata në rastet e parashikuara në ligj. **Afati kohor** që ZPP-ja të vendosë për të dëshmuar është 30 ditë: neni 139 (5) i APP-së. Për sa i përket gjykatave, periudha nga ndërmarrja e veprimit deri në miratimin e vendimit ndryshon; në gjykatën e shkallës së parë (Gjykatën Rajonale) mund të duhet një vit e gjysmë deri në dy vjet për t'u marrë vendimi dhe në gjykatën e shkallës së dytë (Gjykatën e Lartë) duhen rreth dy deri në tre vjet për t'u marrë një vendim. Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar për shkak të interpretimeve të legjislacionit në vendimet e gjykatave. Nuk ka **formularë model**, për kërkesat në lidhje me formën dhe përmbajtjen e ankesës parashikohen përkatësisht në nenet 136 (2) dhe 138 (6) të APP-së. Vendimet e ZPP-së shpërndahen me anë të një poste të regjistruar tek aplikuesi, tek autoriteti kontraktues, ose tek subjekti, dhe, nëse është e nevojshme, tek çdo person me të cilin lidhet vendimi. Vendimi mund të botohet dhe në

faqen e internetit të ZPP-së (pjesë të caktuara të ofertës dhe informacione dhe të dhëna të tjera që mund të jenë konfidenciale fshihen). Vendimet e gjykatave shpërndahen me postë të regjistruar.

21.6 *Kultura e rishikimit*

E drejta e prokurimit publik është pjesë e moduleve të së drejtës ekonomike dhe të biznesit në universitete dhe në disa agjenci private. ZPP-ja kujdeset për **trajnimin** e trajnerëve dhe për trajnimin (dhe ri-trajnimi) e të tjerëve në prokurimet publike, duke përfshirë dhe lëshimin e një certificate pranueshmërie për prokurimet publike. Gjyqtarët, panelistët e ZPP-së, juristët e prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit ose autoritetet/subjektet kontraktuese në procedurat e rishikimit dhe tenderuesit i marrin njohuritë e tyre për funksionimin në praktikë të prokurimeve publike dhe për çështje të tjera financiare dhe teknike gjatë studimeve universitare dhe në kurset e organizuara nën drejtimin e ZPP-së. Disa tenderues nuk dëshirojnë të fillojnë procese rishikimi pasi nuk duan të cenojnë mundësinë për të fituar kontrata të tjera (shihni referencat më lart për proceset e rishikimit si mjet i fundit). Disa kanë si synim të pengojnë prokurimet nëpërmjet proceseve të rishikimit, ose mund të kërkojnë përfitime financiare nëpërmjet proceseve të rishikimit. Disa mund të pengohen nga kërkimi i rishikimit gjyqësor për shkak të tarifave të larta të gjykatave, ose kostot e tjera të larta (p.sh. për përfaqësim ligjor); të tjerë mund të pengohen nga kërkimi i rishikimit gjyqësor nga kohëzgjatja e proceseve, ose dhe mund të mos jenë fare në dijeni të mundësive për rishikim juridik, ose rishikime të tjera. Nga njëra anë, ka nga ata të cilët nuk hezitojnë të ndërmarrin të gjitha hapat e disponueshme ligjore për të fituar procedurat e dhënies së kontratës, edhe me çmimin e përkeqësimit të mundshëm të marrëdhëniet e biznesit me autoritetin kontraktues të përfshirë. **Njohuritë e officerëve kontraktues** për bazën ligjore e baza të tjera të prokurimeve publike përshkruhen si të mira. Autoritetet dhe subjektet kontraktuese janë të detyruara të trajtojnë ankesat dhe të respektojnë vendimet e ZPP-së. Shoqata e Sllovakisë për Prokurimet Publike, Transparency International e Sllovakisë dhe Dhoma e Subjekteve Kontraktuese tregojnë interes për proceset e rishikimit dhe për prokurimet publike në tërësi. Vendimet e GJED-së respektohen plotësisht për aq kohë sa ato janë të ditura dhe mund të gjenden në përkthimin zyrtar. Deri më sot, nuk ka pasur asnjë përfshirje të GJED-së në sistemet kombëtare të rishikimit dhe të ankimimit të prokurimeve publike (neni 234 i Traktatit të KE-së) dhe nuk dërguar procese për shkelje në Komisionin Europian, duke përfshirë dhe proceset e zgjidhura në fazën paragjyqësore (neni 226 i Traktatit të KE-së). **Ndryshimet më të rëndësishme** në sistemin e rishikimit të prokurimeve publike dhe në atë të animimeve gjatë 15 viteve të fundit kanë qenë Akti nr. 263/1993 Coll. (akti i parë i integruar ligjor për prokurimet publike bazuar në UNCITRAL), Ligji nr. 263/1999 Coll. (teksti i parë ligjor bazuar në Direktivat e KE-së), ZPP-ja e krijuar në vitin 2000 mbi bazën e Aktit të përmendur, Akti nr 523/2003 Coll. (harmonizim i plotë i direktivave “të vjetra” të KE-së në legjislacionin shqiptar), dhe Akti nr. 25/2006 Coll. (transpozimi i direktivave “të reja” të BE-së që prej 1 shkurtit 2006). Një qasje shumë formale që del nga tradita historike në zonën e kontrollit dhe auditimit konsiderohet si dobësia kryesore e sistemit, ndërsa sistemi i trajnimit që funksionon mirë në prokurimet publike dhe që e manifeston këtë mirëfunksionim në ulje të gabimeve dhe në ulje të numrit të kundërshtimeve konsiderohet si pikë e fortë. Një ndër problemet kryesore në prokurimet publike ishin kundërshtimet dhe ankimimet e shpeshta, të cilat shpesh bëheshin vetëm me qëllimin e vonimit, komplikimit dhe pengimit të procedurës së dhënies së kontratës. Që prej datës 1 shkurt 2006, sipas nenit 138 (16) të APP-së u prezantua një detyrim i ri për të depozituar një garanci. ZPP-ja do të monitorojë dhe vlerësojë me kujdes zhvillimet për të parandaluar regjimin e dhënies së kontratave nga pengesat e qëllimshme dhe keqdashëse nga ana e tenderuesve, ose kandidatëve të pasuksesshëm.

22. *Sllovenia*

Në Slloveni, procedurat e rishikimit të dhënies së prokurimeve publike kryhen në **dy faza**. Në fazën e parë tenderuesi duhet të bëjë ankimim tek autoriteti përkatës ankimues. Në etapën e dytë, duke mos u kënaqur nga përgjigjja e autoritetit kontraktues për ankesën, tenderuesi mund të fillojë procesin në **Komisionin Kombëtar të Rishikimit e Procedurave të Dhënies së Kontratave (KKR)**. Nuk ka dallim ndërmjet kontratave që janë brenda, ose jashtë fushës së aplikimit të Direktivave të KE-së. Sistemi slloven i rishikimit dhe i ankimimit konsiderohet i shpejtë dhe efektiv.

22.1 *Ankimimi tek subjekti kontraktues*

Subjekti kontraktues ka juridiksion të vendosë për ankesat e tenderuesve si shkallë e parë gjyqimi. Tenderuesit kanë **detyrimin** e ankimit tek organi përkatës kontraktues para se të kërkohet rishikimi tek KKR-ja. Subjektet kontraktuese listohen në dekretin e kategorive dhe listat e subjekteve kontraktuese sipas kushteve të paragrafit 4 të nenit 2.a të Aktit të Prokurimeve Publike (Ur.l. RS, 36/04 – tekst zyrtar i konsoliduar).

22.2 *Rishikimi gjyqësor*

KKR-ja (Slovenska 50, 1000 Ljubljana) është organ i specializuar, i pavarur dhe autonom kombëtar që rishikon procedurat e dhënies së prokurimeve publike siç përshkruhet në Aktin e Rishikimit të Procedurave të Prokurimeve Publike. KKR-ja realizon kërkesat e përcaktuara nga **gjykata** dhe të dhëna në vendimet *Dorsch* dhe *Salzman*. **Kryetari dhe anëtarët e KKR-së** emërohen nga Parlamenti i vendit me propozim të Komisionit për Mandatet dhe Zgjedhjet për një periudhë pesëvjeçare, me mundësinë e rizgjedhjes. Kryetari dhe dy anëtarët duhet të kenë diplomë universitare në juridik dhe licencë avokatie. Dy anëtarët e tjerë duhet të kenë diplomë universiteti në ekonomi dhe inxhinieri. Kryetari dhe anëtarët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të mëposhtme: duhet të jenë qytetar i Republikës së Sllovenisë dhe duhet të kenë njohuri të mirë të sllovenishtesh, të kenë aftësi të përgjithshme për të hyrë në kontrata, të jenë në gjendje të mirë shëndetësore, të jenë të paktën 30 vjeç, të mos jenë dënuar më parë për vepra penale të dënueshme me burgim dhe të kenë të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e prokurimeve publike. Vendimet e KKR-së i dërgohen palëve me postë. Publiku ka vendim tek vendimet nëpërmjet faqes së internetit të komisionit (<http://www.gov.si/dkom/>).

22.3 *Pajtimi*

Procedura e pajtimit synohet të përdoret vetëm për procedura për dhënien e kontratës publike në sektorin e ujit, të energjisë, transportit dhe telekomunikacioneve. Ajo është mënyrë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në procedurën e dhënies së kontratës dhe kryhet vetëm në marrëveshjen e subjektit kontraktues dhe të tenderuesit të pasuksesshëm. Komisioni Europian cakton një person për të drejtuar procedurën (një pajtues) nëse subjekti kontraktues deklaron se ai është në gjendje të marrë pjesë. Të dyja palët në procedurën e pajtimit duhet të deklarojnë me shkrim se ata e pranojnë personin e caktuar nga Komisioni Europian dhe secila palë duhet të propozojë një pajtues shtesë nga lista, i cili e kryen procedurën së bashku me pajtuesin e caktuar nga Komisioni Europian. Personi që kërkon procedurën e pajtimit dhe subjekti kontraktues kanë të drejtë ta përfundojnë procedurën në çdo kohë. Nëse tenderuesi i pasuksesshëm, i ndryshëm nga personi që kërkon procedurën e pajtimit, propozon rishikimin e procedurës në lidhje me dhënien e kontratës publike ose ndjek procese të rishikimit gjyqësor dhe nuk arrin të shprehet brenda afateve kohore të dhëna nëse ai ose ajo janë dakord të marrin pjesë në atë procedurë, pasi ftohet të marrë pjesë në procedurën e pajtimit, nuk përfitojnë më nga ku proces pasi pajtuesi të mbyllin procesin dhe e shpallin të ekzekutuar procedurën e prokurimit publik.

22.4 *Mjetet efektive ligjore*

Organi kombëtar i rishikimit mund të arrijë në dy lloj vendimesh. Ai mund ta kundërshtojë një ankimim si të pabazuar, ose ta pranojë atë dhe të bëjë procedurën të pavlefshme, ose pjesërisht ose plotësisht. Ka shumë arsye për të pezulluar dhënien e një kontrate, si, për shembull diskriminimi i tenderuesve, kufizimi i konkurrencës, kritere dhe faktorë diskriminues për dhënien e kontratës që nuk lidhen me substancën e kontratës, etj. Përfundimi i kontratës nuk mund të anulohet nga vetë autoriteti kontraktues, ose nga subjekti kontraktues. Vetëm KKR-ja mund të anulojë vendimet e subjekteve kontraktuese. Kryetari i KKR-së mund të heqë **masat e përkohshme** me një urdhr të përkohshëm *ex parte*. Një vendim i favorshëm rishikimi është parakusht për një proces të suksesshëm **dëmshpërblimi** për gjykatat civile.

22.5 *Procedura*

Ekziston një kod specifik për rishikimin e prokurimeve publike që mbulon si sektorin publik dhe atë të shërbimeve mbi bazën e të cilit kryhen proceset në KKR. Proceset mund të fillohen vetëm pas një rishikimi

të pasuksesshëm në shkallë të parë para autoritetit kontraktues dhe kur pala e pakënaqur nuk bie dakord (ose pjesërisht ose plotësisht) me vendimin e autoritetit kontraktues për ankesën për rishikim, ose nëse kjo e fundit nuk vendos brenda afatit kohor të parashikuar (prej 15 ditësh). Në pjesën më të madhe të rasteve, tenderuesit që kanë bërë ofertë janë ata që i nisin proceset. Por, çdo person që ka aktualisht, ose që ka pasur në të shkuarën interes në marrjen e një kontrate të caktuar dhe që ka qenë ose rrezikon të jetë cenuar nga një shkelje e pretenduar ka të drejtë të bëjë ankimim. Një palë e pakënaqur ka të drejtë *de facto* në momentin që ajo e ka provuar interesin e saj në dhënien e kontratës dhe kur jep prova për një probabilitet të mundshëm që pala a qenë objekt i një humbje. Palët që bëjnë ankimim duhet të paguajnë një tarifë prej rreth €420 (kontrata furnizimi ose shërbimesh), ose €840 (kontrata punësh). Për kontrata me vlera të larta të botuara në Fletoren Zyrtare të Komuniteteve Europiane, këto tarifa dyfishohen. Tenderuesi duhet të paguajë tarifën vetëm pas bërjes së ankimit të tij/saj. Çdo kosto tjetër mund të shqyrtohet nga gjykatat civile. Në ligjin përkatës parashikohet një parim sipas të cilit pala që shkakton kostot mban barrën e pagimit të tyre. Pra, një ankues i suksesshëm merr tarifën e tij/saj por atij/asaj nuk i rimbursohet asnjë kosto tjetër. Para se të arrijë në këtë vendim, KKR-ja mund të marrë mendimin e ekspertëve në lidhje me çështje teknike, ekonomike ose ligjore të vilat lidhen me çështjen në fjalë. KKR-ja duhet të vendosë për pretendimin dhe duhet të japë një vendim brenda 15 ditësh nga marrja e ankesës. Afati kohor mund të zgjatet në raste të caktuara deri në maksimumin prej 20 ditësh. Ekzistojnë mundësi procedurale për të marrë parasysh nevojën për mbrojtjen e informacionit konfidencial të biznesit; për shembull, nëpërmjet proceseve *in camera* (me dyer të mbyllura). Gjithsesi, parimi i transparencës ka një rëndësi shumë të madhe, ndërsa mundësitë procedurale lidhen me legjislacionin për aksesin publik tek informacioni. Depozitimi i një ankese ka efekt automatik pezullimi *ex lege* para KKR-së. Nuk ka formularë model të detyrueshëm apo dokumente të tjera të detyrueshme që përdoren për proceset e rishikimit të prokurimeve publike. Vendimet e KKR-së botohen në portalin e faqes së internetit dhe i dërgohen subjektit kontraktues, ankimesit dhe ministrisë së financës.

22.6 *Kultura e rishikimit*

Jurisprudenca ka rëndësi të kufizuar, por të madhe, për shkak të një sistemi që përmban si kodifikimin dhe jurisprudencën. Gjyqtarët dhe panelistët e KKR-së, juristë të prokurimeve publike që përfaqësojnë tenderuesit dhe subjektet kontraktuese në proceset e rishikimit i marrin **njohuritë** për të drejtën e prokurimeve publike, në veçanti, dhe për të drejtën e komunitetit, në përgjithësi, gjatë punës. Po ashtu çështjet teknike dhe financiare të prokurimeve publike trajtohen “gjatë punës” si dhe nga trajnimet profesionale, trajnimin vazhdues, etj. **Qëndrimi** i gjyqtarëve dhe i panelistëve të KKR-së ndaj interesit të publikut nga njëra anë, dhe interesave të tenderuesve, nga ana tjetër, konsiderohet si i drejtë dhe i balancuar. Tenderuesit që kërkojnë rishikim të vendimeve të prokurimeve publike i marrin njohuritë e tyre për çështje ligjore, financiare dhe administrative për mënyrën sesi funksionojnë prokurimet publike nëpërmjet juristëve dhe konsulentëve dhe nëpërmjet organizatave të tyre profesionale, të tilla si, ministria e financës. Tenderuesit në përgjithësi angazhohen aktivisht në bërjen e ankesave kur e shohin të arsyeshme. Në përgjithësi, oficerët kontraktues përshkruhen si “kompetentë e për t’u lavdëruar” për sa i përket njohurive ligjore dhe të fushave të tjera të lidhura me prokurimet publike. Qëndrimi i oficerëve kontraktues dhe i eprorëve të tjerë që merren me ankesat e tenderuesve që kanë bërë ankesë, ose kanë kërkuar rishikim të vendimeve të prokurimeve publike janë në dijeni të mundësisë gjithmonë reale të mbrojtjes gjyqësore të palëve. Nuk ka botime të rregullta përveç neneve të botuara në disa periodikë profesionale; qarkullojnë dhe libra dhe botime. Bëhen seminare për të drejtën dhe praktikën e prokurimeve publike të organizuara nga aktorët privatë ku marrin pjesë dhe nëpunësit publik. Nuk ka asnjë shoqatë kombëtare për të drejtën dhe politikën e prokurimeve publike. Shoqëria civile (grupet kombëtare të interesit, të tilla si dhomat e tregtisë, shoqatat e industrive kombëtare të ndërtimit, etj.) është e përfshirë në politikën e prokurimeve publike të tërësi, dhe në pjesët e saj përbërëse në veçanti. Shoqëria ndjek dhe monitoron nga afër proceset e prokurimit, në veçanti kur futen në lojë interesa të mëdha. Roli i medias është shumë i theksuar. Ka një ndikim të madh të vendimeve të GJED-së në proceset kombëtare të rishikimit të prokurimeve publik.

23. Suedia

Sistemi i ankimimit dhe rishikimit të Suedisë bazohet në rishikimin e pavarur gjyqësor. Sistemi mund të ndahet në ankimim para dhe pas përfundimit të një kontrate. Ekzistojnë tri shkallë të ndryshme rishikimi gjyqësor për kontratat mbi dhe nën pragjet e KE-së.

23.1 Ankimimi tek Autoriteti Kontraktues

Nuk është e detyrueshme të bëhet ankimim tek **autoriteti ose subjekti kontraktues**. Nuk ka rregulla të veçanta në fushën e prokurimeve publike që trajtojnë ankesat e drejtuara për autoritetin kontraktues. Gjithsesi, është e mundur të mundohemi e t'i zgjidhin kundërshtitë në këtë mënyrë.

23.2 Rishikimi gjyqësor

Para përfundimit të kontratës, një **gjykatë administrative** mund të pezullojë procedurën e prokurimit dhe të urdhërojë autoritetin ose subjektin prokurues të rifillojë ose të korrigjojë procedurën në shkallën e parë. Në shkallën e dytë mund të apelohe vendimet e gjykatave të shkallës së parë në njërën nga katër gjykatat administrative të apelit, të cilat janë: gjykata “Kammarrätten” në Stokholm, Göteborg, Sundsvall, ose Jönköping. Së fundmi ka dhe një gjykatë administrative të shkallës së fundit që quhet “Regeringsrätten” në Stokholm, e cila gjithashtu rishikon vendimet e prokurimeve publike. Të gjitha këto gjykata janë të pavarura nga ekzekutivi, administrata apo çdo pjesë tjetër e qeverisë dhe vendimet e tyre kanë natyrë detyruese. Rishikimi nëpërmjet gjykatave administrative përjashtohet pas nënshkrimit të kontratës. Gjithsesi, që prej vitit 2002 zbatimi i vendimit për çështjen *Alcatel* siguron një periudhë prej dhjetë ditësh ndërmjet njoftimit të dhënies së kontratës për tenderuesit dhe përfundimin e kontratës. Gjykatat administrative janë forumi kryesor i rishikimit të prokurimeve publike në Suedi. Në vitin 2005 u filluan 1280 çështje – pjesa më e madhe e të cilave në gjykatat administrative. Shumë pak çështje ngrihen nga tenderues nga shtete të tjera anëtare, por pjesa më e madhe e kompanive ndërkombëtare kanë një degë suedeze. Më pak se 1% e të gjitha kontratave të prokurimeve publike kanë çuar në ankesa. Rreth 30% e vendimeve e urdhërojnë autoritetin ose subjektin kontraktues të korrigjojë (13%), ose rifillojë (17%) të procedurës. Pjesa më e madhe e çështjeve nuk shkojnë në vendim për shkak se autoriteti, ose subjekti kontraktues e kanë përfunduar, ose ndrequr procedurën, ose e kanë nënshkruar kontratën. Pjesa më e madhe e çështjeve të rishikimit lidhen me procesin e vlerësimit. Zakonisht duhen tre deri në katër javë ndërmjet depozitimit të një ankese ose padie për rishikimin gjyqësor dhe vendimit përfundimtar. Kostot e sistemeve të rishikimit dhe ankimimit për taksapaguesin nuk janë të llogaritura zyrtarisht. Pika e fortë e sistemit të rishikimit është se sistemi është i shpejtë dhe i lirë për tenderuesit dhe që vendimi merret nga një gjykatë lokale në afërsi të autoritetit ose subjektit kontraktues në fjalë. Pas përfundimit të kontratës, i kontraktuari mund të kërkojë dëmshpërblime vetëm në një **gjykatë rrethi (të zakonshme ose civile)** në shkallën e parë. Në shkallën e dytë mund të bëhet apel kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë në Gjykatën e Apelit. Ekziston një **gjykatë e përgjithshme/e zakonshme e shkallës së fundit**, e quajtur “Högsta domstolen” në Stockholm, e cila po ashtu rishikon vendimet e prokurimeve publike që japin dëmshpërblimet. Këto gjykata janë të pavarura nga ekzekutivi, administrata apo çdo pjesë tjetër e qeverisë dhe vendimet e tyre kanë natyrë detyruese. Ka shumë pak raste që kërkojnë dëmshpërblime. Një dobësi e këtij sistemi të dyfishtë të gjykatave administrative dhe civile është mungesa e parashikueshmërisë për shkak se ka shumë gjykata dhe vendime të përfshira në proces. Po ashtu ka mjete ligjore të pamjaftueshme kundër dhënies të drejtpërdrejta të paligjshme pa botim. Thuajse është e pamundur të merren dëmshpërblime kur janë dhënë kontrata të drejtpërdrejta pa botim. Pra, rreziku i rishikimit është shumë më i vogël kur autoriteti nuk po e ndjek fare legjislacionin, krahasuar me rastet e kontratave me mangësi procedurale, por që janë të botuara. **Gjykata e përgjithshme/e zakonshme e shkallës së fundit** Högsta domstolen, rishikon kontratat e prokurimeve dhe jep dëmshpërblime. **Gjykata administrative e shkallës së fundit** Regeringsrätten bën vetëm rishikimin e vendimeve të prokurimeve. Të dyja gjykatat janë krijuar mbi bazën e Kushtetutës dhe akteve të parlamentit dhe plotësojnë kërkesat e gjykatës të përcaktuara në vendimin *Dorsch* dhe *Salzmann*. Gjyqtarët, të cilët duhet të jenë juristë me eksperiencë dhe të njohur, emërohen sipas një procedure të përgjithshme. Kushtetuta kërkon që gjyqtari të jetë i pavarur. Gjyqtarët mund të hiqen nga detyra vetëm në raste shumë të veçanta. **Kryetarët ose presidentët** e të gjitha gjykatave

emërohen nga qeveria dhe janë të gjithë juritë me emër. Deri tani nuk ka pasur asnjë përfshirje të **GJED**-së në sistemin kombëtar të rishikimit ose të ankimit nëpërmjet procedurës së referencës paraprake. Ka disa çështje të prokurimeve publike që janë objekt i proceseve të shkeljes që i janë dërguar Komisionit Europian, duke përfshirë dhe çështjet e zgjidhura në fazën para gjyqësore. Suedia nuk ka gjykatë arbitrazhi. Tenderuesit mund t'i kërkojnë Bordit Kombëtar për Prokurim Publik ("NOU", Vasagatan 44, 111 20 Stockholm, www.nou.se) mendim dhe ekziston një procedurë pajtimi dhe vërtetimi në **Bordin Suedez për Akreditim dhe Vlerësim C Përputhshmërie (SWEDA; Box 2231, 103 15 Stockholm; telefon +46 8 406 83 00; faks +46 08 791 89 29; faqe interneti: www.swedac.se)**. Gjithsesi, kjo procedurë nuk është përdorur asnjëherë.

23.4 Mjetet efektive ligjore

Mjetet efektive ligjore përfshijnë anulimin e dhënies së vendimeve individuale, një urdhër për të rifilluar proceset e dhënies së prokurimit publik, masa të përkohshme, dëmshpërblime dhe gjoha për ndërmarrjet. Gjykata administrative e shkallës së parë mund të urdhërojë që të rekomandohet procedura e dhënies së kontratës, ose mos përfundimi i kontratës deri sa të jetë ndrequr shkelja. Mbrojtja ligjore është e pranueshme kundrejt vendimeve para përfundimit të kontratës, p.sh. për përzgjedhjen e një procedure të posaçme dhënie kontrate, vendimet e përzgjedhjes së vetëm disa subjekteve për t'u trajtuar gjatë fazës tjetër, ose vendimet e kualifikimit. Jurisprudenca është e paqartë nëse një vendim pas përfundimit të kontratës është objekt i legjislacionit të prokurimeve. Gjykata mund të urdhërojë dhe masa të përkohshme në pritje të një vendimi përfundimtar, duke marrë parasysh pasojat e mundshme të masave për të gjitha interesat që ka të ngjarë të cenohen, duke përfshirë interesin publik, dhe mund të vendosë kundër marrjes së këtyre masave kur pasojat e tyre negative janë më të larta se përfitimet që mund të nxirren. Nëse subjekti kontraktues i ka shkelur dispozitat e nenit 4 të Kreut 1, ose dispozita të tjera të APP-së dhe kjo gjë ka shkaktuar dëm ose rrezikuar shkaktimin e dëmit për tenderuesit, gjykata urdhëron rifillimin e procedurës së dhënies së kontratës, ose përfundimin e saj vetëm atëherë kur të jenë rregulluar shkeljet. Vetë kontrata nuk mund të anulohet, në përjashtim të rasteve të mashtrimit, ose rrethanave të paligjshme. Kur ka përfunduar një procedurë dhënie kontrate, një furnizues që e konsideron veten të dëmtuar mund të ankimojë kundër subjektit kontraktues në një gjykatë (të zakonshme) rrethi. Nuk është e nevojshme që një vendim i kontestuar të pezullohet para se të pretendohet dëmshpërblim. Dëmshpërblimi mund të shkojë përtej kostove të tenderit dhe shpesh përlllogaritet si neto e humbjes së fitimit. Në çështjet që lidhen me prokurimin në sektorët e shërbimeve gjykata mund të vendosë për **pagesa periodike gjobash**, të cilat e ndalojnë subjektin kontraktues të vijojë me procedurën e dhënies së kontratës deri sa të jetë ndrequr shkelja. Sipas Kreut 7, neni 2 dhe 6 - 7 i APP-së, një subjekt kontraktues që nuk ka rritur të respektojë dispozitat e APP-së do të paguajë dëmshpërblim për dëmin që ai mund t'i ketë shkaktuar një tenderuesi. Një tenderues, ose një kandidat që ka marrë pjesë në një procedurë dhënie kontrate të parashikuar në Kreun 4 (sektori i shërbimeve) ka të drejtë të marrë shpërblim për kostot e përgatitjes, ose për marrjen pjesë në procedurën e tenderimit nëse mos respektimi i dispozitave të APP-së ka pasur efekt përcaktues negativ mbi aftësinë e tij për të fituar kontratën.

23.5 Procedura

E drejta përkatëse procedurale rregullohet nga Kodi Civil i Procedurës Gjyqësore, i quajtur "Rättegångsbalken", për gjykatat e zakonshme dhe Kodi i Procedurës Administrative të Gjykatës, i quajtur "Förvaltningsprocesslagen", për gjykatat administrative. Gjykata mund të vendosë të dëgjojë mendimin e një eksperti teknik, ose të marrë një deklaratë me shkrim. Gjykata nuk ka detyrim ta bëjë këtë gjë nëse mendimi i ekspertit nuk është i nevojshëm për procesin. Çdo furnizues që shfaq interes në marrjen e një kontrate, dhe në rast se ai ose ajo nuk kanë bërë ofertë, mund të depozitojnë një ankimim. NOU nuk ka të drejtë të ankimojë, megjithëse kjo gjë është sugjeruar shpesh. Nuk ka tarifa për gjykatat administrative, si dhe nuk ekziston kërkesa për përfaqësim ligjor. Pala që humb në një proces për dëmshpërblim duhet të paguajë kostot ligjore të palës që e fiton procesin. Pas vendimit për dhënien e kontratës padia në gjykatën administrative mund të depozitohet brenda dhjetë ditësh nga data kur i është dërguar kontrata tenderuesve. Padia për dëmshpërblime duhet të ngrihet brenda një viti nga koha e përfundimit të kontratës. Gjykatat

mund të shohin dokumentet pa ua bërë me dije përmbajtjet palëve. Pas depozitimit të dosjes në gjykatën administrative nuk ekziston efekti i pezullimit automatik, por gjykata mund të pezullojë procedurën në mënyrë që kontrata të mund të mos përmbillet pa daljen e vendimit të gjykatës. Gjykatat e shkallës së parë zakonisht i marrin vendimet brenda tre deri në katër javësh. Vendimet u çohen palëve, ndërsa botohen disa çështje të cilat shfaqin interes të përgjithshëm. Bëhet dhe **botimi i vendimeve**: raportet vjetore të gjykatave, të quajtura “Regeringsrättens årsbok (RÅ)”, “Regeringsrätten” për gjykatën administrative të shkallës së fundit dhe “Nytt juridiskt arkiv (NJA)” për gjykatën e zakonshme të shkallës së fundit. Në fletoren “NOU-info” botohet informacion rreth vendimeve të shkallës së fundit dhe disa çështje interesante nga gjykatat e tjera. Shoqata Suedeze e Autoriteteve Vendore dhe e Rajoneve jep informacion për anëtarët e saj. Jurisprudenca është e kufizuar, por ka rëndësi të madhe për shkak të sistemit që përfshin si kodifikimin dhe jurisprudencën. Gjykatat japin interpretime të rëndësishme të së drejtës. Dallimi i vetëm ndërmjet sistemit të rishikimit dhe ankimimit në lidhje me **shërbimet** është mundësia e nxjerrjes së pagesave periodike të gjobave që përmenden më lart si dhe e disa rregullave të posaçme të barrës së provës në çështje të dëmshpërblimit sipas parashikimit në Direktivës 92/13/KEE.

23.6 *Kultura e rishikimeve*

Gjyqtarët dhe juristët më të rinj kanë studiuar për prokurimet dhe të drejtën e KE-së gjatë universitetit. Të tjerë duhet të kërkojnë trajnim, kurse dhe seminare të organizuara nga firmat private ligjore, ose nga organe qeveritare, të tilla si NOU ose organizata ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit ka pasur dhe specializim vullnetar për çështjet e prokurimeve. NOU shpërndan informacion nëpërmjet telefonit, fletushkave informative, botimeve, seminareve dhe konferencave për të mbështetur zyrat qeveritare dhe për të lejuar zhvillimet në fushën e prokurimeve në BE dhe OBT (më shumë informacion mund të gjeni në www.nou.se). Ka më shumë se 100 gjyqtarë që merren me çështjet e prokurimeve. Qëndrimi i tyre është zakonisht i drejtë dhe i balancuar, por mund të ketë dhe përjashtime me tendencë nga interesi i publikut. Administrata duhet të ndihmojë dhe të këshillojë të gjitha palët. NOU u jep informacion tenderuesve, ashtu siç u jep informacion tenderuesve dhe Shoqata e Administratave Lokale dhe e Rajoneve dhe Dhoma e Tregtisë. Në të kundërt, tenderuesit duhet të kërkojnë ndihmën e firmave juridike dhe të konsulentëve. Në vitin 2005 janë filluar 1,280 ankesa për prokurimet publike. Disa tenderues mund të mos jenë në dijeni të proceseve të rishikimit, ndërsa të tjerë mund të abstenojnë të përdorin këtë mekanizëm. Niveli i njohurive të oficerëve kontraktues në lidhje me të drejtën dhe praktikën e prokurimeve publike po bëhet gjithnjë e më i mirë. Brezi i ri po bëhet më i ditur rreth kërkesave ligjore dhe ekonomike. Qëndrimi i oficerëve kontraktues dhe i eprorëve të tyre që merren me ankimet e tenderuesve është përgjithësisht i mirë. Botimi i NOU-t dhe “Anbudsjournalen”, e cila është një gazetë për prokurimet publike që përmban intervista, opinione dhe informacion rreth vendimeve të prokurimeve dhe diskuton për problemet dhe sukseset në prokurimin publik, shpërndan informacion rreth prokurimeve publike dhe luan rolin e forumit të diskutimeve. E drejta e prokurimeve publike diskutohet në konferencat akademike dhe profesionale dhe në seminare të organizuara si nga sektori publik dhe nga ai privat. Nuk ka asnjë shoqatë kombëtare për prokurimet publike, por ka organizata e degë të tjera të lidhura me to. Dhomat e tregtisë janë aktive dhe luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e hapjes së tenderave dhe prokurimin elektronik. Shoqata e industrive Kombëtare si dhe shoqata e ndërtuesve, e pajisjeve mjekësore, e shëndetit dhe e sektorëve të tjerë janë të interesuar për temën dhe organizojnë seminare dhe takime mbi këtë temë. OJQ-të, të tilla si seksioni kombëtar i Transparency International janë aktivë në çështje të tregtisë së lirë dhe të mjedisin. Media e shkruar dhe ajo elektronike rrallë i mbulojnë proceset e rishikimit të prokurimeve publike. Ka arsim universitar për zyrtarët e prokurimeve publike. Ndikimi i vendimeve të GJED-së është goxha i konsiderueshëm në gjykatat më të larta. Palët u referohen vendimeve, të cilat bëhen me dije nëpërmjet botimeve të NOU-t dhe organizatave të tjera.

24. **Mbretëria e Bashkuar**

Prokurimet publike në Mbretërinë e Bashkuar parashikohen në **Rregullat e 2006-ës për Kontratat Publike 2006** (instrumenti statutor 5/2006 që zbaton Direktivën e BE-së nr. 2004/18 dhe 89/665 http://www.opsi.gov.uk/si/si2006/uksi_20060005_en.pdf) dhe në **Rregullat e 2006-ës për Kontratat e**

Shërbimeve 2006 (instrumenti statusor 6/2006 që zbaton Direktivat 2004/17 dhe 92/13 http://www.opsi.gov.uk/si/si2006/uksi_20060006_en.pdf). Instrumentet e përmendura më lart janë të zbatueshme vetëm në Angli, Uells dhe në Irlandën e Veriut. Në Skoci, ekzekutivi skocez ka nxjerrë dy rregullore të ngjashme (instrumentin statutor 1/2006 dhe 2/2006 http://www.opsi.gov.uk/legislation/scotland/ssi2006/ssi_20060001_en.pdf). Sistemi i rishikimit dhe i ankimimit bazohet në kontrollin e pavarur gjyqësor. Ka organizata të ndryshme në Mbretërinë e Bashkuar që ofrojnë shërbime për **zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve** (në veçanti në fazën e performancës). Organet publike dhe kontraktuesit e tyre mund t'i përdorin këto shërbime me raste, por nuk janë të detyruar nga ligji ose politikat t'i përdorin këto shërbime. Mekanizmi i pajtimit i parashikuar në Direktivën e KE-së 92/13 është zbatuar në të drejtën e brendshme nga Rregullat e Kontratave të Shërbimeve.

24.1 Kontrolli gjyqësor

Një tenderues i cili mendon se ka qenë objekt vuajtje, ose ka mundësi të vuajë një humbje për shkak të shkeljes së Rregullave të Kontratave Publike ose Rregullave të Kontratave të Shërbimeve ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nëpërmjet sistemit kombëtar të gjykatave. **Çdo shkelje** e rregullave të sipërpërmendura nga autoriteti/subjekti kontraktues mund të dëshmohet nëpërmjet sistemit kombëtar të gjykatave. Kjo përfshin përzgjedhjen e një procedure dhënie kontrate, mënyrën në të cilën është bërë specifikimi, përjashtimin në fazat e parakualifikimit dhe të dhënies së kontratave, etj. Në lidhje me kontratat që nuk bien nën objektin e rregullave (d.m.th., kontrata nën pragjet e KE-së), proceset mund të fillohen mbi bazën e së drejtës zakonore të përgjithshme. Sipas dokumenteve ligjore, aplikimi kundër një vendimi duhet të bëhet menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data kur janë bërë me dije arsyet për ngritjen e padisë. Afati tremujor për bërjen e padive mund të shtyhet vetëm me vendim të gjykatës për raste të justifikuara në mënyrë të arsyeshme. Po ashtu, ekziston një kërkesë strikte që aplikuesi të informojë autoritetin kontraktues për shkeljen, ose shkeljen e supozuar, si dhe për qëllimin e tij/saj për të ngritur padi sipas bazës ligjore përkatëse para se të fillojë proceset gjyqësore. Gjithsesi, respektimi i këtij detyrimi nuk përbën parakusht për të kërkuar rishikimin gjyqësor. Ankimimi i dërgohet njësisë së prokurimit të autoritetit kontraktues. Paditë parashtrihen në **Gjykatën e Lartë në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut, në Gjykatën e Sesionit ose Gjykatën e Sherifit në Skoci** (Skocia ka gjykata dhe sistem ligjor të ndryshëm nga Anglia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut). Gjykata i bën me dije padinë autoritetit kontraktues, e më pas procedon në përputhje me udhëzimet për gjykatat civile, siç parashikohet në Aktin e Procedurës Civile të vitit 1997. Gjykata e Lartë është organ rishikimi i shkallës së parë për çështje të prokurimeve publike sipas ligjit. Selia bazë është në adresën *Royal Courts of Justice* në Londër (London WC2A 2LL; telefon: +44 (0)207 947 6000), por ka gjykata rajonale në më shumë se 20 qytete më të vogla. Proceset i drejton një gjyqtar i gjykatës së lartë, i cili i dëgjon çështjet e ngritura nga të dyja palët në mbështetje të interpretimit të ngjarjeve prej tyre dhe më pas merr vendim mbi bazën e provave të parashtruara. Në rastin kur një padi e ngritur nga pala paditëse nuk është e suksesshme dhe kur kjo palë është e mendimit se vendimi nuk është i plotë nga pikëpamja ligjore, ai/ajo mund ta apelojë çështjen në **Divizionin Civil të Gjykatës së Apelit** (Londër WC2A 2LL; telefon: +44 (0)20 7947 7882), ku argumentet e kësaj pale do të dëgjohen nga tre gjyqtarë. Organi i rishikimit në shkallën e fundit është Dhoma e Lordëve, në veçanti **Lordët e Apelit të Zakonshëm** (adresa: Lords of Appeal in the Ordinary, The House of Lords, Palace of Westminster, London SW1; Website: http://www.parliament.uk/judicial_work/judicial_work.cfm). Leja duhet të jepet nga gjykata e Apelit, ose nga Dhoma e Lordëve për apelimin e një vendimi të Gjykatës së Apelit në mënyrë që ky apelim t'i dërgohet për shqyrtim Lordëve të Ligjit. Lordët e Ligjit janë persona të emëruar ndërmjet anëtarëve me të njohur të gjyqësorit të Mbretërisë së Madhe nga Shkëlqesia e Saj, me këshillim të kryeministrit dhe mbi bazën e eksperiencës dhe ekspertizës së tyre. Ata formojnë një organ të përhershëm të krijuar me ligj dhe japin vendime ligjore të detyrueshme. Ky organ është i pavarur nga ekzekutivi dhe nga çdo pjesë tjetër e qeverisë. Pas hyrjes në fuqi të dispozitave përkatëse të Aktit të Reformës Kushtetuese të vitit 2005, çështjet e prokurimit do të dëgjohen në shkallën e fundit nga **Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar**.

24.3 Mjetet efektive ligjore

Baza ligjore për mjetet ligjore në çështjet e prokurimeve jepet në Pjesën 9 të rregullave. Nëse Gjykata e Lartë shprehet në favor të aplikuesit, ajo mund të japë urdhër për **ndryshimin e vendimit përkatës** nga autoriteti kontraktues, ose për **ndryshimin e një dokumenti** (të tillë si një specifikim). Nëse aplikuesi ka qenë objekt humbesh për shkak të shkeljeve të autoritetit kontraktues, atëherë mund të jepen dhe **dëmshtëpërblime**. Dëmshtëpërblimet për humbjet (duke përfshirë humbjen e mundësisë për të fituar kontratën) mund të jepen nga gjykatat nëse ajo është e kënaqur nga provat dhe kur konstaton se është shkelur detyrimi për të respektuar ligjet dhe furnizuesi ka pësuar humbje, ose dëme për shkak të kësaj shkelje. Nuk është e nevojshme që vendimi i kontestuar të pezullohet. Kostot e aplikuesit së suksesshëm mund të paguhen dhe nga autoriteti kontraktues. Në përjashtim të rasteve të mashtrimit ose të keqbesimit, dëmshtëpërblimet përbëjnë të vetmin mjet ligjor të disponueshëm pasi të jetë nënshkruar kontrata. Depozitimi i aplikimit nuk ka efekt pezullimi efektiv për procedurën vijuese të tenderimit. Gjithsesi, në çdo fazë procesi, gjykata mund të japë lëshojë urdhër të **ndërmjetëm** në rast të kërkesave urgjente nga aplikuesi. Urdhri i ndërmjetëm ka efekt pezullues për veprimet përkatëse të autoritetit kontraktues. Kur përcakton nëse nevojiten masat e përkohshme, gjykata merr parasysh nevojën për ofrimin e një sistemi efektiv për respektimin e rregullave të KE-së për prokurimet publike dhe mbrojtjen e aplikuesit, nga njëra anë, dhe interesat e publikut për vijimin e projekteve publike, nga ana tjetër. Pra, për të qenë në gjendje të marrë një urdhër të ndërmjetëm për pezullimin e procedurës së tenderimit, ose zbatimit të një vendimi të marrë në lidhje me procedurën e tenderimit, aplikuesi duhet të dëshmojë se çështja që duhet të gjykohej është serioze dhe se dëmshtëpërblimi mund të mos jetë mjeti efektiv ligjor. Gjykata nuk ka kompetencë të kthejë një kontratë pas nënshkrimit të saj. Gjithsesi, në lidhje me kontratat që mbulohen nga Rregullat e Kontratave Publike, Mbretëria e Madhe ka prezantuar **periudhën dhjetë ditore të pezullimit** ndërmjet njoftimit të rezultateve të procedurës së tenderimit për tenderuesit dhe përfundimit formal të një kontrate. Ky rregull konsiderohet si zhvillimi më domethënës i kohëve të fundit në fushën e të drejtës së brendshme të prokurimit publik. Në këtë mënyrë tenderuesit e pakënaqur kanë mundësinë të kundërshtojnë vendimin për dhënien e një kontrate nëse dihet se ka filluar një proces ligjor gjatë periudhës pezull deri në qartësimin e rezultatit përfundimtar. Por ende nuk është e qartë nëse mos respektimi nga autoriteti kontraktues i periudhës dhjetë ditore të pezullimit të detyrueshëm do të thotë se gjykata ka pezulluar dhënien e kontratës. Nuk ka dispozita në lidhje me pagesat e gjobave periodike.

24.4 Procedura

Proceset në Gjykatën e Lartë kryhen mbi bazën e parashikimeve të Rregullave të Kontratave Publike të vitit 2006, Rregullat e Kontratave të Shpërblimeve të vitit 2006 dhe Akti i Procedurave Civile i vitit 1997. Akti i Procedurës Civile zbatohet dhe për proceset para Divizionit Civil të Gjykatës së Apelit. **Çdo person** që ka kërkuar ose kërkon një kontratë, ose do të kishte dashur të ishte personi të cilit i është dhënë kontrata, i cili është nënshkruar në një Shteti *përkatës* që mund të ngrejë padi dhe është i vendosur në këtë shtet mund ta bëjë padinë nëse është objekt ose rrezikon të jetë objekt humbje ose dëmi të shkaktuar për shkak të shkeljes së detyrimit nga autoriteti kontraktues. Këtu mund të përfshihen dhe persona që nuk kanë marrë pjesë në procedurën e tenderimit nëse janë të mendimit se janë penguar nga të marrit pjesë në prokurimet publike për shkak të shkeljes së ligjit. Shtetet *përkatëse* përfshijnë 25 shtetet anëtare të BE-së, shtete e EEA-së, Bullgarinë, Rumaninë dhe shtetet nënshkruese të Marrëveshjes së Prokurimeve Qeveritare. Nuk ka **formularë** model në lidhje me çështjet e prokurimeve, por përdoren disa formularë të përgjithshëm (që mund të gjenden online në adresën: <http://www.hmcourts-service.gov.uk/HMCSCourtFinder/FormFinder.do>). **Ekspertët** thirren nga palët në procese për të mbështetur çështjen e tyre dhe merren në pyetje nga avokatët e palëve kundërshtare. Zakonisht kostot mbulohen nga pala që e humb procesin. Një aplikues mund të kërkojë të **shohë** dosjen e prokurimeve duke ndjekur procedurën e zakonshme të marrjes së informacionit për paditë në gjykatë në Angli dhe Uells. Për marrjen e informacionit konfidencial jashtë proceseve gjyqësore mund të bëhet kërkesë në gjykatë. Vendimi merret nga gjyqtari. Po ashtu, aplikuesi mund të aplikojë për informacion sipas dispozitave të Aktit të Lirisë së Informacionit të vitit 2000. Por, autoriteti kontraktues mund të refuzojë aksesin që parashikohet në akt nëse informacioni në dosjen e prokurimit është marrë nën

angazhimin e ruajtjes së natyrës konfidenciale të informacionit në mënyrë që dhënia e informacionit të mos përbëjë shkelje të konfidencialitetit dhe arsye për të ngritur padi nga tenderuesi përkatës, ose që dhënia e informacionit të dosjes së prokurimit të mos cenojë interesin tregtar të një personi tjetër. **Tarifat e gjyqit** paguhet nga pala që e çon çështjen në gjykatë. Tarifat rregullohen nga Urdhrat e tarifave, të nxjerra nga Lord Kancelari dhe jepen në rendin zbritës, në varësi së vlerës së kontratës objekt shqyrtimi Ato ndryshohen nga Urdhri i tarifave herë pas here. Nuk ka tarifa vetëm për t'u ankuar për një vendim prokurimi. Një palë që çon padi në Gjykatën e Lartë duhet ta financojë çështjen nga burimet e saj në shkallën e parë të gjykimit. Këtu përfshihen kostot e gjykatës dhe tarifat profesionale për juristët dhe ekspertët. Gjithsesi, palës që e humb procesin i duhet të mbulojë kostot e të dyja palëve pasi të jetë mbyllur çështja. Nuk ka afate kohore të detyrueshme për gjykatën për të dhënë **vendimin**. Koha që i duhet gjykatës për të nxjerrë vendimin varet nga kompleksiteti i çështjes nën shqyrtim dhe është shumë e ndryshme nga një çështje tek tjetra. Vendimet në Dhomën e Lordëve i bëhen publike palëve në përfundim të procesit, dhe më pas botohen për dekretim të mëtejshëm. Zakonisht vendimet u jepen përfaqësuesve të palëve në gjykatë. Pjesa më e madhe e vendimeve të Gjykatës së Lartë botohen në faqen e internetit të shërbimit të gjykatës në adresën (<http://www.hmcourts-service.gov.uk>). Shumë çështje botohen dhe në shtypin juridik.

24.5 *Kultura e rishikimit*

Gjyqtarët mund të kenë studiuar të drejtën e prokurimeve si pjesë të kurrikulës së tyre universitare dhe të trajnimeve profesionale, ose nëpërmjet seminareve të ofruara nga qeveria ose institucione të tjera publike dhe/ose private. Njohuritë praktike për funksionimin e politikës së prokurimeve sigurohen kryesisht nga informacioni i grumbulluar nga sektori publik dhe nëpërmjet eksperiencës. Qëndrimi i gjyqtarëve ndaj interesave të përfshira në çështjet e prokurimeve konsiderohet si tërësisht i pavarur dhe pa tendencë. Jurisprudenca e gjykatave më të larta është shumë e rëndësishme, pasi ekziston sistemi i precedentit ligjor që i bën vendimet e gjykatave të detyrueshme për gjykatat më të ulëta. Tenderuesit mund të njihen me praktika të prokurimeve publike nëpërmjet eksperiencës së tyre të punës, ose nëpërmjet organizatave profesionale. Nuk ka të dhëna empirike në lidhje me qëndrimin e tenderuesve për proceseve të rishikimit, por në përgjithësi Mbretëria e Bashkuar nuk ka kulturë tradicionale në kundërshtimin e tenderëve. Për më tepër, “Woods Review” (www.ogc.gov.uk/documents/woodreview.pdf) konstatoi se në përgjithësi tenderuesit e Mbretërisë së Madhe nuk janë të inkurajuar të kundërshtojnë procedurat kryesisht për shkak të pasojave të tyre negative për marrëdhëniet e biznesit dhe vështirësive për të provuar shkeljen. Në lidhje me oficerët kontraktues, ata kanë detyrën të veprojnë në përputhje me rregullat e prokurimeve publike dhe të veprojnë drejt dhe në mënyrë të arsyeshme bazuar në parimet e zakonshme të së drejtës publike. Çdo ankesë trajtohet në përputhje me këto rregulla e parime. Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për procedurat formale të rishikimit, sistemi efektiv i rishikimeve varet në nivelin e duhur të transparencës për vendimet e marra nga autoritete kontraktuese publike si dhe rruga e qartë për një tenderues të pakënaqur nëse dëshiron të ndjekë procesin e rishikimit. Ky sistem duhet të jetë i dukshëm për palët e interesuara dhe duhet të ketë themelet në një kuadër të qartë ligjor në lidhje me ndikimet e ligjeve/rregulloreve përkatëse dhe pasojave të një shkelje të rregullave. Në nivel më pak formal, zyrtarët e përfshirë në procedurat e rishikimit duhet të jenë të trajnuar për të vlerësuar nevojën për një dialog efektiv dhe të hapur me furnizuesit e ekuacionit blerës nëse prokurimet publike funksionojnë efektivisht ashtu siç do të ishte e dëshirueshme për të dyja palët. Një element kyç i këtij dialogu duhet të jetë hapja ndaj diskutimit me tenderuesit për sa i përket justifikimit të vendimeve të marra dhe ankesat e mundshme. Në nivelin akademik ka pasur interes në rritje në të drejtën e prokurimeve publike pas miratimit të Direktivave të KE-së për rishikimin. Gazeta juridike më e rëndësishme është “Public Procurement Law Review (PPLR)/Rishikimi i së Drejtës së Prokurimeve Publike”, e botuar nga Sweet & Maxwell. Konferencat akademike dhe profesionale zhvillohen rregullisht. Nuk ka një shoqatë kombëtare të prokurimeve publike, por ka një gamë të gjerë shoqatash industriale dhe tregtare që përfaqësojnë tek qeveria e Mbretërisë së Bashkuar interesat e anëtarëve të tyre në lidhje me respektimin e prokurimit publik. Këta aktorë mund të mbështesin anëtarët e tyre me këshilla në lidhje me rrethanat specifike. Ndërmjet tyre, më me influencë janë Konfederata e Industrisë Britanike dhe Federata e Bizneseve të Vogla. Trajnimit zyrtarë që synojnë kontraktimin e zyrave përfshihen në programin e Certifikatës së Kompetencës në Blerje dhe Furnizim, e zhvilluar nga Shkolla Kombëtare e Qeverisë dhe

Instituti i Certifikuar i Blerjeve dhe Furnizimeve. Ndikimi i vendimeve të GJED-së për proceset e brendshme është i madh, pasi këto vendime përbëjnë bazën kryesore të interpretimit ligjor të kryer nga gjykatat e Mbretërisë së Madhe. Për sa i përket nenit 226 të Traktatit të KE-së mosmarrëveshjet ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Komisionit European në lidhje me zbatimin e rregullave të prokurimeve të KE-së janë zgjidhur në fazën para-gjyqësore (rreth 15 çështje brenda katër viteve të fundit).